

Nr. 41
VITI 2020



UNIVERSITETI
"EQREMI CABEJ"
GJIROKASTËR

kërkime universitare

PERIODIK, "Shkenca Shoqërore, Ekonomike dhe të Edukimit"
JOURNAL, "Social, Economies and Education Sciences"

Gjirokastrë, Dhjetor 2020



**Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
Fakulteti Ekonomik**

Kërkime Universitare

Nr. 41

2020

**PERIODIK “Shkencat shoqërore, ekonomike dhe të edukimit”
JOURNAL “Social, Economics and Education Sciences”**

GJIROKASTËR, Dhjetor 2020

**BULETIN SHKENCOR I MIRATUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SPORTIT**

**Botim i Universitetit “Eqrem Çabej”
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
Fakulteti Ekonomik**

Drejtor:

Prof. dr. Bektash MEMA

Kordinator Administrativ

Dr. Lorenc KOÇIU

Bordi Editorial

Prof. dr. Gëzim RREDHI

Prof. dr. Shyqyri HYSI

Prof. dr. Lavdi HASANI

Prof. asoc. Valbona DURI

Prof. asoc. Jaho CANA

Prof. asoc. Selfo ORUÇI

Dr. Robert ÇELO

Dr. Eduina GUGA

Dr. Drita LUZO

Dr. Isidor KOKALARI

Dr. Romeo MANO

Korrektor letrar:

Prof. asoc. Spiridhulla POÇI

ISSN: 2226 – 082X

Pronë letrare e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër

Tel: 00355(0) 84 63408 / 00355(0) 84 66146

Tel. dhe Fax: 00355(0) 84 63776

PËRMBAJTJA

HISTORI DHE GJEOGRAFI

Arshela Arapi	Ecuria e marrdhënieve kulturore shqiptaro-franceze 1945-
Valentina Duka	1990.....6
Doris Malaj	Zhvillimi i demokracisë në Shqipëri25
Ermal H. Baze	Fillesat e përhapjes dhe të konsolidimit të bektashizmit në
Jaho Cana	viset shqiptare (gjysma e dytë e shek. XVII – Janar 1921).....34
Jaho Cana	Tezat e pleniumit partiak të Beratit.....42
Ermal H. Baze	
Lazarela	Rrethanat historike të lindjes së urdhrit europian të ndalimit
Ndoci	dhe rëndësia e tij në BE.....54
Valbona Duri	Marrëdhëniet Shqipëri-Kinë (1956-1978) nga aspekti
Bilal Draçi	ekonomik: ndihmat dhe kreditë kineze, sprovë për
Irena Boboli	kronologji dhe hartifikim.....73

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

Spiridhulla	Kontributi i prof. Kolec Topallit në fushën e fonetikës dhe
Poçi	gramatikës historike.....85
Almira Sadikaj	Dritëro Agolli, përfaqësues i letërsisë bashkëkohore
	shqipe.....93
Arqile V. Gjata	Musine Kokalari e vetmja poetë e shkrimtare femër e
	viteve 1935–1945.....105
Merita	“Dasma lunxhote”, ceremoniali që i ngre kult përtëritjes së
Gjokutaj	jetës.....123
Mimoza Zekaj	Vështrime të prof. Kolec Topallit për historinë e zanoreve
	hundore në gjuhën shqipe.....128

Merita Gjokutaj	Artistikja dhe e vërteta tek “Funerali i Hijës” së Odise Kotes.....137
Kostando Ksera Olieta Polo	Leksikografia greko – shqiptare dhe shqiptaro – greke në shërbim të përkthimit.....144
Entela Kore	Veçori të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në çamërishten e sotme.....159

SHKENCAT SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

Elona Toro	Modifikimi i procesit të të nxënës në një mjedis mësimor i cili përdor teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK)169
Jonida Leshaj	Shqyrtim sistematik literature mbi besimet e mësuesve në menaxhimin e klasës.....180
Eralda Zhilla Loreta Mamani	Të dhunshme apo të dhunuara? Analizë psikosociale e grave që kryejnë krime të dhunshme.....188
Arben Gaba	English and Albanian somatic idioms according to conceptual phraseological fields.....202

SHKENCAT EKONOMIKE DHE TURIZMI

Daniela Qiqi	Aspekte të burimeve njerëzore në sektorin turistik.....217
Belinda Xarba Etleva Peta Daniela Qiqi Zamira Veizi	Lidhja midis edukimit dhe mirëmenaxhimit të financave personale230

Agim Berisha	Ndikimi dhe efekti ekonomik i remitencave në Kosovë para dhe gjatë Pandemisë Covid 19.....	240
Aleksander Qiqi	Eventet sportive dhe impakti i tyre ekonomik.....	251
Daniela Qiqi		
Irena Boboli	Karakteristikat e udhëtimit dhe të sjelljes në destinacion të vizitorëve në zonën rurale të Gjirokastrës.....	267
Valbona Duri		
Drita Luzo		

SHKENCAT JURIDIKE

Leonard Sala	Vështrim historik mbi të drejtën penale zakonore shqiptare.....	279
Anxhelina Zhidro	Perspektivat e legjislacionit procedural penal shqiptar ne kuadrin e integritit ne bashkimin europian.....	298
Sokol Mëngjesi		
Leonard Sala	E drejta penale dhe kanuni i Lekë Dukagjinit.....	321
Fatjon Malaj		

ARSHELA ARAPI

Ministria e Punëve të Jashtme, Paris, Francë

VALENTINA DUKA

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës

ECURIA E MARRËDHËNIEVE KULTURORE SHQIPTARO-FRANCEZE 1945-1990

ABSTRACT

In the conditions of deep isolation of Albania in the Communist period, the Albanian government placed special importance on the relations with France. The reasons why France occupied a special place in the eyes of official Tirana were many. French politics, which was relatively independent, was considered a very positive element by the Albanian media, which was a reflection of the government. France, unlike other western countries, was not seen in Albania as an 'invading force', nor was it considered an imperialist country. The excellent French results in the scientific and technical field evoked a special respect and credibility in Albania. This was also the reason why France was selected to carry out the work of the Koman water turbines. The French language and culture occupied a special place among the leading class of the country. French medicine was also held in high prestige and then Albanian leaders received medical treatment in France. This paper aims to provide an overview of bilateral cultural relations between the Republic of Albania and France for the period 1945-1990.

Hyrje

Në kushtet e izolimit të thellë të Shqipërisë në Periudhën Komuniste, qeveria shqiptare i jepte një rëndësi shumë të veçantë marrëdhënieve me Francën. Të shumta ishin arsytet për të cilat Franca në sytë e Tiranës zyrtare zinte një vend të veçantë. Politika franceze e cila ishte relativisht independente konsiderohej si një element shumë pozitiv nga media shqiptare e cila ishte pasqyrë e qeverisë.

Franca nuk kishte njohur asnjë problem diplomatik me Shqipërinë sikurse kjo e fundit kishte me US-në dhe Britaninë e Madhe. Franca në kundërshtim me vende të tjera oksidentale nuk kishte në Shqipëri një të kaluar ‘zaptuesi’, si dhe nuk cilësohej si një vend imperialist.

Rezultatet e shkëlqyera franceze në fushën shkencore dhe teknike ndillnin një respekt dhe besueshmëri të veçantë në Shqipëri, arsyeja për të cilën Franca u përzgjedh për të kryer punimet e turbinave të Komanit. Gjuha dhe kultura franceze zinte një vend të veçantë në klasën udhëheqëse të vendit. Gjithashtu, edhe prestigji i mjekësisë franceze: udhëheqësit shqiptarë kuroheshin të gjithë në Francë.

Ndonëse pala franceze kishte hasur vështirësi me burokracinë dhe ftohtësinë e palës shqiptare, mund të thuhet se bilanci i këtyre marrëdhënieve ishte pozitiv. Franca zinte realisht vendin e parë e ndjekur nga Italia e konsideruar si partnere në bashkëpunimin shkencor, kulturor e teknik, duke marrë parasysh dhe pasojat tejet pozitive dhe direkte në ekonominë e vendit. Shpeshherë pala shqiptare kishte shprehur bindjen se këto marrëdhënie do të njihnin një progres akoma më të spikatur, nëse Franca do të rriste numrin e kontakteve në nivel të lartë, për arsye politike, por dhe psikologjike.

Ky punim ka si synim të japë një pasqyrë përmbledhëse të marrëdhënieve kulturore dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe asaj Franceze për periudhën 1945-1990.

Materiali dhe metoda

Një gjë e tillë është mundësuar nga vjelja e një materiali burimor arkivor. Kryesore janë materialet nga Arkivat e MPJ të Shqipërisë dhe i MPJ të shtetit francez.

Rezultate

Në periudhën e parë kohore që i përkiste viteve 1924-46-1949 u vu re se marrëdhëniet që kishte Shqipëria me Francën ishin në një farë mënyre të suksesshme. Franca gjithmonë e ftonte Shqipërinë në evenimente kulturore të organizuara në Paris, siç ishin panairët e ndryshme.

Arsimimit të rinjve shqiptarë iu dha një rëndësi e veçantë nga Franca. Kjo gjë u forcua edhe më tej nëpërmjet dhënies së bursave të rinjve shqiptarë për të studiuar në Francë.

Më 18 nëntor të vitit 1947 Presidenti i Komitetit Drejtues i "Fiore de Paris" i drejton Kryeministrit shqiptar një letër, ku e ftonte Shqipërinë të merrte pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Parisit që do të mbahej më 17 maj të vitit 1949. Vendi ynë në këtë panair pati mundësinë të paraqiste punimet e veta tradicionale, veshjet e veta, të cilat tregonin gjithnjë e më shumë për traditat dhe kulturën e shqiptarëve. Në 1947 Shqipëria mori pjesë në panairin e organizuar nga shoqata "La Pouponiere", ku çoi prodhime artizanale vendase dhe të ardhurat shkuan në favor të organizatave shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve.

Tashmë po i jepej një rëndësi më e madhe procedurave të integruara për të ndihmuar fëmijët në nevojë, familjet në pamundësi ekonomike apo personat që kanë nevojë për ndihmë mjekësore.

Në vitin 1948, u dërguan shumë studentë shqiptarë për studime universitare në Francë.

Franca ishte një shtet që filloi të përkrahte mjaft edukimin e popullatës së vendeve me të cilat ajo arriti që të krijonte marrëveshje. Tashmë filloi t'i kushtojë rëndësi edhe edukimit të

vendit tonë nëpërmjet ofrimit të bursave nga shteti francez.

Kjo ishte një lloj ndihme shumë e madhe për vendin tonë, i cili tashmë do të kishte persona të shkolluar në profesione të ndryshme, të cilët do të kontribuonin më tej në zhvillimin e Shqipërisë. Shqipëria tashmë ishte në hapat e parë drejt zhvillimit, ku edukimi do të ishte primar.

Personat që u dërguan me sisteme të plota burse përfituan falas të drejtën e shkollimit, tarifën, ushqimin dhe fjetjen.

Një çështje tjetër e rëndësishme që u vu re në vitin 1949, ishte në lidhje me njohjen e diplomës së farmacistëve, inxhinierëve, agronomëve dhe doktorëve veterinerë francezë.

Kjo kishte të bënte me një pengesë të vendosur tashmë nga vendi ynë, lidhur me njohjen e diplomave të këtyre mjekëve që do ta ushtronin tashmë profesionin e tyre në vendin tonë.

Në periudhën tjetër kohore që i përket viteve 1951-1958, u vu re që tashmë ishte rritur ndërgjegjësimi i bashkëpunimit midis këtyre dy vendeve, pra, kishte një fushë më të gjerë bashkëpunimi midis këtyre dy vendeve.

U krijua një shoqatë që kishte si synim organizimin e përbashkët për tematika të ndryshme në lidhje me artin dhe kulturën e të dy vendeve. I kushtohej një rëndësi organizimit të festivaleve të filmit në shtetin Francez, ku luante një rol të madh edhe pjesëmarrja e shtetit tonë me filmat që tregonin shumë për zakonet, traditat dhe kulturën shqiptare.

Materialet e botuara në gjuhën shqipe kishin një rëndësi të veçantë në lidhje me shpërndarjen e tyre nëpër libraritë e Francës. Gjithashtu, u realizuan ekspozita në Francë me materiale të dërguara nga Shqipëria, që tregonin një pjesë të historisë së Shqipërisë.

Më 1 nëntor të vitit 1952, qeveria shqiptare mori një ftesë për të marrë pjesë në festivalin e përvitshëm të filmit që do të bëhej në

datat 11-26 mars në Cannes (Francë).

Festivali i filmit në Cannes u hap në 25 mars, me pjesëmarrjen e 40 shteteve. Në mbrëmjen e datës 25 mars, u shfaq filmi amerikan "Furtuna nën detin". Në mbrëmjen e 26 marsit u shfaq filmi ynë "Skënderbeu", i cili është duartrokitur për më tepër se 10 herë. Filmi u lëvdua dhe për të shkruan më tepër se 40 gazeta. Kritika kryesore ishte se ishte i gjatë. Kur u shfaq filmi ynë, delegacioni Italian doli nga salla. Ata nuk donin që të dilnin në film kritikant e Venedikut.

Ambasada Turke kishte kërkuar në formë proteste që filmi "Skënderbeu" të mos shfaqej në festival për arsye se ishte kundër Turqisë, por kjo nuk u mor parasysh.

Çmimi që mori filmi ynë ishte "Prix international avec mention d'honneur le realisateur".

Më 18 qershor, shoqëria "Francë-Shqipëri" hapi ekspozitën mbi Shqipërinë. Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës. Kjo ekspozitë qëndroi e hapur për 2 ditë dhe u vizitua nga 500-600 vizitorë.

Aty u paraqitën shumë punime të cilat kishin si synim pasqyrimin e traditave dhe kulturës së vendit tonë. Kjo ekspozitë pati një sukses në transmetimin e idesë kryesore të saj.

Në vitin 1955, në Shqipëri kishte 6 institucione të larta arsimore, në po këtë vit dolën pedagogët e parë shqiptarë nga shkollat e larta jashtë vendit, të cilët filluan të jepnin mësim në universitetet shqiptare.

Franca ka dhënë mbështetje edhe më herët për arsimimin universitar të të rinjve shqiptarë.

Universitetet franceze kanë dhënë bursa universitare të plota me të gjitha të përfshira p.sh: ngrënien, fjetjen dhe koston e studimeve në tërësi. Përgjegjës për mësimdhënien e këtyre të rinjve në universitetet shqiptare do të ishin të arsimuarit e mëparshëm që

dolën nga universitetet franceze.

Në vitin 1958, Shqipëria ftohet të marrë pjesë në Olimpiadën e Dytë Ndërkombëtare të këngëve korale, që do të zhvillohej në datat 9-16 nëntor 1958.

Pra, mund të themi se në krahasim me periudhën e parë, në periudhën e dytë tashmë u shtuan ndërveprimet sociale dhe kulturore midis vendit tonë dhe Francës.

Në periudhën e tretë kohore që i përket viteve 1959-1962 u vu re që si Shqipëria, ashtu edhe Franca kanë qenë të hapura për bashkëpunime të përbashkëta. U realizuan shumë mbrëmje kulturore. Ato në vetvete kishin synime politike, por u vu re një bashkëpunim i mirë në lidhje me pjesën e artit dhe të kulturës, p.sh., Shqipëria pati mbështetje në lidhje me demonstrimin e materialeve të cilat tregonin më shumë për artin dhe kulturën e shtetit shqiptar.

U vu re që mediat në këtë periudhë nuk komentuan shumë mbi lidhjen midis dy shteteve, veçanërisht ato shqiptare. Mungonin artikujt për Shqipërinë. Një tjetër element mjaft i rëndësishëm në këtë periudhë ishte dhe dhënia e bursave nga shteti francez për studentët shqiptarë.

Nuk mungonin edhe specializimet për profesionistët e fushave të caktuara, p.sh., agronomët (duke qenë se Shqipëria ishte një vend kryesisht bujqësor).

Në vitin 1961 u realizuan shkëmbime turistësh mes Shqipërisë dhe Francës. U krijuan, kështu, mundësi të shumta për shkëmbime turistësh në mënyrë që të vizitonin vendin tonë, po ashtu edhe për shqiptarët u hapën rrugët për të vizituar Francën. Pati një numër të lartë të personave që donin të vizitonin Shqipërinë, tregues që gjatë gjithë kësaj kohe Shqipëria kishte tërhequr vëmendjen e francezëve dhe konsiderohej si një destinacion i bukur me vende mahnitëse për t'u parë.

Kjo i krijonte mundësi të tjera shtetit tonë, i cili tashmë po i

hapte rrugë bashkëveprimit kundrejt izolimit social që e kishte pushtuar, për të lidhur marrëveshje kulturore, ekonomike etj.

Në vitin 1961-1962 u realizuan shkëmbime kulturore mes dy vendeve.

-Universiteti Shtetëror i Tiranës do të presë nëpunës të shkencave nga Franca për të mbajtur leksione për 15 ditë.

-Universiteti i Lartë Bujqësor në Tiranë do të presë një specialist francez për të mbajtur leksione për vitikulturën për dy javë.

-Teatri i Operës dhe Baletit të Tiranës do të presë 4 artistë francezë për të ekzekutuar dhe dhënë koncerte për 10 deri në 35 ditë në Shqipëri.

-Komiteti shqiptar i kulturës fizike dhe sportit do të presë skuadrën përfaqësuese të futbollit francez prej 20 vetash për të bërë një ndeshje.

-Universiteti Shtetëror i Tiranës do të dërgojë në Francë një punonjës për kërkim arkivor në bibliotekë për të dhënat që ekzistojnë mbi vendin tonë.

-Teatri i Operës dhe Baletit në Francë do të dërgojë në Tiranë dy artistë të cilët do të ekzekutojnë në opera për të dhënë koncerte për 15 ditë.

Të dy palët do të përpiqen të shkëmbejnë në rrugë tregtare dhe jo- tregtare filma artistikë ose dokumentarë.

-Universiteti Shtetëror i Francës dhe Instituti i Lartë Bujqësor i Tiranës do të shkëmbejnë vepra shkencore.

-Bibliotekat Kombëtare të dy vendeve do të shkëmbejnë bibliografi dhe libra.

Në periudhën e katërt kohore që i përket viteve 1963-1966, marrëdhëniet kulturore ishin pak a shumë në të njëjtin nivel si në periudhat e mëparshme kohore.

Plani kulturor pati shumë arritje të mëdha. Më 25 mars të vitit 1963, shkuan në Paris dy historianë shqiptarë. Ata shkuan atje në bazë të planit kulturor për të studiuar arkivat franceze mbi historinë e Shqipërisë dhe të marrëdhënieve shqiptaro-franceze.

Ata do të mbanin edhe konferenca dhe do të qëndronin për 2 muaj.

Më 17-24 mars të vitit 1963, në bazë të planit kulturor, bëri një vizitë në Shqipëri profesori i literaturës franceze Frederik Delofre, i cili mbajti disa leksione mbi literaturën frënge.

Në 1965, u mendua të zhvillohej ekspozita e parë shqiptare në Francë. Kjo do ishte e një rëndësie të veçantë dhe do të përgatitej në ‘‘Muzeun e Njeriut’’.

Një tjetër element që iu kushtua rëndësi në 1965 ishte zhvillimi i turizmit.

Në fushën e arsimit, shkencës dhe teknikës:

-pala shqiptare do të dërgojë në Francë, në fillim të vitit universitar 1965, dy profesorë të nivelit të lartë për t’u specializuar në dhënien e mësimit të gjuhës dhe letërsisë franceze, duke parashikuar krijimin e katedrës së frëngjishtes pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës.

-pala shqiptare do të dërgojë në Francë, nga fundi i vitit 1965 ose fillimi i vitit 1966, dy profesorë për t’u njohur me organizimin e arsimit të lartë për një periudhë prej 2-4 javësh.

-pala shqiptare do të dërgojë në Francë në 1965, dy historianë të cilët do të mbajnë konferenca dhe do të bëjnë kërkime dhe studime në bibliotekat dhe arkivat franceze mbi historinë e Shqipërisë dhe të marrëdhënieve shqiptaro-franceze. Secili prej tyre do të qëndrojë nga tre muaj.

-pala shqiptare do të dërgojë në Francë në vitin 1965 dy gjeologë për shkëmbim eksperience në fushën e magnetizmit dhe të

problemeve të stratigrafisë, për një periudhë prej 3-4 javësh.

-pala franceze do të dërgojë në Shqipëri në vitin 1965 dy profesorë që të ndihmojnë në organizimin e katedrës së frëngjishtes pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe të japin aty mësim.

-pala franceze do të dërgojë në Shqipëri në 1965 një specialist të problemeve demografike dhe shoqërore i cili do të mbajë konferenca.

-pala franceze do të dërgojë në Shqipëri në 1966 dy arkeologë për t'u njohur me kërkimet dhe zbulimet arkeologjike në Shqipëri për një periudhë 3- javore.

-pala franceze do të dërgojë në Shqipëri një profesor specialist në mjekësi çdo vit.

Në periudhën tjetër kohore që i përket viteve 1967-1979, pati një ecuri pak a shumë të njëjtë me periudhat e tjera kohore.

Pati përpjekje dhe interesa nga shteti francez për të marrë më shumë informacione mbi vendin tonë nëpërmjet realizimit të një reportazhi lidhur me bukuritë e vendit tonë, duke u fokusuar edhe në aspektin historik.

Ashtu si në të gjitha periudhat e tjera kohore, edhe në këtë periudhë një çështjeje tjetër që iu kushtua rëndësi ishte çështja e arsimimit. Kështu, gjatë vitit 1973, vajtën me studime në Francë 15 studentë shqiptarë që ndiqnin mësimet për gjuhë - letërsi franceze dhe dy studentë për metalurgji.

Për të ndjekur studimet pasuniversitare dy- dhe trevjeçare shkuan dy mësues të gjuhës frënge, 7 për degë të ndryshme të shkencave dhe dy linguistë për një kurs dyvjeçar mbi estrukologji dhe epigrafi. Gjatë gjithë vitit 1973, erdhën 33 kuadro të ndryshëm: mjekë, inxhinierë, veterinerë.

Nga pala franceze janë dërguar në Shqipëri gjatë vitit 1973 dy profesorë të gjuhës frënge. Në periudhën tjetër kohore që i përket

viteve 1980-1986 marrëdhëniet e vendit tonë me Francën kanë qenë pak a shumë në të njëjtën linjë si në vitet e kaluara. Shkëmbimet në fushën e kulturës janë zhvilluar mbi bazë të programit të shkëmbimeve kulturore që ekzistonte mes dy vendeve.

Në përgjithësi, pala franceze është treguar korrekte në zbatimin e këtij programi. Në këtë kuadër janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme në Francë, si ditët e filmit shqiptar, kolokuiumi mbi letërsinë shqipe, botimi i një antologjie mbi prozën shqiptare në Francë etj.

Të dy palët ranë dakord të inkurajonin importimin në rrugë tregtare dhe shitjen e librave dhe periodikëve të botuara në secilin nga të dy vendet. Ato favorizonin shkëmbimin e librave artistike dhe dokumentarëve në rrugë tregtare. Po ashtu inkurajonin shkëmbimin e emisioneve radiofonike dhe televizive që përfshinin material të shkruar, shirita magnetofoni, disqe të muzikës klasike, folklorike ose popullore dhe filma për fëmijë dhe me karakter tekniko-shkencor. Një vend të veçantë në marrëdhëniet kulturore ndërmjet dy vendeve zinte edhe shkrimtari i njohur shqiptar Ismail Kadare. Në Francë ishin botuar shumë prej librave të autorit dhe diskutohej për xhirimin e filmit ‘Gjenerali i ushtrisë së vdekur’¹; ²

Gjithashtu, mbi romanin e Kadaresë “Kronikë në Gur” janë shkruar disa artikuj në gazetat e mëdha “Le Monde”, “Le Figaro”, si dhe në gazeta me më pak rëndësi.

Gjithashtu, si një arritje domethënëse vlerësohej botimi i veprave të shkrimtarëve shqiptarë. Midis tyre mund të përmendet shtëpia botuese « Osvold » në Paris, e cila kishte botuar kohët e fundit librin me titull “I. Kadareja dhe poezia e re shqiptare”, të përkthyer nga francezi Mishel Mete. Ky vëllim prej 200 faqesh përfshin poezi të I. Kadaresë, D. Agollit, F. Arapit dhe N. Lakos. Për më tepër pala franceze kishte rënë dakord të dërgonte specialistë në Shqipëri për

¹ AMPJ, viti 1973, dos. 348, fl. 103-114

² AMPJ, viti 1984, dos. 581, fl. 38-39

studime shkencore dhe shkëmbim eksperience. Studiuesit do të vinin për të studiuar historinë e lashtë të vendit tonë dhe një fushë tjetër ishte edhe për studimet mbi zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

Brenda dy viteve të fundit katër shtëpi botuese franceze, ku mund të përmendim Albin Michel, Seuil, Maspero dhe Hachette kanë botuar këto vepra shqiptare ose mbi Shqipërinë : “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Kadaresë, “L’Albanie” e Zakhos, “Face au révisionnisme” e Enver Hoxha dhe “Les Tambours de la Pluie” e Kadaresë.

Janë në përpunim për t’u botuar “Historia e Skënderbeut” nga autorë shqiptarë, “Lufta e partizaneve shqiptare” nga D.Eudi, « Lufta e PPSH-së kundër revizionizmit » nga P.Kessel dhe “Kronikë në gur” e Ismail Kadaresë. Këtyre u duhet shtuar shitja e botimeve shqiptare në një numër librash dhe qytetesh të tjera në Francë.

Në lidhje me xhirimin e filmit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” shkrimtari Ismail Kadare ka marrë një letër prej firmës kinematografike franceze “Films66”, e cila po përgatit realizimin filmik të tij, ku i kërkohet që ai të shkojë në Francë për të parë edhe një herë skenarin e filmit.

Në këtë kuadër kineastët franceze erdhën në Shqipëri për të diskutuar me autorin e romanit skenarin e përgatitur prej tyre. Ky diskutim është një kërkesë e kontratës, bërë me qëllim që pa u angazhuar në bashkautorësi me kineastët e huaj, qeveria shqiptare të kishte një kontroll mbi veprën.

Për të pasur mundësi që skenari të shqyrtohej sa më me kujdes, u kërkua prej autorit një shtyrje e afatit të diskutimit, kështu që kineastët francezë u larguan, pa i marrë vërejtjet e palës shqiptare. Ndërkaq u krijua një grup pune i përbërë nga Anastas Kondo, Javer Malo, Vangjush Zallëmi, Viktor Gjika dhe autori i romanit Ismail Kadare.

Grupi i punës pasi e shqyrtoi skenarin me kujdes formuloi vërejtjet dhe sugjerimet, të cilat autori ua dërgoi me shkrim kineastëve të huaj. Këto konsistonin në:

1) Vërejtje konkrete, kryesisht episode, pasazhe ose sekuenca që duhej të hiqeshin ose të zëvendësoheshin, sepse nuk ishin konform librit.

2) Sugjerime për dy çështje: së pari, nxjerrja në pah e luftës së popullit tonë; së dyti, pozicioni sa më i mirë i Shqipërisë sot në botë.

Ndërsa vërejtjet ishin tepër precize, sepse tregoheshin konkretisht në tekst, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sugjerimet, të cilat do të realizoheshin me anë të shtesave dhe që ishin dëshirat tona që filmi të dilte sa më i favorshëm për vendin tonë dhe luftën e popullit tonë. Këtu duhet theksuar se, përsa i përket sugjerimeve, realizimi i tyre varet kryesisht nga mirëkuptimi i kineastëve francezë.

Veç kësaj, duke qenë se kemi të bëjmë me kineastë të huaj, për të cilët kuptimi i luftës e heroizmit është i ndryshëm nga yni, kuptohet se transmetimi i këtyre sugjerimeve ishte i vështirë të bëhej me sukses me korrespondencë.

Në 6 maj 1980, kineastët francezë i dërguan një letër autorit ku i njoftojnë se morën vërejtjet e tij, me të cilat janë, pothuajse, krejtësisht dakord. Po në këtë letër ata kërkojnë që pas 15 gushtit autori të shkojë në Francë për të parë edhe një herë bashkë me tre skenaristët e “Films 66” skenarin e filmit.

Kërkesa e bërë prej kineastëve francezë ishte e favorshme për palën shqiptare, sepse i jepte mundësi përmirësimit të skenarit dhe, sidomos, shpjegimit gojariht të sugjerimeve që kanë të bëjnë me evidentimin e luftës së popullit tonë dhe me pozitën e Shqipërisë sot në botë, dy mungesat kryesore të skenarit.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh se me këtë kërkesë kineastët

francezë e shlyejnë detyrimin e tyre ndaj autorit të veprës, ndaj është e nevojshme të përfitohet prej këtij rasti të fundit që shkrimtari Ismail Kadare të kryejë këtë shërbim jashtë shtetit në kohën që kërkohet.

Pas përkthimit dhe botimit në Francë të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” të shkrimtarit të njohur Ismail Kadare, në fillimin e viteve 1970, libër i cili pati një jehonë të madhe dhe u prit mjaft mirë, jo vetëm në qarqet frankofone, por edhe më gjerë, romani zgjoi kureshtje dhe interes të madh edhe te një pjesë e kineastëve e producentëve francezë³. Këta të fundit rendën të krijonin kontaktet e para me stafin e ambasadës shqiptare në Paris, përfaqësues të shtetit shqiptar si dhe me vetë autorin e romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, shkrimtarin Ismail Kadare, me qëllim ekranizimin e tij. Dhe pas shumë kontaktesh e takimesh, përfaqësuesit e shoqërisë filmike franceze “WOHORDUN”, në mesin e viteve ’70, arritën që të lidhnin edhe kontratat përkatëse për realizimin e filmit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, me përfaqësuesit e palës shqiptare dhe vetë autorin e skenarit, Kadarenë, gjë që duhet thënë se kaloi nëpërmjet një “filtri të hollë” të palës shqiptare, nisur nga skenari që iu pa Kadaresë me “lupë” nga autoritetet “kompetente” në Tiranë, e mjaft aspekte të tjera të kësaj natyre⁴. Gjithsesi, duhet thënë se ajo gjë, pra, fakti se francezët po ekranizonin një vepër të një shkrimtari shqiptar, u quajt “një arritje e madhe” nga Tirana zyrtare, ashtu siç dhe ishte në të vërtetë. Dhe në këtë kuadër, pala shqiptare u impenjua plotësisht për realizimin e kontratës me shoqërinë filmike franceze “WOHORDUN” dhe vetë shkrimtari Ismail Kadare u lejua që të shkonte disa herë në Francë për këtë problem. Por, me gjithë impenjimin dhe seriozitetin e palës shqiptare, për arsye ende të pasqaruara, shoqëria filmike franceze po e zvarriste gjithnjë e më shumë realizimin e filmit, aq sa e detyroi palën shqiptare që jo vetëm të hiqte dorë nga bashkëpunimi me ta,

³ <http://www.gsh.al/2017/07/31>

⁴ AMPJ, viti 1982, dos. 604, fl. 4

por edhe ta prishte kontratën dhe ta hidhte në gjyq shoqërinë filmike franceze. Dhe për këtë gjë ajo angazhoi gjithë stafin e ambasadës sonë në Paris, juristë dhe diplomatë të ndryshëm nga Ministria e Jashtme në Tiranë për ndjekjen e problemit në fjalë. Po kështu, për ta përfaqësuar në gjyq, ajo pajtoi avokatin e njohur francez George Kijeman, me të cilin lidhi edhe një protokoll marrëveshjeje. Ndërkohë që ende vazhdonin bisedimet dhe seancat gjyqësore, në fundin e viteve '70, për realizimin e filmit u vetofrua një tjetër shoqëri filmike franceze ("FILMSS 66"), me në krye aktorin e njohur Michel Piccoli.

Pas disa përpjekjesh, Tirana zyrtare pranoi t'ia besonte Piccoli-së "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur" dhe si rezultat u lidhën menjëherë kontratat përkatëse. Po kështu, me urdhër e porosi nga "Iart", u vunë në dispozicion disa ministri e institucione, si Ministria e Jashtme, e Financave, e Arsimit e Kulturës, e Mbrojtjes, e Punëve të Brendshme, Albturizmi, Kinostudioja "Shqipëria e Re", Lidhja e Shkrimtarëve, Komiteti për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme etj., etj., pra, me pak fjalë i gjithë shteti shqiptar, për të realizuar gjithçka që kërkonin francezët. Por diku nga fillimi i vitit 1982 (pak ditë pas ngjarjes së datës 18 dhjetor 1981, me kryeministrin Mehmet Shehu, që u gjet i vrarë nga plumba pistolette në dhomën e tij të gjumit), ngjarjet morën tjetër rrugë nga sa ishte parashikuar⁵. Papritur, si me magji, u ndërruan rolet. Tashmë ishte pala shqiptare që po e zvarriste gjithnjë e më shumë realizmin e "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur", duke nxjerrë pretekste dhe pretendime nga më të ndryshmet.

Aq sa në gushtin e vitit 1982, (teksa vazhdonte procesi hetimor ndaj të ashtuquajturit 'Grupi armiqësor i Mehmet Shehut e Kadri Hazbiut'), zëvendësministri i Punëve të Jashtme në Tiranë, Sokrat Plaka, me anë të një telegrami shifër "Tepër sekret", njoftonte ambasadat shqiptare në Paris, Romë, Beograd e Athinë, që në

⁵ AMPJ, viti 1982, dos. 604, fl. 5.

mënyrë kategorike të mos i pajisnin me vizë hyrëse për në Shqipëri Michel Piccoli-n dhe ekipin realizues të “Gjeneralit të ushtrisë së vdekur”⁶.

Me studimin e veprës së Kadaresë janë marrë autorë të shteteve të ndryshme të cilët kanë botuar vepra dhe studime për të në gjuhët e tyre amtare: Eric Faye dhe Jean-Paul Champseix (frëngjisht), Piet de Moor (hollandisht), Peter Morgan, Jose Carlos Rodrigo Breto⁷.

Në vitin 1984, Ambasada Shqiptare në Paris nëpërmjet një radiogrami u njoftua se gazeta “La Liberation” kishte kërkuar nga ana e Ismail Kadaresë të dërgohej një shkrim 2-3 faqesh lidhur me Evropën, si shikohet ajo nga vendi ynë.

Në notën verbale të Ambasadës Franceze në janar të vitit 1986, theksohej se « *aktivitetet me karakter kulturor kanë marrë një kthesë shumë pozitive që prej viteve 70, ato janë zhvilluar në kuadrin e programeve bilaterale, ku ai i ardhshëm do të nënshkruhet në pranverën e vitit 1986 në Paris. Ky program do të konkretizohet me ardhjen e 60 studentëve shqiptarë me bursa në Francë, formacione shkencore, prania e dy lektorëve francezë pranë Universitetit të Tiranës, dhurim librash, filmash, materialesh pedagogjike dhe organizim eventesh kulturore. Në këtë kuadër është hapur në 1984, një ekspozitë shumë e rëndësishme e arteve plastike shqiptare, është parashikuar një turne i orkestrës së radio televizionit shqiptar në Francë, më 1986. Vlen për t’u përmendur dhe një kontigjent prej 15 bursa suplementare për të formuar informaticienë shqiptarë »⁸.*

Në planaksionin e Ambasadës Franceze në Shqipëri⁹, të vitit 1986, përmendej se dy lektorë francezë punojnë tashmë në Universitetin e Tiranës dhe një atashë kulturor është në dispozicion

⁶ AMPJ, viti 1982, dos. 604, fl. 7.

⁷ https://sq.wikipedia.org/wiki/Ismail_Kadare

⁸ Notë Verbale N°43/eu, 17 janar, 1986

⁹ Planaksioni i Ambasadës Franceze në Shqipëri, 17 shkurt, 1986

pranë ambasadës.

- Më 4 dhjetor 1986, u organizua në Paris java e kinemasë shqiptare si përgjigje reciprociteti e javës së kinemasë franceze në Tiranë (korrik 1986).

- Kolokuiumi i organizuar nga autoritetet franko-shqiptare në kolegjin e Francës në Paris më datë 26 prill 1986, mbi veprat e Enver Hoxhës. Nje kolokuium letrar franko - shqiptar është organizuar në Tiranë 12-18 qershor 1986.

- U zhvillua me sukses java e librit teknik francez në Tiranë në prill 1987.

- Një ekip futbolli i federatës franceze ka shkuar në Tiranë nga 26 qershor deri në 1 korrik 1987.

- Ndër të tjera përmendim se një Komision i përbashkët kulturor franko-shqiptar është mbledhur në Tiranë më 25-27 qershor 1987 (Ambasada franceze në Shqipëri në 17 shkurt 1986).

- Më 21 shtator të vitit 1986 u hap në Lyon Kongresi XI Ndërkombëtar i Arkeologjisë Mesjetare. Ai u mbajt për 4 ditë.

Morën pjesë 500 studiues, ku përfshiheshin edhe studentët stazhierë, nga 26 shtete te ndryshme kryesisht evropiane. Nga studiuesit shqiptarë u mbajt një referat “Gjendja aktuale e kërkimeve mbi origjinën e qyteteve mesjetare në Shqipëri”. Gazeta “Figaro” e datës 11 dhjetor të vitit 1986 botoi lidhur me vizitën e shokut Sokrat Plaka në Francë, shkrimin me titull: “Shqipëria, mineral për Francën”.

Marrëdhëniet kulturore gjatë periudhës 1989-1990 zhvillohen në një kontekst të privilegjuar. Shumica e elitave udhëheqëse është fankofone, 30% e studentëve shqiptare mësojnë frëngjishten si gjuhë të huaj dhe sipas vlerësimeve tona, 10% e popullsisë (rreth 300 000 banorë e kanë studiuar).

Franca ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe sajë tyre ajo luan

një rol mjaft të rëndësishëm të planit të parë në fushën e kulturës në Shqipëri. Buxheti global i investimit të Francës në fushën e kulturës prek shumë e 3.3 milionë frangave në 1986 (nga këto 1.87MF në fushën e kooperimit shkencor dhe teknik) dhe prej 4.4MF në 1987 (ku 2.5MF është buxheti i bashkëpunimit shkencor dhe teknik). Konstatohet një rritje e konsiderueshme.

Lidhur me marrëdhëniet kulturore, shkencore dhe teknike pala franceze vlerësoje që këto marrëdhënie ishin në nivele të kënaqshme. Franca ka qenë donatori kryesor i bursave të studimit, 106 bursa studentësh në universitete. Gjuha frënge zë një vend të veçantë në Shqipëri falë marrëdhënieve të privileguara mes dy vendeve¹⁰.

Në këtë kuadër qeveria shqiptare « dëshiron që lektorët francezë të kenë kompetencën dhe lejen e Ambasadës Franceze për të dhënë mësim në Liceun e gjuhëve të huaja në Tiranë. Qeveria shqiptare ka kërkuar formimin e 4 përkthyesve shqiptarë, 2 stazhe perfeksionimi të profesorëve të Liceut të gjuhëve të huaja. Kuptohet që Franca do të japë pëlqimin e saj për të gjitha kërkesat e palës shqiptare. Një vizitë e studentëve të INALCO të Parisit do të zhvillohet në Tiranë, kjo iniciativë vjen pas ftesës së z. Malile MPJ, gjatë vizitës së tij në Paris¹¹ ».

Në një korrespondencë të drejtorisë së Evropës, drejtuar kabinetit të ministrit të Punëve të Jashtme franceze¹², niveli i marrëdhënieve kulturore vlerësohej i shkëlqyer. Përpjekjet e palës franceze lidhur me bashkëpunimin kulturor me Shqipërinë janë shumë të rëndësishme, 110 studentë me bursa ndjekin studimet e larta në Francë, më së shumti në disiplina shkencore. Marrëveshja kulturore e nënshkruar në shkurt të 1988 gjatë vizitës së M. Bariani i dha një bazë të re juridike këtyre marrëdhënieve. Vendi i gjuhës frënge në

¹⁰ Valbona Nathanail, Ambasadorët tanë, Vëllimi I (2014).

¹¹ AMPJ Franceze, Note Verbale 3 korrik, 1990.

¹² Instruksione AMPJ Franceze 10 prill, 1989.

mësimdhënie është shumë i lartë (300 000 nxënës dhe studentë frëngjishtfolës) si dhe elitat frankofone.

Konkluzion

Historia e marrëdhënieve kulturore mes Shqipërisë dhe Francës është e gjatë, interesante dhe e bukur. Ato janë marrëdhënie të hershme që themelet i kanë me praninë në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore të trupave të Ushtrisë Franceze të Lindjes të gjeneralit Sarraill, të cilat lanë pas tyre liceun e famshëm francez, djepin e elitave drejtuese dhe intelektuale të vendit, për të mbërritur në kohët moderne me një prani reciproke franceze në Shqipëri dhe shqiptare në Francë, prani kjo politike, ekonomike, tregtare, universitare dhe gjuhësore, e cila falë përpjekjeve të jashtëzakonshme dhe të respektueshme të të gjithë shqiptarëve dhe francezëve që bartin stafetën e këtyre marrëdhënieve dhe të kësaj miqësie, vazhdon të jetojë dhe të zhvillohet sot e kësaj dite. Shqipëria është, gjithashtu, fatmirësisht, një vend anëtar i Frankofonisë dhe kjo jo thjesht në letra, por duke qenë shumë aktive. Kjo është gjithashtu dëshmi e një dashurie të sinqertë për Francën që vazhdon të jetë e gjallë te shqiptarët e ditëve tona.

Bibliografia

AMPJ, viti 1973, dos. 348.

AMPJ, viti 1984, dos. 581.

AMPJ, viti 1982, dos. 604.

AMPJ, viti 1982, dos. 604.

AMPJ, viti 1982, dos. 604.

<http://www.gsh.al/2017/07/31>.

Instruksione AMPJ Franceze 10 prill 1989.

Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria Financ Revizion Tiranë, më 15.5.1982 Nr.2286 Prot.

Notë Verbale N°43/eu 17 janar 1986.

Notë Verbale, 3 korrik, 1990.

Planaksioni i Ambasadës franceze në Shqipëri në 17 shkurt 1986.

Valbona Nathanail, Ambasadorët tanë, Vëllimi I (2014).

DORIS MALAJ

Instituti i Studimeve Europiane

Universiteti i Tiranës

ZHVILLIMI I DEMOKRACISË NË SHQIPËRI

ABSTRACT

The transformation of the Albanian political system into a democratic one, restored the importance of the development of democratic principles to the political scene. Nevertheless, it remains to be noted that the evolution of democratic principles in Albania is not a phenomenon of the last 25 years. Undoubtedly, the real face of the features of liberal democracy and its constituent elements appear best during the democratic transition of the country, but that does not mean that democratic principles did not exist before. Rather, on the basis of a genuine study aimed at analyzing the developments of the democratization process in Albania, I conclude that this country has experienced three phases during which democratic principles have evolved. Beginning with the first wave of democratization in the period of the establishment of the Albanian state to move on to the 1920-1924, during which a series of elements, that are still characterized as essential for democratic systems, evolved and lastly the political changes of the '90s when political pluralism, peaceful rotation of power, constitutionalism, the development of market economy and other elements, closely related to the evolution of democratic principles in Albania, underwent a fundamental change and adapted to the concept of liberal democracy.

Key words: *liberal democracy, democratic evolution, democratic principles, democratic elements*

Lindja e parimeve demokratike

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, në 1912 u hodhën themelet e shtetit shqiptar. Ishte pikërisht akti i pavarësisë, kushti politik që mund të konsiderohet si premisa e parë dhe themelore për zhvillimin e demokratizimit të vendit. Pak ditë pas shpalljes së pavarësisë, “Kuvendi i Vlorës zgjodhi edhe Pleqësinë” (Duka 2007:24). Një element tepër i rëndësishëm për demokracinë e asaj kohe, ishte ky organ institucional i cili përbëhej nga 18 anëtarë dhe luante rolin e pushtetit legjislativ, ku vendimet merreshin në mënyrë demokratike me shumicë votash. Edhe pse ishte një institucion tepër i brishtë, tregonte se po zhvilloheshin parimet e para të demokracisë shqiptare dhe se qeveria, e porsakrijuar, mbarte në vevete frymën demokratike.

Qeveria e parë shqiptare u vetidentifikua si një qeveri sovraane në arenën ndërkombëtare, e cila njëkohësisht përfaqësonte vullnetin e popullit shqiptar brenda territorit, ashtu siç e bënte edhe në arenën ndërkombëtare, si në rastin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, për caktimin definitiv të kufijve të Shqipërisë pas Luftës Ballkanike. Mbetet për t’u shtuar se, në parim, qeveria shqiptare në mënyrë formale zgjodhi si formë qeverisjeje atë të një monarkie kushtetuese. Megjithatë elementet përbërëse të kësaj forme qeverisjeje mund të konsiderohen si inekzistente, kjo ishte një zgjedhje fiktive, e cila vlente si një lloj përpjekjeje për të krijuar përshtypjen e një orientimi perëndimor.

Duhet theksuar se Shqipëria demokratike nuk arriti të përmbushte të gjitha pritshmëritë për adaptimin e parimeve demokratike të Evropës Perëndimore në realitetin shqiptar. Përveç arritjeve të sipërpërmendura, të cilat, me patjetër, mbeten për t’u vlerësuar, nuk pati evoluim të parimeve të tjera demokratike. Edhe pse në këtë periudhë u shfaqën disa parime, të cilat përkufizohen si demokratike, të shfaqura në këtë formë ato ishin jashtëzakonisht të zbehta në realitetin e vendit tonë. Qeveria e parë shqiptare e periudhës së Pavarësisë e kishte të pamundur të shtynte më tej arritjet e saj. Krizat që shoqëruan qeverinë e Vlorës, e ngadalësuan

tepër procesin e krijimit të një identiteti demokratik të brendshëm, pasi ndërmarrja e hapave të tjera që do të mundësonin zhvillimin demokratik të vendit, ishte, pothuajse, e pamundur. Në tërësinë e tyre, këto zhvillime përbëjnë valën e parë të procesit të demokratizimit të Shqipërisë. Fazë kjo e cila, edhe pse kishte parime demokratike tepër të brishta, do të kishte një rëndësi të madhe, sepse, pikërisht, këtu kemi fillesat e parimeve demokratike në Shqipëri që do të evoluonin në vazhdim.

Demokracia e zbehtë e viteve 1920-1924

Një realitet i ri politik u krijua me përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Shqipëria u shndërrua, nga një shesh lufte dhe arenë përleshjeje e fuqive të huaja gjatë luftës, në një shtet që si synime kryesore kishte rifitimin e statusit të pavarësisë dhe njëkohësisht zhvillimin e institucioneve politike dhe demokratike. Ndryshimet reale ndodhën në vitin 1920 “kur vendi u çlirua nga pushtimet dhe jeta politike fitoi dimensionet e humbura të viteve të Pavarësisë. “(...) u krijua qeveria e re, u ngritën institucionet e para demokratike dhe u larguan të gjitha ushtritë e huaja nga vendi” (Krasniqi 2006: 44). Pa dyshim që, si derivat i këtyre ndryshimeve, u krijuan edhe mundësitë reale për të formuar institucione demokratike dhe parti politike, të cilat, domosdoshmërisht, do të nxisnin edhe zhvillimin e zgjedhjeve të para demokratike në Shqipëri.

Momenti kyç, i cili përcaktoi tërësinë e zhvillimeve demokratike në Shqipërinë e viteve 1920-1924 ishte Kongresi i Lushnjës i mbajtur në janar 1920, pasi ishte, pikërisht, ai vendi ku u vendos që të afirmohej statusi i Pavarësisë së Shqipërisë si dhe të mbrohej tërësia tokësore si kundërpërgjigje ndaj planeve për copëtimin e Shqipërisë të Konferencës për Paqe në Paris në 1919. Duhet theksuar se, në këtë fazë, një hap shumë të rëndësishëm drejt demokratizimit të vendit përbënte formimi i qeverisë shqiptare me në krye Sulejman Delvinën dhe, pa diskutim, edhe formimi i Këshillit Kombëtar, i cili luante rolin e një organi legjislativ që mbarte kompetencat dhe kryente funksionet e parlamentit deri në momentin që do të zhvilloheshin zgjedhje të lira në vitin 1921. Megjithatë anëtarët e Këshillit Kombëtar nuk ishin të zgjedhur nga elektorati, por të emëruar, ky institucion mund të konsiderohet si shembulli i parë i jetës parlamentare në Shqipëri.

Një tjetër aspekt që dëshmon mbarëvajtjen e evoluimit të parimeve demokratike në Shqipëri, është përcaktimi i formës së regjimit. Shqipëria do të ishte një monarki kushtetuese, edhe pse deri në zgjedhjen e Asamblesë Kushtetuese, në krye të vendit do të vepronte Këshilli i Lartë, i cili përbëhej nga katër anëtarë që përfaqësonin komunitete fetare. Ishte pikërisht ky institucion që luante rolin e pushtetit ekzekutiv. Pas përcaktimit të pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, mbeti pas përkufizimi i pushtetit juridik, por shpejt u vendos që baza juridike do të ishte Statuti i Lushnjës. Gjashtë nenet e tij do të rregullonin mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e institucioneve qeverisëse. Ambienti politik i viteve 1920 – 1924 ishte i larmishëm dhe nxiti akoma më tej zhvillimin e demokracisë. Një sërë precedentësh që vërtetonin evoluimin e demokracisë, e shënuan këtë periudhë. Këtu vlen për t'u përmendur “dorëheqja e kryeministrit Sulejman Delvina, që erdhi si pasojë e një lufte të brendshme politike” (Duka 2007: 128).

Në këtë periudhë, dolën në pah karakteristikat e opozitës shqiptare që ofronin një alternativë ndryshe nga ajo e qeverisë. Si pasojë, qeveria e Sulejman Delvinës dha dorëheqjen duke shënuar kështu një rast unik edhe për zhvillimet e mëvonshme politike të Shqipërisë, ku një qeveri largohet në mënyrë paqësore dhe demokratike, pasi kishte humbur shumicën qeverisëse në Këshillin Kombëtar. Avancim të mëtejshëm pati procesi i demokratizimit, pa dyshim, edhe nga krijimi i partive politike. Ekzistenca e tyre dëshmonte vullnetin e mirë të klasës politike shqiptare për një demokraci parlamentare, të ngjashme me vendet e Evropës Perëndimore. Grupimet politike po bëheshin gati për të garuar në zgjedhjet e para në historinë e Shqipërisë, për një post në Këshillin Kombëtar. Dy parti politike, Partia Popullore dhe Partia Përparimtare, do të merrnin pjesë në zgjedhje duke i premtuar elektoratit që do të respektonin parimin e lirisë së fjalës, të shtypit dhe besimit. Partia Popullore shqetësohej për një zhvillim liberal të vendit dukë kërkuar edhe mbështetjen e grupimeve të ndryshme shoqërore.

Partia Përparimtare, ndryshe nga Partia Popullore, interesohet kryesisht të përkrahej nga shtresa e lartë e shoqërisë së kohës. Në tërësinë e tij, programi i kësaj partie përmbante premtime me tendencë konservatore, duke e vënë fokusin kryesor te zhvillimi

ekonomik i vendit. Krijimi i këtyre partive ishte një zhvillim i jashtëzakonshëm për Shqipërinë, dhe pse mbetet për t'u verifikuar nëse këto parti i përmbushnin vërtet të gjitha kriteret për t'u karakterizuar si një e tillë.

Zhvillimi i zgjedhjeve të para është po ashtu pjesë e kësaj vale demokratizimi dhe mund të konsiderohet si elementi më i rëndësishëm i fazës së dytë. Këto zgjedhje do të përbënin eksperiencën e parë elektorale në zhvillimet demokratike në Shqipëri. Zgjedhjet nuk u zbatuan pas një kodi elektoral, por gjithsesi disa rregulla parimore u vendosën për të garantuar mbarëvajtjen e eksperiencës së parë elektorale. Pa dyshim, që mungesa e eksperiencës u vu re edhe në këtë proces elektoral, pasi shkaktoj edhe probleme gjatë zhvillimit të zgjedhjeve por, gjithsesi, nuk duhet mohuar se ato kishin vlerë të madhe në evoluimin e standardeve demokratike në Shqipëri. Rezultati i këtij procesi elektoral ishte një “parlament legjitim dhe i zgjedhur në mënyrë demokratike” (Krasniqi 2006: 5).

Procesi paszgjedhor në vend që të përcillte qëndrueshmëri politike, solli krejt të kundërtën. Paqëndrueshmëria dhe krizat qeveritare ishin kryefjala e zhvillimeve politike të kësaj periudhe. Në 1922 Ahmet Zogu u bë kryeministri i Shqipërisë dhe “qeverisi me dorë të fortë” (Puto 2009: 335). Zgjedhjet për formimin e Asamblesë Kushtetuese që do të përcaktonte edhe formën e regjimit, do të mbaheshin në 17 dhjetor 1923. Në këtë klimë mjaft të tensionuar politike rezultati ishte një proces elektoral i karakterizuar nga manipulime të shumta, i polarizuar, defektoz dhe i kontestuar. Fitorja e bllokut qeveritar të Zogut i precipitoi më tepër ngjarjet. Rivali i tij Fan Noli i kundërshtoi këto zgjedhje dhe në këtë situatë mjaft të tensionuar, ku pakënaqësitë ishin në rritje të vazhdueshme, u zhvillua në qershor, 1924, ai që njihet në histori si Revolucioni i Qershorit.

Si përfundim mund të themi se Shqipëria e asaj kohe karakterizohej nga “një jetë parlamentare të brishtë, të trazuar dhe me kufizimet që impononte mungesa e përvojës në qeverisje” (Puto 2009: 44). Evoluimi i parimeve demokratike, fryma përëndimore dhe zhvillimet politiko-juridike të shfaqura gjatë këtyre viteve ishin tepër përparimtare për realitetin politik të Shqipërisë dhe bënë që

kjo valë e dytë e demokratizimit të përfundonte. Tashmë në Shqipëri do të mbizotëronin regjimet autoritare dhe diktatoriale.

Evoluimi i parimeve demokratike pas viteve '90

Në fillim të viteve '90 edhe Shqipëria u bë pjesë e një përmbysje të madhe, e cila nisi edhe valën e tretë dhe të fundit të demokratizimit. Rënia e bllokut komunist në Shqipëri dhe në tërësi, dështimi i modelit diktatorial socialist e futi vendin në një valë të re demokratizimi. Akti që shënoi fillimin e erës së re të demokracisë shqiptare ishte legjitimi i pluralizmit politik nga Partia Komuniste, pas protestave të fuqishme studentore në Tiranë. Shpallja e pluralizmit demokratik mund të karakterizohet si hap i parë drejt fundit të një kapitulli të dhimbshëm për Shqipërinë politike dhe në të njëjën kohë ishte fillimi i një rruge të gjatë drejt adaptimit të demokracisë së plotë liberale.

Themelimi i Partisë Demokratike në 12 dhjetor 1990 dëshmoi që procesi i demokratizimit tashmë kishte nisur. Ky hap u pasua edhe me themelimin e partive të tjera politike, organizatave të pavarura dhe shtypit të lirë. Pas zgjedhjeve të 1992, demokratët e sapoardhur në pushtet synonin ndryshimin e situatës politiko-ekonomike në vend. Në zotimet e tyre gjatë procesit elektorale mund të përmendim “kalimin në ekonominë e tregut të lirë, privatizimin e ekonomisë socialiste, uljen e papunësisë masive, reformimin e institucioneve kushtetuese, ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe integrimin në komunitetin Evropian” (Krasniqi 2006: 218).

Të gjitha këto aspekte, pa diskutim, që dëshmojnë nxitjen e evoluimit të parimeve demokratike, por, gjithsesi, mbeten pa përgjigje akoma pyetjet se si ka evoluar procesi i demokratizimit në Shqipëri deri në ditët e sotme dhe se çfarë ecurie ka pasur demokracia shqiptare në vitet e tranzicionit? Pra, konkretisht mund të shtrojmë pyetjen nëse ka ecur në mënyrë progresive performanca e demokracisë në Shqipëri? Mjaft të dobishme për këtë punim paraqiten pritshmëritë politike të demokracisë.

Rrotacioni politik dhe paqësor i vitit 1992 ishte prelud i pluralizmit politik dhe mund të konsiderohet si elementi më thelbësor i rrugës drejt transformimit demokratik të vendit. Por në të vërtetë Shqipëria u fut në rrugën e tranzicionit demokratik e

papërgatitur dhe me mungesë të theksuar mbi njohjen e kulturës demokratike. “Elita e re politike po operonte në një terren tërësisht të panjohur që solli si pasojë zhgënjimin e njerëzve që prisnin nga liria më shumë se sa i ofronte ajo në të vërtetë” (Weidenfeld 1999: 17). Ndryshimi i kuadrit ligjor është një e dhënë tjetër në evoluimin e standardeve politike të demokracisë. Shteti ligjor, si gur themeli bazë i demokracisë, u fut në procesin e përafrimit me legjislacionin e shteteve, pjesë të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst gjatë tranzicionit demokratik kuadri ligjor u fut në rrugën evolutive. Referendumi i 6 nëntorit i 1994-ës i iniciuar nga Partia Demokratike për miratimin e projektkushtetutës u hodh poshtë me shumicë votash nga qytetarët shqiptarë, por ky proces i miratimit të kushtetutës, si baza konstitucionale e demokracisë, u realizua në 28 nëntor 1998 me konsensus të plotë politik të dy poleve të majtë e të djathtë. Me konsensus, por jo me të njëjtën pritshmëri, u kryen edhe ndryshimet kushtetuese të shumë diskutuara të prillit 2008.

Në rrugën e avancimit të Shqipërisë drejt demokracisë së shëndoshë dhe të konsoliduar, proceset elektorale shfaqen si një element thelbësor në përcaktimin e performancës së demokracisë në Shqipëri. Pra, demokracia përfaqësuese është pashmangshmërisht e ndërruar me sistemin elektoral. Në Nenin 1, Pika 3 të Parimeve Themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është sanksionuar në këtë mënyrë *“qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”* Nëpërmjet zgjedhjeve elektorale shprehet kuptimi real i demokracisë si një qeverisje e elitës politike në vend me pëlqimin e votës së qytetarëve. Studiuesi dhe historiani Llambro Filo e konsideron demokracinë elektorale “si kriter vlerësimi të funksionimit të vetë demokracisë” (Filo 2010: 96). Proceset elektorale në Shqipëri kanë ardhur drejt një evolucioni gradual dhe këtë e dëshmojnë edhe raportet e organizatave ndërkombëtare, si OSBE-ja, ku përparimi është i dukshëm. Megjithatë kontestimi i rezultatit është një praktikë që ka shoqëruar zgjedhjet në Shqipëri. Përveç zgjedhjeve të 22 marsit 1992, ato të 3 korrikut 2005 dhe ato të 23 qershorit 2013, të gjitha proceset e tjera elektorale janë

kontestuar nga pala humbëse. Dyshime mbi manipulime dhe parregullsi në zgjedhje janë kryefjala që ka shoqëruar politikën shqiptare gjatë tranzicionit demokratik të këtyre 25 viteve.

Përfundime

Janë të shumta diskutimet që ngrihen mbi vlerësimin, analizën, dhe evoluimin e platformës demokratike të Shqipërisë. Tranzicioni i stërgjatë demokratik dhe kompleksiteti me të cilat përballet Shqipëria në rrugën e saj për anëtarësim në familjen e madhe të Bashkimit Evropian, janë çështjet bazë mbi të cilat vlerësohet shkalla e demokratizmit të shoqërisë shqiptare. Si një tregues që Shqipëria ende nuk ka një demokraci të konsoliduar, është klima politike, përgjithësisht, konfliktuale mes dy kampeve kryesore politike. Në mjaft raste, krizat e herëpashershme politike kanë sjellë hapa pas në performancën tërësore të zhvillimeve demokratike. Ciklet periodike të shfaqjes së këtyre krizave politike në interval të caktuar kanë penguar avancimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në familjen e Bashkimit Evropian. Rasti ekstrem i krizës politike dhe ngjarjet e dhunshme të vitit 1997 e çuan vendin disa vite pas në kohë. Po ashtu edhe kriza e shtatorit, 1998, apo së fundmi demonstrata e 21 janarit 2011. Në rastet e krizave politike në Shqipëri mes opozitës dhe qeverisë, është bërë e udhës të kërkohet ndihma e faktorit ndërkombëtar në zgjidhjen definitive të saj.

Krizat e vazhdueshme politike e sociale, si ajo e vitit 1997, sollën regres në zhvillimet demokratike të vendit. Ato, gjithashtu, kanë ndikuar në krijimin e një modeli të keq në qeverisjen e vendit. Në disa raste këto zhvillime kanë ngadalësuar e në disa të tjera kanë stopuar procesin e integritetit të Shqipërisë. Bashkimi Evropian në mënyrë të përsëritur ka kërkuar nga klasa politike shqiptare përgjegjshmëri dhe qeverisje efikase, me qëllim shmangien e krizave të vazhdueshme politike në luftën e ashpër për pushtet. Këshilla këto që duke ia sugjeruar vendit më proevropian të rajonit, marrin një kuptim të veçantë.

Demokracia shqiptare ka evoluar si një proces i pandalshëm. Gjithsesi, duhet theksuar se këto elemente, edhe pse për kohën në të cilën ato janë zhvilluar ishin shumë përparimtare, sot ato vlerësohen si parime shumë të zbehta të demokracisë liberale. Për t'u nënvizuar mbetet edhe fakti që megjithëse procesi ishte i pandalshëm, pati momente regresi, siç ndodhi edhe pas valës së dytë. Në fazën e tretë, pati pa diskutim një progres të demokratizimit dhe të vlerave demokratike. Ky progres nuk mund të konsiderohet thjesht si produkti i 25 viteve të fundit, por si rezultati i tre valëve të demokracisë në terrenin shqiptar.

Mbi bazën e një analize modeste, me synimin e shpjegimit të zhvillimit të parimeve demokratike dhe të procesit të demokratizimit në terrenin shqiptar, arrijmë në konkluzionin se Shqipëria ka përjetuar tri faza të demokratizimit. Duke pasur parasysh që secila prej valëve të demokratizimit është ndikuar detyrimisht, qoftë prej kontekstit të zhvillimeve politike botërore, por, gjithashtu, edhe të ngjarjeve politike dhe ekonomike brendapërbrenda territorit shqiptar, është më se e rëndësishme të pranojmë se secila fazë përfaqëson procesin e vazhdueshëm dhe kompleks në evoluimin e demokracisë shqiptare.

Referenca

- Duka, V., (2007), Historia e Shqipërisë 1912 – 2000, Tiranë.
- Filo, Ll., (2010), Sistemi Politik Bashkëkohor – Evropa, Tiranë.
- Krasniqi, A. (2006), Partitë Politike në Shqipëri (1920 – 2006), Tiranë.
- Puto, A. (2009), Shqipëria Politike 1912 – 1939, Tiranë.
- Weidenfeld, W. (1999), Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore, Tiranë.

Ermal H. BAZE

Universiteti i Tiranës

Jaho CANA

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

**FILLESAT E PËRHAPJES DHE TË
KONSOLIDIMIT TË BEKTASHIZMIT NË VISET
SHQIPTARE**

(Gjysma e dytë e shek. XVII – Janar 1921)

ABSTRACT

Bektashi tradition must have been old in Albanian areas (end of the century XIV – beginning of the century XV), but the historical sources know so far track its record since the second half of XVII century. The rhythm of the Bektashi spread among the Albanian people was accelerated during the second half of the XVIII century and the early XIX century, while the order of the above won the support of Ali Pasha, ruler of Pashalik of Ioannina (Yanina), and also after the liquidation of the Janissary corps of the Sultan Mahmud II on July 17th 1826. The political positions of the Albanian Bektashi in the late XIX century and early XX century, are particularly interesting: they would give their patriotic contribution in the Albanian National Movement, as well as in the independence of the country. In this way, the Congress sanctioned the creation of the Albanian Bektashi Community. The first Bektashi Congress of Prishtë, as far as it decided, was very important to the development and consolidation of the positions of the Bektashi in Albania. It marked a milestone in the institutional independent organization of Bektashism in Albania, and also had special significance for the strengthening of the Albanian state at the time, under the initial context of detachment from the world religious centers, whose headquarters were abroad.

Key words: Islam, bektashi, kongres, statut, Lëvizje Kombëtare Shqiptare

Bektashinjtë – shkruan studiuesi italian i historisë bashkëkohore, Roberto Moroco dela Roka, – *përbëjnë urdhrin islamik heterodoks që është përhapur më shumë në vendet ballkanike nën Perandorinë Osmane, kurse Shqipëria historikisht është atdheu i dytë i tyre, pas rajonit të Anadollit*.¹ Nuk ka njohuri të sigurta rreth fillimeve të bektashizmit në Shqipëri. Tradita bektashiane duhet të ketë qenë e hershme në viset shqiptare (fundi i shekullit XIV – fillim i shekullit XV), por burimet historike të njohura deri më tani i regjistrojnë gjurmët e saj që nga gjysma e dytë e shekullit XVII.² Sipas të dhënave të përfutura nga udhëpërshkrimi i gjeografit osman Evlija Çelebiu, në disa qytete shqiptare të kësaj kohe, si në Elbasan, Berat, Gjirokastër, Vlorë, Kaninë, Përmet, Mitrovicë, Kavajë, Peqin etj., ekzistonin vende të shenjta dervishësh, si teqe, tyrbe etj.³

Ritmet e përhapjes së bektashizmit në radhët e popullit shqiptar u shpejtuan gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVIII dhe fillimeve të shekullit XIX, kohë kur urdhri i mësipërm fitoi mbështetjen e Ali pashë Tepelenës, sundimtarit të Pashallëkut të Janinës,⁴ si dhe pas likuidimit të korpusit të jeniçerëve nga sulltan Mahmuti II më 17 korrik 1826.⁵ Në të njëjtën kohë, në Stamboll dhe në qendra të tjera

¹ Roberto Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920 – 1924* (Tiranë: Elena Gjika, 1994), 34. John Kingsley Birge, *The Bektashi Order of Dervishes* (London: Luzac & Co, 1937), 84 – 85.

² Stefanaq Pollo, “Tipare të Bektashizmit të shqiptarëve gjatë Rilindjes”, në: *Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët*, simpozium ndërkombëtar, (Prishtinë, 15, 16, 17 tetor, 1992), Prishtinë: Graçanica, 1995, 218. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllim I, (Tiranë: Toena, 2002), 594. Për historinë e bektashinjve në Shqipëri shih: Von Peter Bartl, *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung 1878 – 1912*, (Eiesbaden, 1968), 99 – 111. Georg Stadtmüller, “Der Derëischorden der Bektaschi in Albanien”, në: *Serta Slavica in Memoriam Aloisii Schmaus*, (München, 1971), 638 – 688. Alexandre Popovic et G. Veistein, “Les ordres mystiques musulmans du Sud – Est Européen dans la période post – ottomane”, në: *Les ordres mystiques dans l’Islam*, (Paris, 1972), 67.

³ Evliya Çelebi, *Shqipnia para dy shekujsh* (Tiranë: Shtypshkronja Shkodra, 1930), 35 – 106.

⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllim I, 595.

⁵ Petrika Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane* (Tiranë: Shtëpia Botuese e

të Perandorisë Osmane, shpërtheu një stuhi e fortë dhune e represioni kundër “vëllazërisë fetare të bektashinjve, të cilët mbështetnin jeniçerët dhe mbaheshin si frymëzuesit e kundërvënies së jeniçerëve ndaj sulltanit”.⁶

Për këto arsye, viset shqiptare, ku bektashinjtë qenë të mirëpritur e të respektuar, u bënë strehimi më i sigurt për ta.⁷ “Në Shqipëri radhët e tyre shtoheshin me shpejtësi e ata fitonin rëndësi gjithnjë e më të madhe, aq sa në shek. XIX bektashizmi u kthye në një urdhër fetar shqiptar”.⁸

Pozitat politike të bektashinjve shqiptarë në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, janë, veçanërisht, interesante: ata do të jepnin kontributin e tyre patriotik në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, si dhe në çështjen e pavarësisë së vendit.⁹ Në këtë zgjedhje të tyre ndikuan jo vetëm marrëdhëniet tradicionalisht të vështira me autoritetet politike e fetare të Bosforit, por edhe hapja e tyre, karakteristike ndaj sensibilitetit të bashkëkohësve dhe ndaj

Librit Universitar, 1997), 168.

⁶ Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane* (Tiranë: Dituria, 2004), 413.

⁷ Bektashizmi në Shqipëri do të mernte një rëndësi akoma më të madhe, kur qendra botërore e tij kaloi nga Ankaraja në Tiranë, pas vendimit që dha Asambleja Turke më 20 nëntor 1925, në bazë të të cilit u mbyllën të gjitha teqetë dhe zavijetë bektashiane në Turqi. Në këtë mënyrë, në Shqipëri u vendos Selia e Përgjithshme e Bektashizmit, në krye të së cilës vu shqiptari Salih Nijazi Dedeji (1876 – 1941), ish – kryetar i Teqesë së Haxhi Bektashit në Turqi. Marrë nga: Baba Selim R. Kaliçani, *Histori e Bektashizmit si sekt mistik islam*, 1, (Tiranë: Shtëpia Botuese Koha, 1999), 189; Pas Kongresit III (26 shtator, 1929) Bektashian, qendra e Kryegjyshitës Bektashiane Botërore u vendos në Teqenë e Turanit (Tepelenë) prej nga në fund të vitit 1930 u zhvendos dhe u vendos në Teqenë e Melçanit (Korçë). Në maj të vitit 1937 me vendim të Këshillit të Shenjtë Gjyshnor dhe Këshillit Mikst në Kryesinë Salih Nijazi Dedejit, u vendos transferimi i saj me seli në Tiranë, ku ndodhet edhe sot. Marrë nga: Fatmira Musaj, “Përpyjekjet autoqefale të Bektashizmit në Shqipëri”, në: *Bektashizmi dhe Atdhetarizmi*, (Çorovodë (Skrapar), 21 korrik, 1996), f. 5.

⁸ Stefanaq Pollo, *Në Gjurmë të Historisë Shqiptare*, 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Historisë, Tiranë: 2003, 46.

⁹ Stefanaq Pollo, “Tipare të Bektashizmit të shqiptarëve gjatë Rilindjes”, 221 – 223.

ideve të reja.¹⁰

Roli politik aktiv dhe rritja me ritme të shpejta e numrit të bektashinjve në Shqipëri bëri të domosdoshëm dhe njëherësh të mundshëm për disa arsye organizimin institucional të tyre në fillim të viteve `20 të shekullit të kaluar. Është e vështirë të vlerësohet me saktësi numri i bektashinjve në Shqipëri, në dekadat e para të shekullit XX, sepse mungojnë regjistrimet dhe statistikatat e sakta. Megjithatë, shifrat që japin autorë të ndryshëm për numrin e bektashinjve në Shqipëri gjatë kësaj periudhe, lëvizin nga 50. 000 deri në 250. 000 besimtarë.¹¹

Një panoramë e tillë e përhapjes në një shkallë relativisht të gjerë e tarikatit (sektit) bektashian ishte më e theksuar në Shqipërinë e Mesme dhe atë të Jugut. Ky sekt kishte institucionet e veta që ishin teqetë, numri i të cilave në vitin 1920 arrinte në më shumë se pesëdhjetë.¹² Të tilla kishte në krahinat Krujë, Elbasan, Berat, Skrapar, Korçë, Përmet, Vlorë, Gjirokastrë etj. Në çdo teqe kryesonte babai dhe shërbenin disa dervishë ose varfë. Teqetë shqiptare ishin të pavarura nga njëra – tjetra dhe problemet ekonomike i zgjidhnin me pronat që kishin, si dhe me kontributin e besimtarëve. Ato kishin vartësi dhe i bindeshin urdhrit të kryegjyshit me rezidencë në Turqi.¹³

Nga disa personalitete klerikale shqiptare bektashiane ishin bërë

¹⁰ Roberto Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri*, 38.

¹¹ Stefanaq Pollo, *Problemi fetar gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, (dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë), f. 49. Fatmira Musaj, “Organizimi institucional i sektit bektashian në Shqipëri në vitet 1920 – 1939”, në: *Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët*, simpozium ndërkombëtar, (Prishtinë, 15, 16, 17 tetor, 1992), (Prishtinë: Graçanica, 1995), 225. Historianë bektashinj shqiptarë, në një shkrim të vitit 1929, përmendnin se fuqia numerike e sektit bektashian në Shqipëri, e vërtetuar në bazë të statistikave të brendshme të mbajtura deri më 1826 rezultonte të ishte deri në 100. 000 veta. Ali Tyrabiu, *Historia e Përgjithshme e Bektashinjet* (Tiranë, 1929), 64.

¹² Fatmira Musaj, “Kongreset Bektashiane”, në: *URTESIA*, nr. 2, Tiranë: Botim i Komunitetit Bektashian Shqiptar, 1994, f. 8.

¹³ Ali Prishta, *Bektashinjtë e Shqipërisë* (Korçë, 1921), f. 5.

përpjekje për një organizim e drejtim të pavarur të bektashizmit në Shqipëri edhe më parë, para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë.¹⁴ Por, meqenëse në Shqipëri nuk pati një shtet të konsoliduar që të merrte në mbrojtje institucionet fetare, edhe në drejtim të autoqefalisë bektashiane nuk u arrit ndonjë rezultat konkret.¹⁵ Kjo u bë e mundur në fillim të vitit 1920, me krijimin në Shqipëri të situatës së favorshme politike mbas Kongresit të Lushnjës, ku në njërin nga nenet e miratuara në statutin e këtij kongresi merreshin në mbrojtje besimet fetare: “*Shqipëria njeh dhe mbron baraz, synizmën, bektashizmën, ortodoksizmën e katolicizmin*”.¹⁶

Duke përfitur nga kjo dispozitë, baballarët bektashinj më në zë, si Ahmet Turani e Hysen Prishta, të mbështetur edhe nga disa intelektualë shqiptarë, i paraqitën qeverisë së re më 13 korrik 1920 një program, ku i kërkohej leje për thirrjen e një kongresi bektashian.¹⁷ Në program, veç datës ku do të mbahej kongresi (17 janar 1921) dhe vendit ku do të organizohej (në Teqenë e Prishtës, Skrapar),¹⁸ ishin shprehur edhe problemet kryesore që do të diskutoheshin, si: krijimi i “*Këshillës Atnore*” bektashiane, krijimi i arkës së përgjithshme, përkthimi në gjuhën shqipe i gojëdhanës bektashiane etj.¹⁹

Fatmirësisht, qeveria e Lushnjës dha përgjigje pozitive për zhvillimin e kongresit, i cili u zhvillua më 17 – 21 janar 1921 në Teqenë e Prishtës,²⁰ një nga teqetë bektashiane më të pasura e më të

¹⁴ Fatmira Musaj, “Përpjekjet autoqefale të Bektashizmit në Shqipëri”, f. 1.

¹⁵ Fatmira Musaj, “Organizimi institucional i sektit bektashian në Shqipëri në vitet 1920 – 1939”, f. 225.

¹⁶ Fatmira Musaj, “Kongreset Bektashiane”, 8. Sokrat Ahmataj, *Bektashizmi nën smogun e një libri* (Tiranë: Urtësia, 1999), f.95.

¹⁷ Arkivi Qendror Shtetëror, (Më tej, A. Q. SH.), F. 249, V. 1920, D. VI/24, dok. 327, fl. 5.

¹⁸ A. Q. SH., F. 249, V. 1920, D. VI/24, dok. 327, fl. 6.

¹⁹ A. Q. SH., F. 249, V. 1920, D. VI/24, dok. 327, fl. 6.

²⁰ A. Q. SH., F. 249, V. 1921, D. VI/67, dok. 345/1, fl. 60. Ali Prishta, “Kongresi i Përgjithshëm Bektashian në Teqe të Prishtës”, në gazetën: *Mbrojtja Kombëtare*, Vlorë, nr. 19, 15 shkurt 1921, f. 4. Ali Prishta, “Kongresi i Përgjithshëm

rëndësishme në Shqipëri, sidomos për rolin që kishte luajtur në fillim të periudhës pasotomane.²¹ Aty morën pjesë baballarë nga 37 teqe si dhe laikë, simpatizantë të bektashizmit nga disa krahina të vendit, si nga Gjirokastra, Tepelena, Leskoviku, Elbasani, Vlora, Frashëri etj.²² Përfaqësuesit e këtyre krahinave vinin në këtë kongres me vepra atdhetare në të kaluarën.²³ Si përfaqësues i qeverisë u dërgua Fejim bej Zavalani.²⁴

Fillimisht u formua një komision i posaçëm, i cili hartoi projektin e statutit. Sipas procesverbalit të Kongresit projekti i përbërë nga 28 nene iu paraqit delegatëve nën për nen dhe, pasi u miratua, u vendos të shkruhej i plotë në procesverbal. Statuti që u quajt “*Lidhja Bektashiane*”, në thelb shprehte organizimin dhe veprimtarinë e bektashizmit në Shqipëri. Në nenin e parë të statutit sanksionohej “*Këshilli Atnor*”, si organi më i lartë i klerit bektashian, i cili përbëhej nga shtatë anëtarë. Anëtarët e parë të “*Këshilli Atnor*” ishin: Ahmet Baba Turhani, gjysh Sulejman Baba Gjirokastra, etërit Ahmet Baba Elbasani, Xhemal Baba Përmeti, Hajdar Baba Turani,

Bektashian në Teqe të Prishtës”, në gazetën: *Shqipëri e Re*, Konstancë, nr. 27, 1 prill 1921, f. 2. Nuri Çuni, “Roli patriotik i teqeve në Skrapar”, në: *Bektashizmi dhe Atdhetarizmi*, (Çorovodë (Skrapar), 21 korrik, 1996), f. 1.

²¹ Nathalie Clayer, *L' Albanie pays des derviches: Les ordres mystiques musulmans en Albanie a l' époque post – ottomane (1912 – 1967)*, (Berlin: In kommission bei Otto Harrassoëitz – Eiesbaden, 1990), 324. (Në librin *Historia e Bektashinjvet*, botuar në Tiranë më 1929, shkruhet se përpara themelimit të teqesë së Prishtës nga ana e Baba Tahirit në krahinën e Skraparit dhe të Beratit rreth vitit 1850, besimtarët bektashinj mund “të numëroheshin si gishtat e dorës”. Në sajë të veprimtarisë së këtij personazhi, sekti do të shtrihej në krahinat malore të Skraparit, Dëshnicës, në pjesën e Toskërisë së Tepelenës, në *nahijen* e Beratit dhe të Mallakastrës së sipërme, krahina këto që ndodhen në Berat dhe Tepelenë, të cilat do të bëheshin zonat e jugut të vendit ku do të zotëronte elementi bektashi. Marrë nga: Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar* (Tiranë: Marin Barleti, 2009), 45.

²² Fatmira Musaj, “Organizimi institucional i sektit bektashian në Shqipëri në vitet 1920 – 1939”, 226.

²³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllim III, (Tiranë: Toena, 2007), 193.

²⁴ A. Q. SH., F. 249, V. 1921, D. VI/67, dok. 345/1, fl. 60.

Mustafa Baba Frashëri dhe Kamber Baba Prishta.²⁵

“*Këshilli Atnor*” kishte të drejtën për të zgjedhur kryetarin, ku si rregull zgjidhej anëtari më i vjetër në moshë dhe i jepej titulli *Veqil Dede*. Autoriteti dhe të drejtat që i atribuoheshin “*Këshillit Atnor*” ishin të njëjta me kompetencat që dispononte zëvendësi i kryegjyshit. “*Këshilli Atnor*” do ta kryente aktivitetin e tij në bazë të “Ligjit të Përjetshëm Bektashian”, ku i jepej dhe fuqia e plotë për kryesimin dhe administrimin e të gjitha teqeve bektashiane në Shqipëri.

Në këtë mënyrë, ky kongres sanksiononte krijimin e Komunitetit Bektashian Shqiptar. Neni 8 i statutit paraqiste raportet e “*Këshillit Atnor*” me Prindin e Bektashinjve, në Teqenë e madhe të Haxhi Bektash Veliut në Turqi.²⁶ Në thelb, neni 8 i Statutit të Kongresit të Përgjithshëm të baballarëve bektashinj nënkuptonte dhe shprehte pavarësinë e bektashizmit shqiptar nga Kryegjyshata Botërore e Bektashizmit, pasi lidhjet e “*Këshillit Atnor*” me Kryegjyshitën u ruajtën në aspektin moral vetëm për ndërmarrjen e virgjinisë për varfët, baballarët e gjyshit.²⁷ Me sa duket, kjo lidhje u ruajt duke u nisur nga fakti se në atë kohë kryegjyshi i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane në Turqi ishte me origjinë shqiptare.²⁸ “*Më 17 – 21 janar 1921 – thekson Edëin E. Jacques – në teqenë e Prishtës, afër Beratit, u mbajt një kongres historik pan – bektashian, ku nën udhëheqjen e Gjysh Ahmet Turanit, bektashinjtë ishin bashkësia e parë fetare në Shqipëri që u shpallën të lirë nga çdo kontroll i huaj*”.²⁹

Ndër nyjet e tjera të rëndësishme të statutit, ishte edhe ajo (nyja

²⁵ A. Q. SH., F. 155, V. 1929, D. VIII/118, fl. 63.

²⁶ A. Q. SH., F. 155, V. 1929, D. VIII/118, fl. 64.

²⁷ Po aty.

²⁸ Alexandre Popovic, *Islamizmi Ballkanik: Myslimanët e Europës Juglindore gjatë periudhës osmane* (Tiranë: Dituria, 2006), 36.

²⁹ Edëin E. Jacques, *Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme* (Tiranë: Kartë e Pendë, 2004), 412.

12, 13) që sanksiononte krijimin e arkës së përgjithshme bektashiane në Shqipëri, e cila do të ndikonte në zhvillimin e konsolidimin e mëtejshëm të bektashizmit.³⁰ Gjithashtu, Kongresi i Parë Bektashian në Shqipëri i kushtoi një vëmendje të veçantë përgatitjes intelektuale dhe arsimore të klerit të tij. Në lidhje me këtë çështje, studiuesja F. Musaj pohon se: *“Kjo ishte një kërkesë imediate për organizimin dhe drejtimin e institucioneve bektashiane, pasi shumë dervishë, baballarë e gjyshër për ndjenjat e tyre kombëtare ishin ndjekur e persekutuar nga forcat e huaja që pushtuan Shqipërinë në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit XX”*.³¹ Për këtë u vendos që të themelohej *“Mësimorja Bektashiane”* në teqenë e Sukës (Përmet), e cila u caktua edhe si qendër e *“Këshillit Atnor”*.³² Vendimit për ngritjen e nivelit arsimor dhe intelektual në radhët e kuadrove bektashianë shqiptarë i kushton rëndësi edhe studiuesi Edëin E. Jacques, në librin *“Shqiptarët”*, ku veç të tjerash ai vë në dukje se: *“Përveç riorganizimit të bashkësisë bektashiane shqiptare, u votua edhe për krijimin e një kolegji filozofik, për pajisjen me arsim të lartë fetar të pasuesve të vet dhe për përmirësimin e përgatitjes së dervishëve të ardhshëm”*.³³

Si përfundim mund të themi se Kongresi i parë Bektashian i Prishtës, për aq sa vendosi, pati rëndësi të madhe për zhvillimin dhe konsolidimin e pozitave të bektashinjve në Shqipëri. Ai shënoi një gur kilometrik në organizimin institucional të pavarur të bektashizmit në Shqipëri, si dhe pati rëndësi të veçantë për forcimin e shtetit shqiptar të asaj kohe, në kuadrin nismëtar të shkëputjes nga qendrat fetare botërore, selitë e të cilave gjendeshin jashtë vendit.

³⁰ A. Q. SH., F. 155, V. 1929, D. VIII/118, fl. 65. Ali Prishta, “Kongresi i Përgjithshëm Bektashian në Teqe të Prishtës”, në gazetën: *Mbrojtja Kombëtare*, f. 2.

³¹ Fatmira Musaj, “Organizimi institucional i sektit bektashian në Shqipëri në vitet 1920 – 1939”, 227.

³² Ali Prishta, “Kongresi i Përgjithshëm Bektashian në Teqe të Prishtës”, në gazetën: *Mbrojtja Kombëtare*, f. 2.

³³ Edwin E. Jacques, *Shqiptarët*, 412.

Jaho Cana

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

Ermal Baze

Universiteti i Tiranës

TEZAT E PLENUMIT PARTIAK TË BERATIT

ABSTRACT

The Communist Party of Albania (referred to as PPSH) since its founding, was accompanied by a severe political struggle. Also, the foundation Act of this Party, as witnessed by its founders, was legalized on the basis of uniting several political groups and fractions which for a long time had been designated as left extremists. According to abundant documentary data, it is proven that this struggle was embodied in terms of repeated crisis with the top leadership as an expression of rivalry between the clans in order to grab the highest posts in the state and party level. The political struggle was institutionally shaped in the party plenum of Berati. The Albanian historiography of communist regime particularly that focused on the War has largely treated this plenum and its decisions. Anyhow, the thesis and conclusions of this plenum were contradictory especially when it comes to causes and foreign interventions. They have been done due to the time political conjectures, both domestic and outer. Within this framework, we should draw the attention to the publications of History of Party before 70-ies with those of 80-ies.

Key words: party, plenum, politics, clans, rivalry

Partia Komuniste e Shqipërisë (e mandej PPSH) që kur u formua si e tillë, u shoqërua nga një luftë e ashpër politike. Edhe vetë akti i themelimit të kësaj partie, siç edhe vërtetohet nga vetë themeluesit e saj, u legalizua mbi bazën e bashkimit të disa grupeve dhe grupimeve politike, të cilat prej kohësh ishin cilësuar si ekstremiste të majta. Analistët, sidomos historianët, po binden gjithnjë e më shumë të thonë se kjo luftë të krijon përshtypjen sikur udhëheqja komuniste preokupohej më shumë nga ethet e pushtetit, se sa nga hallet dhe përpjekjet për përparimin dhe zhvillimin e vendit. Nga të dhënat e shumta dokumentare, provohet se kjo luftë u mëshirua në formën e krizave të përsëritura në udhëheqjen më të lartë të saj, si shprehje e rivalitetit midis klaneve për t'i rrëmbyer njëri-tjetrit postet më të larta shtetërore dhe partiake¹

Lufta politike mori formën më institucionale në plenumin partiak të Beratit. Plenumet ishin forume të rëndësishme të kësaj partie, që gëzonin statusin e organit vendimmarrës për probleme të rëndësishme, organizative dhe ideologjike. Për nga rëndësia, ato vinin menjëherë pas Kongresit të partisë.

Ky plenum u mbajt më tepër si kurorëzim i fitores dhe i arritjeve që kishte pasur kjo parti gjatë viteve të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar. Historiografia shqiptare e regjimit komunist, sidomos ajo pjesë që bën fjalë për luftën, e ka trajtuar gjerësisht këtë plenum dhe vendimet e tij. Por tezat dhe konkluzionet e saj kanë qenë kontradiktore, veçanërisht, për sa i takon shkaqeve dhe ndërhyrjeve nga jashtë. Ato janë hedhur në vartësi të koniunkturave politike të kohës, si ato të jashtme, ashtu edhe ato të brendshme. Për këtë mjafton të sjellim në vëmendje botimet e Historisë së Partisë të para viteve '70, me ato të viteve '80.

¹ “*Historia e Shqipërisë*”, vëll. IV, Tiranë, 1984; “*Historia e PPSH-së*”, botimi I, II, Tiranë 1978, 1982; “*Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*”, vëll. I, II, Tiranë, 1984; E. Hoxha, “*Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re*”, Tiranë, 1984; E. Hoxha, “*Titistët*” (Shënime historike), Tiranë, 1981.

Duhet thënë se mosmarrëveshjet dhe grindjet që ekzistonin brenda radhëve të Partisë, ishin të shpeshta dhe ngandonjëherë ato ishin edhe parimore, duke i shfrytëzuar më shumë kujdes PKJ². Kjo e fundit e përdori statusin e saj të ndërmjetësimit, apo të sekserit politik, të dhënë nga Komiterni³, ose e ashtuquajtura Internacionalja III Komuniste, për ta shndërruar nga një status konsulent e këshillimi në një status për nënshtrimin dhe, mandej, në kolonializimin e plotë ekonomik e politik të Shqipërisë⁴. Politikisht, Beogradi zyrtar synonte ta kthente Shqipërinë në një pjesë përbërëse të Federatës Jugosllave, si një republikë të shtatë të saj⁵. Me këtë rast, ata realizonin dhe ëndrrën e madhe serbomadhe atë të “*Narçetanies*” ose të “*Projektit*” të shpallur zyrtarisht qysh në mesin e shek XIX. Nga ana tjetër, zgjidhte përfundimisht edhe statusin e Kosovës në favor të Serbisë, duke pretenduar se në këtë mënyrë do t’i jepnin fund njëherë e përgjithmonë njërit prej konflikteve më të ashpër dhe më të përgjakshëm në Ballkan.

Në të vërtetë, kjo strategji e jugosllavëve u shfaq që me krijimin e PKSH- së, por mori përmasa institucionale në plenumin e Beratit. Siç pohojnë edhe vetë drejtuesit e lartë komunistë, ky plenum u thirr për të bërë bilancin e punës dhe të luftës së popullit tonë dhe për të evidentuar rolin udhëheqës të kësaj partie gjatë luftës. Por shumë shpejt, gjatë punimeve të këtij plenumi, nën kujdesin e veçantë të të dërguarit të posaçëm të Beogradit, Vladimir Stoiniçi, ky plenum i devijoi punimet e veta dhe hoqi dorë edhe nga misioni për të cilin ishte thirrur. Përfundimisht, ky plenum u kthye në një institucion penalizimi për disa drejtues kryesorë të lëvizjes antifashiste shqiptare.⁶

Për qëllimet e veta shoviniste, udhëheqja e Beogradit i shfrytëzoi

² *Historia e Shqipërisë*, vëll III, Tiranë, 1984, fq. 107.

³ *Po aty*, fq. 107.

⁴ *Po aty*.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Po aty*.

në interesin e saj pakënaqësitë e disa krerëve shqiptarë, të cilët kishin shprehur rezervat e tyre, edhe më parë, për mjaft probleme që shqetësonin vendin në këtë periudhë. Figura më e preferuar për jugosllavët në këtë periudhë u bë Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Të dy këta drejtues të lartë shfaqnin një zemërim të dukshëm për vendin, gjoja të pamërituar, që zinin në hierarkinë e lartë partiake e shtetërore. Ata e justifikonin këtë zemërim me pretekstin se përpjekjet e tyre kërkonin të shpërbleheshin me poste më të denja për kontributet e tyre në luftë. Ndërkohë, edhe Nako Spiro e Sejfulla Malëshova ushqenin një egoizëm më të madh. Këto pretendime, sipas tyre, buronin nga aftësitë e jashtëzakonshme intelektuale që ata zotëronin. Natyrisht, duhet thënë se këta dy të fundit, në krahasim me anëtarët e tjerë të udhëheqjes komuniste, i kishin këto potenciale intelektuale, të cilat bënë dukshëm diferencën me të tjerët.

Pikërisht, këto situata zemërimi e pakënaqësie u përdorën me mjeshtëri nga të dërguarit e Beogradit. Pikësynimi i tyre fillestar ishte që ta thëllonin akoma edhe më shumë këtë situatë brenda partisë. Edhe pse vendi përjetonte katastrofën më të rëndë ekonomike e politike, edhe pse para kësaj force drejtuese në plan të parë shtrohej detyra urgjente e rimëkëmbjes së shpejtë ekonomike dhe e rivendosjes së autoritetit shtetëror, vendosja e normalitetit dhe qetësisë publike, plenumi u mor me të tjera probleme, të cilat, për momentin, duhej të dilnin në plan të dytë.

Për Beogradin zyrtar, thellimi i këtyre mosmarrëveshjeve i shkonte për shtat dhe, njëkohësisht, krijonte kushte optimale për zbatimin në praktikë të politikës së tyre kolonializuese. Qëllimi ishte që Tirana zyrtare ta ndiente kapitullimin para këtyre vështirësive dhe të zgjaste dorën e kërkesës për ndihmë nga Partia simotër e komunistëve jugosllavë. Në të tilla konkluzione del edhe vetë lideri komunist, Enver Hoxha. Më vonë, vetë ky i fundit, kur i bën një analizë marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, në librin e tij me kujtime dhe shënime historike, i titulluar “Titistët”, pranon në

një farë mënyre ose indirekt, përgjegjësinë e tij, duke u justifikuar me faktin se vetë populli shqiptar nuk mund ta pranonte një kapitullim apo akoma dhe më keq, një pushtim eventual të jugosllavëve⁷

Gjatë zhvillimit të punimeve të këtij plenumi, Enver Hoxha nuk arriti dot që t'i nuhaste qëllimet e errëta të udhëheqjes jugosllave. Ai, edhe në këtë moment kaq delikat për fatet e atdheut, mbeti peng i etjeve të tij karrieriste për të luajtur rolin e njëshit në Parti, por edhe për menaxhimin e gjithë jetës ekonomike e politike në vend. Qëllimi i tij final për momentin ishte të mbante me çdo kusht postin e Sekretarit të Parë të Partisë. Në funksion të këtij qëllimi, ai i mbështeti vendimet ose të ashtuquajturat tezat e plenumit të Beratit. Këto teza u formalizuan nga Byroja Politike e Partisë. Kjo e fundit ishte organi më i lartë qendror dhe ekzekutiv i PKSH-së e më pas i PPSH-së. Edhe pse pjesa dërrmuese e këtyre tezave vinte ndesh me realitetin, ato u pranuan në tërësinë e tyre. N. Sirminova, një historiane që është marrë me studimin e kësaj teme, thekson se ky forum partiak parashitri gjatë punimeve të veta edhe disa teza akuzë, të cilat, pothuajse, ishin përqendruar te figura e Enver Hoxhës që u cilësua si “*bartësi i të gjitha gabimeve*”⁸. Në këtë konkluzion ajo del duke iu referuar diskutimit të Sejfulla Malëshovës. Ky i fundit, në fjalën e tij, e vinte theksin te fakti që ishin vënë re shenja të instalimit të praktikave terroriste në parti⁹. Sipas tij, terrorizmi ishte një fenomen mjaft negativ, i cili është, në fund të fundit, një praktikë dhe teori e të dobëtve¹⁰. Në thelb, këto mendime kishin si qëllim kryesor të sulmonin vijën politike të ndjekur nga ana e PKSH-së, gjatë viteve të Luftës Antifashiste, duke e cilësuar këtë vijë, si një rrugë sektare dhe oportuniste. Dhe, si e tillë, kjo vijë i kishte sjellë dëme të pallogaritshme punës së

⁷ E. Hoxha, “*Titistët*” (Shënime historike), Tiranë, 1981, fq. 230.

⁸ Nina Simirnova, “*Historia e Shqipërisë përgjatë shek. XX*”, Ideart, 2004, fq. 291.

⁹ Po aty, fq. 291.

¹⁰ Po aty, fq. 292.

Partisë në bazë dhe në qendër. Në fakt, këto teza e vinin në dyshim dhe, madje, shtronin edhe një pikëpyetje të madhe për rolin e kësaj Partie, si forcë drejtuese e kësaj lufte. Madje, ata kërkonin të vinin në pikëpyetje edhe vetë fitoren e kësaj lufte nga komunistët shqiptarë. Kjo mënyrë të arsyetuar kërkonte të theksonte se rolin e vërtetë udhëheqës në këtë luftë nuk e luajtën komunistët shqiptarë, por udhëheqja e lartë komuniste jugosllave, si dhe ndihma vëllazërore dhe këshillat e tyre të vlefshme, të cilat ishin shpëtimtare për fatet e Luftës Antifashiste të popullit shqiptar. Pa këtë ndihmë, lufta dhe rezistenca e shqiptarëve do të kishte hyrë në një rrugë pa krye.

Politika zyrtare e pasvitit 1948, ashtu sikurse edhe vetë historiografia shqiptare e kësaj periudhe, i ka penalizuar rëndë tezat e këtij plenumi. Më së shumti, ky plenum është trajtuar në kuadrin e veprimtarisë armiqësore jugosllave dhe si një ndërhyrje e saj e hapur në punët e brendshme të shtetit shqiptar.

Dokumentacionin bazë historik të këtij plenumi e përbëjnë tri fjalime të rëndësishme:

- Fjalimi i Enver Hoxhës për situatën politike në vend;
- Fjalimi i Sejfulla Malëshovës për gjendjen e brendshme dhe situatën politike ndërkombëtare;
- Fjalimi i Koçi Xoxes për çështjet organizative të Partisë.

Pa dashur që të hyjmë në hollësira të panevojshme në përmbajtjen e këtyre tri fjalimeve, duhet të theksojmë se në to vihen re disa deformime mbi qëndrimet dhe taktikat politike të PKSH-së, të ndjekura ndaj forcave politike kundërshtare, sidomos, ndaj nacionalistëve dhe aleatëve të mëdhenj ndërkombëtarë. Marrja e këtyre fjalimeve në kompleks ndihmon shumë në zbulimin e shkaqeve të fitores së luftës. Pavarësisht se strategjia dhe taktikat politike të PK-së për luftën vuanin nga mangësi e dobësi të shumta, fakti ishte se rezultatet e arritura kërkonin analiza të kujdesshme

dhe përgjithësimet e drejta. Pranimin e tezave të plenumit të Beratit, Enver Hoxha e shpjegon me besimin e tepërt, që PKSH-ja ushqente për PKJ-në.¹¹ Fjalës së saj, shprehet ai, udhëheqja shqiptare i jepte kuptimin e së vërtetës absolute dhe të padiskutueshme¹². Në shumë dokumente historike partiake, Jugosllavia klasifikohet “si mikja dhe aleatja më e sinqertë dhe më e sigurt e shqiptarëve”¹³

Ky koncept politik anakronik, sa naiv aq edhe antishqiptar, përkeqësohet edhe nga rivaliteti i ashpër dhe i egër i kupolës së lartë drejtuese të PKSH-së për poste sa më të larta drejtuese. Me kohë, por, sidomos, pas përfundimit të Luftës Antifashiste, në Byronë Politike të PKSH-së ishin kristalizuar dy rryma politike të kundërta. Rryma e parë mbrohet nga S. Malëshova dhe N. Spiro. Sipas saj, rolin e udhëheqësve kryesorë në drejtimin e Partisë dhe të shtetit duhet ta luanin elementët me formimin e duhur intelektual¹⁴. Në udhëheqjen e partisë e të shtetit, theksonte Sejfulla Malëshova, duhet të vinin njerëz të aftë e të zotë, që t’u vinin shpatullat punëve të mëdha që kishin përpara¹⁵. Në këtë pikëpamje, Malëshova kishte mbështetjen e fortë të Nako Spiros. Këta dy drejtues të lartë partie edhe pse për momentin dukej se ishin të bashkuar, për qëllime të larta dhe parimore, në të vërtetë, ata ishin edhe dy rivalë deri në vdekje, për t’i zënë njëri-tjetrit postet më të larta partiake. Kjo ndodhte, sepse që të dy kishin ambicie dhe sedër të theksuar për pushtet. Kjo ambicie e sëmure për pushtet ndikonte mjaft negativisht në ecurinë e mëtejshme të kësaj aleance të përkohshme. Qëndrimi unik në këtë rast shpjegohet edhe me origjinën e tyre intelektuale¹⁶.

Rryma e dytë binte ndesh me të parën. Ajo përfaqësohet nga

¹¹ E. Hoxha, “*Titistët*”, (shënime historike), vepër e cituar, fq. 231.

¹² Po aty, fq. 231.

¹³ PPSH, *Dokumente kryesore*, vëll. I, Tiranë, 1971, fq. 78.

¹⁴ Po aty, fq. 79.

¹⁵ E. Hoxha, “*Titistët*”, vep. e cituar, fq. 232.

¹⁶ Po aty, fq. 232.

Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Tuk Jakova. Sipas tyre, drejtimin e shtetit dhe të Partisë duhej ta merrnin në dorë kuadrot që kishin dalë nga radhët e klasës punëtore¹⁷. Kjo sepse, sipas tyre, këta lloj kuadrosh ishin kalitur në luftë dhe ishin njëkohësisht edhe pararoja reale e klasës punëtore në Shqipëri. Nisur nga kjo, ata dinin të ishin të aftë që të mbronin interesat e vegjëlisë dhe të shtresave të ulëta e të vobekta të shoqërisë. Këtë detyrë as nuk mund ta kryenin dhe jo më ta zbatonin në praktikë intelektualët e tipit të Sejfulla Malëshovës¹⁸. Sepse ata kanë për orgjinë të tyre dhe, njëkohësisht, mbrojnë interesat e borgjezisë.

Enver Hoxha, duke qenë i spostuar dhe deri diku i goditur nga plenumi i Beratit, nuk ishte në gjendje të vendoste autoritetin e duhur në Byronë Politike. Duke qenë se nuk luante dot rolin e udhëheqësit kryesor, ai përpiqej të ruante dhe të forconte të paktën atë status që gëzonte momentalisht. Dukej qartë se pozitat e tij ishin ende të lëkundura dhe, ndoshta, rrezikonte që edhe të spostohej fare nga drejtimi i partisë. Për këtë arsye, ai shpeshherë ndërmernte veprime koniunkturale, duke u pozicionuar herë në mbështetje të një grupi dhe herë të grupit tjetër kundërshtar. Pavarësisht këtyre lojërave, Koçi Xoxe e fuste atë te grupi intelektual dhe, rrjedhimisht, nuk kishte fare besim te mbështetja e Enver Hoxhës.

Duke u nisur nga këto dy rryma, në Byronë Politike të përbërë prej shtatë vetash, në të vërtetë qenë rivalizuar tri klane kundërshtare me njëra-tjetrën, të cilat në mjaft dokumente të kohës shfaqen me emrin grup:

- Grupi intelektual i përbërë nga Enver Hoxha, Sejfulla Malëshova dhe Nako Spiro;
- Grupi punëtor i përbërë nga Koçi Xoxe e Pandi Kristo;

¹⁷ E. Hoxha, “*Titistët*”, vep. e cituar, fq. 232.

¹⁸ *Po aty* fq. 233.

- Grupi i tretë, i ashtuquajtur neutral, i përfaqësuar nga Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu.¹⁹

Ky i fundit mbante një qëndrim pasiv dhe nuk gjente dot kurajën të pozicionohej qartë se cilin grup të mbështeste apo të përkrahte²⁰. Ky qëndrim i tij shpjegohet edhe me faktin se e kishte marrë më parë një goditje, duke u cilësuar si “oportunist”. Ky cilësim në atë kohë, sipas normave të Partisë, quhej një gabim jo i vogël dhe mund të ndëshkohej shumë ashpër. Prandaj ai i ruhej ndonjë goditjeje të re, e cila mund të ishte fatale për të. Kurse Tuk Jakova qëndrimin e vet e shpjegonte me ofendimet që i bëheshin “grupit punëtor” nga ai “intelektual”. Këto qëndrime për këtë grup më shumë i shfaqnin Sejfulla Malëshova dhe Nako Spiro. Duke folur për shkaqet e neutralitetit të tij politik, në shkurt të vitit 1948, Bedri Spahiu theksonte se në Byronë Politike “... e shikoja veten si provizor, si mëkatar ose si vrima e fundit e kavallit. Më dukej sikur Byroja ishte e ndarë në të mëdhenj dhe në të vegjël. Po të mos e shikoja kështu, vazhdonte ai, unë do të flisja”²¹. Një shpjegim të tillë jepte edhe Tuk Jakova i cili shprehej: “Sejfullahu, “llafazan” për nga goja dhe “bibili”, Nako Spiro, monopolizonin bisedimet dhe nuk linin asnjë me fol”²².

Kjo ishte një arsye tjetër, që pa kaluar asnjë vit nga çlirimi i vendit udhëheqja komuniste e eleminoi nga skena politike Sejfulla Malëshovën. Largimin e tij nga politika, Enver Hoxha në shkrimet e tij të hershme, por edhe në ato të mëvonshme e shpjegon dhe e lidh me shumë faktorë. Mbi të gjitha, ai përdor si argument politikat e tij ekonomike, të cilat ishin në kundërshtim me vijën e Partisë në këtë sektor, duke e devijuar qëllimisht atë. Me qëndrimet e tij kërkonte t’i dilte në mbrojtje sektorit privat, si e vetmja rrugë që mund të çonte në shërimin e shpejtë të plagëve të luftës. Madje, Enver Hoxha arsyetonte se qëllimi i tij ishte të frenonte ritmin e reformave ekonomike të ndërmarra nga ana e qeverisë. Në këtë

¹⁹ Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH) Fondi (F) 14, viti 1948, dosja (dos) 42, fl. 17, Procesverbali i mbledhjes së plenumit VIII të PKSH.

²⁰ Po aty, fl. 17.

²¹ Po aty, fl. 19.

²² Po aty fl 21.

mënyrë, ky element antiparti, i dilte në mbrojtje borgjezisë. Ai, ndërmjet të tjerave, e akuzon Malëshovën për pikëpamje oportuniste. Këto pikëpamje të tij, në aspektin politik, kërkonin që në Shqipëri të instalohet një demokraci tipike, si ajo e vendeve Perëndimore.

Kuptohet që këto akuza edhe pse kanë në themel të tyre disa doza të vërteta, duhet theksuar se nuk përmbajnë tërësisht të vërtetën. Kryesore, për të kuptuar këtë të vërtetë, është fakti se formimi politik i Sejfullait në të gjitha aspektet përfshinte edhe teorinë e tij të famshme të “*gradualitetit politik*”²³ apo të teorisë tjetër, asaj të “*respektimit të etapave të revolucionit*”²⁴, nuk dilte jashtë kornizave teorike të filozofisë komuniste apo të rrugës marksiste-leniniste²⁵. Edhe në dokumentet e arkivit personal Malëshova shprehet qartë se teoritë e tij s’janë gjë tjetër, veçse përgjithësime dhe zbatime në praktikë të filozofisë marksiste-leniniste në kushtet konkrete, që po kalonte vendi ynë në këtë etapë të zhvillimit të tij ekonomik²⁶. Kjo do të thotë se Sejfulla Malëshova, në të vërtetë, përfaqësonte krahun më moderat në udhëheqjes komuniste shqiptare. Si i tillë, ai ishte bërë një pengesë serioze²⁷ për ambiciet e krahut ekstremist të majtë, e cila në atë kohë, për hir të së vërtetës historike, përfaqësohej nga vetë Enver Hoxha.

Pa u ndalur hollësisht në shkaqet e largimit apo asgjësimit të tij politik, ka rëndësi të thuhet se edhe ky akt apo masë e ashpër ndëshkimore ndaj tij, nuk e frenoi dot luftën dhe rivalitetin politik në udhëheqjen e lartë komuniste. Por, përkundrazi, ajo dha efektin e kundërt. Në vend që ky dënim të bëhej një shembull për vendosjen e një disipline të hekurt dhe respektimin e diktatit politik të Enver

²³ Po aty, fl. 21.

²⁴ Po aty fl. 21.

²⁵ E. Hoxha, *Veptra*, vëll. V, Tiranë, 1970, fq. 131; *Fjalimi në plenumin V të Komitetit Qendror të PKSH-së*, 5 shkurt 1946.

²⁶ Po aty, fq. 132.

²⁷ Po aty, fq. 132.

Hoxhës, ajo i dha një shtysë akoma edhe më të egër rivalitetit politik brenda radhëve të Byrosë Politike. Grindjet, konfliktet dhe mosmarrëveshjet për pushtet u shtrinë dhe u përhapën akoma dhe më shumë. Ana më negative e kësaj situatë ishte se menjëherë mbas kësaj ngjarjeje në këtë vorbull u përfshinë edhe elementë të rinj, që deri në këtë periudhë nuk kishin shfaqur asnjë pretendim apo qëndrim të caktuar ose, ndoshta, deri atëherë nuk kishin pasur ambicie për poste të larta partiake apo shtetërore. Kështu që ky rreth u zgjerua edhe me personalitete të reja, të cilët po i shfaqnin gjithnjë dhe më hapur ambiciet e tyre për pushtet dhe lufta për pushtet po merrte përmasa të reja edhe më të rrezikshme.

Një faktor i përhershëm konfliktualiteti mbetej ndërhyrja politike e qeverisë jugosllave, e cila, duke parë situatën politike në Shqipëri, hodhi hapa të reja. Kjo e fundit e gjykonte kohën dhe momentin si më të përshtatshmit për të realizuar përfundimisht synimin e tyre final. Në nëntor të vitit 1946 ajo nxitoi që të nënshkruante me palën shqiptare një konventë ekonomike. Nëpërmjet kësaj konvente, në fakt, jugosllavët sanksionuan “*de jure*”, por edhe “*de fakto*” varësinë ekonomike të Shqipërisë nga Jugosllavia²⁸. Ndërmjet të tjerash, në këtë konventë parashikohej përdorimi i një monedhe të përbashkët për të dyja vendet²⁹. Po kështu unifikoi çmimet për të gjitha mallrat e përdorimit të përditshëm dhe, njëkohësisht, hoqi e fshiu kufijtë doganorë³⁰. Kjo marrëveshje dha shkas që në vendin tonë të vërshonin në mënyrë të shfrenuar mallrat jugosllave³¹. Rrjedhimisht, kjo çoi në falimentime masive të sipërmarrjeve vendase. Nga ana tjetër, kjo çoi edhe në boshatisjen e tregut vendas nga mallrat e përdorimit të përditshëm, për të cilat kishte mjaft nevojë tregu i brendshëm jugosllav³². Në këtë periudhë vendi ynë po kalonte një vështirësi shumë të madhe ekonomike që erdhi si

²⁸ *Historia e Shqipërisë*, vëll. IV, Tiranë, 1984, fq. 98.

²⁹ Po aty, fq. 98.

³⁰ Po aty fq. 98.

³¹ Po aty, fq. 99.

³² Po aty, fq. 99.

pasojë e drejtpërdrejtë e zbatimit në praktikë të kësaj marrëveshjeje. Jugosllavët këtë vështirësi ekonomike kërkonin që ta zbusnin dhe ta justifikonin me premtime false dhe boshe, sepse kjo gjendje ishte e përkohshme. Sipas tyre, gradualisht ata do të ndihmonin në mënyrë të shpejtë në ringritjen dhe lulëzimin e ekonomisë shqiptare. Ata u zotuan edhe për një rrugë efikase zhvillimi, që do të ishte krijimi i shoqërive me kapital të përbashkët. Madje, ata prematuan se duke filluar nga viti 1947 do të financonin një plan zhvillimi me afat pesëvjeçarë³³. Ky plan, sipas tyre, do të bënte të mundur që ekonomia shqiptare jo vetëm do të zhvillohej me ritme të shpejta dhe do të dilte nga rruga pa krye ku ishte futur, por ajo do të shndërrohej në një ekonomi konkurruese në të gjithë Evropën Lindore.

³³ Po aty, fq .100.

LAZARELA NDOCI

Instituti i Studimeve Europiane

Tiranë

**RRETHANAT HISTORIKE TË LINDJES SË
URDHRIT EVROPIAN TË NDALIMIT DHE
RËNDËSIA E TIJ NË BE**

ABSTRACT

The European Protection Order is a judicial decision issued by an issuing judicial authority to be executed by an executing judicial authority. It replaced the extradition procedures between the Member States provided for both in the extradition convention and others adopted across the European Union member states. The European Protection Order is a Framework Decision which entered into force in 2004 in the Member States of the European Union. The European Protection Order has certain features, which distinguish it from extradition conventions, but which in themselves constitute its advantages over them. His adoption was mainly tied to the execution as soon as possible by the existing executing judicial authorities, supplanting the administrative procedure and the diplomatic route provided for by the extradition convention. This legal instrument is of particular importance in the context of judicial cooperation in criminal matters, especially after the entry into force of the Treaty of Lisbon. The European Protection Order is considered to be the best instrument of the principle of mutual recognition between the Member States of the European Union.

Key words: *European Protection Order, mutual recognition, historical conditions, judicial authorities, time limits.*

Hyrje

Vendimi-kuadër mbi Urdhrin Evropian të Ndalimit dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare, u miratua në vitin 2002 dhe hyri në fuqi në vitin 2004.

Hyrjes në fuqi të vendimit-kuadër i parapriu miratimi i disa akteve në nivel të Bashkimit Evropian, të cilat synonin përshpejtimin e procedurave të ekstradimit ndërmjet Shteteve Anëtare, njohjen e vendimeve dhe aktgjykimeve në fushën penale me qëllim krijimin e hapësirës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Ngjarjet të cilat i dhanë shtysën kryesore miratimit të Urdhrit Evropian të Ndalimit, ishin ato të 11 shtatorit 2001, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto ngjarje, si dhe të tjera terroriste sollën nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë gjyqësor ndërmjet Shteteve Anëtare, duke rrëzuar disa nga barrierat ligjore dhe burokratike.

Me hyrjen në fuqi të tij, ky vendim-kuadër zëvendësoi konventat mbi ekstradimin, të cilat ishin në fuqi ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

Rëndësia e këtij akti në nivel të Bashkimit Evropian, në këtë punimi, është parë në disa aspekte të cilat janë të parashikuara nga dispozitat ligjore të tij dhe që në vetvete përbëjnë një përparësi krahasuar më parashikimet e konventës mbi ekstradimin.

I. Rrethanat historike të lindjes së Urdhrit Evropian të Ndalimit

Urdhri Evropian i Ndalimit konsiderohet si instrumenti më i mirë i parimit të njohjes reciproke. Ai në vetvete konsiderohet edhe një marrëveshje politike mes Shteteve Anëtare, të cilat vendosen që të zëvendësonin procedurën e ekstradimit të parashikuara nga konventa e ekstradimit e Këshillit të Evropës, por edhe konventat mbi ekstradimin të parashikuara në nivel të Bashkimit Evropian, më një procedurë të re.

Urdhri Evropian i Ndalimit përbën një hap përpara drejt zonës evropiane të zbatimit të ligjit¹.

Vendimi–kuadër zëvendësoi, në kontekstin e marrëdhënieve ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, institucionin klasik të ekstradimit, në favor të një sistemi më të shpejtë dhe përgjithësisht automatik, pa ndërhyrje politike².

Siç e përmendëm edhe më lart, miratimit të tij i paraprinë disa akte, të cilat në vetvete kishin si qëllim njohjen në nivel të Bashkimit Evropian të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore, si dhe përafrimin e legjislacionin për atë që ishte e mundur, por edhe lehtësimin dhe përsheptimin e procedurave të ekstradimit mes Shteteve Anëtare.

Këshilli Evropian i Kardifit³, në përfundimet e presidencës, pikërisht ato që kishin të bënin me "*Drejtësinë dhe Punët e Brendshme*", pikat 37-42, parashikonte që me qëllim sigurinë e qytetarëve është thelbësore që Shtetet Anëtare të veprojnë së bashku për të përballur rreziqet në rritje që vijnë nga kriminaliteti ndërkombëtar. Këshilli nënvizonte rëndësinë që ka bashkëpunimi gjyqësor në luftën kundër kriminalitetit ndërkufitar. Si rrjedhojë, lindte nevoja e fuqizimit të sistemeve juridike kombëtare për të bashkëpunuar ngushtësisht dhe për t'i kërkuar Këshillit për të përcaktuar se deri në çfarë pikë duhet të shtrihet njohja reciproke e vendimeve të gjykatave⁴.

Këshilli Evropian i Tamperës u zhvillua me 15-16 tetor 1999. Përfundimet e Këshillit parashikonin ndër të tjera në kuadrin e

¹ Corinne Gay, The European Arrest Warrant and its application by the Member States, Fondation Robert Schuman, European Issues, No 16, 20016, fq 1.

² Martina Lipani, Stefano Montaldo, I motivi ostativi all'esecuzione del Mandato D'arresto Europeo nella legge italiana di recepimento e la Corte di Cassazione: Uno sguardo di insieme, alla luce dei principi generali dell'ordinamento UE e della Giurisprudenza della Corte di Giustizia, 2017, fq 1-2.

³ Consiglio Europe di Cardiff, Conclusione della Presidenza, 15-16 giugno 1998.

⁴ Po aty, pika 39.

hapësirës së vërtetë evropiane të drejtësisë, një drejtësi akoma dhe më të arritshme nga qytetarët evropiane si dhe njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore. Përforcimi i njohjes reciproke të vendimeve gjyqësore dhe gjykimeve, si dhe përafrimi i nevojshëm i legjislacioneve do të lehtësonte bashkëpunimin mes autoriteteve. Këshilli Evropian miratonte parimin e njohjes reciproke, si gurin e themelit të bashkëpunimit civil dhe atij penal në gjirin e Bashkimit⁵. Në fushën penale, Këshilli Evropian vlerësonte se procedurat zyrtare të ekstradimit duhet të shfuqizohen mes Shteteve Anëtare për personat që mundoheshin t'i shpëtonin drejtësisë, pasi ishin dënuar me vendim përfundimtar.

Është më rëndësi që të kujtohet se Urdhri Evropian i Ndalimit kishte si precedent dhe model marrëveshjen e lidhur mes Italisë dhe Spanjës *"me qëllim ndjekjen të veprave të rënda ndërmjet tejkalimit të ekstradimit në një hapësirë të drejtësisë së përbashkët"*, e cila në nenin 1, në rubrikën *"Njohja reciproke e masave"*, parashikonte që palët do të njihnin në territorin e tyre vendimet e dënimit dhe të masave shtrënguese të lirisë të lëshuara nga pala tjetër dhe të merrnin masat për ekzekutimin e tyre⁶.

Puna përgatitore filloi në korrik të vitit 2000, pak më pak se një vit pas samitit të Tamperës. Në fillim kjo punë eci më ngadalë. Por, pas tentativave të 11 shtatorit 2001 kundër ShBA-së, Komisioni hartoi shumë shpejt një projektvendim-kuadër për Urdhrin Evropian të Ndalimit, në të cilin u përdor për herë të parë ky term⁷.

Këshilli Evropian i Laeken-it⁸ dha një shtysë përfundimtare në miratimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit. Përfundimet e

⁵ Pika 33 e Përfundimeve të Presidencës së Këshillit Evropian të Tamperës.

⁶ Giorgio Lattanzi Il mandato di arresto europeo nell'ordinamento italiano (Intervento all'Incontro trilaterale tra la Corte costituzionale italiana e i Tribunali costituzionali di Spagna e Portogallo, 16 novembre 2012, Lisbona) fq. 3.

⁷ Jean Pradel, Geert Corstens, Gert Vermeulen, E drejta Penale Evropiane, Papirus, 2009, fq 548.

⁸ European Council meeting in Laeken, 14-15 December 2001

Presidencës, në seksionin që kishte të bënte me luftën kundër terrorizmit, konfirmonin solidaritetin me popullin amerikan dhe komunitetin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Po ashtu Këshilli konsideronte draftmarrëveshjen për Urdhrin Evropian të Ndalimit një hap përpara. Përcaktimi i njëjtë i veprave penale që kishin të bënin me terrorizmin, hartimin e listave të terroristeve dhe organizatave terroriste, grupeve dhe njërive, bashkëpunimin ndërmjet specialisteve dhe dispozitat që kishin të bëjnë me ngrirjen e asetëve që miratuar nga Rezoluta 1373 e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, përbënin një përgjigje në praktikë në luftën kundër terrorizmit.⁹

Propozimi në lidhje me Urdhrin Evropian të Ndalimit¹⁰ u shpall nga Komisioni në 2001. Në përgatitjen e këtij propozimi, departamentet e Komisionit organizuan një sërë takimesh me ekspertë ligjorë, oficer ligjorë, akademikë, përgjegjës të ministrive përkatëse që kanë të bëjnë me ekstradimin¹¹.

Me 14/15 dhjetor të vitit 2001, nën ndikimin edhe të sulmeve terroriste u krijua Vendimi kuadër për Urdhrin Evropian të Ndalimit i cili përfaqëson rezultatin përfundimtar të një sërë ndryshimesh që kishte pësuar në kohë e hapësirë mekanizmi i ekstradimit¹².

II. Natyra juridike e Urdhrit Evropian të Ndalimit

Objektivi i Bashkimit Evropian është krijimi i një hapësire të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë duke sjellë shfuqizimin e ekstradimit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe zëvendësimin e tij me sistemin e

⁹ Po aty, pika 17

¹⁰ Commission of the European Communities, Proposal for a Council Framework Decision on the European arrest warrant and the surrender procedures between the Member States, Brussels, 19.9.2001 COM(2001) 522 final 2001/0215 (CNS)

¹¹ Po aty, pika 4.2

¹² Artan Hoxha, Ekstradimi dhe Urdhri Evropian i Ndalimit, Tiranë, 2011, fq. 196.

dorëzimit ndërmjet autoriteteve gjyqësore¹³.

Urdhri Evropian i Ndalimit u miratua si një vendim-kuadër, në bazë të nenit 31 pika a) dhe b) dhe nenit 34, paragrafi 2, pika b) të traktatit të Bashkimit Evropian.

Sipas përkufizimit të dhënë nga e drejta evropiane vendimet-kuadër janë të detyrueshëm për Shtetet Anëtare sa i përket rezultatit që duhet të arrijnë, por i lihet autoriteteve kombëtare për zgjedhjen e formës dhe metodave. Madje, Shtetet Anëtare kanë detyrimin për të interpretuar legjislacionin e brendshëm në përputhje me vendimet kuadër.

Në lidhje me detyrimin e Shteteve Anëtare për të interpretuar legjislacionin e brendshëm në përputhje me vendimet kuadër i referohemi më mirë çështjes *Pupino*¹⁴. Në këtë vendim Gjykata e Drejtësisë konfirmoi detyrimin e Shteteve Anëtare për ta interpretuar legjislacionin e brendshëm në përputhje me vendimet-kuadër. Ajo shmangu argumentin e parashtruar nga disa Shtete Anëtare që efekti i tërthortë i vendimeve-kuadër do të kishte një efekt *contra legem*. Gjykata vendosi që legjislacioni i shtyllës së tretë ishte përfundimisht i detyrueshëm dhe se Shtetet Anëtare zotoheshin për ta zbatuar atë në mënyrë korrekte. Përfundimisht, në opinionin e Gjykatës, parimi i konformitetit të interpretimit të legjislacionit të brendshëm, duhej të ishte në përputhje me vendimin-kuadër, i cili ishte miratuar në bazë të traktatit. Gjatë interpretimit të legjislacionit të brendshëm, gjykatat kombëtare duhej ta interpretonin legjislacionin në përputhje me vendimet-kuadër, me qëllim arritjen e rezultateve të kërkuara nga këto të fundit, por edhe nga vetë traktatet

Në lidhje me natyrën juridike të Urdhrit Evropian të Ndalimit,

¹³ Pika 5 e Preambulës së Vendimit Kuadër të Këshillit të 13 qershorit 2002, lidhur me Urdhrit Evropian të Ndalimit dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare, 2002/584/GAI

¹⁴ GJDK, çështja C-105/03, *Maria Pupino*, Vendim i datës 16.06.2005.

ka pasur kontestime, nga ana e Shteteve Anëtare, të cilat e kanë implementuar atë në sistemin e tyre të brendshëm.

Rasti konkret ishte pikërisht ai i shoqatës "Advocaten voor de Wereld"¹⁵. Kjo shoqatë kërkoi anulimin e ligjit belg që implementoi dispozitat e vendimit-kuadër mbi Urdhrin Evropian të Ndalimit, duke kontestuar instrumentin ligjor të përzgjedhur nga Këshilli, që sipas tyre duhet të ishte rregulluar me anë të një konvente dhe jo me anë të një vendimi-kuadër.

Sa më sipër, me anën e vendimit të saj, Gjykata e Drejtësisë konfirmoi vlefshmërinë e vendimit-kuadër mbi Urdhrin Evropian të Ndalimit, duke hedhur poshtë pretendimet e bëra në lidhje me natyrën e papërshtatshme të instrumentit ligjor të përdorur dhe shkeljes së supozuar të parimeve të ligjshmërisë dhe mosdiskriminimit.

Sa i përket pretendimit që objekti i Urdhri Evropian të Ndalimit duhet të ishte rregulluar me anë të një konvente dhe jo me anë të një vendimi-kuadër, Gjykata vuri re se neni 34 i Traktatit të Bashkimit Evropian nuk vendos ndonjë rend përparësie ndërmjet instrumenteve të ndryshëm të renditur në atë dispozitë, çka do të thotë se s'mund të përjashtohet që Këshilli mund të ketë një zgjedhje ndërmjet disa instrumenteve për të rregulluar të njëjtën lëndë, duke iu nënshtuar kufizimeve të vendosura nga natyra e instrumentit të zgjedhur. Megjithëse është e vërtetë se Urdhri Evropian i Ndalimit mund ishte subjekt i një konvente, por është në diskrecionin e Këshillit t'i japë përparësi instrumentit ligjor të vendimit-kuadër në rastin kur, si këtu, kushtet që rregullojnë miratimin e një mase të tillë janë të kënaqshme.

Gjykata vazhdoi edhe më tej, duke u shprehur se vendimi-kuadër, nga 1 janari 2004, zëvendësoi dispozitat përkatëse të konventave të mëparshme mbi ekstradimin, ndërmjet Shteteve

¹⁵ GJDK, çështja C-303/05, Advocaten voor de Wereld VZW v Leden van de Ministerraad, Vendim i datës 3 maj 2007.

Anëtare. Çdo interpretim tjetër i pambështetur në neni 34, paragrafi 2 të traktatit të Bashkimit Evropian ose nga ndonjë dispozitë tjetër e Traktatit të Bashkimit Evropian, do të privonte Këshillin në ushtrimin e kompetencave të tij për të miratuar vendime-kuadër në fushat e qeverisura më parë nga konventat ndërkombëtare.

Përfundimisht, gjykata hodhi poshtë pretendimet në lidhje me paligjshmërinë e instrumentit të përdorur duke lënë në fuqi vendimin-kuadër në lidhje me Urdhrin Evropian të Ndalimit.

Siç u përmend edhe më lart, vendimi-kuadër i Këshillit në lidhje me “Urdhrin Evropian të Ndalimit dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare” u miratua më 13 qershor 2002 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2004. Urdhri Evropian i Ndalimit zëvendësoi procedurat e ekstradimit ndërmjet Shteteve Anëtare.

Sipas nenit 31, paragrafi 1 të vendimit-kuadër, dispozitat e këtij zëvendësuan, nga 1 janari 2004, dispozitat korresponduese të konventave të mëposhtme të zbatueshme në fushën e ekstradimit në marrëdhëniet ndërmjet Shteteve Anëtare. Konkretisht ky vendim-kuadër zëvendësoi:

Konventën Evropiane “Për Ekstradimin”¹⁶, Protokollin e saj shtesë¹⁷, protokollin e saj të dytë shtesë¹⁸ dhe të Konventa Evropiane “Për shtypjen e terrorizmit”¹⁹ për sa i përket ekstradimit

Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Anëtare të Komunitetit Evropian mbi thjeshtimin dhe modernizimin e metodave të transmetimit të kërkesave për ekstradim²⁰;

Konventën “Për procedurën e thjeshtuar të ekstradimit ndërmjet

¹⁶ Miratuar më 13 dhjetor, 1957.

¹⁷ Miratuar më 15 tetor, 1975.

¹⁸ Miratuar më 17 mars, 1978.

¹⁹ Miratuar më 27 janar, 1977.

²⁰ Miratuar më 16 maj, 1989.

Shteteve Anëtare të BE-së”²¹; dhe

Konventën ”Për ekstradimin ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian”²²;

Konventën e 19 qershorit 1990 në zbatim të Marrëveshjes Shengen të 14 qershorit 1985 ”Mbi heqjen graduale të kontrolleve në kufijtë e përbashkët”.²³

Mekanizmi i Urdhrit Evropian të Ndalimit bazohej në një nivel të lartë të besimit ndërmjet Shteteve Anëtare. Zbatimi i një mekanizmi të tillë mund të pezullohej vetëm në raste të shkeljeve të rënda të vazhdueshme të dhunimit nga ana e një Shteti Anëtar të parimeve të parashikuara nga neni 6, paragrafi 1, i Traktatit të Bashkimit Evropian.²⁴ Shtetet Anëtare e ekzekutojnë çdo Urdhër Evropian Ndalimi mbi bazën e parimit të njohjes së ndërsjellë dhe në përputhje me dispozitat e këtij vendimi-kuadër.²⁵

III. Rëndësia e Urdhrit Evropian të Ndalimit dhe përparësitë e tij. Disa nga ndryshimet mes tij dhe ekstradimit

Vendimi-kuadër ka pasur tri qëllime kryesore: së pari, të reduktojë kohën për ekstradimin e personit nga një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian në një tjetër; së dyti, duke krijuar këtë strukturë të bëjë më të vështirë që personat e dyshuar ose të dënuar t’i shpëtojnë drejtësisë; së treti, të balancojë të drejtën e lëvizjes brenda Bashkimit Evropian me masat e duhura për të zvogëluar abuzimet më këtë privilegj.²⁶

Urdhri Evropian i Ndalimit solli disa të reja të rëndësishme krahasuar me procedurën e ekstradimit të parashikuar nga konventat

²¹ Miratuar më 10 mars, 1995.

²² Miratuar më 27 shtator, 1996.

²³ Miratuar më Titulli 3, Kapitulli 4 i Konventës.

²⁴ Pika 10, Preambulës së Vendimit-Kuadër.

²⁵ Neni 1, paragrafi 2 i Vendimit-kuadër.

²⁶ Senior European Experts | The experts’ briefing, The European Arrest Warrant, 2011, fq 2.

mbi ekstradimin, por që në vetvete përbëjnë edhe nevojën për miratimin e tij. Si të tilla mund të përmendim:

i. *Heqja e parimit të inkriminimit të dyfishtë për disa kategori veprash penale.*

Neni 1, paragrafi 1 e kufizon Urdhrin Evropian të Ndalimit si një vendim gjyqësor lëshuar nga një Shtet Anëtar për arrestimin dhe dorëzimin në një Shtet tjetër Anëtar të personit të kërkuar, me qëllimin e ndjekjes penale, të ekzekutimit të dënimit ose një mase sigurie me privimin e lirisë.

Autoritetet gjyqësore lëshuese kompetente mund të lëshojnë Urdhrin Evropian të Ndalimit në rastet e mëposhtme²⁷:

-për kryerjen e ndjekjes penale apo gjykimit, nëse vepra penale ndëshkohet nga ligji i shtetit lëshues me heqje lirie, së paku, prej 12 muaj;

-për ekzekutimin e një mase sigurie me heqje lirie më lartë se 12 muaj;

-për ekzekutimin e një dënimi, nëse dënimi i dhënë me vendim gjyqësor është me lartë se 4 muaj.

E reja më e rëndësishme që solli Urdhri Evropian i Ndalimit ka të bëjë pikërisht me kategorinë prej 32 veprash penale të parashikuara nga neni 2, paragrafi 2. Këto vepra penale janë konkretisht:

- pjesëmarrja në organizatë kriminale;
- terrorizmi;
- trafikimi i qenieve njerëzore;
- shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe pedopornografia;
- trafiku i paligjshëm i drogave dhe i lëndëve psikotrope;

²⁷ Neni 2, paragrafi 1 i Vendimit-kuadër.

- trafiku i paligjshëm i armëve, municioneve ose eksplozivëve; - korrupsioni;

- mashtrimi, përfshirë mashtrimin që cenon interesat financiare të Komuniteteve Evropiane, sipas asaj që parashikohet në Konventën e 26 korrikut 1995, në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane;

- pastrimi i parave që rrjedhin nga krimet;

- falsifikimi i parave, përfshirë edhe falsifikimin e euros; - kiberkriminaliteti;

- krimet kundër mjedisit, përfshirë edhe trafikun e paligjshëm të specieve të kafshëve dhe trafikun e paligjshëm të llojeve dhe esencave bimore të kërcënuara;

- dhënia e ndihmës për hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm;

- vrasja me dashje, plagosjet e rënda;

- trafikimi i paligjshëm i organeve dhe i pjesëve të tjera të trupit të njeriut;

- marrja peng, sekuestrimi dhe zënia e pengjeve;

- racizmi, ksenofobia;

- vjedhje të organizuara me armë;

- trafiku i paligjshëm i objekteve me vlera kulturore;

- vjedhja me mashtrim;

- vjedhja e parave me ushtrim dhune dhe presioni;

- falsifikimi i dokumenteve zyrtare dhe trafikimi;

- falsifikimi i mjeteve të pagesës;

- falsifikimi i paligjshëm i substancave hormonale dhe lëndëve të tjera të rritjes;

- trafikimi i paligjshëm i lëndëve bërthamore dhe radioaktive;

- trafikimi i automjeteve të vjedhura; - përdhunimi;
- zjarrvënia e qëllimshme;
- krime që janë nën juridiksionin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare;
- rrëmbimi i avionëve dhe i anijeve; - sabotazhi.

Për veprat e mësipërme, kryhet dorëzimin në bazë të Urdhrit Evropian të Ndalimit, sipas kushteve të parashikuara nga vendimi-kuadër dhe pavarësisht inkriminimit të dyfishtë. Mjafton që këto vepra penale të jenë të parashikuara si të tilla nga legjislacioni i Shtetit Anëtar lëshues me një dënim ose privim me heqje lirie të barabartë, ose më të lartë se 3 vjet.

Sipas nenit 2, paragrafi 3, është në të drejtën e Këshillit, për të përfshirë kategori të tjera veprash penale në listën e lartpërmendur.

E reja më e rëndësishme e Urdhrit Evropian të Ndalimit qëndron pikërisht në heqjen e parimit të inkriminimit të dyfishtë, i cili është parimi thelbësor i parashikuara nga procedura e ekstradimit.

Nëse i referohemi nenit 2, paragrafi 1, i Konventës së Ekstradimit²⁸, ajo parashikon që i japin shkas ekstradimit veprat që ndëshkohen nga ligjet e Palës kërkuuese dhe të Palës së kërkuar me privimin e lirisë ose me një masë sigurimi privuese të lirisë, e shumta, deri në një vit ose edhe më të rëndë.

Sa më sipër, dallimi i parë dhe thelbësor ndërmjet Urdhrit Evropian të Ndalimit dhe ekstradimit është pikërisht heqja e parimit të inkriminimit të dyfishtë për listën e parashikuar më lart të veprave penale.

Lista e mësipërme ka pasur kontestime. Së pari, lista e mësipërme është konsideruar heteroklite dhe, së dyti, cilësimet janë më shumë të fushës së kriminologjisë sesa të fushës juridike, që do të

²⁸ Konventa Evropiane e Ekstradimit, Paris, 13 dhjetor 1957.

thotë se nuk janë shumë të sakta²⁹.

Në lidhje me parimin e inkriminimit të dyfishtë unë mendoj se, pavarësisht se cilësimet janë më shumë të fushës së kriminologjisë sesa të fushës juridike, kategoritë e veprave penale të parashikuara me lart, parashikohen në të gjitha legjislacionet e brendshme penale të Shteteve Anëtare. Edhe nëse nuk janë parashikuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi-kuadër, me ndryshimet legjislative ato duhet të jenë parashikuar tashmë.

Për veprat penale, të cilat nuk janë të parashikuara nga neni 2, paragrafi 2, dorëzimi mund të behet me kusht që faktet për të cilat është lëshuar Urdhri Evropian i Ndalimit përbëjnë vepër penale sipas ligjit të Shtetit Anëtar ekzekutues, pavarësisht elementeve konstitutive ose kualifikimit të vetë atij³⁰.

ii. Heqja e shtetësisë si motiv i detyrueshëm për të mos ekzekutuar Urdhrin Evropian të Ndalimit

Vendimi-kuadër në nenet 3 dhe 4 parashikon motivet e detyrueshme dhe ato fakultative të mosekzekutimit të Urdhrit Evropian të Ndalimit.

Ndër motivet e mosekzekutimit të detyrueshëm të Urdhrit Evropian të Ndalimit janë:

- kur vepra penale për të cilën është lëshuar Urdhri Evropian i Ndalimit është amnistuar në Shtetin Anëtar të ekzekutimit, nëse ky i fundit ishte kompetent për të ndjekur veprën penale;

- në bazë të informacionit të autoriteteve gjyqësore të ekzekutimit rezulton se personi i kërkuar është gjykuar me vendim përfundimtar nga një Shtet Anëtar me kusht që, në rast dënimi, dënimi është zbatuar ose është në fazë të ekzekutimit, ose nuk mund të ekzekutohet sipas ligjit të Shtetit Anëtar të dënimit;

²⁹ Jean Pradel, Geert Corstens, Gert Vermeulen, E drejta Penale Evropiane, Papirus, 2009, fq. 553.

³⁰ Neni 2, paragrafi 4 i Vendimit-kuadër.

- nëse personi subjekt i Urdhrit Evropian të Ndalimit, për shkak të moshës, nuk mban përgjegjësi penale, sipas ligjit të Shtetit Anëtar ekzekutues.

Ndërsa neni 4 parashikon motivet e mosekzekutimit fakultativ të Urdhrit Evropian të Ndalimit. Sipas këtij neni, autoriteti gjyqësor i ekzekutimit mund të refuzojë ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit ndër të tjera, në rastet kur:

-përpos veprave penale të parashikuara nga neni 2, paragrafi 2, vepra penale nuk konsiderohet si e tillë sipas ligjit të Shtetit Anëtar ekzekutues, përjashtim përbëjnë veprat penale në fushën e doganave dhe të taksave;

-nëse kundër personit subjekt i Urdhrit Evropian të Ndalimit është në proces ndjekja penale në Shtetin Anëtar të ekzekutimit për të njëjtat fakte, për të cilat është lëshuar Urdhri Evropian i Ndalimit;

-nëse autoritetet gjyqësore të Shtetit Anëtar ekzekutues kanë vendosur mosekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit për veprën penale objekt të Urdhrit.

-nëse ndjekja penale ose dënimi janë parashkruar sipas legjislacionit të Shtetit Anëtar ekzekutues;

-në bazë të informacioneve nga autoriteti gjyqësor i ekzekutimit rezulton që personi i kërkuar është gjykuar me vendim të formës së prerë për të njëjtat fakte në një shtet të tretë me kusht që, në rast dënimi, dënimi është ekzekutuar ose është në fazë ekzekutimi, ose nuk mund të ekzekutohet sipas ligjit të shtetit të dënimit;

-në rastet kur Urdhri Evropian i Ndalimit është lëshuar me qëllim të ekzekutimit të një dënimi ose të një masë sigurie me privim të lirisë, atëherë kur personi i kërkuar është shtetas ose rezident, nëse Shteti merr përsipër ekzekutimin e një dënimi ose mase sigurie sipas së drejtës së tij të brendshme;

-nëse Urdhri Evropian i Ndalimit parashikon vepra penale që nga ligji i Shtetit Anëtar të ekzekutimit konsiderohen të kryera tërësisht

ose pjesërisht në territorin e tij, ose në një vend të njëjtë me territorin e tij, ose që janë kryer jashtë territorit të tij të shtetit anëtar lëshues, nëse Shteti Anëtar i ekzekutimit nuk parashikon ndjekjen penale për të njëjtat vepra jashtë territorit të tij.

Nëse i krahasojmë Urdhrin Evropian të Ndalimit me konventën Evropiane në këtë pikë mund shohim këto ndryshime:

Shtetet të cilat kanë ratifikuar konventën mbi ekstradimin kanë të drejtë për të mos lejuar ekstradimin e shtetasve të tyre, pra, ekstradimi është i lidhur ngushtësisht me shtetësinë. Neni 6, paragrafi 1, pika a) e konventës, parashikon që çdo palë kontraktuese do të ketë të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të vet. Kjo rregull kufizues ishte i kuptueshëm në një epokë kur mbizotëronte mosbesimi në marrëdhëniet ndërkombëtare³¹.

Diçka e tillë nuk është e parashikuar në motivet e mosekzekutimit të detyrueshëm të Urdhrit Evropian të Ndalimit, por parashikohet nga neni 4, pika 6 e motive të mosekzekutimit fakultativ të Urdhrit Evropian të Ndalimit, nëse Shteti merr përsipër ekzekutimin e një dënimi ose mase sigurie sipas së drejtës së tij të brendshme

Shtetësia nuk është një kusht i qenësishëm për të mos ekzekutuar Urdhrin Evropian të Ndalimit.

Në ndryshim nga Urdhri Evropian i Ndalimit, konventa mbi ekstradimin nuk lejon ekstradimin për shkelje politike (neni 3), shkelje ushtarake (neni 4), shkelje financiare (neni 5).

iii. Autoritetet lëshuese dhe ekzekutuese të Urdhrit Evropian të Ndalimit

Objektivi themelor i Urdhrit Evropian të Ndalimit është, thjeshtëzimi dhe përsheptimi ndërmjet procedurës gjyqësore që bazohet në parimin e njohjes reciproke të vendimeve dhe që përbën

³¹ Jean Pradel, Geert Corstens, Gert Vermeulen, E drejta Penale Evropiane, Papirus, 2009, fq. 551.

gurin e themelit të bashkëpunimit gjyqësor³².

Urdhri Evropian i Ndalimit përcakton se cilat janë autoritetet gjyqësore kompetente dhe cilat janë autoritetet qendrore. Sipas nenit 6, paragrafi 1 për autoritete gjyqësore lëshuese nënkuptohen autoritetet gjyqësore të Shtetit Anëtar lëshues që, në bazë të ligjit të Shtetit, janë kompetente për të lëshuar një Urdhër Evropian Ndali. Ndërsa neni 6, paragrafi 2 parashikon për autoritete gjyqësore ekzekutuese, autoritetet gjyqësore të Shtetit Anëtar ekzekutues, që në bazë të ligjit të Shtetit, është kompetent për të ekzekutuar Urdhrin Evropian të Ndalimit.

Gjyqtari kthehet në lojtarin kryesor në zbatimin e Urdhrit.³³

Ndërsa neni 7, paragrafi 1, parashikon autoritetet qendrore, duke i dhënë çdo Shteti Anëtar për të përcaktuar autoritetin ose, kur sistemi juridik e parashikon, autoritete për të asistuar autoritetet gjyqësore në bazë të së drejtës së tij të brendshme.

Në lidhje me transmetimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit, neni 9 parashikon procedurën e hollësishme. Nëse vendi në të cilin gjendet i kërkuari dihet, autoriteti gjyqësor lëshues mund të komunikojë Urdhrin Evropian të Ndalimit direkt autoritetit gjyqësor të lëshimit. Autoriteti gjyqësor lëshues mundet, në çdo rast, të vendosë të shënojë personin e kërkuar në Sistemin Informatik “Shengen”. Shprehja më e rëndësishme në këtë nenë është ajo direkt, që do të thotë komunikim i drejtpërdrejtë përmes autoriteteve gjyqësore lëshuese dhe ekzekutuese.

Megjithatë neni 10, paragrafi 2 parashikon që autoritetet gjyqësore lëshuese nëse dëshirojnë mund të transmetojnë Urdhrin Evropian të Ndalimit, përmes sistemit të mbrojtur

³² Daniela Savy, La tutela dei diritti fondamentali ed il rispetto dei principi generali del diritto dell’Unione nella disciplina dell’arresto europeo, 2012, fq. 4.

³³ Corinne Gay, The European Arrest Warrant and its application by the Member States, Fondation Robert Schuman, European Issues, No 16, 20016, fq. 5.

telekomunikativ të Rrjetit Gjyqësor Evropian.

Procedura e mësipërme lidhur me transmetimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit, ka lidhje pikërisht me ekzekutimin e shpejtë të Urdhrit Evropian të Ndalimit.

Në ndryshim nga procedura e transmetimit të Urdhrit Evropian të Ndalimit që kalon përmes organeve gjyqësore, ajo e ekstradimit kalon përmes rrugës diplomatike. Konkretisht neni 12, paragrafi 1, parashikon që kërkesa formulohet me shkrim dhe paraqitet me rrugë diplomatike.

iv. Afatet kohore në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit

Një Urdhër Evropian duhet të trajtohet me "*urgjencë të madhe*". Ky është termi i përdorur nga neni 17, paragrafi 1.

Në rastet kur i kërkuari jep pëlqimin e tij, vendimi përfundimtar mbi ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit duhet të merret brenda 10 ditëve nga komunikimi i pëlqimit. Në raste të tjera, vendimi përfundimtar mbi ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit duhet të merret brenda 60 ditëve nga arrestimi i të kërkuarit.

Kur Urdhri Evropian i Ndalimit nuk mund të ekzekutohet brenda afateve kohore të parashikuara më lart, autoriteti gjyqësor ekzekutues njofton menjëherë autoritetin gjyqësor lëshues për motivet. Në këto raste afatet mund të shtyhen me 30 ditë.

Megjithatë, ajo çfarë theksohet nga vendimi-kuadër, është që nëse refuzohet Urdhri Evropian i Ndalimit, duhet të jepen gjithmonë motivet³⁴.

Në lidhje me konventën për ekstradimin, nuk parashikon afate të tilla kohore.

³⁴ Neni 17, paragrafi 6 i Vendimit-kuadër.

Përfundime

Urdhri Evropian i Ndalimit konsiderohet si instrumenti më i mirë i parimit të njohjes reciproke ndërmjet Shteteve Anëtare, pavarësisht diskutimeve që ngjalli gjatë fazës së miratimit, por edhe të implementimit në legjislacionet e brendshme të Shteteve Anëtare. Urdhri Evropian i Ndalimit është një vendim gjyqësor, i cili lëshohet nga një autoritet gjyqësor lëshues drejt një autoriteti gjyqësor ekzekutues. E reja e rëndësishme që solli Urdhri Evropian i Ndalimit ishte lista prej 32 kategorish veprash penale, për të cilat nuk kërkohet parimi i inkriminimit të dyfishtë, por mjafton që ato të parashikohen nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Anëtar lëshues. Mosekzekutimi i Urdhrit Evropian të Ndalimit nuk është i lidhur me shtetësinë, në ndryshim nga konventa evropiane mbi ekstradimin, e cila parashikon që shtetet kanë të drejtë për të mos lejuar ekstradimin e shtetasve të vet. Po ashtu Urdhri Evropian i Ndalimit parashikon që ekzekutimi i Urdhrit Evropian të Ndalimit kalon përmes organeve gjyqësore. Afatet kohore në lidhje me ekzekutimin e tij janë më të shkurtra se ato të parashikuara nga konventa mbi ekstradimin. Urdhër Evropian i Ndalimit parashikon që ai duhet të trajtohet me "*urgjencë të madhe*".

Sa më sipër, rëndësia e tij në kuadrin e Bashkimit Evropian ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje dhe kjo konkretizohet me numrin e madh të Urdhrave Evropian të lëshuar dhe atyre të ekzekutuar.

Bibliografia

- Hoxha, A. (2011). *Ekstradimi dhe Urdhri Evropian i Ndalimit*, Tiranë.
- Pradel, J., Corstens, G., Vermeulen, G. (2009). *E drejta Penale Evropiane*, Papirus.
- Gay, C. (2016). *The European Arrest Warrant and its application by the Member States , Fondation Robert Schuman, European Issues*, No 16.
- Lattanzi, G. (2012). *Il mandato di arresto europeo nell'ordinamento italiano (Intervento all'Incontro trilaterale tra la Corte costituzionale*

italiana e i Tribunali costituzionali di Spagna e Portogallo, 16 novembre 2012, Lisbona)

Lipani, M., Montaldo, S. (2017). *I motivi ostativi all'esecuzione del Mandato D'arresto Europeo nella legge italiana di recepimento e la Corte di Cassazione: Uno sguardo di insieme, alla luce dei principi generali dell'ordinamento UE e della Giurisprudenza della Corte di Giustizia.*

Savy, D. (2012). *La tutela dei diritti fondamentali ed il rispetto dei principi generali del diritto dell'Unione nella disciplina del mandato d'arresto europeo.*

Senior European Experts, The experts' briefing, The European Arrest Warrant, 2011.

Commission of the European Communities, Proposal for a Council Framework Decision on the European arrest warrant and the surrender procedures between the Member States, Brussels, 19.9.2001 COM(2001) 522 final 2001/0215 (CNS).

Consiglio Europe di Cardiff, Conclusione della Presidenza, 15-16 giugno 1998. European Council meeting in Laeken, 14-15 december 2001.

Decisione Quadro del Consiglio del 13 giugno 2002 relativa al mandato d'arresto europeo e alle procedure di consegna tra Stati membri (2002/584/GAI).

Përfundimeve të Presidencës së Këshillit Europian të Tamperës, 1999 Konventa Evropiane e Ekstradimit, Paris, 13 dhjetor 1957.

GJDKE, çështja C-105/03, *Maria Pupino*, Vendim i datës 16.06.2005.

GJDKE, çështja C-303/05, *Advocaten voor de Wereld VZW v Leden van de Ministerraad*, Vendim i datës 3 maj 2007.

VALBONA DURI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

BILAL DRACI

Universiteti i Tiranës

IRENA BOBOLI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

**MARRËDHËNIET SHQIPËRI-KINË (1956-1978)
NGA ASPEKTI EKONOMIK : NDIHMAT DHE
KREDITË KINEZE, SPROVË PËR KRONOLOGJI
DHE HARTIFIKIM**

ABSTRACT

Albania, since the beginning of diplomatic relations with China, it turned towards economic cooperation (not only in its requests for nutrition aid and consumer goods), which consolidated after the 1960s until the first half of the 1970s. During this period, protocols of grand economic importance signed, especially for Albania. The establishment and development of economic relations between the two countries was based on ideological and political principles. In this point of view the political and economic cooperation follows the same line in terms of alliance between the two countries. On this basis, the number of signed agreements began increasing, which really helped the Albanian economy on its mostly difficult years.

In this article, aid and loans Chinese are presenting in chronological term of allocation, of their distribution according to the structure of economic sectors: agriculture, industry (hydropower, metallurgical, chemical works), etc. It is necessary to underline an important aspect in this context that they are presented even cartographically, in the dimension of their spatial extent, geographical.

1. Tiparet e bashkëpunimit Shqipëri-Kinë në fushën ekonomike

Hapat e para të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kinës u hodhën menjëherë mbas fitores së revolucionit në Kinë dhe mbas formimit të qeverisë kineze në vitin 1949. Qeveria shqiptare e njohu Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës dhe i propozoi asaj lidhjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Ndërsa përfaqësuesit diplomatikë nuk u shkëmbyen deri në vitin 1954. Me shkëmbimin e ambasadorëve në këtë vit, Shqipëria dhe Kina parashikuan se lidhjet e miqësisë dhe të bashkëpunimit do të bëheshin më të ngushta në vitet në vazhdim më shumë për arsye ideologjike e politike. Me ndërprerjen e marrëdhënieve sovjetiko – shqiptare, ku shumë nga marrëveshjet dhe planet ekonomike do të mbeteshin të papërfunduara, Shqipëria e kishte shumë të vështirë mbijetesën në këto kushte dhe për këtë arsye duhet të gjente një zgjidhje. Referuar faktit që Kina kishte treguar interes për bashkëpunim, qeveria shqiptare mendoi të shfrytëzonte bashkëpunimin dhe ndihmën kineze dhe në këtë mënyrë do të mund të dilte nga situata e vështirë e pasndërprerjes së marrëdhënieve me Rusinë, si në aspektin politik ashtu dhe në zhvillimin ekonomik. Në mënyrë të përgjithshme bashkëpunimi shqiptaro - Kinez është karakterizuar nga disa tipare:

➤ Si fillim duhet thënë se kjo ish një aleancë e veçantë (e pabarabartë) referuar fakteve gjeografike (vendet më të skajshmet e bllokut socialist, një distancë e largët gjeografike), përmasave territoriale, diferencave historike dhe kulturore si dhe nga fuqia (një kontrast i theksuar në aftësitë ekonomike).

Kjo aleancë, me pazakontësinë e saj dhe bashkëpunimin dypalësh në fushën politike, ekonomike dhe ushtarake ka rezultuar të jetë aleanca më e gjatë e pabarabartë në historinë e politikës së jashtme të shtetit shqiptar që vazhdoi të surprizonte gjithë bllokun komunist.

➤ Në bashkëpunimin shqiptaro-kineze evidentohet shumë qartë se faktor përcaktues i nivelit të marrëdhënieve ekonomike ishin marrëdhëniet politike dhe ideologjike midis të dy partive dhe qeverive përkatëse të Shqipërisë dhe Kinës. Pra bashkëpunimi politik dhe ai ekonomik ecën në të njëjtën linjë përsa i përket aleancës mes dy vendeve. Një mendim i tillë përforcohet edhe në një nga deklaratat e Cu En Lait ku thuhet: "Megjithëse të dy vendet tona gjenden me mijëra milje larg njëri - tjetrit, baza jonë ideologjike e përbashkët dhe qëllimet e përbashkëta të luftës sonë, e kanë çimentuar miqësinë vëllazërore të dy popujve tanë".¹ Ekonomia ishte instrumenti që synonte realizimin e parimeve politike dhe ideologjike të cilat vinin të parat dhe ekonomia pas tyre. Pra të dy vendet i qëndruan "besnikë tezës mbi prioritetin e politikës ndaj ekonomisë, ata e panë politikën si shprehje të koncentruar të ekonomisë, si përgjithësim dhe shprehje e detyrave themelore të zhvillimit ekonomik sepse ishte ajo që orientoi zhvillimin e shoqërisë në rrugën socialiste."² Gjatë kësaj kohe Shqipëria dhe Kina shërbyen si një shembull i qartë i solidaritetit socialist në bllokun komunist.

➤ Shqipëria, që në fillimin e lidhjeve diplomatike me Kinën u drejtua herët drejt një bashkëpunimi ekonomik dhe jo vetëm në kërkesat e saj për ndihma ushqimore dhe mallra konsumi. Megjithatë, deri në vitet '60 nuk u formua një eksperiencë e mjaftueshme sa i përket ndihmave ekonomike, të cilat u konsoliduan pas viteve 1960 deri në gjysmën e parë të viteve 70. Në këtë periudhë u nënshkruan edhe protokolle me rëndësi të madhe ekonomike, sidomos për Shqipërinë.

➤ Bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kinës përfshiu të gjitha fushat. Kina ishte një partner model për Shqipërinë, e cila e

¹ Kreka, A. Marrëdhëniet Shqipëri-Kinë gjatë viteve 1960-1978, Tiranë, 2015

² Rruga e Partisë, "T" i trajtojmë dhe t'i zgjidhim politikisht problemet ekonomike", Po aty, nr 5, Maj 1966, 5.

ndihmoi për të ecur para, ndërsa Shqipëria i shërbeu aleancës duke bërë rolin e “përfaqësuesit” pranë organizatave ndërkombëtare.

➤ Ndihma kineze ka qënë faktori themelor për krijimin dhe qëndrueshmërinë e aleancës, po aq i rëndësishëm sa edhe faktorët e tjerë politikë dhe ideologjikë, si frika e rrëzimit të udhëheqjes komuniste shqiptare nga sovjetikët, tensionet e Shqipërisë me vendet fqinje si Greqia dhe Jugosllavia, ideologjia “e drejtë” marksiste - leniniste, ndihmat e nevojshme ekonomike, fryma antiperëndimore etj.

➤ Ndihamat e kreditë, në fillimet e marrëdhënieve ekonomike mes Kinës dhe Shqipërisë, nuk u mbështetën në mundësitë dhe aftësitë reciproke, sidomos për realizimin e projekteve të ndërtimit. Të dy vendet trashëguan një prapambetje të thellë ekonomike. Të dy vendeve do t’u duhej një farë kohe që të formulonin politikën e ndërtimeve dhe zhvillimit intensiv e ekstensiv, me qëllim adresimin e nevojave dhe të mundësive të financimit të objekteve industriale të prodhimit e shërbimit.

➤ Nga bilanci i përfitimeve të aleancës mes Shqipërisë dhe Kinës, mund të themi se përfitimet e Kinës nuk u justifikuan me shpenzimet që ajo bëri.

➤ Zhvillimi ekonomik bazohej në parimin ideologjik komunist: “**zhvillimit të pavarur**”, (parim i cili më vonë me prishjen edhe të marrëdhënieve me Kinën do të avanconte deri në absurdin – mbështetje në forcat e veta), ku bujqësia ishte dega bazë e ekonomisë, ndërsa industria si dega udhëheqëse (drejtuese që rrit pavarësinë e vendit). Për pasojë ky sektor mori më shumë investime: në objekte, materiale, makineri, pajisje etj, ku ritmet e zhvillimit të industrisë ishin më të larta se ato të zhvillimit të bujqësisë, dhe baza e industrisë së rëndë u fokusua drejt industrisë minerare dhe lëndëve djegëse si dhe më vonë tek industritë përpunuese/prodhuese dhe prodhimit të mjeteve prodhuese të tipit të fabrikave, uzinave deri kombinatë (shih më poshtë..).

- Gjeografia e investimeve përcaktohej nga parimet tona kombëtare (të zbutjes së pabarazive hapësinore, depërtimit më në thellësi të vendit, afrimit pranë lëndëve të para dhe tregut.
- Zhvillimi i bashkëpunimit bazohej në shkëmbimin deri në marrje shabllon (kopjim) modelesh ekonomike, të tipit vepra të mëdha e njohur me termin gjigandomania, me rezultate dhe efektivitet të diskutueshëm (fitimprurës për ne).
- Disa ishin ndihma dhuratë dhe investime pa synim përfitimi ekonomik. Ndërsa disa të tjera për përfitime reciproke. Eksportet bazoheshin kryesisht lëndë të minerale dhe prodhime bujqësore.
- Një rezultat tjetër nga aspekti ekonomik si tipar tjetër mbetet fakti “borxhe të pakthyeshme” me Kinën.
- Periudha e bashkëpunimit, pavarësisht aspekteve ideologjike të kohës rezultoi positive si në planin ekonomik ashtu dhe të marrdhënieve ndërkombëtare, pasi Shqipëria, por dhe Kina njohu zhvillime e progress kombëtar e ndërkombëtar.
- Bazuar në dokumentacionin e kohës, ndihmat kineze rezultuan të ishin vendimtare për ecurinë e ekonomisë shqiptare. Pesëvjecarët e zhvillimit socialist të Shqipërisë (1961-1975), të cilët synuan industrinë e rëndë, u dedikohen kryesisht ndihmave kineze.

2. Marrëdhëniet ekonomike dypalëshe gjatë viteve 1950 – 1975 (kronologjia)

Bashkëpunimi me Kinën ka filluar që gjatë viteve '50. Pas vdekjes së Stalinit, Shqipëria po shihte mundësinë e një rruge tjetër për të siguruar ndihma apo kredi, krahas bashkëpunimit me BRSS. Në 3 dhjetor 1955 u nënshkrua në Tiranë marrëveshja bazë mbi shkëmbimin e mallrave, por edhe shumë marrëveshje të tjera, në bazë të të cilave (që nga viti **1956 – 1960**) çdo vit përfundoheshin protokolle mbi këmbimin e mallrave dhe të pagesave. Nga viti në vit rritej import – eksporti me RP të Kinës.

Për herë të parë, qeveria kineze i dha kredi qeverisë

shqiptare në shumën prej 30 milion rublash sovjetike në janar 1956.³ Kina kompesoi humbjen që iu shkaktua Shqipërisë nga prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Ndhimat ekonomike që Kina i dha Shqipërisë ishin një mbështetje e madhe për ekonominë shqiptare. Ajo e furnizoi vendin me një numër të madh materialesh për pjesë këmbimi, të mira materiale dhe të tjera, të cilat i ishin premtuar Shqipërisë nga Moska. Kreditë e dhëna nga Kina u përdorën për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Ndihma ekonomike e Kinës kontribuoi në realizimin e planit të III-të pesëvjeçar (1961-1965), i cili synonte zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së rëndë, prandaj kredia e dhënë nga Kina do të përdorej për blerje ndërmarrjesh, makinerish, pajisje dhe mallra të shumtë. Ky realizim i planit u bë i mundur në sajë të nënshkrimit të marrëveshjes për këmbime mallrash mes dy vendeve. PK e Kinës kishte deklaruar se ekonomisë shqiptare do t'i akordohej ndihmë ekonomike pa rezerva. Ky bashkëpunim reciprok nisi një epokë të re të lidhjes dhe forcimit të marrëdhënieve me Kinën, duke iu përmbajtur interesave dypalëshe të tyre.

Në total për vitin 1959 Kina i ka dhënë Shqipërisë “35.000.000 rubla dhe për vitin 1961 500.000.000 rubla”. Në fushën ekonomike, Kina do të përmbushte një nga planet më të mëdha të Shqipërisë për të ndërtuar 25 vepra industrisë kimike, metalurgjisë, energjetikës, ndërtimit, industrisë së lehtë etj, gjatë viteve 1962-1965. Disa nga projektet më të rëndësishme ishin: “hidrocentrali i Matit dhe Bistricës, uzina metalurgjike e bakrit në Kukës dhe Rubik, uzina e autotraktorëve në Tiranë, uzina e Tekstilit në Berat dhe rafineria e naftës në qytetin Stalin”.⁴ **Në vitin 1963 Kina i akordoi Shqipërisë një kredi prej 25 milion rublash.**

Në vitin 1965, nënshkruhet marrëveshja për dhënien e kredisë nga Kina Shqipërisë të ndihmës teknike dhe pajisjeve të plota,

³ Po aty

⁴ Biberaj. Albania, 60.

pajisjeve dhe makinerive të veçanta, materialeve të ndryshme si dhe marrëveshja mbi shkëmbim gjatë viteve 1966-1970.⁵

Plani i IV pesëvjeçar (1966 – 1970) rezultoi më efektiv se i mëparshmi falë ndihmave bujare kineze, të cilat llogariten të kenë qenë “450 mln \$ dhe që kanë ndihmuar në kapërcimin e vështirësive të mëdha financiare”.⁶

Prodhimi industrial kundrejt pesëvjeçarit të tretë kish rritje prej 46-50 %, ndërsa prodhimi bujqësor, një rritje prej 41-46%.⁷ Këto rritje dhe arritje njëkohësisht nuk mund të realizoheshin pa ndihmën e Kinës, e cila nuk ishte vetëm në vlerë monetare por ajo synonte ta ndihmonte Shqipërinë edhe në projektimin, ndërtimin dhe montimin e këtyre ndërmarrjeve. Kredia ishte afatgjatë dhe afati i shlyerjes së saj fillonte dhe mbaronte në vitet 1981- 1990.

Edhe gjatë vitit 1969 marrëveshjet ekonomike, këmbimet e specialistëve të ndryshëm dhe tregtia vazhduan me të njëjtat ritme. Bisedime dypalëshe u bënë edhe në vitin 1969, të cilat përfunduan me nënshkrimin e një marrëveshje mbi dhënie kredie dhe ndihmë teknike, pajisje të plota, dhënie makinerish etj. Në bazë të marrëveshjeve dhe protokolleve përkatëse të nënshkruara, në Shqipëri do të ndërtoheshin një numër objektesh të rëndësishme dhe do të krijoheshin degë të reja të industrisë. Ishte metodë pune që institucionet e shtetit shqiptar të hartonin planin e investimeve dhe të ndërtimit të objekteve të ndryshme dhe me dosjen e këtyre projekteve, delegacionet shqiptare shkonin në Pekin, negocionin me palën kineze, nënshkruanin marrëveshjet përkatëse dhe ktheheshin në Shqipëri me valixhen e ndihmave dhe kredive financiare kineze, në mbështetje të realizimit të planeve pesëvjeçare.

Ndërsa nomeklatura e eksportit shqiptar në Kinë ishte shumë e

⁵ “Komunikatë mbi vizitën e delegacionit qeveritar ekonomik shqiptar në RP të Kinës”, Ekonomia Popullore, nr 3, 1965, 4.

⁶ Duka. Histori,

⁷ Komunikatë mbi vizitën e delegacionit qeveritar ekonomik shqiptar në RP të Kinës”, Ekonomia Popullore, nr 3, 1965, 4.

kufizuar dhe kryesisht në artikuj të tillë si naftë bruto dhe produkte të saj, bakër blistër, krom etj. Nevoja kineze për këto mallra ishte e madhe. Në qoftë bëhet një bilanc mes importit kinez, të cilin e shlyente vetë Kina me kreditë që jepte ajo, dhe eksportit shqiptar nga ana tjetër, ishte me një diferencë të madhe në favor të importit.

Deri në vitet '70 Shqipëria siguroi nga ndihmat kineze ndërtimin e 41 projekteve të rëndësishme, nga të cilat 24 i përkisnin industrisë së rëndë⁸. e., ndërkohë që Pekini tërhoqi sa mundi disa lëndë të para, në kompesim ose si shkëmbime për shlyerjen e kredive të buta, të cilat i jepeshin Tiranës zyrtare. Në qoftë se bëjmë një analizë krahasimi të ndihmave të marra nga Kina me ato më herët nga Bashkimi Sovjetik, do të arrijmë në përfundimin se mes tyre kishte një ndryshim të madh. Vetë udhëheqja politike shqiptare e kohës ka pranuar se ndihma kineze nuk mund të krahasohej me atë sovjetike në vitet '50 ose atë jugosllave në vitet '40. Ajo që rezulton është se këto dihma kanë qenë të mëdha, me afat shumë të gjatë për shlyerjen e kredive dhe në raste të tjera (ushtarake, etj), ato janë përfituar falas.⁹

Marrëveshja shqiptaro-kineze e tetorit 1970 për dhënien e një kredie Shqipërisë nga ana e Kinës parashikoi ndërtimin e objekteve, rikonstruksionin e uzinave dhe fabrikave ekzistuese, si dhe furnizimin e Shqipërisë me lëndë të para për periudhën e pesëvjeçarit të pestë. Shqipëria përfitoi një kredi prej “1 miliard e 880 milion juanë kinezë.”¹⁰

Në pesëvjeçarin e pestë, u ndërtuan vepra shumë të mëdha si Hidorcentrali i Fierzës, Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, Azotiku i Fierit, Superfosfati i Lacit, Fabrika e Letrës në Lezhë etj. Në vitin 1971 shumë vepra të nisura më herët do të përfundonin, si rasti i

⁸ Biberaj. Albania, 69.

⁹ Po aty

¹⁰ AQSH, F 490, V 1970, D 36

hidrocentralit të Vaut të Dejës (kapaciteti 225.000 kv), ndërsa disa të tjera si hidrocentrali i Fierzës (500.000 kv), Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, rafineria e naftës në Ballsh, kombinati i autotraktorëve etj arritën të përfundonin gjatë planit të VI-të pesëvjeçar. **Gjithashtu dhe viti 1972** do të shënonte një tjetër bashkëpunim mes Shqipërisë dhe Kinës, me nënshkrimin e një marrëveshje mes dy qeverive për dhënien e **një kredie prej 70 milion juen**. Përdorimi i kredisë konsistonte në zhvillimin e bujqësisë duke u bazuar tek makineritë që do të livroheshin nga Kina. Konkretisht u parashikuan⁴⁹ lloje makinerish bujqësore, të cilat do të mbërrinin nga Kina në Shqipëri gjatë vitit 1973”.

Përsa i përket importit, 60 % i volumit të përgjithshëm merrej nga RPK, veprat e mëdha merreshin nga Kina dhe kreditë merreshin vetëm nga Kina dhe nga asnjë vend tjetër. Gjithsesi pas vitit 1973 nuk do të kishte më një zhvillim aq pozitiv të marrëdhënieve ekonomike dhe për pasojë, ndihmat e kreditë kineze do të vinin duke u zvogëluar. **Marrëveshja ekonomike e vitit 1975 i dha Shqipërisë një kredi “prej 500 milion juen që ishte baraz me 225 milion rubla. Deri në vitin 1975 në Shqipëri ishin përfunduar 75 vepra nga 132 gjithsej, po ndërtoheshin 32 vepra dhe 25 ishin të pafilluara ende.**¹¹

Ngjarjet politike të kohës diktuan edhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Skic-identë japin gjithashtu një tablo mbi shlyerjen e kredive të marra deri në vitin 1980 (me përjashtim të BS), nevojat për drithërat e bukës, zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese pa kërkuar më kredi, përmirësimin e mirëqënies materiale të punonjësve çdo pesëvjeçar etj.

Pas debateve politike të vitit 1971 rreth vizitës së presidentit amerikan Nikson në Kinë, angazhimi i Pekinit për të realizuar në kohë dhe afat ndihmat e kreditë ndaj Shqipërisë ishte në rënie.

¹¹ “Shantazhe dhe bllokadë ekonomike të Kinës kundër Shqipërisë”, në Hoxha, Shënime II, 270.

Vizita e Niksonit në Kinë ndikoi në ftohjen e marrëdhënieve pasi pala shqiptare nuk e miratoi ndryshimin e politikës së jashtme kineze. Distancimi i marrëdhënieve ndërmjet palëve sigurisht që ndikoi në këmbimet ekonomike.

Në këtë periudhë kemi një ndërthurje mes aspekteve politike dhe ekonomike që karakterizojnë marrëdhëniet mes dy vendeve. Mungesa e gatishmërisë kineze për të pëmbushur kërkesat shqiptare vinte si pasojë e qëndrimit anti-kinez të palës shqiptare.

Shkëputja zyrtare u njoftua nga diplomatët në Pekin, të cilët në korrik të vitit 1978 njoftuan zyrtarisht ndërprejen e të gjitha ndihmave ekonomike dhe teknike ndaj Shqipërisë.

3. Gjeografia e ndihmave/kredive si analizë e shpërndarjes dhe proceseve hapësinore territorial.

Analiza dhe vleresimet gjeografike (hapësinore-territoriale), bëhen përmes hartës gjeografike e cila përbën një metodë dhe instrument studimi hapësinor. Si e tillë ajo sintetizon tërësinë e faktorëve shkak/pasojë në hapësirën ku shfaqet fenomeni.

Sipas kësaj metode studimi, në analizën dhe vleresimet gjeografike, thelbësore janë: **vendosjet, pra ku ndihmat kineze janë vendosur dhe pse këtu, si dhe proceset dinamike të investimeve kineze, ku janë destinuar, si ka ndryshuar shpërndarja(shtrirja gjeografike), etj.**

Nga ky këndvështrim, rezultatet e përgjithsuara do të ishin:

✓ Parimet e shpërndarjes gjeografike të ndihmave përputhen me konceptet politike dhe ideologjike të zhvillimeve. Parim ky që i përgjigjet pyetjes **Ku u shpërndanë ndihmat:** në sektorin e industrisë, fokusuar drejt industrisë minerare dhe lëndëve djegëse si dhe më vonë tek industritë përpunuese / prodhuese dhe prodhimit të mjeteve prodhuese të tipit të fabrikave, uzinave deri kombinate. Referuar fakteve, **deri në vitet '70 Shqipëria siguroi nga ndihmat kineze ndërtimin e 41 projekteve të rëndësishme, nga të cilat 24**

i përkisnin industrisë së rëndë: Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, Azotiku i Fierit, Superfosfati i Lacit, uzina metalurgjike e bakrit në Kukës dhe Rubik, etj.

✓ Zhvillimet dhe shpërndarja bazohen në parimet kombëtare ndonëse të ideologjizuara. Pra përgjigja e pyetjes **Pse këtu** rezulton e qartësisht e kuptueshme referuar parimit: Zhvillimi I industrisë garanton pavarësinë e vendit. Vec kësaj **pse-ja** e shpërndarjes së ndihmave është e lidhur me politikën e shpërndarjes së tyre, e bazuar në:

- lidhjen dhe afrimin sa më shumë të zhvillimeve me pasuritë kombëtare: ndërtimi i veprave të mëdha hidroenergjitike (**hidrocentrali i Fierzës, Vau I Dejës, Matit dhe Bistricës** u bazua në kapacitet hidrike të lumenjëve Drin, Mat, Bistricë), uzinat e përpunimit të naftës në Q.Stalin dhe Ballsh (areale naftë mbajtëse), uzina metalurgjike e bakrit në Kukës dhe Rubik (si zona të shtrirjes së bakrit), etj.

- shpërndarjen e ndihmave në funksion të zhvillimit të ekuilibruar territorial me qëllim zvogëlimin e pabarazive të theksuara si trashëgimi nga e kaluara. Evidentohet qartë në paraqitjen gjeografike të objekteve me shtrirje në të gjithë vendin: Shkodër (uzina e telave prej bakri,), Kukës, Mat, Mirditë (uzina metalurgjike të bakrit), hidrocentralet mbi Drin, i Matit, **Lezhë (fabrika e letrës), në ferro kromi në** . Lac (fabrika e superfosfatit), Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, uzina e Tekstilit në Berat dhe rafineria e naftës në qytetin Stalin dhe Ballsh, **kombinati i autotraktorëve, Vlorë**(soda kaustike, etj).

- zhvillimin dhe depërtimin në thellësi(brendësi) të territorit. Zhvillimet ishin pothuajse të reja në zonat e brendshme ndërsa nga trashëgimia e zonave të brendshme, ato pak industri (nxjerrëse të mineraleve) u ruajtën për një farë kohe dhe u zgjeruan më tej me

objekte të përpunimit të tyre (uzinat metalurgjike të bakrit, rafeneritë e naftës).

- përafrimin me tregjet e huaja në eksportin e disa produkteve të rëndësishme.

- ✓ Industritë shërbyen si ndërlidhje sektoriale duke krijuar deri një rrjet industrial kombëtar, pra duke i shërbyer njera-tjetres, psh: ind elektroenergjitike metalurgjisë, kjo e fundit prodhimin të mjeteve të punës, këto bujqësisë etj.

Çuditërisht dhe paradoksalisht, edhe pse ne ndryshuam tërësisht sistemin, Kina është ajo që duket se ka kryer shumë më tepër ndryshime gjatë këtyre dekadave se sa ne. Kina nuk është më ajo e djeshme.¹² Duhet kuptuar se marrëdhëniet me Republikën Popullore të Kinës duhen ridimensionuar sipas kohës që jetojmë, nuk është koha e ndihmave dhe kredive kineze për plane pesëvjeçare, por është koha e investimeve të mëdha të mundshme të kapitalit kinez në Shqipëri. Por është koha kur me Republikën Popullore të Kinës do të duhet të shpejtojmë për të kapur kohën e humbur në këto 24 vite për investime dhe bashkëpunim të gjithanshëm në fushën ekonomike e financiare. Të mos harrojmë: në periudhën e krizës europiane të para pesë viteve, vetë Bashkimi Europin i drejtoi sytë nga potencialet kineze për kapërcimin e asaj krize. Prandaj shfrytëzimi i potencialeve specifike që krijojnë bashkëpunimi ekonomik dhe investimet kineze në vendin tonë janë shërbimi më i madh që mund të bëhet në funksion të mirëqenies dhe rritjes ekonomike.

¹² Boriçi, GJ. “Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e ftohtë 1956-1978” .

SPIRIDHULLA POÇI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

**KONTRIBUTI I PROF. KOLEC TOPALLIT NË
FUSHËN E FONETIKËS DHE GRAMATIKËS
HISTORIKE**

ABSTRACT

The scientific activity of prof. Kolec Topalli confirms him as one of the most outstanding scientific personalities with a very important and valuable contribution in the field of albanology. Since the beginning of 1970-ies prof. Kolec Topalli, in about 186 of his scientific articles and studies, published in scientific magazines in Albanian and abroad, he treated issues related to Historical Phonetics, Historical Morphology, Historical syntax, Etymology, Dialectology and Orthography, etc. Although his scientific activity is focused on various aspects of linguistics, it is strongly connected with the disciplines of Albanian language history.

Two of the most remarkable works of prof. Kolec Topalli “Historical Phonetics of Albanian language” Tirana 2007 and “Historical Grammar of Albanian Language” 2011 provide further the Albanian linguistic learning in terms of two of the main disciplines of the history of language: “Historical Phonetics” and Historical Grammar”. They contain significant scientific information about several problems of historical linguistics, which remain highly disputable due to various historical and linguistic reasons.

Hyrje

Veprimtaria shkencore e prof. Kolec Topallit e afirmon atë si një personalitet të spikatur shkencor, si një nga figurat kryesore, me kontribut shumë të rëndësishëm shkencor në fushën e dijes albanologjike.

Që nga shek. XIX, për një periudhë të gjatë studimet në fushën e historisë së gjuhës janë zhvilluar nga albanologë të huaj, të cilët në studimet e tyre kanë trajtuar probleme të rëndësishme të gjuhës shqipe, si: përkatësia gjenialogjike e gjuhës shqipe; vendi që zinte ajo në familjen indoevropiane; marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera etj. Në mesin e shek. XX qendra e studimeve albanologjike zhvendoset në trojet shqiptare dhe studimet, duke qenë se kryheshin nga specialistë shqiptarë si A. Xhuvani, M. Camaj, M. Domi, K. Cipo, E. Çabej, S. Riza, K. Topalli, njohën një hop të ri cilësor.

Që nga fillimet e viteve 1970 e në vazhdim prof. Kolec Topalli trajton në rreth 186 artikuj e punime të ndryshme, të botuara në revista shkencore, brenda dhe jashtë vendit, probleme që lidhen me Fonetikën historike, Morfologjinë historike, Sintaksën historike, Etimologjinë, Dialektologjinë, Drejtshkrimin etj. Por, edhe pse veprimtaria shkencore e tij shfaqet në fusha të ndryshme të gjuhësisë, ajo është e lidhur fort me disiplinat e historisë së gjuhës shqipe.

Pas vitit 1995 e në vazhdim, prof. K. Topalli boton rreth 17 vepra. Ai thekson: “Pas një pune të tillë,....., lind nevoja e një sinteze, ku përfundimet e arritura të shoshiten e të bashkërenditen me arritjet shumëvjeçare të gjuhëtarëve të tjerë¹”. Ndër veprat kryesore mund të përmendim: Theksi në gjuhën shqipe (1995); Për historinë e hunderësisë së zanoreve në gjuhën shqipe (1996); Shndërrimet historike në sistemin e zanoreve të gjuhës shqipe (2000); Mbylltoret e gjuhës shqipe (2002); Fërkimoret dhe afrikatat

¹ K. Topalli, Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2007, fq. 9.

e gjuhës shqipe (2003); Dukuri fonetike të sistemit bashkëtingëllor në gjuhën shqipe (2004); Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes; Sonantet e gjuhës shqipe (2001); Dy kryeveprat, Fonetika historike e gjuhës shqipe (2007) dhe Gramatika historike e gjuhës shqipe (2011). Vepra “Fonetika historike e gjuhës shqipe” (2007) është nderuar me çmimet “Ekselencia Shqiptare 2007” dhe “Çmimi i Albanologjisë 2008”. Përveç këtyre, prof. K. Topalli ka përgatitur për nevojat e studentëve dy tekste mësimore “Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005 dhe “Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2011.

Aftësitë shkencore të autorit, njohja e thellë e veprave të autorëve të vjetër, të dialekteve, nëndialekteve e të së folmeve të gjuhës shqipe, njohja e arritjeve shkencore të albanologëve të huaj dhe shqiptarë, njohja e shumë gjuhëve të huaja dhe zbatimi i metodës së krahasimit të brendshëm e të jashtëm në dukuritë fonetike, morfologjike dhe sintaksore, u kanë siguruar veprave një nivel të lartë shkencor, i cili na ndihmon të kuptojmë zhvillimin historik të sistemit fonologjik e morfologjik të gjuhës shqipe në shekuj. Siç thekson E. Çabej “ të shkruash historinë e një gjuhe do të thotë të përshkruash fatet e zhvillimit që përshkon ajo gjuhë që nga fillimet e saj e gjer në ditë të sotme (kur kemi përpara një gjuhë të gjallë) a gjer në fund të saj (kur kemi të bëjmë me gjuhë të vdekur). Në këtë kuptim, siç ka populli shqiptar historinë e tij, ashtu dhe gjuha e tij, gjuha shqipe, ka historinë e saj”.² Dhe një punë të tillë ka mundur ta realizojë në veprat e tij prof. Koleci.

Dy veprat madhore të prof. Topallit “Fonetika historike e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, dhe “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, 2011, plotësojnë më tej dijen gjuhësore shqiptare për dy nga disiplinat kryesore të historisë së gjuhës: “Fonetikë historike” dhe “Gramatikë historike”. Ato sjellin informacion shkencor të rëndësishëm për mjaft nga problemet e gjuhësisë historike, që kanë

² E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, I, fq. 9.

qenë dhe vazhdojnë të jenë të diskutueshme për arsye të ndryshme historike e gjuhësore.

Veprat “Fonetika historike e gjuhës shqipe” është konceptuar në dy pjesë. Pjesa e parë përbëhet nga 7 krerë ku trajtohen probleme të ndryshme të sistemit zanor, si: theksi dhe llojet e tij në gjuhët indoevropiane dhe në gjuhën shqipe; zanoret e theksuara dhe të patheksuara; gjatësia e zanoreve; diftongjet etj. Pjesa e dytë përbëhet nga 6 krerë ku trajtohen problemet e sistemit bashkëtingëllor, si: sistemi bashkëtingëllor indoevropian, sistemi bashkëtingëllor i gjuhës shqipe; sonantet; bashkëtingëlloret mbylltore, fërkimore, afrikate dhe dukuritë e ndryshme fonetike. Vepra është e pajisur, gjithashtu, me një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha fjalëve që janë përdorur si shembuj krahasimi, ku spikatin shembujt nga shumë gjuhë indoevropiane, duke përfshirë edhe fjalët e gjuhës indoevropiane të rindërtuar: nga indishtja e vjetër, iranishtja, armenishtja, ilirishtja, trakishtja, dakishtja, greqishtja (e vjetër, e mesme, e re), latinishtja, gjuhët e dialektet romane, gjuhët kelte, gjuhët gjermanike (islandishtja e vjetër, gotishtja, anglishtja, gjermanishtja etj), gjuhët balltike, gjuhët sllave. Nuk mungojnë krahasimet edhe me turqishten, e cila s’i përket familjes së gjuhëve indoevropiane.

Kështu, analiza e sistemit fonologjik të gjuhës shqipe në veprën “Fonetika historike e gjuhës shqipe” të K. Topallit përforcon dhe plotëson më tej tezat e ndryshme, tashmë të njohura, jo vetëm për origjinën dhe karakteristikat e gjuhës shqipe, por, tërthorazi, hedh dritë edhe për zgjidhjen e shumë problemeve që kanë të bëjnë me prejardhjen dhe djepin e shqiptarëve.

Ky evolucion dëshmon:³

- Karakterin indoevropian të gjuhës shqipe, vendin e veçantë që ajo zë në familjen indoevropiane dhe afritë me gjuhët simotra.

³ K. Topalli, Fonetika historike e gjuhës shqipe, 2007, fq. 427-428.

- Karakterin inovues të gjuhës shqipe, e cila ka ndryshuar shumë prej fonemave të trashëguara, si: zanoret e gjata, zanoren ò, bashkëtingëlloret qiellzore, fërkimore, grupet e bashkëtingëlloreve etj. Ajo ka krijuar, gjithashtu, fonema të reja, si: y, ë; sonantet nj, j, ll,rr; fërkimore th, dh, f, v, h; afrikatet c, x, ç, xh etj.

- Shqipja karakterizohet: nga një theks i fuqishëm dinamik, me prirjen për t'u vendosur në rrokjen parafundore; nga rënia ose rëgjimi i zanoreve të patheksuara; nga reduktimi i diftongjeve të trashëguar në zanore të thjeshta; nga krijimi i diftongjeve të reja nëpërmjet zbërthimit të zanoreve të thjeshta. Gjithashtu, gjuha shqipe ka krijuar brenda sistemit të vet një sistem të ri të gjatësisë së zanoreve, hundorësinë e zanoreve, metafoninë etj.

- Disa fonema, p.sh., /ǫ/, /s/, të cilat janë fonema të trashëguara, gjatë evolucionit janë shndërruar në fonema të tjera dhe, më vonë, janë rikrijuar dhe rifutur në sistem nga evolucioni i fonemave të tjera, p.sh.: /ā/, /ē/ : o; /ǫ/ : /a/ lat. nox>shq.natë; ie. nos: shq.na; ie. tā: shq.ato (përemri i gjinisë asnjane); ie. mēm: shq. mua (mon); /s/ : /sh/. /gj/. /h/, /th/; dhe /tj/ : /s/, p.sh.: lat. sinus : shq. gji, lat.sūs : shq.thi etj.

- Duke pasur si metodë kryesore krahasimin me sistemin fonologjik indoevropian dhe me gjuhët e tjera, autori përpaket të shpjegojë dhe moshën e fonemave të shqipes:

a. Të trashëguara: /a/, /e/, /i/, /u/; /k/, /g/, /p/, /b/, /t/, /d/, /m/, /n/, /l/, r/.

b. Të zhvilluara brenda shqipes nga evolucioni i fonemave të tjera: /o/, /y/, /ë/; /sh/, /th/, /dh/, /f/, /v/, /q/, /gj/, /ll/, /rr/, /nj/, /h/, /j/, /s/, /z/, /c/, /x/, /ç/, /xh/, /zh/.

Evolucioni i fonemave të shqipes, siç thekson dhe prof. K. Topalli⁴, ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e sistemit gramatikor

⁴ K. Topalli, Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2007, fq. 427

të gjuhës shqipe, i cili, krahas elementeve të trashëguara nga gjuha indoevropiane, ka bërë shumë ndryshime, që i japin atij një frymë të veçantë. Kështu, në veprën “Gramatika e gjuhës shqipe”, 2011, prof. Koleci, për shumë çështje, sjell mendimin e vet ose përkrah një mendim tjetër nga ai që gjejmë në veprat e tjera të Gramatikës historike.

Në shpjegimin e nyjes së përparme -e- të gjinisë femërore nga tezat e ndryshme që janë parashtruar⁵, prof. Topalli përkrah tezën e parashtruar nga G. Mayeri, që e lidh burimin e saj me përemrin indoevropian iā, i cili në pozicion të theksuar ka dhënë përemrin dëftor -ajo- dhe në pozicion të patheksuar ka dhënë nyjen -e- dhe formën e patheksuar të përemrit vetor -e. Ndërsa Çabej e lidh burimin e saj me emrat e tipit nuse, qene⁶ ose me sufiksin e mbiemrave e madhe, e kuqe, prof. Topalli e shpjegon burimin e saj nga emrat djep-djepja, shëndet-shëndetja, paradigma e të cilave sot ka dalë nga përdorimi, por që ka qenë e gjallë tek autorët e vjetër gegë e toskë⁷. Mbaresa -ja e këtyre emrave përbëhet nga -j që shfaqet vetëm në trajtën e shquar dhe që e ka burimin te nyja -e- e gjinisë femërore dhe -a- që është nyja shquese. Pra, në një kohë më të hershme trajta e shquar e këtyre emrave ka qenë lote, ende, ku me përsëritjen e nyjes së prapme -e- u përftua nyja e përparme -e te mbiemrat dhe emrat e rasës gjinore. Nyja shquese -a, u shtri për analogji dhe te këta emra që e formonin shquarsinë me nyjen -e.pra, lote: lotea: lotja.

Për sa i përket burimit të përemrit vetor të vetës së parë njëjës – unë- prof. Topalli pajtohet me mendimin se forma e tij mund të shpjegohet duke marrë si pikënisje formën e trashëguar të gjuhës ie. eëghom⁸, që krahasohet më indishten e vjetër aham, persishten e vjetër adam, greqishten egó. Bashkëtingëllorja hundore fundore –m

⁵ Sh. Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1986, fq. 344-345.

⁶ Shih E. Likaj, Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe, Tiranë, 2003, fq. 69.

⁷ K. Topalli, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, fq. 431.

⁸ K. Topalli, Evolucioni historik i përemrave të shqipes, Tiranë, 2008, fq. 30-36.

është kthyer në/ n/ dhe më vonë ka rënë. Zanorja /o/ ka evoluar në /u/, kurse qiellzorja e trashëguar ka evoluar në mbylltoren e zëshme dhëmbore /d/, që më vonë ka rënë duke u ndodhur ndërmjet dy zanoreve. Së fundmi, zanorja në ballë të fjalës ka rënë. Elementi tjetër është shtesa /në/, që është një rrokje e shtuar në fund të disa fjalëve pa pasur ndonjë funksion të caktuar semantik a gramatikor, si te / tinë-ti/, /atënë-atë/, /ainë-ai/ etj. Si burim i saj mund të jetë mbaresa /-në/ e kallëzores, e cial mund të jetë përdorur si mbaresë përforcuese. Kështu shpjegohet dhe mungesa e rotacizmit në të folmet jugore.

Edhe për përemrin e vetës së dytë shumës ju K. Topalli⁹ mendon se burimi i tij është një formë ie. **i us** që lidhet me lit. jus, got. jus e avestishten yūš, ku gjysmëzanorja indoevropiane është ruajtur në gjuhën shqipe dhe burimin e trajtës së shkurtër –u- e sheh te përemri i gjuhës indoevropiane *uos/ues (uos/ues>u).

Edhe për përemrat pronorë, për përbërjen dhe rrugën e formimit të tyre, prof. Topalli sjell mendimin e vet¹⁰, sipas të cilit te disa forma të përngjitura elementi i parë është një (im, yt, ynë) dhe te disa të tjera përemër dëftor (jot, juaj, jonë) etj.

Një vend të rëndësishëm zë në vepër analiza e evolucionit të sistemit foljor të gjuhës shqipe. Duke e krahasuar me sistemin foljor të gjuhës ie. dhe të gjuhëve të tjera autori vë në dukje dukuritë e trashëguara, të zhdukura ose të zhvilluara brenda shqipes. Edhe në sistemin foljor kemi mjaft risi, si zgjerimi i kriterëve për klasifikimin e foljeve në zgjedhime, shpjegimi i formantit –sh të dëshirores nga një –s- me burim indoevropian, që mund të ketë qenë formant i futurit sigmatik dhe jo nga –v-ja e së kryerës së thjeshtë etj. Interes të veçantë paraqesin në vepër kreu mbi kategoritë e paeptueshme si ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe fjalëformimi etj.

⁹ K. Topalli, Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe, Tiranë, 2011, fq. 127.

¹⁰ Po aty, fq. 137-140.

Si përfundim, themi se vepra e prof. Topallit pasuroi më tej dijen në fushën e albanologjisë. Ajo do të shërbejë si bazë dhe udhërrëfyes shkencor për të gjithë ata që do të vazhdojnë të japin kontributin e tyre në këtë fushë.

Literatura

1. K. Topalli, Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2007.
2. K. Topalli, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011.
3. K. Topalli, Evolucioni historik i përemrave të shqipes, Tiranë, 2008.
4. K. Topalli, Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe, Tiranë, 2011.
5. E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 1976.
6. E. Likaj, Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe, Tiranë, 2003.
7. Sh. Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1986.

Almira Sadikaj

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër

**DRITËRO AGOLLI, PËRFAQËSUES I
LETËRSISË BASHKËKOHORE SHQIPE**

ABSTRACT

Dritëro Agolli is one of the greatest poets of Albanian literature. He did not break his ties with his homeland, neither physically, nor *poetically, artistically, and linguistically*. He wrote dozens of poems about the natural environment he came from and wrote so simply and so clearly that he is amazing, becoming a model and guide for others in this regard. The clarity and simplicity brought with special art, without falling into simplification and stripped of figuration, accompanied him until he wrote the last verse. Among the numerous scholars who have treated his work is Academician J. Bulo who closely followed the creative work and growth of Dritëro Agolli as a poet and a prose-writer. He writes about him: "Dritëro Agolli is a prominent personality and protagonist of the cultural, artistic and social developments of Albanians during the last half century; He is undoubtedly the most popular writer of contemporary Albanian literature.

Key words: Agolli, writers, literature, contemporary, original

Historia e letërsisë shqipe dhe e publicistikës shqiptare nuk mund të kuptohet pa emrin e Dritëro Agollit¹, kjo për faktin se Dritëroi ka dhënë një kontribut të vyer në emancipimin dhe demokratizimin e jetës politike e shoqërore në Shqipëri. Ai hyri në letërsinë tonë si një prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të brezit të viteve 1960, si dhe si një ndër kritikët më të mëdhenj ndaj frymës së re të pasluftës². Dritëro Agolli solli në letërsi shqipe ndryshime e teknika te reja, por, njëkohësisht, u tregua i kujdesshëm duke prekur rrënjësisht edhe vjershërimin shqip të poetëve të Rilindjes e këtej. Në krijimtarinë e tij poetike midis të tjerash vihet re dukshëm ndikimi prej letërsisë gojore, çka pohohet edhe nga vetë Agolli kur shprehet se: "Unë erdha në poezi nga kënga populllore... Pastaj hyra në libra. Poezinë populllore, përrallën, humorin dhe të gjithë kulturën populllore nuk e mësova, por e jetova. Në fillim unë shkruaja si populli."³. Pra, D. Agolli, I. Kadaresë, J. Xoxës, A. Pashkut e shkrimtarë të tjerë nëpërmjet veprës së tyre shfaqën një cikël të ri etnografik dhe i krijuan botës shqiptare një imazh tjetër të Shqipërisë në botën evropiane. Mund të pohojmë se ky brez autorësh krijoi themelet e një të ardhmeje tjetër në letërsinë dhe publicistikën shqiptare, duke shpërfaqur koncepte të reja jo vetëm në letërsi, por edhe në art, muzikë, etj., të cilat ndikuan bindshëm në orientimin e shoqërisë shqiptare.

Studiuesit R. Zisi-L. Boçi pohojnë se Dritëro Agollin e shohim sot si një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm e më të spikatur të letërsisë shqipe, një poet prodhimtar e cilësor⁴, autor i veprave të shumta të përfunduara e të paplotësuara, si poet idealist, ëndërrimtar

¹ M. Gero, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit*, Hyrje, Botimet Toena, Tiranë, 2013, f. 15.

² Sh. Sinani, "*Njerëzit e krisur*" të Dritëro Agollit, Shtëpia botuese "Naimi", Tiranë, 2012, f. 16.

³ D. Agolli, *Jeta në letërsi*. Tiranë, 1987, f. 265.

⁴ R. Zisi-L. Boçi, *Dritëro Agolli dhe letërsia shqipe*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Dritëro Agolli, Personalitet i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare", Gjirokastër, 2013, f. 17.

e shtegtar i përjetshëm. Pra, ai është një prej poetëve tanë më të mirë bashkëkohorë, por edhe njëri prej poetëve tanë më të mirë të të gjitha kohërave. Pavarësisht faktit që Dritëroi u mbështet në traditën e letërsisë gojore popullore si dhe të letërsisë së krijuar para tij, ai u mundua ta ngrinte veprën e tij në një nivel më të lartë duke përdorur teknika të ndryshme ritmiko-melodike.

Agolli gjatë gjithë jetës së tij hulumtoi e studioi gjuhën e popullit, u mbështet tek ajo dhe u udhëhoq prej saj për çdo gjë. Krijimtaria poetike e D. Agollit është e shumanshme, gjë të cilën e vë re edhe M. Zeqo kur shprehet se: "Poezia në krijimtarinë e D. Agollit është gjëja më e çmuar, por jo e vetmja"⁵, kjo për faktin se Agolli lëvront pareshtur poezinë në gjithë larminë e saj: poezinë e shkurtër, poemën, baladën, fabulën, sonetin, etj.,

Dihet që poezia e Dritëro Agollit identifikohet më tepër me krijuesin e vet, ai i qëndroi besnik frymës që solli deri në ditët e fundit të jetës së tij. Këtë besnikëri e ruajti gjatë gjithë krijimtarisë së tij jo vetëm si *tregimtar*, *novelist*, *kritik letrar*, *romancier*, *dramaturg*, etj., por edhe në fushën e gazetarisë, të cilat bënë që figura e Dritëroit të ngrihet në nivelet e poetikës naimiane dhe asaj lasgushiane.

Dritëroi gjatë gjithë rrugëtimit të tij krijues u mundua që si bashkudhëtarë të kishte gjithmonë poezinë, pavarësisht brendisë së vargut. Ai u mundua të mëshirojë nëpërmjet poezisë gjithë rrugën jetësore të tij. Është fakt që gjatë gjithë procesit të tij krijues Agolli është ndikuar drejtpërdrejt në poezisë popullore, në artin naimian, lasgushian, te Bërnsi e autorë të tjerë rus të shekullit të 20-të, të cilët ndikuan në frymën, thjeshtësinë dhe madhështinë e vargut agollian, veçori të tilla i gjejmë sot që nga përmbledhjet e para poetike "Në rrugë dola" e deri te "Fletorkat e mesnatës", apo "Pelegri i vonuar".

⁵ M. Zeqo, *Liriku i tokës, Demon i fjalës*, Botimet Toena, Tiranë, 1996, f. 31.

Në bashkudhësi me krijuesin e vet ai u frymëzua nga principet me të larta e të bukura të kohës. Agolli njëkohësisht njihet edhe për prurje të reja në letërsinë shqipe, pasi pasqyroj në veprën e tij vlerat më të mira të shqiptarisë, humanizmin, drejtësinë e dashurinë për njeriun, për atdheun dhe historinë e tij, për gjuhën shqipe, tokën dhe këngën shqiptare, për folklorin dhe zakonet e mrekullueshme të etnisë së vetë. Nga ana tjetër, në tërësinë e vet vepra dhe aq më tepër poezia e Dritëro Agollit sundohet nga bota e gjallë, shpirtëzimi i mjedisit, shenjtërimi i mjedisit, i natyrës, i arës dhe i bagëtisë. Nëpërmjet këtij tipari poeti rishfaq në poezitë e tij panteizmin e Naimit dhe gjurmë të botëkuptimit bektashian. Dritëroi u njoh në mbarë letërsinë shqipe si poeti që krijoi në poezi imazhin e një Shqipërie ideale, "u shfaq si poet që dëshironte të ndërtonte një Shqipëri të lumtur"⁶, gjë që e përcjell nëpërmjet poemës "Nënë Shqipëri".

Në studime të ndryshme për krijimtarinë e tij, Agolli konsiderohet si një ndër njerëzit dhe mjeshtërit e penës, i cili duke jetuar në gji të popullit, përveç temave, subjekteve dhe elementeve më të mira të ligjërit të tij, që i përdor në mënyrë të qëlluar, tenton ta bëjnë më vepruese dhe më të këndshme shprehjen gjuhësore të përmbajtjes së dhënë, pra, punën e përditshme si mjeshtër i fjalës e lidh edhe me kërkesën se në ç'mënyrë do ta bëjnë krijimin e tij sa më ndikues dhe të kuptueshëm për lexuesit. Në mënyrë të veçantë në poezinë e Agollit, tematika që tërheq vëmendjen, siç vëren, edhe studiuesi B. Kucuku (1998)⁷, është zigzagu i gjatë e herë-herë i mundimshëm i 'vajtje-ardhjeve', gjë e cila pasqyrohet edhe në vargjet:

Kur nisem për udhë
Më ndrit çdo gjë e kam shpresë
Kur kthehem, kam gjumë

⁶ Sh. Sinani, "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit, Shtëpia botuese "Naimi", Tiranë, 2012, f. 20.

⁷ Bashkim Kuçuku, Përtëritje e lirikës shqiptare, në D. Agolli, *Lutjet e Këmbanës*, Tiranë, 1998. f.341-375.

Diçka fillon nga vetja ime të vdesë.

Ndër studiuesit e shumtë që janë marrë me veprën e tij është edhe akademiku J. Bullo i cili e ka ndjekur nga afër krijimtarinë dhe rritjen e Dritëro Agollit si poet e prozator. Ai shkruan për të: “Dritëro Agolli është një personalitet i shquar dhe protagonist i zhvillimeve kulturore, artistike e shoqërore të shqiptarëve gjatë gjysmëshekullit të fundit; ai është padyshim shkrimtari më popullor i letërsisë bashkëkohore shqiptare. Dritëro Agolli është një nga prijësit e atij brezi që erdhën në letërsinë shqipe në vitet '60 të shekullit që shkoi dhe me veprën e tyre i hapën rrugë emancipimit të mendimit e të modernizimit të letrave e të kulturës shqiptare, edhe pse ajo zhvillohej brenda shtratit skematik të realizmit socialist.”⁸

Dhe vështrimi i akademikut J. Bullo për poetin bëhet më i gjerë, kur ai pohon se “Në të gjitha kohët Dritëro Agolli ka përballuar me dinjitet sfidën për t'i dhënë vlerën e merituar lirisë dhe sfidën e pritjes në horizonte të reja. Vepra e Dritëroit është pasuria jonë shpirtërore, ne nuk mund të bëjmë pa të, ne na zë malli për të; me të ne jemi më të mirë, më të pasur mendërisht, më të bukur shpirtërisht, më njerëzorë dhe më paqësorë. Dashuria për njerinë, filozofia e pajtimit me njerinë dhe me natyrën, është një motiv i rrallë bektashian në veprën e Dritëro Agollit, e cila na jep qetësi shpirtërore kur e lexojmë.”⁹

Një studiues tjetër që është marrë me veprën e Dritëro Agollit, sidomos me pasurinë e saj gjuhësore, është dhe gjuhëtari Emil Lafi. Ai shkruan: “Dritëroi erdhi në letërsinë shqipe, siç e ka shkruar vetë, me torbën e tij të mbushur me baltë nga Devolli. Por që kjo baltë e mirë e Devollit të bëhet letërsi, duhet dhe ajo “fryma e shenjtë” ose “demoni i krijimit”, që kam përshtypjen sikur te Dritëroi ka zbritur nga malet e Dangëllisë nëpërmjet pllajës së

⁸ J. Bullo, *Dritëro Agolli*, në J. Bullo, *Shpirti i fjalës*, Tiranë, 2014, f. 381.

⁹ J. Bullo, *Dritëro Agolli*, në J. Bullo, *Shpirti i fjalës*, Tiranë, 2014, f. 382.

Kolonjës. Poezia e Dritëroit lind natyrshëm dhe e shëndetshme, pa shtërzime; ai e zotëron mirë artin e lakmueshëm për të bërë vargje të rrjedhshme, që hyjnë në zemër, që mësohen e mbahen mend.”¹⁰

Gjuhëtari Emil Lafe vazhdon më tej se duke bërë një karakterizim të shkrimtarit përmes arritjeve të tij në prozë dhe në poezi. Studiuesi shkruan: “Dritëroi është poet “që bisedon ngrohtë me njerëzit, që flet me ta thjesht e bukur, duke i dhënë poezisë tonin e një bisede të përzemërt e intime”. Jo vetëm poezia, po edhe proza e D. Agollit dallohen për një përpunim mjeshtëror të gjuhës së gjallë të njerëzve të thjeshtë. Te veprat e Dritëroit të bën për vete pasuria, gjallëria, larmia e ngjyrave dhe e aromave të ligjëritit popullor. Mbaj mend se kur lexova “Zhurmën e erërave të dikurshme” (1964), vepra e parë në prozë e shkrimtarit, më tërhoqi aq shumë edhe gjuha e tregimeve dhe e personazheve të tyre. Me këtë mjeshtëri të tregimit ai vazhdoi edhe në veprat e tjera më pas. Nuk besoj se ka ndonjë që e ka lënë në mes një libër të Dritëroit.”¹¹

Dritëro Agolli nëpërmjet veprës së tij realiste e me vlera të veçanta të artit letrar, shpeshherë me satirë të mprehtë e humor të hollë, e ndonjëherë edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, ka paraqitur në mënyrë shumë artistike të vërtetën për jetën dhe kohën. Poezia e tij është e afërt me njeriun, gjë që e bën Agollin poet të tokës dhe të dashurisë për të, shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes njerëzore. Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi në këtë mënyrë traditën e re të shkrimit në letërsinë shqiptare. Njihet si shkrimtari i madh i një “gjuhe të vogël¹²”, si shkrimtari bashkëkohor më i njohur, më i dashur prej lexuesve bashkëkombës dhe njëkohësisht po aq i njohur edhe jashtë vendit, në metropolet e kulturës botërore. Nëpërmjet idesë dhe tematikës që përcjell me krijimtarinë e tij, Dritëroi, përkufizohet si letrari inteligjent, si zot dhe rob i fjalës, i figurës dhe

¹⁰ E. Lafe, *85-vjetori i Dritëro Agollit, si e kam njohur 30 vjet më parë*, internet.

¹¹ E. Lafe, *85-vjetori i Dritëro Agollit, si e kam njohur 30 vjet më parë*, internet.

¹² Sh. Sinani, *Dritëro Agolli, Shkrimtari i dhimbjes dhe i filozofisë jetësore*, Letërsia bashkëkohore shqiptare, Tetovë, 2002, f. 133.

i mendimit, si krijues i frymëzimit filozofiko – metafizik, pra, një individualitet poetik i rrallë me vlera universale. Veprat e tij janë përkthyer në mjaft gjuhë të botës.

Me mënyrën e vet Dritëro Agolli krijoi në këtë pikë “një Shqipëri alternative”, që mbështetej në një ideal romantik. Kjo është një marrëdhënie e zakonshme poetike me realitetin, e njohur në traditën shqiptare dhe atë të huaj. “Shqipëria tjetër” e Dritëroit hyjnizohet te “Nënë Shqipëri” dhe në vepra të tjera, nëpërmjet të cilave Agolli dëshironte të krijonte një Shqipëri të lumtur, gjë që poetikisht mund të arrihej ose në formën e mitit të së shkuarës (nostalgjisë për “motin e madh¹³”, siç bënë shumica e rilindësve), ose në formën e utopisë-kultit të së ardhmes, idealizmit të një vendi që nuk ekziston.

Duke e parë në këtë këndvështrim, Dritëro Agolli konsiderohet pa dyshim njëri ndër poetët më të shquar të letërsisë së sotme shqipe, të cilën e shohim të pasqyruar në qëndrimin e tij emocional ndaj jetës, në shprehjen gjuhësore artistike si dhe përvoja e veçantë në fushën e artit. Duke qenë se vepra e tij pasqyron realitetin e shoqërisë shqiptare të pas viteve 60’, mund të themi se në të përfshihen të gjitha aspekte e shoqërisë shqiptare që nga gjendja sociale, mendësia shqiptare, sfera të ndryshme të jetës shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në mjedisin e në tokën shqiptare. Pra, vepra e tij arrin të përfshijë gjithë universin e jetës shqiptare, bashkangjitur këtu idetë, karakteristikat dhe tematikat e një vepre letrare të realizuar suksesshëm.

Vepra e tij ka lënë gjurmë, jo vetëm në poezinë shqipe, ku ai shquhet, si një nga poetët, sidomos epoka e tij më e kalitur, e jehonshme edhe e ndikueshme. Por, edhe në prozën shqipe ai ka qenë një njeri që ka lënë vepra të shquara, këtu mund të përmendim një nga veprat më të mira të humorit shqiptar, siç është “Shkëlqimi

¹³ Sh.Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e D. Agollit*, Studime për letërsinë shqipe të shëkullit të 20-të, QSA, Tiranë, 2010, f. 269.

dhe rënia e shokut Zylo” apo dhe “Arka e djallit”. Por, ka dhënë edhe një kontribut të rëndësishëm në kinematografi. Ai është ndër ata shqiptar, që janë bërë pikë reference, dhe jo të gjithë arrijnë që të bëhen të tillë.

Jo vetëm në poezi, por edhe në prozë ai u dallua për një strukturë narrative, solli risi të kësaj natyre edhe në galerinë e personazheve. Dritëro Agolli u dallua edhe për një frazeologji të pasur popullore me anë të së cilës pasqyrore filozofinë jetësore në gjithë krijimtarinë e tij. Gjithashtu, solli shembuj interesantë në prozën e shkurtër edhe në trajtimin e temave që përbënin fokusin kryesor të letërsisë në një periudhë të gjatë kohore dhe një angazhim të madh të shkrimtarëve dhe artistëve, siç ishte trajtimi i figurës së gruas, femrës apo e njohur ndryshe si tema e emancipimit të gruas dhe paraqitjen e realitetit bashkëkohor. Shoqëria totalitariste dhe letërsia e realizmit socialist në këtë drejtim krijuan mite të progresit dhe të së ardhmes, të barazisë gjinore dhe rinisë, me të cilat përpiqeshin të zbutnin dhe zbukuronin, por që nuk mund dot ta fshihnin, zbrazëtirën dhe realitetin e shpëlarë që rrethonte "parajsën" socialiste.

Pra, Dritëro Agolli, për t'iu shmangur kërkesave dhe klisheve të artit zyrtar, herë në mënyrë të vetëdijshme e herë me pavetëdijen e artistit, gjithnjë kërkues ndaj artit të tij, përdori futjen e "personazheve problemore", nën etiketimin si njerëz të krisur e paksa të çuditshëm që me sjelljet e tyre, me paudhësitë dhe moralin e tyre u bien ndesh rregullave të shoqërisë. Për këtë ata shpesh përfundojnë të abandonuar prej saj, e ndonjëherë edhe në fatkeqësi tragjike. Krahas temave të preferuara zyrtare, të cilat ai i trajtoi me një këndshikim vetjak, e në shumë raste duke shmangur konformizmin e përgjithshëm. D. Agolli pati kurajën për të gërshtuar brenda këtyre temave edhe motivet e dëshpërimit, zymtësisë, vdekjes, mërzi së jetës duke i paraqitur ato si komplekse ekzistenciale të vetë jetës njerëzore. Mund të themi se krijimtaria e D. Agollit në prozën e shkurtër shprehu esencën e tij të

narratorit virtuoze duke iu shmangur formave perverse, shablloneve të kthyera në tabu të socrealizmit. E kjo përbën një sfidë të vështirë për një artist të vërtetë.

Studiuesja e letërsisë shqipe, akademikja Floresha Dado, e cila është marrë me kontributin e Dritëro Agollit në letërsinë tonë, thekson se “Proza dhe sidomos poezia e Dritëro Agollit ka reflektuar vazhdimisht ndjesi të fuqishme të dashurisë për vendin, për të ndershmen, për raporte njerëzore midis njerëzve, për singëritetin dhe ndershmërinë e komunikimit. Vepra e Agollit, duke qenë në grupin e autorëve më të shquar të letërsisë shqiptare, përcjell gjithnjë mesazhe njerëzore, parime të një morali dhe marrëdhënie të qytetëruar. Përmes një komunikimi origjinal, herë përmes humorit, herë përmes dëshpërimit njerëzor, herë përmes afirmimit të idealeve sociale, shkrimtari ynë ndërton një marrëdhënie krejt të veçantë me shqiptarët e tij, ku mbizotëron, nga njëra anë thjeshtësia, mënyra e drejtpërdrejtë e shprehjes, nga ana tjetër filozofia e thellë njerëzore mbi thelbin e jetës dhe të njeriut. Është pikërisht kjo filozofi e brendshme, që vjen thjesht e pa bujë, që depërton në shpirtin tonë.”¹⁴

Kurse studiuesi Gjovalin Shkurtaj shkruan se “Poeti vjen nga anët e Devollit dhe vendlindjen, natyrën, njerëzit, punët e çdo gjë të mirë të saj do t’i përmendë aq dendur në vjershat e tij, porse ai s’është aspak poet fshatar. Poezia e tij nuk mund të cilësohet si bukolike, edhe pse aq të shpeshta janë në të fjalët e termat e bujqësisë, të blegtorisë, emrat e kafshëve e të bimëve të arës, të pemëve e të drunjve të pyllit, të gjithë shpezërisë. D. Agolli e ka fshatin si “bazë nisjeje” për të mësyre shtigjet më të epra të poezisë se lëvruar hijshëm dhe përfaqëson krijuesin ngulmues që

¹⁴ F. Dado, *Vlerësim me rastin e dhënies së titullit “Doctor Honoris Causa” shkrimtarit D. Agolli*, në Dritëro Agolli “Doctor Honoris Causa”, Korçë, tetor, 201, f. 8-9.

“mundohej e heq mbi poezinë”, që “vuan mbi rrokje e vargje” dhe që nuk kënaqet me pak.”¹⁵

Gj. Shkurtaj shkruan se “Dritëro Agolli, që në vëllimet e tij poetike më të para, u shfaq në letërsinë tonë si një poet me veçanti tepër të spikatur, si një krijues që lakmon të arrijë majat më të larta të ligjërimit artistik të organizuar mirë dhe që sjell vargje me theks të qartë origjinaliteti, por që nuk i heq kurrë këpucët me baltën e arave e që e ndien veten kurdoherë të thjeshtë, si njeri që vjen nga gjiri i popullit. Vargu i tij i hershëm *“jam fshatar i Jugut jo poet”*, do të përsëritet e rimerret aq herë në forma e gjetje artistike të ndryshme, po gjithmonë për të spikatur lidhjen e tij të thellë shpirtërore me njerëzit e thjeshtë të vendlindjes, me bujqit e me blegtorët, me të gjithë ata që i kanë *“duart e lëruara”* nga puna.”¹⁶

Njëkohësisht Dritëroi ka qenë aktiv me krijimtarinë e tij edhe pas viteve '90, pavarësisht rrethanave politike të kohës ai ka mundur të mbijetoj duke i kapërcyer me mençuri e vullnet të rrallë sulmet ndaj talentit të tij. Duke kundruar veprën e tij në të dy periudhat mund të pohojmë se Agolli mbetet poet i qartësisë dhe thjeshtësisë. Në të dy periudhat ai ruan parapëlqimin për detajin, pavarësisht nga metaforat dhe krahasimet e freskëta. Në periudhën e dytë të krijimtarisë së tij ka shtuar muzikalitetin, po pa e zëvendësuar si mjaft poetë në fund të krijimtarisë së tyre, me kultin e ftohtë të formës vrullin rinor të brendshëm. Qartësia dhe thjeshtësia e poezisë së tij lidhen me prirjen për të poetizuar të zakonshmen dhe me çiltërsinë që nuk e lejon të marrë poza, as të rendë pas modash që do ta shtynin të tradhtonte thelbin e individualitetit të vet krijues. Agolli do të mbetet një nga poetët që këndojnë deri në fund dhe të cilëve vetëm vdekja ua mbyll gojën, si thotë vetë ai me humor të këndshëm në një poezi të tij.

¹⁵ Gj. Shkurtaj, *Disa tipare të ligjërimit poetik të Dritëro Agollit*, në Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 137.

¹⁶ Gj. Shkurtaj, *Disa tipare të ligjërimit poetik të Dritëro Agollit*, në Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 133.

Duke qartësuar pozicionin e tij letrar te viteve '90, në pasthënien e përmbledhjes poetike "Pelegriini i vonuar", përveç mesazhit poetik që reflektojnë vargjet e këtyre poezive, ai ndër të tjera shkruar: " Ne besonim në ndërtimin e një shoqërie ku njerëzit të jetonin të lirë dhe në barazi..., mandej ai vazhdon "Nuk dinim se plaga e së sotmes bëhej gangrenë e së nesërme"¹⁷.

Duke pohuar vlerësime të njohura për Dritëro Agollin, theksojmë edhe një herë se ai është një nga personalitet më të spikatur të kulturës sonë kombëtare dhe një nga autorët më në zë të letërsisë bashkëkohore shqipe. Ndiheja e veprës së tij është shumëdrejtimëshe: për nga mesazhet që mbart, për nga larmia e tematikave e problemeve që shtron, për këndvështrimet interesante, për prurje të jashtëzakonshme në stil, për gjuhën e bukur, të pasur, të zhdërvjelltë e plotë kolorit lokal e kombëtar. Dritëro Agolli ka rreth 50 vjet krijimtari të pasur, e cila erdhi gjithnjë e duke u rritur në vlera. Gjuha e veprës së tij është një laborator ku janë ngjizur shumë fjalë të reja, ku kanë lindur shumë kuptime, janë qëmtuar në ligjërimet lokale e janë hedhur në përdorim me qindra e qindra fjalë e kuptime krahinore. Gjuha e poezisë së tij dhe jo vetëm ajo, është kryekreje metaforike dhe një burim i jashtëzakonshëm për demokratizimin dhe intelektualizimin e shqipes bashkëkohore.

Dritëro Agolli, gjithashtu njihet edhe si përkthyes i zoti, duke shqipëruar shumë vepra poetike e autorë në zë të letërsisë dhe të kulturës botërore (kujtojmë këtu poetët R. Bërnes e P. Eluar). Ai, kështu, krahas përkthyesve të tjerë, ka meritën se e ka përballur shqipen me gjuhë të tjera shumë të përpunuara dhe me traditë të shquar në krijimtarinë letraro-artistike dhe fjala shqipe përmes penës së Dritëro Agollit, dhe në këto përkthime, ka ardhur me vlera shënuese shprehëse tepër cilësore.

Si përfundim, mund të themi se: Janë shkrimtarët ata të cilët me krijimtarinë e tyre, me letërsinë artistike bëhen burim i pashtershëm

¹⁷ R. Zisi, *Letërsi bashkëkohore shqipe-Poezia*, Tiranë 2008, f. 146.

për pasurimin e gjuhës standarde shqipe. Ndër to edhe gjuha e poetit Dritëro Agolli, që bën pjesë në letërsinë artistike, konsiderohet një burim i pashtershëm për pasurimin e gjuhës kombëtare letrare shqipe.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Bashkim Kuçuku, Përtëritje e lirikës shqiptare, në D. Agolli, *Lutjet e Këmbanës*, Tiranë, 1998.
2. Dritëro Agolli, *Jeta në letërsi*. Tiranë, 1987.
3. Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009.
4. Jorgo Bullo, *Dritëro Agolli*, në J. Bullo, *Shpirti i fjalës*, Tiranë, 2014.
5. Mina Gero, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit*, Hyrje, Botimet Toena, Tiranë, 2013.
6. Moikom Zeqo, *Liriku i tokës, Demon i fjalës*, Botimet Toena, Tiranë, 1996.
7. Roland Zisi, *Letërsi bashkëkohore shqipe-Poezia*, Tiranë 2008.
8. Shaban Sinani, *Dritëro Agolli, Shkrimtari i dhimbjes dhe i filozofisë jetësore*, Letërsia bashkëkohore shqiptare, Tetovë, 2002.
9. Shaban Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e D. Agollit*, Studime për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të, QSA, Tiranë, 2010.
10. Shaban Sinani, "*Njerëzit e krisur*" të Dritëro Agollit, Shtëpia botuese "Naimi", Tiranë, 2012.

Arqile V. Gjata

gjata.arqile2@gmail.com

MUSINE KOKALARI E VETMJA POETE E SHKRIMTARE FEMËR E VITEVE 1935–1945



ABSTRACT

The literary work of Musine Kokalari remains special in the background of Albanian literature of the years 35 -45 of the XX century. Semantic analysis of poems as well as linguistic and stylistic analysis of her verse as well as the selection of many wedding songs in the volume "How life swayed", form the essence of this paper. Given the fact that the language she uses has many folkloric elements, expressed through a morpho-linguistic analysis, seen also as an expression of a delicate feminine soul, it is necessary to assess how qualitative and how close to the standard it is, to the social conditions where the poet raises her voice which turns into an extremely legitimate revolt, albeit advanced for the time. A revolt that would follow that of other writers and poets of the time in search of a better life. The Musine thesaurus with her work is part of the modern lyricism of that time, its linguistic features are still appreciated today.

Key words: *poetic work, modern and lyric poet, selected wedding songs, phraseology.*

Hyrje

Përzgjedha këtë emër për ta trajtuar si një studim të mëvetësishëm, jo për vlerat e saj të qëndresës, as si personalitet i politikës, por si e vetmja poete dhe shkrimtare femër e viteve 35–45 të shek. XX në Shqipëri. “Ajo është quajtur dhe është shkrimtarja e parë shqiptare me fytyrë të konsoliduar në letërsinë shqipe (si femër)”.¹

Musineja pati “si synim njohjen e plotë të kulturës së popullit shqiptar dhe themelimin e ngritjen e godinës së Letërsisë Etnografike”.² M. Kokalari mbaroi shkëlqyeshëm Universitetin e Romës më vitin 1941 dhe, rrjedhimisht, u ballafaqua me sfidat që vinin nga përpjekjet e sistemit politik të kohës. Ajo i njihte shumë mirë kërkesat e gjeografisë gjuhësore dhe në udhën e saj krijuese punoi për të regjistruar dhe me sa ishte e mundur, të paraqiste në një vepër të veçantë, arealin e këngëve të dasmës të krahinave të trevave të Gjirokastrës. Në vitin 1944 botoi në Mesagjeritë shqiptare librat “*Rreth vatrës*” dhe “*Sa u tund jeta*”. Poezia e saj e parë është e vitit 1937 me titull “*KOLLA E VDEKJES*”:

“Era frynë / frynë me tërbim.

Pika e shiut / Goditin xhamat e penxhereve. / Kurrizin e të xhveshurve

*Të braktisurve që enden rrugës...”*³

“Errësira vjenë, mbulon natyrën, / vë në heshtje zogjtë ligjëronjës”.⁴

Poezitë e përzgjedhura në këtë studim janë:

“Kolla e vdekjes”, “Pas xhamave të dritares”, “Anës detit”, “Shi”, “Një Melodi”, “Të Isha një Lule”, “Ja...Unë” si dhe këngët

¹ Novruz Shehu, Musine Kokalari, Vepër, vëll. I, f. 42.

² Novruz Shehu, M. Kokalari, Vepër, vëll. I, f. 43.

³ Novruz Shehu, Musine Kokalari, Vepër, Vëll. I, f. 46.

⁴ Vepër po aty “Pas xhamave të dritares”, f. 72.

e mbledhura, si pasuri kombëtare në Etnografinë shqiptare.

Musine Kokalari dhe poezia e saj

Nëse do i hedhim një vështrim dhe ta krahasojmë me autorët e tjerë, që shkruan poezi përgjatë viteve 30–40, natyrisht, që poetja dhe shkrimtarja Musine Kokalari ka vlera të qenësishme letrare dhe studimore për kohën që ajo shkroi. Në ditët e sotme, krijimtaria e poetes dhe shkrimtares M. Kokalari vjen si një realitet nga një hapësirë kohe, që na tregon se, kushtëzimet shoqërore mbi poezinë dhe prozën gjejnë adhurim, përkushtim dhe zbatim dhe tek individët–femra, siç është rasti i saj.

Te kjo “Figurë” e rëndësishme ndihet, dallohet qartë jo vetëm ndikimi i familjes dhe i mjedisit në të cilin ajo u formësua, u poq dhe shfaq imazhin dhe personalitetin e saj si femër ndaj kulturës, gjuhës dhe krijimtarisë letrare, por një rol të rëndësishëm ka luajtur edukimi i saj letrar dhe shkencor në një nga universitetet e dëgjuaara të asaj kohe në Romë, që për kohën ishte e jashtëzakonshme. . .

Që të jesh “Figurë” duhet medoemos të zotërosh dituri, të jesh i (e) mençur dhe patriot dhe Musineja, këto vlera i kishte.

Dhe pse në ato vite, në përgjithësi, poetët shkruanin poezi natyrshëm, në stilin klasik, me rimë, M.Kokalari shkruan në varg të lirë, pa rimë, ku ngërthehet në çdo fund vargu tingëllima e zanoreve të zëshme, si:

*“dëgjohet, afrohet, largohet, prej gazit, të këndojnë, ndëgjohet kudo, çastet e kaluara, në dëfrime të shkuara, prapë vazhdojnë”.*⁵

Poezia “*Të isha një Lule*” përcakton më së miri “Unin” poetik, shumë të veçantë për nga individualiteti që paraqet. Si nga ana gjuhësore poetike, e mbështetur në gjuhën letrare të pastër e të pasur, poezia është shkruar me vargje të lira, ndikimet mbi lexuesin, ngjyrat poetike, figurat artistike dhe mendimet e saj me vlera

⁵ “Një Melodi” M. Kokalari, Vepra, vëll. I, f. 99.

filozofike japin një tablo të kohës e cila ka brenda vlera gjuhësore, (për nga leksiku i përdorur e për nga semantika kuptimore), shpirtin e butë femëror, por njëkohësisht revoltën që ziente përbrenda çdo shqiptari për jetën e vështirë dhe problematikat e kohës.

T'ISHA NJË LULE...

T'isha një lule–lule are, e vogël dhe me erë.

Të çelnja në pranverë

dhe në vjeshtë të vishkesha në vetminë t'ime.

T'isha një lule vjollce në mes të ferrave.

Të qëndroja e fshehur, e pa dukur

dhe një ditë të zbulohesha prej duarve të dy të

rinjve.

Prej frike,

të larguar prej njerzisë do t'më këputnin,

do të dhurohesha te njëri–tjetri

për shënjë kujtimi.⁶

Në poezinë e mësipërme bie në sy efekti “dialektor”i përdorimit të zanores “i”, në vend të “y” që nuk i përshtatet fjalës letrare, por përbënë një detaj morfo-gramatikor dhe dialektor.

“*në vjeshtë të vishkesha në vetminë time.*” (Përdorimi “i” në vend të zanores “y”, i jep vargut ngjyrim krahinor, atë nga Gjirokastra ku ajo jeton.)

Në kohën kur Musineja shkroi poezi (vitet 1937–38) ishte një vajzë e emancipuar, me kulturë, që lexonte poezi dhe prozë në gjuhë të huaj. Poetja që në ato vite shkruante me një gjuhë më të pastër, më të qëmtuar se disa nga bashkëkohësit e saj. Gjuha që përdor

⁶ M.Kokalari, Vepra e parë, f. 95-5.

poetja M.Kokalari ka kulturë gjuhësore; Ajo është vetë Gjuha Shqipe e Jugut. Jo vetëm kaq, por përdor fabulën poetike me shumë profesionalizëm, jo thjesht si një gjetje. E ndërthur poezinë, duke i dhënë asaj dinamizmin, ritmin dhe efektet e thyerjes së vargut. Si për shembull:

*“Nëna ngadalë kërkon fytyrën,
hëna lëviz në qiell dhe rrezet bien mbi ata të dy
që janë në rrugë. Ajo e sheh, e sheh mirë,
për herën e fundit. Heshtazi afron buzët dhe i puth ata sy
që s’do hapen më,
me lotët e saj, vadit dhe pastron ato faqe
dhe me dorë i ndreq flokët”.*⁷

Njësi frazeologjike të tipit: *"ata sy që s'do hapen më"* që ka kuptim figurativ *"ka vdekur"*, *"s'kanë më jetë"*; *"e sheh për herë të fundit"* që ka kuptimin *"nuk e sheh më"* etj., i shoh të motivuara me metaforë dhe i japin vlera figurative, stilistike dhe semantike poezive, në krijimin e domethënies së tyre nga ana kuptimore.

Te: *"dhomë e zhveshur"* ka kuptimin *"dhomë bosh"*; *'kalon plasjet e mureve"* - kuptimi *"depërton, kalon tejprtej"*; dhe *"i lë shteg"* – ka kuptimin *"e lejon"*

Te *"gjallëri gjysmake"* - ka kuptimin *"jo e mjaftueshme"*; *"çape të rënda"* – ka kuptimin *"ecën rëndë"* (është i lodhur, i sëmurë, i mërzitur etj. .)

Ndjeshëm, ndihet përdorimi i frazeologjisë, e motivuar me figuracione në funksion të idesë dhe kontekstit, sa që bëhesh të të dridhet trupi si purtekë nga dhimbja e madhe që ndien. Kjo poezi është vërtet një mrekulli poetike... *“Nëna ngadalë kërkon fytyrën”,*

⁷ M.Kokalari, "Në gji të nënës" Kokalari, Vepra I, f. 78.

mos vallë vërtet ajo fytyrë njomëzake e fëmijës ka humbur? Po lotët e asaj nëne të drobitur, mos vallë po vadit apo pastron faqkat e vogëlushit?! Eehhh, me dorën e saj, “*ndreq flokët*” që vogëlushit mos t’i prishet bukuria, dhe ashtu, siç është, i pajetë!

Indentiteti shoqëror e gjuhësor në krijimtarinë e M. Kokalarit

M. Kokalari u rrit dhe u edukua në një mjedis familjar të përparuar, të shkolluar dhe vetë dinjiteti i saj vetjak është superior ndaj gjithë pjesës tjetër të vajzave të asaj kohe.

Sapo lexon krijimtarinë poetike të M. Kokalarit, bie në sy një ligjërim fonetik dhe leksikor tipik i trevave të Labërisë së Gjirokastrës si dhe me pak kuriozitet dallojmë dhe strukturën e gjuhës së saj, të atij mjedisi që përkon me stadin zhvillimor të shoqërisë të asaj kohe.

Duhet dalluar dhe veçuar krijimtaria e saj poetike e mirëfilltë, shkruar me kulturë gjuhësore, me kujdesin për të shkruar me gjuhë letrare, me veti ekspresive–emocionale. Gjithë krijimtaria e saj poetike, e cila dallohet thelbësisht nga pjesa tjetër e veprës së saj si mbledhëse e përkushtuar e folklorit gojor të këngëve në dasmat e trevave të Gjirokastrës dhe rrethinave të saj.

Duhet thënë se në veprën e poetes dhe shkrimtares Musine Kokalari dallohet e ndihet më se reale fryma e revoltës, e dhimbjes që brente jetën dhe shoqërinë e asaj periudhe. Bukuria e gjuhës poetike të ndjerë, përdorimet e shumta të shprehjeve nga gurma popullore i takojnë asaj treve ku dhe vetë autorja ka jetuar. Këto prurje që gjejmë në të dy vëllimet e botuara nga Shtëpia Botuese “GEER”, 2009, të përzgjedhura nga Novruz Shehu, këngë që tregojnë truallin e së folmes ku janë formësuar e folur dhe ku ato janë kënduar, vijnë në këtë studim me një analizë morfo-linguistike, për të nxjerrë në pah vlera gjuhësore dhe semantike-kuptimore.

Gjithë lënda e mbledhur që gjendet në librin “*Sa u tund jeta*”,

përmban shumë elemente dialektore. Kjo prurje këngësh dasme, tregon gjithashtu se si e kanë hedhur shtatin e tyre në zhvillim, nga njëra këngë te tjetra, nga njëra periudhe në tjetrën, mënyrën se si i këndohej brezave të ndryshëm, pjesëtarëve në dasmë, (dasmorëve, nuses, dhëndrit, vjehrrës, kunatës, familjes, fisit, etj.), mënyrës së të jetuarit, shkallën e humorit. Elementet, si: arkaizmat, apo karakteristikat e së folmes dialektore dhe nivelin e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të atyre trevave, janë të pranishme në atë vëllim.

Në krijimtarinë e M.Kokalarit, e cila: *“...për të dhënë më mirë atmosferën sa më të natyrshme, sa më afër jetës së popullit, zgjedhi dialektin e Gjirokastrës duke ruajtur atë në disa shfaqje nga më tipiket.*⁸ Në të gjitha poezitë e saj dallohen bindshëm situatat, ndodhitë, përjetimet, ndjenjat nga bota femërore.

Duke lexuar veprën letrare të kësaj poeteje, ndeshesh, ballafaqohesh me një përcaktim tipik bardhezi. Është bota e kontrastit, e përballjes të së mirës me të keqen, e dhimbjes dhe gëzimit, e revoltës dhe e heshtjes.

*“Errësira vjen, mbulon natyrën, / vë në heshtje zogjtë ligjëronjës”.*⁹

*“Kështu ngadalë përsëri largohet / pa bërë zhurmë, si një fantazëm e zezë”.*¹⁰

Në këtë poezi tronditëse, shpreshtohet ritmi i fortë i fjalës, i efekteve emocionuese, rritet intensiteti i mendimeve nga një strofë në tjetrën:

*“Bubullima buçet prej qiellit me forcë,
një kollë e thatë ngulçon.*

⁸ Dalan Shaplo, Vepra e M.Kokalari, në “Duke kërkuar të vërtetën dhe humanizmin”, Toena, Tiranë, 1999, f. 118.

⁹ Poezia “Pas xhamave të dritares”, f. 72.

¹⁰ Poezia “Kolla e vdekjes” 12-Vepra e parë, 2009, f. 73.

në kraharorin e së mjerës.

.....

Përsëri kollë, por më e fortë.

Gruaja s'ka më fuqi,

rrëzohet për tokë dhe drejton sytë nga qielli.

Derdh lotë, lotë dëshpërimi dhe mëshirë...

asnjeriut s'i dhimbset.

.....

Sytë pa shkëlqim mbyllen dhe drita çduket dal-nga-dalë.

Buzët rrinë pak të çelura me një nënëqeshje tallëse.

Merr frymë për herën e fundit.

Kolla nuk dëgjohet më,

ajo triumfoi”.¹¹

Poezia e Kokalarit ka efekte të forta emocionale, ndjesi dhe përfytyrime që shkojnë përtej së mundshmes. Sarkazma poetike e përdorur vjen si rezultat i revoltës së brendshme të saj, gërshetuar me intelektin që e karakterizon atë. Po pse, drita ka aftësi të “*çduket dalëngadalë*”? Ç’mund të mendojë dhe të përjetojë një lexues gjatë leximit të këtyre vargjeve...?

Janë vargje poetike që të treten në shpirt. Zemra qan dhe gjaku pulson nga ngashërime! Të tilla ndjesi lexuesi i has në tërë krijimtarinë e saj.

Krahas Nolit e Migjenit, ajo është poetja e atdhedashurisë me shpirt revolte, poetja e dhimbjes, që ngrihet mbi realitetin për të thënë me zë të lartë gjendjen e mjerueshme të popullit të saj dhe në veçanti përshkruan dhe vendos në qendër të poezive të saj

¹¹ M.Kokalari, Vepra e parë, Tiranë, 2009, f. 68–69.

pozicionin e femrës shqiptare të vuajtur, të lodhur nga injoranca dhe gjendja ekonomike dhe të shtypur nga interesa shoqërore të kohës.

Poezia “*Vdekje*” është tronditëse, shkruar me shpirt revolte, të pikëllon, drithërohesht nga ai realitet i jetës së popullit. Poetja, vajza e asaj kohe, e njeh shumë mirë botën ku jeton dhe ka për mision, jo vetëm të pasqyroj realitetin, por dhe ta publikojë, ta ndërgjegjësojë shoqërinë ku ajo jeton.

..Dua bukë!’’¹²

Ajo hesht, s’di ç’të bëjë; vetëm derdh lot.

Fëmija lebetitin, thërresin dhe ky zë oshëtin

në dhomën e çveshur prej çdo orendije

dhe si jehonë vajtimi dëgjohet ngadalë jashtë,

pasi kalon plasjet e mureve

dhe të çatisë,

të cilët i len shteg erës dhe shiut

në netët e ftohta të dimrit.

Lebetitja e fëmijës, si jehonë vajtimi, pasi “*kalon plasaritjet e mureve dhe të çatisë*”, i “*hap udhën*” (i lë shteg) erës dhe shiut. Poetja jep një panoramë ngjyrash, ravijëzim të profilit të gjendjes së mureve nëpërmjet figurave poetike plot magji e fantazi! Por më shumë, poetja e ka shkruar këtë poezi me shpirtin e saj. Vajtimi i saj jehonë përtej vargjeve:

“Ja mjerimi!

Ja vdekja! Vdekja shpirtërore! Vdekja për së gjalli!”

Te kjo poezi “*Elegjika*” shikohet si pikë kulminante, ku efekti i përsëritjes së kryefjalës “*vdekja*”, arrin kulmin e saj semantik! Në këtë poezi “*Vdekje...*” gjen figura poetike të mahnitshme, groteske,

¹² M.Kokalari, Vepra, Vëllimi I, Shtëpia botuese Geer, 2009 f. 75.

të përjetuara artistikisht, ku metafora të drithëron si një dhimbje e madhe.

Në tërë lëvizjen e jetës elementet vajtues shprehen; “...*me fytyra të palara, me gjallëri gjysmake, që largohen me çape të rënda*”, vdekja shpirtërore, si vdekje vuajtjesh, mjerimi, skamje dhe paditurie!

“dyert çelen prej njerëzve me fytyra të palara,

rendin të lozin me baltën e rrugës.

Kudo lëvizje;

një gjallëri gjysmake duket.

Vajtje–ardhje, hapje mbyllje dyerësh

dhe çape(hap) të rënda që largohen...”¹³

Poezia “ANËS DETIT” është e veshur me një lirizëm të hollë poetik dhe përshkrim të qetë...” duke marrë me vete disa psherëtima.” Duket sikur ka një lloj paralelizmi me “Anës lumenjve” të Nolit..., por ka edhe individualitet të Musinesë, që ajo nuk i ka të kopjuara. Ajo çfarë për mua është inkurajuese, është kapja dhe shtrimi i problemeve kaq të mprehta për kohën, për të cilat ajo ngre zërin, madje, fort...dhe s’ka frikë.

“Këndshëm frynte era e detit ;

lehtas e ngadalëz përplaseshin dallgët

në shkëmbijt e gërryer shekuj përpara;

megjithatë heshtja mbretëronte.

Era pushon së fryri,

oshëtima e detit dëgjohet duke u larguar

¹³ Vepra po aty fq. 74.

*dhe duke marrë me vete disa psherëtima,
barishtat e grabitura prej valëve
qëndrojnë në mes të detit
dhe dielli i fshehur prapa malit,
lëshonë rreze të argjenta
në sipërfaqen e qetë”.*¹⁴

Në këto vargje poezia është e strukturuar qartë nga njësi semantike, ku dallohet mënyra “e qetë” e një përshkrimi poetikë lakonik dhe me semantikë lirike. Në këtë poezi veçohet trajta zvogëluese e ndajfoljes “e ngadalëz”, që e përçon me delikatesë përplasjen e dallgëve, ashtu si me buzëqeshje dhe butësi. Është karakteristike e së folmes së saj, idiolektit të saj, individualitet, që spikat në këtë poezi me ngjyra ledhatuese, për ta sjell fjalën përkëdhelisht të bukur.

Përfundimisht, mund të themi se stilistika e poetes M.Kokalari ka formatin, peshën dhe figuracionin e një poezie moderne, e cila prodhon frazeologji, që kanë ngjyrim, efekte dhe trajta ndërtimore të ndryshme. Pasi pamë, vëzhguam, lexuam poezinë e poetes M.Kokalari, pranojmë se ajo shkruan një gjuhë të përafërt letrare për kohën kur poetja shkroi, të qëmtuar dhe me pak dialektizma dhe huazime, që natyrshëm bëhen pjesë e fjalorit të atyre poezive.

Ndërsa, kur lexojmë skicat, tregimet dhe “*Sa u tunt jeta*” vërejmë se autorja tërësisht përdor gjuhën, të folmen e krahinës së Gjirokastrës dhe këngët janë burimore, gojore të mbledhura dhe të shkruara me merak nga ajo, ku fjalët dialektore të trevave të Gjirokastrës janë të shumta, të cilat përmbushin tërësisht objektin e studimit.

Vlera folklo-etnografike e përzgjedhjeve “këngë dasme” nga M. Kokalari dhe ndikimi i tyre sot

¹⁴ Musine Kokalari, Vepra një, Shtëpia Botuese “Gjeer” Tiranë, 2009, f. 82.

Një vlerë për Musine Kokalarin përbën puna e saj e admirueshme në mbledhjen e këngëve (folklorike) të dasmave dhe ngjarjeve në të folmen e bukur të Gjirokastrës.

Sipas autorit, (Novruz Xh. Shehu, përgatitës i veprave të M.Kokalarit), mësojmë se Musineja ”në moshën 10 vjeçe nis të grumbullojë dhe të sistemojë këngë dhe tregime të popullit.”¹⁵

Musineja në vitin 1937 boton vazhdimisht skica letrare në gazetën “Shtypi” me pseudonimin “Muza” duke vendosur në qendër të tyre femrën dhe problemet sociale të kohës. Besoj se nuk do jetë rastësi, as imitim, por një këndvështrim, një qasje rreth një dukurie shoqërore ku ashtu si Ali Asllani dhe M. Kokalari trajtojnë poetikisht të njëjtën temë dhe të dy të ndikuar nga poetika e krijimtarisë popullore të Labërisë.

Ajo që dua të theksoj dhe ta përcaktoj si një arritje dhe si pasuri të madhe etnografike është fakti i pamohueshëm se puna e M. Kokalarit, nuk është thjesht për të përgatitur një vëllim, për të grumbulluar vargje, këngë nga trashëgimia gojore e trevave të Gjirokastrës, por sepse ajo diti, gjeti me shumë mençuri dhe aftësi krijuese, që të stilojë, të harmonizojë me fantazi në mënyrë të përkryer “JAVËN E DASMËS GJIROKASTRITE”.

Ajo çka e bënë shumë interesante këtë vepër etnografike është se çdo ditë e dasmës ka një shkak, një ritual–zakonor për t’u mbledhur, si në shtëpinë e vajzës (nuses), ashtu dhe në shtëpinë e djalit (dhëndrit). Për shembull:

“Daltë nga gola t’ënde e vafte në vesh të Perëndisë”, “U, u! Kur kështu?”, “Dita e nishanit”, “Sa të vije...”, “Për së shpejti kemi dasmën”, “Javën që vjen...”, “Dita e vetullave”, “Nata e brumit”, “Dita e kënasë...”, “Natë e kënjat...”, “Nën’ e vajzë...”, “Dit’ e nuses...”, “Nat’ e dhëndrrit...”. “Pala...(paja)”, “E pesta”...

¹⁵ M.Kokalari, Vepra vëll. I, f. 41.

“Dasmë, sa u tunt jeta”

Musineja me pasion dhe me vullnet të çuditshëm, sigurisht, dhe me shumë vështirësi, ka mundur t’i lërë kohës, të nesërmes, trevave gjirokastrite, këngë që kapin një hark kohor prej disa shekujsh, që këndoheshin në ato vatra familjare, si në Gjirokastrë, por dhe në fshatrat për rreth saj. Këto këngë janë pasuri e gjithë popullit të krahinës, ato nuk kanë autor me emër të përveçëm, janë këngë të botës shpirtërore të brezave të mëparshëm që jetuan në ato vendbanime (aty gjejmë jo më pak se 504 vjersha të tilla). Këto kanë ardhur nëpërmjet gojëtarëve që me dashuri i kënduan këto këngë nëpër dasma, brez pas brezi. Të gjitha këngët janë në vargje dhe e ruajnë melodinë, ritmin, rimën, por më shumë karakterizohen nga ritmi dhe tingëllima. Në ato këngë dallohet ironia e hollë dhe përcëlluese. Pothuajse, në të gjitha vargjet, rrokjet fundore përfundojnë me zanoret; “a, e, i, u, o, y” dhe përdorimi i “ë” si një element shumë i veçantë, karakteristike e gjuhës shqipe, nëse e krahasojmë me gjuhët e tjera, nuk e kanë këtë pasuri gjuhësore.

“Moj nuse koqe(krahinore) lajthi, / Ato që thanë për ti(y-i) / T’u bëfçin(sh-ç) kurban e hi. / Gjithë bota fjalë thanë. / Xhiko nuse moj sulltanë, / Ne të zumë e s’të lamë. / Xhiko nuse moj sulltanë.”¹⁶

“Filxhani larë me bojë, / Keshë(kam/kisha, kohë e shkuar) mall pa të kërkojë, / Nga bukurija të doja; Vashë leshra mavrija(huazim nga “mavro”, ndikim nga greqishtja). / Moj të keshe ment’ e mija. / Ment’ e mija moj t’i keshe; (keshe –kishe, folja “kam”, koha e shkuar, veta e dyte); Saraf në Stamboll do jeshe(jam, ishe, -kohë e shkuar) / Treqind lira do ti keshe.”¹⁷

“Mike me shami më nj’anë, / Moj mike, / Mos mike se dogje fshanë(fshatin, krahinën, / Moj mike; /Ç’i bëra fshatit të shkretë. / Un’(bie zanorja-ë) e mjera? / Ra zjarri dhe u–doq vetë, / Un’(trajtë

¹⁶M.Kokalari, Vepra, vëll. II, f. 3.

¹⁷M.Kokalari, po aty, f. 34.

e shkurtër e përemrit vetor, dialektore) e mjera”¹⁸ ; “Bram bëri dyfeku, / Prapa atij bregu. / Dil moj nënë dil, / Dil të bëç(përdorimi i “ç” ne vend të “sh”); sehir(huazim nga turqishtja)./Se ç’të pruri djali. / Nexhip kanakari (huazim nga greqishtja), / Zogun e beharit / Thëllëzën e malit.”¹⁹

“Në maj të malit-o /Trëndelina zarik-o, / Lulet e beharit-o, / Trëndelina zarik-o, (veme re përdorimin e shpeshte të zanores “o”, për t’i dhënë vargut muzikalitet dhe njëkohësisht zbulojmë edhe karaktere dialektore të jugut të Shqipërisë).

Eja o behar ku je, / Të dergjemi n’ atë qe. / N’ato bashte plot me mollë, / Ato mollë ç’qen të ëmbla; ...vajza griqë-zëna. / Të mbulonin me mënga. / Me mëngat e sqetullavet,

Të keqen e vetullavet. / Vetullat pse t’u nxinë, / Apo ke vënë mazinë? / Jo,jo, jo, për Perëndinë, / Po kam vetë bukurinë.”²⁰

Frazeologjia dhe përdorimi i saj në veprat e Musine Kokalari

Frazat apo shprehjet e përdorura me zgjuarsi e ndjenjë thellësisht delikate femërore e të ndjera do t’i klasifikojë si konkrete dhe të figurshme. Do të parashtroja dy anë të gjuhës së përdorur me kaq mjeshtëri duke lënë ambiguitete të cilat i japin frazës jo vetëm figuracionin, por edhe karakterin pragmatik, nëpërmjet asaj që nënkuptohet, dhe që lexuesi e bënë vetë këtë ndarje të pashmangshme kuptimore...

¹⁸ M.Kokalari, po aty, f. 78.

¹⁹ M.Kokalari, po aty, f. 15.

²⁰ M.Kokalari, po aty, f. 17.




Figura 1. Mbi klasifikimet e njësive frazeologjike²¹

a) Fraza shihet si togfjalësh i lirë, ku veprim konkret është i dukshëm, si p.sh.:

“... ja ke hipur kalit”; “në maj të malit-o”; “prapa atij bregu”; “eja o behar ku je”; “...koqe(krahinore) lajthi”; “gjithë bota fjalë thanë” etj. të cilat i shohim edhe si togfjalësha të lirë me kuptim e veprim konkret.

b) Fraza shihet si njësi frazeologjike, veprim i figurshëm ku fraza vishet me metaforë, si p.sh.:

“Ti, ja ke hipur kalit, prandaja më flet kështu moj Aishe”; “të thom të mbaç golën”; “ra në të zeza”; “moj mollë e kuqe”; “je bërë dillë..”; “gjithë bota fjalë thanë” etj., por shpesh këto lloj njësish frazeologjike gjejmë të motivuara edhe me hiperbole: *“i doli gazi mbi rroba”; “e mori zoti me gurë”* etj., apo edhe me krahasim: *“Si flori u duk përmbi të gjitha shoqetë”* etj., ku gjejmë edhe të rimuara ku brenda kanë krahasime me karakter folklorik: *“moj si zez’ e gushë bardhë, moj si zez’ e kaço prerë, siri jot një lir’ e verdhë”*; *“moj nuse koqe(krahinore) lajthi etj.*

²¹ Sh. Gjergji, “Mbi Relativizmin Gjuhësor, Frazeologji e Shqipes/Frazeologji e Anglishtes”, doktratura, 2016.

Spikasin gjithashtu edhe elemente të tilla fonetike, si shprehje e së folmes dialektore, si: *t"u bëfçin kurban; të më duaç derëzinj; (përdorimi i "ç" në vend "sh"), ose "Zotrote je verdhur e je bërë dillë; vajza grike-zëna; ato që thanë për ti etj. (përdorimi i "i" në vend të "y"), "kren sitë", ose "Pala...(paja); "daltë nga gola t'ënde..."; "të thom të mbaç golën"; (përdorimi i "l" në vend të "j"); "në ato bashte-në ato baçe"; "të thom të mbaç golën" (përdorimi i "sh" në vend të "ç" ose "ç" në vend të "sh") etj.*

Gjithashtu nëpër vargje zbulojmë vlera morfo-gjuhësore, si: "barishtat" për "barishtet" (një formë dialektore e formimit të shumësit të emrave); "ngadalëz përplaseshin dallgët"(pjesa fundore e ndajfoljes me nuancë zvogëluese); "të çelnja në pranverë" në vend të çelesha (dialektore) etj.

Të tilla njësisht, qoftë frazeologjike, qoftë togfjalësha të lirë, zbërthejnë më së miri atë semantike kuptimore, të cilën Musineja e vlerësoi me punën e saj përzgjedhëse dhe sot ato qëndrojnë me shumë domethënie në arkivin e gjuhës poetike shqipe me vlera popullore e gjuhësore.

Përfundime

1-Krijimtaria letrare poetike e M. Kokalarit ka vlera gjuhësore leksiko- semantike, ku frazat me domethënien e tyre hyjnë në ligjërime bukurshkruar e artistikisht, për të dhënë këto vlera së bashku me mesazhin e tyre në mënyrë të ndryshëm nga autorë të tjerë dhe hera-herës me karakter dialektor, ku spikat dialekti i trevës së Gjirokastrës, prejardhja dhe vendi ku ka jetuar edhe vetë autorja.

2-Shpesh brenda poezive të Musinesë është e pranishme dhimbja e gërshetuar me një revoltë femërore, por që ka forcën e duhur dhe është shprehje e vazhdës së autorëve si Noli, Migjeni etj., për të dalë nga kjo gjendje e vështirë e atyre viteve, në të cilën krijimtaria e saj është shkruar, ku ata iu drejtuan vargjeve si mjeti kryesor shprehës.

3-Autorja përdor një gjuhë shqipe të shkruar bukur dhe shumë afër standardit të gjuhës letrare, duke na prurë, brenda një kontrasti edhe mjerimin, por edhe “gazin” e dashurinë për jetën.

4-Në përdorimin e dialektalizmave jugore spikatin përdorimi i zanores "i" në vend të zanores "y", përdorimi i "ç" në vend të "sh" dhe anasjelltas, (*bëfçin, duaç, mbaç etj*), përdorimi i “l” në vend të “j” , (*siri, sitë, dillë etj.*) përdorimi i shumësit në forma, si : *barishtat etj.*, përdorim të foljeve kam, jam, tha, si forma të tilla: *jeshe, keshe, thom etj.*

5-Vargu i Musinesë është i lirë, pa numër të caktuar rrokjesh dhe me strukturë të ndryshueshme që i ngjason shumë poezisë moderne, pa rregulla, por që i përket poezisë lirike moderne e shkruar ndër vitet 30-të të shek. XX.

Bibliografia dhe literatura e konsultuar

Musine Kokalari, Vepra, vëllimi i parë, Shtëpia Botuese “Geer”, 2009, Tiranë.

Musine Kokalari, Vepra, vëll. II, Shtëpia Botuese “Geer”, 2009, Tiranë.

Ali Asllani, Vidi-vidi pëllumbeshë, poezi të gjedhura, Toena, Tiranë, 1999, f, 244–249.

Ndreca, M., Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë, 2000.

Jashari, A., Fjalor me shprehje të huazuara në Gjuhën Shqipe, Korçë, 2007.

Jashari, A., Material frazeologjik nga krahina e Devollit, Sf., nr.4, 1975.

Kostallari, A., (1984). Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë, Sf., 4.

Kostallari, A., (1989). Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, III, Tiranë, f. 41-76.

Memisha, V., (2006). Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike. Në, Sf., nr. 3 - 4.

Memisha, V., “Studime për fjalën shqipe”, përmbledhje artikujsh, Tiranë, 2011.

Nerlich, B., Semantic theories in Europe 1830- 1930, Philadelphia, 1992.

Sh. Gjergji, “Mbi Relativizmin Gjuhësor, Frazologji e Shqipes/Frazologji e Anglishtes”, dokt. 2016.

Gjoçaj, Z., Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe, Prishtinë, 2001.

Shkurtaç Gj., Të shkruajmë Shqip, Toena, 2008.

Shkurtaç Gj., Kundrime Gjuhësore, Shtëpia Botuese, “Pegi”, Tiranë, 2006.

MERITA GJOKUTAJ-SHEHU

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

**“DASMA LUNXHOTE”, CEREMONIALI QË I
NGRE KULT PËRTËRITJES SË JETËS.**

ABSTRACT

It is necessary to mention that it is not a purely folkloric study, but also an ethnologic one. The syncretic character of folkloric creations has stimulated the author of this study to undertake a complex analysis of Gjirokastra wedding lyrics, viewed as being closely connected with the rites, geography and ethnography of the folkloric zone under study. While making this analysis, the author has used not only studies related to folklore, but also ethnographic and historical ones. While carrying out this ethnographic analysis we have regarded the nature of the genre: lyrics that focus on the feelings sometimes lose or fade the reflective function, often mimetic, in some cases they transform the situations, details, atmosphere etc in the name of beautifying or other functions characteristics of the oral creation.

Hyrje

Fondit të botimeve me hulumtime të etnokulturës shqiptare i është shtuar edhe libri “Dasma Lunxhote” e autorit Koço Vasili. Ky punim është i natyrës anketuese - hulumtuese dhe bën për objekt të vetin ritin e dasmës në zonën e Lunxhërisë. Ky punim vjen pas një seri punimesh të pjesshme e të përgjithshme që trajtojnë aspekte të veçanta të lirikës së dasmave shqiptare, probleme të përgjithshme të riteve të dasmave etj. Si e tillë ajo sjell një ndihmesë me vlerë në plotësimin më të mirë të fondit etnografik e folklorik të dasmës shqiptare.

Duhet thënë që në krye, që ky nuk është një punim ngushtësisht folklorik, por një punim etnologjik. Vetë karakteri sinkretik i krijimit folklorik i ka imponuar autorit të këtij punimi një trajtim kompleks të lirikës lunxhote, parë të lidhur ngushtë me ritualin, me gjeografinë dhe etnografinë e zonës folklorike që bën objekt hulumtimi.

Autori ka gjurmuar lëndën etnografike që gjendet brenda vargjeve të këngës së dasmës lunxhote, gjë që nuk lidhet vetëm me ritin e dasmës, por me jetën në përgjithësi, si p.sh.: veshjet tradicionale të stolisura me gajtanë, arkitekturën e fshatrave që i përngjajnë qytetit të Gjirokastrës, vreshtarinë, vallet e bukura lunxhote, toponimet, ngjyrimet leksikore që sjellin koloritin e jetës në Lunxhëri etj.

Punimi dëshmon për një hulumtim e njohje gati shteruese të materialit folklorik, në radhë të parë duke regjistruar vetë tekstet e këngëve nga subjekte të veçantë dhe në dasma në fshatrat: Dhoksat, Këllëz, Selckë, Erind, Nokovë, Mingul, Saraqinishtë, Krinë e Stegopul, ku tradita dhe folklori bëjnë ende një jetë të gjallë e aktive.

Gjatë kryerjes së këtij hulumtimi etnografik është mbajtur parasysh natyra e zhanrit: lirika duke e vënë theksin mbi ndjenjat, jo rrallë zbeh funksionin pasqyruës, mimetik, madje, në disa raste edhe i

transformon situatat, detajet, atmosferën etj, në emër të funksionit zbukurues apo funksionesh të tjera karakteristike për krijimtarinë orale.

Gjatë hulumtimit të dasmës lunxhote bie në sy kalimi mjaft i detajuar mbi lidhjen e krushqisë, ndërrimin e nishanit, javën e dasmës si dhe mbi aspektet ekonomike të lidhjes martesore. Në jetën e përditshme këto aspekte luanin rol parësor, sepse lidheshin me jetesën e ardhshme të çiftit, por edhe sepse martesa kishte si funksion, krahas të tjerash të krijonte lidhje miqësie, përkrahjeje, bashkëpunimi midis dy familjeve. Gjejmë në të takëme të argjendta, salltanete të rënda, shpenzime ekonomike, vajtje - ardhjet, trapezet e stolisur e të mbushur plot, kostumet lunxhote me vlera të pallogaritshme etnografike, estetike e monetare, shtëpitë zapana si dëshmi e këtij realiteti historik etj, etj.

Parë në këndvështrimin social-psikologjik ndër prindërit e çiftit, babai dhe vjehri nderohen më shumë, në një kohë që nëna (në funksionin e krushkës) dhe vjehra jo rrallë bëhen burim humori. Paradoksi që posa përmendëm bëhet më i perceptueshëm kur pranëvitet me një element tjetër: vëmendje më e madhe i kushtohet nuses kurse dhëndri, krahasuar me të del si figurë sekondare. Pra, në njërin rast kanë përparësi meshkujt, në tjetrin femrat. Arsytet e këtyre paradokseve mund të jenë nga më të ndryshmet. Ndër to kemi mendojmë si të tilla: pozita prej namusqari e burrit në familje, të kënduarit e një pjese të mirë të kësaj lirike nga gratë dhe në ambiente grash, prirja për të poetizuar bukurinë dhe pastaj rininë, forcën e vitalitetin si ideale etike e estetike për çiftin etj. etj.

Zërat që dëgjohen në këtë lirikë janë nga më të ndryshmit, dëgjojmë të flasë nusja, dhëndri, shokët e shoqet e tyre, nëna, babai, krushka, vjehra, kunata, motra etj., etj., por në më të shumtat e rasteve jemi para një ligjërimi të imagjinuar, ndaj themi se mbisundues është zëri i bashkësisë. Larmia e këtyre zërave realë e të imagjinuar bëhet burim i një materiali të pasur psikologjik, ashtu siç bëhet shkak edhe për një karakter të theksuar dialogues, gjë që bie më në sy kur këndohet në grupe që alternojnë njëri - tjetrin.

Bashkësia, në më të shumtën e rasteve, flet në emër të nuses,

dhëndrit, nënës, babait etj, etj. Kur mbajmë parasysh këtë fakt na bëhet më e kuptueshme pse në këtë lirikë zë vend aq të madh motivi i tjetërsimit. Ky motiv përfshin tjetërsimin vajzë – nënë – baba – vëlla - të afërm, nuse – vjehërr – vjehërr – kunatë - farefis, djalë – nënë - shokë të rinisë etj, etj.

Motivi i tjetërsimit dhe motive të tjera që u përmendën më lart sjellin në këtë lirikë një materie të pasur sociale e psikologjike, i japin asaj një sens realiteti e mbijetese, sepse, si rregull, janë dukuri me rrezatim gati universal. Pjesa më e madhe e tyre sjellin përfytyrime të Shqipërisë tradicionale ose të një shoqërie tradicionale ballkanike në përgjithësi.

Në hulumtimin e ritit së dasmës lunxhote, autori është ndalur në karakterin spektakolar dhe në karakterin emotiv. Me karakter spektakolar nënkuptojmë një ceremonial madhështor që tërheq vëmendjen me bukurinë dhe që presupozon gjithësi raporte aktorë - spektatorë, paçka se shpesh këto raporte shtrihen edhe brenda të njëjtit individ. Karakteri spektakolar i këtij ceremoniali buronte sa nga natyra e tij solemne, aq edhe nga mungesa e jetës së mirëfilltë artistike, si dhe nga kontributi i një numri jo të vogël bartësish brenda të njëjtit ceremonial.

Karakterin e theksuar emotiv i dasmës lunxhote lidhet me faktin që ceremoniali i saj shënonte një ngjarje dramatike që rrezatonte gjerë. Faktikisht, festimi me solemnitët e martesës së çiftit e nxirrte më në reliev gëzimin e familjes, fisit e të bashkësisë, ashtu siç nxirrte më në reliev dramën e ndarjes së vajzës nga vatra amtare, trishtimin e lehtë të kalimit nga djalëria në burrëri etj. Në një atmosferë spektakolare, masive e solemne, këto e të tjera përjetime kanë pasur prirjen të iniciojnë dukurinë e projektimit.

Për mendimin tim do të qe punim më interesant, nëse autori do të kishte shfrytëzuar edhe studimet e ndryshme për folklorin, si dhe studimet etnografike e historike në sistem krahasimi.

Punimi i Koço Vasilit edhe pse është thjesht një punim përshkrues, dëshmon përpjekjen për të vënë në dukje, si prirjen për konservim dhe prirjen për rinovim të saj, si shprehje të një dialektike zhvillimi historik, përcaktuar prej faktorësh të brendshëm

e të jashtëm. Me të drejtë autori i punimit shprehet se ***“Ky botim etnokulturor është shpirti, truri, zemra dhe bota e pasur shpirtërore e atyre njerëzve, mbushur me thesare e xhevairë, që s’ua çmon dot vlerën, por që mbeten dëshmi historike e së dashurës, të madhes, nënës tonë të përbashkët, Lunxhëri.”***¹

Në mbyllje do të doja të përfundoja me fjalët e studiuesit Tasim Gjokutaj, një njohës shumë i mirë i lirikës së dasmës tradicionale gjirokastrite: ***“Është kënaqësi për mua të theksoj se koloriti tradicional i lirikës së dasmës më ka sjellë gjatë gjithë kohës së hulumtimit një kënaqësi të veçantë, kënaqësinë e takimit dhe të çmalljes me gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, me botën e tyre pak të vjetruar, por gjithsesi të dashur e të respektuar.”***²

Literatura e shfrytëzuar

1. Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, 1994.
2. Ismail Kadare, Autobiografia e popullit në vargje, Tiranë, 1980.
3. Tasim Gjokutaj, Lirika e dasmës tradicionale gjirokastrite, Tiranë, 1996.
4. Koço Vasili, Dasma lunxhiote, Botimet “Argjiro”, Gjirokastrë, 2013.

¹ Koço Vasili, Dasma lunxhote. Botimet Argjiro. Gjirokastrë, 2013. F.12.

² Tasim Gjokutaj, Lirika e dasmës tradicionale gjirokastrite. Tiranë, 1996. F. 228.

MIMOZA ZEKAJ

Universiteti i Gjirokastrës

**VËSHTRIME TË PROF. KOLEC TOPALLIT PËR
HISTORINË E ZANOREVE HUNDORË NË
GJUHËN SHQIPE**

ABSTRACT

The aim of this paper is to examine some scientific research of prof. Kolec Topalli, with reference to the history of nasal vowels in Albanian language. The contribution of prof. K. Topalli is remarkable in the field of historical phonetics, but we are mainly concentrated on his views over the chronology of this phenomenon. Nasal vowels are not inherited, because the Indo-European language does not have such types of phonemes. They were created during the internal development of the Albanian language. Defining the time milestones over the phenomenon of nasality was initiation in the Albanian language, on one hand presents difficulties concerning this phenomenon antiquity, and on the other hand, the late documentation of the Albanian language. Taking into consideration the conducted studies over this phenomenon and scientifically being based on them, we assert that the appropriate answer has been given about the history of nasal vowels in the Albanian language.

Key words: *Albanian language, historical phonetics, nasal vowels, dialectical character, phonetic conditions*

Zanoret hundore të gjuhës shqipe kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e dijetarëve, që janë marrë me studimin e kësaj gjuhe. Ato i kanë studiuar gjuhëtarë të shekullit të kaluar e të ditëve tona, indoevropianistë e ballkanologë, historianë të gjuhës, dialektologë e autorë gramatikash, të cilët drejtpërdrejt, në artikuj a libra të veçantë, ose tërthorazi, në punime të tjera, i kanë bërë ato objekt studimi¹.

Zanoret hundore nuk janë të trashëguara, meqenëse gjuha indoevropiane nuk ka fonema të tilla. Ato janë krijuar gjatë zhvillimit të brendshëm të shqipes, ndaj dhe vendosja e caqeve kohore se kur ka vepruar dukuria e hundorësisë në gjuhën shqipe, paraqet vështirësi, nga njëra anë, nga lashtësia e kësaj dukurie e nga ana tjetër, nga dokumentimi i vonë i gjuhës shqipe.

Para se të flasim për kronologjinë e nazalizmit, na duhet të bëjmë objekt të kumtimit tonë disa dukuri të tjera gjuhësore të lidhura ngushtë me të dhe të trajtuara shkencërisht, mbështetur gjerësisht te studimet dhe studiuesit më të shquar shqiptarë dhe albonologë të ndryshëm nga prof. Kolec Topalli.

Karakter i dialektor i hundorësisë

Sot nazalizmi është një fenomen i gegërishtes, kurse toskërishtja, në vend të tyre, ka zanore gojore. Zanoret hundore, si tipar i gegërishtes dhe **ë-ja** e toskërishtes, duhen parë bashkë, sepse **ë-ja** e dialektit jugor është e lidhur historikisht me sistemin e zanoreve hundore të dialektit verior². Kjo lidhje shihet edhe sot nga një krahasim i thjeshtë i dy dialekteve: atje ku gegërishtja ka **a** (**hundore**), të gjitha të folmet e toskërishtes kanë /**ë**/, si: *za-zë; ban-bën; rraj-rrënjë* etj. Dhe atje ku gegërishtja ka **e** (**hundore**), të folmet e toskërishtes jugore kanë /**ë**/ në të gjitha rastet. Të folmet e

¹ K. Topalli, *Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996, f. 23.

² E. Çabej, *Fonetika historike e shqipes II*, f. 59.

anës së Korçës i përgjigjen asaj pothuaj vetëm me /e/, ndërsa të folmet e tjera të toskërishtes veriore pjesërisht i përgjigjen me /e/: *pe, fle, emër*, etj. dhe pjesërisht me /ë/: *zëmër, qën, vënt, brënda, mënt* etj³.

Edhe gegërishtja, për sa i përket dukurisë së hundorësisë, si një tërësi të folmesh, nuk paraqitet në vetvete homogjene, duke dalë në të dallime ndërmjet grupeve të të folmeve, por jo të atilla që të shkaktojnë ndarje të theksuara në sistemin e fonemave të këtij dialekti. Kështu, në anët e Ulqinit, të Dibrës, në Preshevë e te shqiptarët e Dalmacisë, fonemat zanore e kanë humbur karakterin hundor. Kjo dukuri del më e fuqishme në pjesën më të madhe të bllokut verior të gjuhës shqipe, veçanërisht, në gegërishten veriperëndimore, të cilat formojnë një sistem katërkëndësh. Aty mungon zanorja /o/ hundore. Vendin e saj e zë *a-ja*, e cila, meqë në përgjithësi është e prapme dhe e buzorëzuar, ndihet gati si *o-ja*, duke u radhitur në klasën e prapme së bashku me *u-në*. Ngjyrimi hundor i zanoreve është më i dobët në të folmet lindore të Shqipërisë së Mesme, veçanërisht në disa vise të saj, ku po shkon drejt zhdukjes. Ka të ngjarë që me këtë të shpjegohet fakti që në këtë areal juglindor të gegërishtes zanoret hundore mbetën gati po me atë shkallë të hapjes si zanoret gojore⁴. Në Jug, përkundrajt pjesës më të madhe me zanore gojore, gjenden gjurmë të këtyre zanoreve në të folmen e Labërisë dhe të Çamërisë.

Duke marrë në konsideratë studimet e kryera rreth kësaj dukurie dhe duke u mbështetur shkencërisht në to, me të drejtë i është dhënë përgjigjja pyetjes nëse zanoret hundore janë një dukuri e shqipes së përbashkët apo risi e dialektit gegë.

Albanologu i njohur Norbert Jokli mendon se zanoret hundore i ka pasur edhe toskërishtja, që dëshmohet jo vetëm nga format e

³ J. Gjinari, *Zanoret hundore të gegërishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes*, SF., 3, 1981, f. 49.

⁴ J. Gjinari, *po aty*, f. 50.

trajtës së shquar, si: *gjiri, gjuri*, por edhe nga trajta toske zë, me zanoren /-ë/, përkundrejt gegërishtes *za*: (Jokl IF 36, 99). Këtë mendim e përkrah edhe gjuhëtari S. Riza (Tri mon. alb. 81). Gjatë trajtimit të këtij problemi prof. E. Çabej është shprehur kundër, duke dhënë mendimin se *nazalizmi vështirë të jetë një dukuri ruajtjeje, konservimi, dhe një proces i gjithmbarshëm i gjuhës, por pas gjase është risim, një inovacion relativisht i ri, i gegërishtes, i kryer mbase aty nga mesjeta e hershme*⁵.

Gjuhëtari Sh. Demiraj, lidhur me këtë dukuri, shkruan “Pyetjes a ka qenë procesi i hundorëzimit të zanoreve i mbarë shqipes apo përkundrazi ka qenë i kufizuar vetëm në dialektin verior, është vështirë t’i jepet një përgjigje e prerë dhe e argumentuar bindshëm...Mendimi që procesi i hundorëzimit duhet të ketë përfshirë edhe dialektin jugor duket mjaft i mundshëm, por ai ka nevojë të argumentohet e të sqarohet më tej” (Gjuha shqipe 232).

Sipas studiuesit Ilia Dilo Sheperit në “Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe”, përkundrejt pjesës më të madhe të të folmeve që kanë zanore gojore, gjenden gjurmë të hundorësisë në të folmet e Labërisë dhe Çamërisë, në rastet kur zanoret ndodhen përpara bashkëtingëlloreve hundore *n, m, nj*, si: *hena, flama, zonjë, mëllenjë, komb* etj., në fund të emrave mashkullorë dhe foljeve që mbarojnë me zanoret e gjata *i, ë, y, u*, si: *fre, sy, dru* etj., apo në fjalët *esht, nje, me* etj⁶.

Dialektologu i shquar J. Gjinari, gjatë përcaktimit të dallimeve dialektore, ka shprehur mendimin e tij lidhur me këtë dukuri. “...nuk mund të mendohet që shqipja ta ketë pasur hundorësinë që në krye të herës, por në një fazë të dhënë të historisë së saj, në mos pastë qenë edhe si tipar fonologjik, të paktën nuk mund të mos ketë ekzistuar për të dy dialektet si tipar thjesht fonetik, në kuptimin që

⁵ E. Çabej, *Dy çështje gjuhësore*, në “Gjurmime albanologjike” Seria Filologjike, VII, 1977, f. 27.

⁶ I. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 27.

zanoret në kushte të caktuara fonetike për një periudhë janë realizuar fonetikisht si hundore, kanë qenë pra variante fonetike të fonemave zanore gojore dhe pas kësaj u bë degëzimi duke lindur prej tyre seria e fonemave zanore hundore në gegërishte dhe duke sjellë ndryshime të këtylla në sistemin fonetik të toskërishtes; lindi aty zanorja /ë/ e theksuar. Bashkëtingëlloret hundore nuk ndikonin më në artikulin e zanoreve pasardhëse, pra zanoret para një bashkëtingëlloreje hundore nuk shqiptoheshin më si hundore.”

Në vazhden e ndihmesave të shumta në shqyrtimin e shumë çështje me rëndësi, edhe për këtë anë të veçantë të kësaj dukurie, prof. Topalli, duke u mbështetur së shumti në studime diakronike, ka shprehur mendimin e tij të argumentuar shkencërisht. Sipas tij zanoret hundore, megjithëse sot gjenden vetëm në dialektin e gegërishtes, ato i kanë pasur të gjitha të folmet e shqipes, pra, edhe ato të Jugut, gjë të cilën e dëshmon me disa argumente.

a. Errësimi i zanores /a/ në /ë/ para një bashkëtingëlloreje hundore në të folmet e Jugut mund të shpjegohet vetëm me hundorëzimin e kësaj zanoreje.

b. Rënia e bashkëtingëllores /-n/ në pozicion fundor është pasojë e hundorëzimit të zanores dhe ky proces ka përfshirë të dy dialektet.

c. Në shfaqjet e ndryshme të kësaj dukurie, të dyja dialektet dëshmojnë tipare të ngjashme; kështu për zanoren /a/, atje ku të folmet e Veriut kanë zanore hundore, të folmet e Jugut kanë zanoren /ë/.

d. Gjurmët e hundorësisë së zanoreve në disa të folme të toskërishtes jugore, nuk mund të jenë një shfaqje risie e atyre të folmeve, sepse hundorësia aty ka prekur ato fjalë që janë të tilla edhe në dialektin e gegërishtes, por nuk ka prekur fjalët që kanë hyrë në gjuhën shqipe në kohë të më vona, kur kishte përfunduar ky proces.

e. Kthimi /e/ (hundore) në /ë/ në fjalët ku kjo zanore ka qenë para

një bashkëtingëlloreje hundore (*drë, flë, zëmër*), që e kanë disa të folme të Jugut, ashtu si kthimi tjetër /a/ në /ë/, dëshmon se ajo vjen nga një zanore e hundorëzuar.

Pra, në një fazë të caktuar të zhvillimit të tyre zanoret hundore të toskërishtes janë çhundorëzuar. Shkakun e kësaj dukurie e kanë lidhur me rotacizmin në këtë dialekt dhe procesi i çhundorëzimit të këtyre zanoreve del më i vonë se rotacizmi.

Kushtet fonetike

a. Kushtet fonetike të krijimit të zanoreve hundore lidhen me praninë e bashkëtingëlloreve hundore pas zanoreve gojore. Bashkëtingëlloret që kanë shkaktuar hundorëzimin e zanoreve janë: **n, m, nj**.

b. Për sa i përket gjatësisë, këto zanore mund të dalin të gjata, të mesme, të shkurtra dhe ndryshimi i gjatësisë së tyre është i lidhur me përbërjen rrokjesore të fjalëve, *fre, dru, hënë, kand, bënj* etj.

c. Hundorësia e këtyre zanoreve nuk është kudo e njëjtë. Më e fuqishme është kur zanorja dhe bashkëtingëllorja hundore janë në të njëjtën rrokje, si: **shty, vu** etj. Bashkëtingëllorja me shkallë hundorësie më të madhe është bashk. /n/ dhe me shkallë hundorësie më të vogël bashk. /m/, e cila në disa përdorime nuk e ka hundorëzuar zanoren para saj, duke bërë të mundur krijimin e diftongjeve, si: *dhjamë*.

d. Megjithëse zanoret hundore janë krijuar nga prania e bashkëtingëlloreve hundore, vihen re raste ku zanoret hundore gjenden edhe në fjalë që në origjinë s'kanë pasur zanore të tilla. Në këto trajta bashkëtingëlloret hundore mund të jenë shtuar më vonë, si: **la- lë** ose këto zanore janë krijuar me rrugë analogjike, si: **flë-flëj**.

e. Në toskërishte, për shkak të rotacizmit, zanoret hundore, duke mos pasur pranë bashk. /n/, janë kthyer në gojore. Këto zanore e kanë prirjen të çhundorëzohen veçanërisht, kur janë para bashk.

fërkimore.

f. Diftongjet e gjuhës shqipe, të krijuara nga zbërthimi i zanoreve të thjeshta, janë diftongje gojore. Edhe kur këto zanore janë hundorëzuar, nuk janë zbërthyer në diftongje edhe kur kanë qenë kushtet. P. sh. Zanorja /e/ e shkurtër indoevropiane, nuk është diftonguar kur ndiqej nga bashk. hundore /n/, /nj/, si: *pesë* nga *pensë*.

g. Në analizën e diftongjeve të zanores /o/ në lidhje me **–on**, vihet re mungesa e bashkëtingëllores hundore në tërë paradigmen, kur ajo ka qenë në pozicion fundor. Kjo tregon se zanorja /o/ e hundorëzuar e temave me **–on** është çhundorëzuar më parë dhe pas këtij procesi ka mundur të zbërthehet në diftongun **–ou**.

h. Në ato gjuhë që ka vepruar hundorësia ka shkaktuar ndryshime të timbrit të zanoreve. Për shkak të hundorësisë zanorja /a/ është kthyer në /ë/ në mbarë toskërishten dhe zanorja /e/ është shndërruar në /ë/ në të folmet e Labërisë dhe Çamërisë. Ka edhe shndërrime të tjera që kanë prekur gjithë truallin e shqipes.

Kronologjia

Hundorësia e zanoreve është një dukuri e vjetër e shqipes dhe fillimi i saj është më i hershëm se ndarja dialektore e shqipes. Kjo dukuri ka prekur jo vetëm elementet autoktone të shqipes, por edhe huazimet më të vjetra nga greqishtja e latinishtja, në periudhën kur shqipja ishte në marrëdhënie me këto dy gjuhë. Ndaj, për të bërë një studim sa më shkencor, lidhur me kohën se kur ka ndodhur ky proces, studiues të ndryshëm janë marrë me huazime të ndryshme që i janë nënshtruar kësaj dukurie.

Studiuesi Majer-Lybkeja, duke u bazuar në fjalën **osten**, të huazuar nga sllavishtja, ka arritur në përfundimin se hundorësia e bashkëtingëlloreve me të edhe rotacizmi i toskërishtes janë procese të zhvilluara para marrëdhënieve të shqipes me sllavishten. I këtij mendimi është edhe prof. Demiraj, duke pohuar se hundorësia e

zanoreve të shqipes, me rrugë fonetike, ka pushuar së vepruari para kontakteve të shqipes me sllavishten⁷.

Sipas Joklit veprimi i këtyre dy dukurive është i një kohe më të vonë, aty rreth shekullit X. Studimin e tij e ka mbështetur jo vetëm në dëshmitë gege *ustë* dhe *cura* (nga sll. *osten e ceren*) apo trajtës toske *spërk* (nga greq. e re *spanos*), por ka përfshirë edhe shtresën më të vjetër të huazimeve sllave. I të njëjtit mendim është dhe Çabej, i cili në mbështetje të këtij argumenti, sjell shembuj të tjerë me hundorësi nga dialekti i Veriut, si: *shtëpa* (stopan), *Shtëpoza* (afër Tiranës), *Shtëpanjë*, në krahinën e Shpatit, apo dukuri të tjera me rotacizëm në dialektin e Jugut, si: *shtëpreshë* (stanore, amvisë e mirë), *Shtëpëz* etj.

Sipas prof. K. Topallit, ashtu siç ndodh me huazimet nga greqishtja e latinishtja, edhe huazimet sllave, ndonëse më të reja mund të shtresëzohen, duke dalluar në to një shtresë më të vjetër e një tjetër më të re. Kjo ndarje mund të bëhet duke marrë për bazë kriteret gjuhësore, si: evolucioni i tingujve të gjuhës huazuese dhe të gjuhës marrëse, zëvendësimet e tingujve të gjuhës dhënëse me tinguj të tjerë të përafërt në gjuhën marrëse, kur kësaj i mungojnë tingujt gjegjës. Në shtresën më të vjetër të huazimeve sllave: *shtëpa*, *ustë*, *tërsirë*, *shtëpreshë*, *orendi*, *patkua*, *gatuaj*, *rrëke* etj, janë ruajtur dukuri të vjetra fonetike të gjuhës shqipe e të sllavishtes, si hundorësia e zanoreve, rotacizmi, diftongjet, *-ua/-ue*, të zanores /o/, forcimi i bashkëtingëlloreve dridhëse në fillim të fjalës etj. Ndërsa në shtresën më të re të huazimeve sllave: *zakon*, *stan*, *sanë*, *kosë*, *bravë*, *kovë*, *lopatë*, *hosten*, *Bistricë* etj., vihen re refleksime të reja të tingujve të sllavishtes e të shqipes, si: mungesa e hundorësisë dhe rotacizmi, ruajtja e pandryshuar e afrkate /-ç/, ruajtja e bashkëtingëllores buzodhëmbore /-v/, ruajtja e pandryshuar e zanores /-o/ etj.

Duke kundruar edhe një pjesë të huazimeve sllave, sipas prof.

⁷ Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 74.

Topallit, dukuria e hundorësisë dhe bashkë me të edhe rotacizmi, kanë vepruar edhe pas shekujve VII-VIII, kur fillojnë marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave. Mungesa e kësaj dukurie në pjesën më të madhe të këtyre huazimeve tregon se me fillimin e këtyre marrëdhënieve ajo ishte në shuarje e sipër. Gjithashtu, është e papranueshme të flitet për një ndikim të sllavishtes në krijimin e zanoreve hundore të shqipes. Veprimi i kësaj dukurie është më i hershëm se takimet e para të shqipes me sllavishten. Në fillimin e marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhët sllave hundorësia ishte në shuarje e sipër.

Me një vështrim të përmblodhur të kësaj dukurie, mund të themi se ndihmesa e prof. Kolec Topallit edhe në këtë lëmë të fonetikës historike, i bën nder punës së tij shkencore, por mbi të gjitha gjuhësisë shqiptare.

Burime bibliografike

E. Çabej, *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988.

I. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001.

J. Gjinari, *Zanoret hundore të gegërishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes*, SF., nr. 3, 1981.

J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003.

K. Topalli, *Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996.

K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.

Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.

MERITA GJOKUTAJ-SHEHU

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

**ARTISTIKJA DHE E VËRTETA TE
“FUNERALI I HIJES” I AUTORIT ODISE
KOTE**

ABSTRACT

Odise Kote, by now, has managed to build his own reputation, through his talent and passion, his elegance of narration, the power of the phenomena which become the centerpiece of his novels and stories, attracting the readers to the labyrinths of the book and the wise words, fixing memories, events, impressions, episodes, live experiences, encompassing a diverse and rich theme.

The author attempts to draw the reader in a world full of diverse characters, individual and collective processes that are directly related to him, Petro, the banker. The author’s style is seemingly simple, but the further we read on, the more we are convinced of his expressive power, energy, where details slowly emerge, making it impossible for the reader not to be captivated by the author’s narrative structure.

Key words: Odise Kote, Funerali i hijes

Odise Kote autori i një sërë veprave si: “Orët e mëngjesit”, “Disa poezi”, “Ajkuna”, “Tregime”, poezi, ese”, “E qeshura pas porte”, “Vejusha”, “Betimi i rremë”, “Ura e margaritës”, “Performancë”, vjen para lexuesit gjirokastit, por edhe më gjerë me një roman interesant që në titull “Funeral i hijes”, botuar nga shtëpia botuese “TOENA”.

Odise Kote ka arritur të krijojë profilin e tij, duke shfaqur talentin dhe pasionin, elegancën e të rrëfyerit, forcën e fenomeneve që ai zgjedh dhe vë në qendër të romaneve e tregimeve të tij, tërheqjen e lexuesit drejt labirinteve të librit dhe mençurisë së fjalës, duke fiksuar e përbluajtur vazhdimisht kujtime, ngjarje, përshtypje, episode, përjetime të gjalla, me një tematikë të larmishme e të pasur.

Autori tenton që të fusë lexuesin në një botë të ngërthyer me shumë karaktere, procese individuale e kolektive të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me atë, bankierin Petro. Stili i tij në dukje shfaqet i lehtë, por, ndërsa e lexon, të siguron për forcën shprehëse, energjinë, ku fillojnë të pluskojnë detajet duke shkaktuar një joshje të sigurt për të ndjekur vazhden e rrëfimit të tij.

Ja disa elemente të cilat do të dëshiroja të ndalesha:

1. Romani ka një fillim interesant me një fjali të paplotë.....tridhjetë e shtatë vjeç, bankieri Petro vendosi të zhdukej nga bota. ¹Me art autori mbledh arsye, pikënisje, copëra gjurmësh, rrebeshe urretjesh, pjesëza kundërshtish ndaj regjimit, mëri e inate të vjetra për të krijuar një subjekt interesant që zgjat shtatë ditë, në fundmarsin e 1949.

Gjithçka vërtitet rreth asaj që quhet hapsanë.....asnjë shtëpi e madhe nuk mund të kuptohej pa një hapsanë brenda. Zakonisht në katin përdhes, brenda në qilar ose ngjitur me sterat. Pa dyer, pa dritare, ku zbritej me shkallë.

¹ Kote. O, Funerali i hijes, TOENA, 2017, fq. 9.

Deri në faqen 84 të librit gjithçka vërtitet e rrëfëhet rreth pyetjes, dilemes së zhdukjes. Në vazhdim kemi dalje prej saj, aq sa në fq. 150 duket sikur përfundon enigma.

2. Shkruan me frymëzim e përgjegjësi artistike, procedon me mjeshteri për thurjen e detajeve që janë të shumta e të gjetura me sens. Fantazia e lexuesit shkon tej falë përshkrime interesante: **kemi pamje të qytetit.....**uljengritjet e sokakëve që ngjiten e zbresin janë të rënda, të marrin shpirtin. Në to duhet të dish të ecësh, ndryshe bëhen qorrsokakë. Humbet, thyen qafën, gremisesh në përrua a në çatinë e ngrehinës më poshtë....²; **kemi portrete interesante.....**babazoti i ftohtë, nevrik, i largët, përçmues, ngjante me fatkeqin që kishte humbur fatin në ruletë. I freskët, i fisëm, kreko. Fin. Fliste ngadalë sikur s'filitej kur zgjidhte fjalët. **Por nuk mungon as mistikja e këtij qyteti.....**në këtë qytet të ngushtë, ku ca shenja është vështirë t'i dallosh e më vështirë akoma t'i zbërthesh.....sekreti i dënimit të njerit nga familja ishte i rëndësishëm, sekreti i shtetit s'qe gjë para tij, asnjë fjalë nuk duhej të dilte jashtë mureve të shtëpisë.³

3. Në roman gjejmë artin dhe realitetin, të vërteta që jetojnë edhe sot...në qytetthin e ngushtë trillet dhe fantazitë janë profesion, s'kanë fund e anë, por në thelb, mbështillen me moskuptim e dyshim si në guaskë. Në këtë qytet, njeriu para se të jetë qytetar i lirë, i pavarur, është fillimisht gjyqtar. Ose më saktë është gjyqtar, po aq sa është edhe i gjykuar. Çdokush gjykohet e gjykon tjetrin, për gjithçka.⁴

4. Autenticitetin veprës midis të tjerash ia jep edhe prezenca e personave konkretë si: Cile Muka, Kola, Zigai, Koçollari, Kufo, Dhoska, Prifti, Cico, Kozmai, Maze Kotroçi, hebreu Gurga, Kapo Kaçi, Afuz Gusmari, Baftjar Dobi etj. **Emërtesat tipike për**

² Kote. O, Funerali i hijes, TOENA, 2017, fq. 71.

³ Po aty, fq. 23.

⁴ Po aty, fq. 31.

Gjirokastrën.....xhexhetë e Cfakës, fusha e Bajraktarit, shpellat e guvat e Dunavatit dhe Kërcullës, Mali i Gjerë, Meçite, Pazari i Vjetër, shtëpitë e Mezinëve, klubi i gjuetarëve, vila e Papavangjelit, Hadërajve, Qafa e Pazarit, Bashte e Teqesë, shtatë penxheret, ura e Angonate, hani i Çoparkajve.

5. **Operon me fjali të shkurtra**.....bah, shaka, si hije, trokth, turp, kurrsesi, përvëloja, shqeva sytë, tallje, gëk, xëc, kalimthi, kokëposhtë, katastrofë, gjëmë, mbytje, gremisje, tinzare, dinake, e lehtë, pupël etj.

6. **Një faktor i rëndësishëm që forcon në mënyrë të veçantë koloritin e veprës është materiali, që rrjedh në pasurinë e figuracionit poetik dhe të shprehjeve frazeologjike.** Fjala është sa e drejtpërdrejtë dhe e figurshme, përshkrimi lakonik, pamjet janë të kapshme dhe konkrete, kurdoherë me një ndjenjë të këndshme dhe të përmallshme. Duke qenë kërkues dhe qëmtues ndaj materialit gjuhësor e figurativ shfrytëzon:

Gjuhën tipike gjirokastrice.....fërkoj sitë fort, sa të të pëlcastin mbi libër⁵, sakën se shqep golën, mendja i bëhej qiqër, gjalmë, bina, ditëpreri, u mek, mollois, kësodh, shapllameno, trushkukur, tyryfil, zabërhan, kaqol, dërsirë, juku etj., por përdor edhe **turqizmat, greqizmat dhe fjalët e vjetra**..... dufet, marazet, hapsanë, fakirfukarenj, xhehnem, katran, musandara, mavrisë, aguridh, kaqol, gërmuq, mastrapan, tromaksur, allishverish, sojsëz, gjëma, hataja, anapolla, qepena, penxhere, lanet, tespiket, shashtisur, mesele, gjynah, kuturu etj.

7. **Për sa i përket figuracionit** paraqet një origjinalitet të vetin, që dallohet për një thjeshtësi e spontanitet të çuditshëm, herë ndërlikohet e herë pasurohet, duke u bërë më i larmishëm. Ky figuracion është gjithnjë funksional, rrjedhimisht, proza është plot ajër e dritë. Në tërësinë e figurave përdor dendur, bukur e me

⁵ Po aty, fq. 22

mjeshtëri:

a. **enumeracionin**.....mungesën, ikjen, dënimin.....u mbyll, u egërsua, u zymtua, u ashpërsua.....e lezecme, e mençur, djallushe.....tronditëse, pikëlluese, e zbrazet.....edhe pendesë, edhe mall, edhe keqardhje, edhe pamundësi.....vetëm shteg, rrëpirë, gur gremisje....

b. **aliteracionin**.....gri, gri brenda grisë.....gjithë jeta ankh e makth.....

c. **metaforën**.....sytë i ka lëndina të blerta.....e qara e foshnjës u rrokullis nëpër hone.....purpur prush, një nur të ylltë....

8. Për ta dhënë sa më mirë botën e këtij qyteti absurd, **një pjesë e mirë e pjesëve nëse mund t'i quajmë të tilla përfundojnë me pyetje**.....sa shtëpi në Gjirokastrë nuk kanë hapsanë, ke dëgjuar të zhduket njeri.....,⁶ po pse po vononte dënimi i babazotit...,⁷ ç'po ndodh kështu,⁸ E gjete gjë Petron,⁹ nuk e sheh që u kthye bota përmbys¹⁰

9. Të pranishme në roman kemi edhe thëniet koncentrat shprehje të mentalitetit shqiptar.....qipi i krisur nuk ngjitet më, por rron gjatë,¹¹ lidhe gjuhen, po e zgjidhe, e mori ferra uratën. U rrokullis fati,¹² gratë duken njëlloj kur janë të lumtura. Dëshpërimi i bën të duken ndryshe,¹³ dhemshuria nuk është dhuratë e perëndisë, është e njeriut,¹⁴ Mos beso asnjëherë në ato që dëgjon, beso vetëm gjysmat e atyre që sheh,¹⁵ vdekja nuk ka miq, asnjëherë se tregon

⁶ Fq. 20

⁷ Fq. 29

⁸ Fq. 56

⁹ Fq.122

¹⁰ Fq.192

¹¹ Fq. 73

¹² Fq. 75

¹³ Fq.87

¹⁴ Fq.98

¹⁵ Fq.150

udhën e saj. Çdo vdekje mban një mister, një sekret të patreguar,¹⁶ fytyra është kodi i racës njerëzore,¹⁷ aktrimi është profesion i guximshëm, por gjithçka duhet mësuar në kohën e duhur,¹⁸ rruga më e shkurtër për të goditur zemrën e një njeriu është poshtërimi,¹⁹ tre vetë e ruajnë një sekret, vetem kur dy vdesin,²⁰ Urrejtja është si zinxhiri rreth qafës që të tërheq e të shpie atje ku vetë nuk do të shkosh,²¹ Kur heshtja flet me shpirtin ajo është e bekuar,²² tek çdo grua fle një ëngjëll, një demon dhe një princeshë,²³ Mençuria e burrit dhe durimi i gruas sjellin paqe e lumturi në familje,²⁴ Secili ka brenda vetes një mrekulli që i takon vetem atij. Përdoreni për punë të mbara mrekullinë tuaj,²⁵ njeriun e mirë mbaje, të ligun largoje, pa mëdyshje²⁶

10. Frazja e tij është koncize larg shablloneve e gjuhës libreske, është fine në teknikë e stil duke e bërë atë të ngrohtë. Mjafton të përmendim **përshkrimet ndjesore.....mishrat iu treten. I mbeti vetem kocka. Dhe vështrimi i thellë. Mezinë i rëndë, u bë i lehtë si era. Pa peshë. Sikur ishte gjethe. Megjithëse parkinsoni iu shtua, mendja i ndritej. I bëhej më e hapur. Më e mprehtë. Më e hollë. Plot dituri.**²⁷

Portreti i Petros.....vinte i trazuar, vetmitar, mosbesues, eksperimentues pa fund, bredharak i natyrës, marruk, ëndërrimtar i pashpresë, me trishtimin e përhershëm, vrullet e egra, shpërthimet... I ftohtë e shurdh, që nuk iu përgjigj as vështrimeve,

¹⁶ Fq.169

¹⁷ Fq. 190

¹⁸ Fq. 204

¹⁹ Fq. 204

²⁰ Fq. 209

²¹ Fq. 216

²² Fq. 221

²³ Fq. 270

²⁴ Fq. 286

²⁵ Fq. 287

²⁶ Fq. 300

²⁷ Fq. 74

*as pyetjeve të njerëzve.*²⁸

11. Romani ka një perfundimi shumë domethënës....ku u fshehe shtatë ditë o Petro....atje ku fshihen njerëzit kur janë të mërzitur, në fëmijëri u fsheha. Pse ti nuk bën kështu...

Në mbyllje do të theksoja se në romanin “Funerali i hijes” të Odise Kotes gjejmë botë, shpirt, kohë të mbrapshta. Njerëzia nuk di më ç’të mendoje. E mendimi nuk di më ku të ndërtojë shtëpi. Vërtiten të gjithë: të gjallë e të vdekur, mendime e ulërime, pa gjetur kurrë paqe, sepse siç thotë dhe vetë autori i romani:Ju kam thënë, kujdes. Gjërat nuk janë kaq të thjeshta në këtë qytet. Herë-herë e nxjerr kokën ai...absurdi, absurdi që ju e nënvlerësoni.....²⁹

Literatura e shfrytëzuar:

- Ali Aliu. Personazhi në romanin e sotëm shqiptar. NËNTORI 1981,3.
- Jorgo Bulo. Mbi disa veçori tipologjike të romanit të sotëm shqiptar. NËNTORI 1981,2.
- Odise Kote. Funerali i hijes. TOENA, 2017.

²⁸ Fq. 254

²⁹ Fq. 289

KOSTANDO KSERA

OLIETA POLO

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

**LEKSIKOGRAFIA GREKO – SHQIPTARE DHE
SHQIPTARO – GREKE NË SHËRBIM TË
PËRKTHIMIT**

ABSTRACT

Communication of people are alongside each other and who speak different languages is a perennial need and people have always tried to find ways of communication. The design of bilingual dictionaries and translation are two of the key factors in the inter-ethnic communication service. Finding the most appropriate equivalent word in another language is an indication of a good and accurate translation. The bilingual dictionaries help translators in this regard and provide the right solutions. On the other hand, a good vocabulary is one that for a given word are given all its semantic nuances in the other language using the right words.

On the framework of this paper we will follow the development of Greek - Albanian and Albanian - Greek dictionaries over time, as well as the circumstances in which these dictionaries were drafted. A critical description of the values of each one and their practical use in the field of bilingual translation will still be made.

Fjalë kyçe: leksikografi, përkthim, fjalor, fjalor dygjuhësh

Hyrje

Fjalorët dygjuhësh janë hartuar për të ndihmuar përdoruesit të përkthejnë fjalë nga një gjuhë në një tjetër dhe zakonisht tregojnë elemente të tilla gramatikore: si numri, gjinia, etj. për të ndihmuar folësit jonatyral të një gjuhe për të identifikuar më saktë kuptimin e fjalës në gjuhën tjetër.

Gjatë hartimit të një fjalori leksikografi mbledh, hulumton, kategorizon dhe sistemon "të shenjtat e të shenjtave", simbolet me të cilat shprehet një popull, simbolet me të cilat shprehet një komb. Sepse një fjalor mund të nxjerrë në pah këto simbole, mendimin dhe gjuhën e një populli. Kjo është arsyeja pse roli i tij është shumë i rëndësishëm.¹

Në rastin e një fjalori dygjuhësh kemi një klasifikim të dyfishtë të botës nga dy sisteme të ndryshme gjuhësore. Sepse, sipas Saussurit, çdo gjuhë është «një rregullim, sistemim i botës» është mënyra, se si çdo popull percepton, përpunon, sistemon dhe shpreh botën. Për këtë arsye dhe çdo gjuhë nuk është fjalë të tjera për të njëjtat gjëra, por një tjetër mënyrë konceptimi dhe shprehjeje të botës².

Në kuadër të këtij artikulli do të shohim marrëdhëniet e leksikografisë me përkthimin dhe se sa është ndihmuar fusha e përkthimeve greko - shqiptare dhe shqiptaro – greke nga ekzistenca e fjalorëve dygjuhësh.

Karakteristika të përbashkëta të leksikografisë dhe përkthimit

a. Sipas literaturës përkthimi është i lidhur ngushtë me gjuhësinë, për faktin se kalimi nga **një gjuhë - burim** në **gjuhën - synim** kërkon përpunim të gjuhës – dmth analizë gjuhësore.

¹ Η χρήση του λεξικού στη διδασκαλία της γλώσσας μας.
<http://www.babinotis.gr>

² Për më shumë shih: Γ. Μπαμπινιώτης, Εισαγωγή στη θεωρητική γλωσσολογία, Αθήνα, 1998

Përkthimi është një proces gjuhësor i transferimit të kuptimit, të strukturës dhe të stilit – domethënë të opsioneve të krijuesit – në të gjitha rrafshet e gjuhës (kryesisht në rrafshin morfologjik, sintaksor dhe leksikor), të një teksti nga **gjuha e nisjes** në **gjuhën e mbërritjes**. Prandaj, procesi i përkthimit përfshin në vetvete përpunim gjuhësor, edhe kur bëhet fjalë për analizën e tekstit të gjuhës burim, edhe për riformulimin e kuptimit, të strukturës dhe të stilit të tekstit në gjuhën e mbërritjes.³

Nga ana tjetër, leksikografia si degë e gjuhësisë së aplikuar në Fjalorin e Gjuhës Greke përcaktohet si *"shkenca që ka si objekt studimi parimet dhe metodat e hartimit të fjalorit duke zbatuar parimet e leksikologjisë."*⁴ Leksikografi gjatë hartimit të fjalorëve dygjuhësh bën pothuajse atë që bën edhe përkthyesi, përpunon njësitë gjuhësore dhe funksionimin e tyre brenda një sistemi gjuhësor dhe gjen njësitë përkatëse ose i përkthen ato në sistemin tjetër gjuhësor.

b. Çdo gjuhë nuk mund të konceptohet jashtë kontekstit kulturor, shoqëror dhe gjeografik i saj. Prandaj, leksikografët e fjalorëve dygjuhësh janë në kërkim të fjalës së duhur për transmetimin e gjithë këtë konteksti në gjuhën tjetër. Shembull: Fjalët dhe shprehjet me ngarkesë kulturore, që kanë lidhje me farefisninë (*κουνιάδα, μπατζανάκης*), ierarkinë kishtarë (*σεβασμιότητα, μακαριότητα*), urimet (*Καλά στέφανα!, Χρόνια πολλά!*), konceptin e kohës (*κυριακάτικα, χειμωνιάτικα*), ritet fetare (*κόλλυβα, αγιασμός*), festat (*Τσικνοπέμπτη, Καθαρά(-ή) Δευτέρα*), institucionet shtetërore (π.χ. *γιατί προεδρευόμενη δημοκρατία και όχι προεδρική δημοκρατία;*)⁵.

³ Μαρία Τσίγκου, Σύντομη εισαγωγή στις σχέσεις γλωσσολογίας και μετάφρασης, 2011, http://dflti.ionio.gr/sites/default/files/Tsigou03_0.pdf

⁴ Γ. Μπαμπινιώτης, Λεξικό Νέας Ελληνικής Γλώσσας, Αθήνα 1998

⁵ Αγγελική Ι. Σακελλαρίου και Άννα Αναστασιάδη-Συμεωνίδη, Κριτήρια παρουσίασης και αξιολόγησης δίγλωσσων λεξικών, *Πανεπιστήμιο Δυτ. Μακεδονίας και Αριστοτέλειο Πανεπιστήμιο Θεσσαλονίκης* <http://www.enl.auth.gr/symposium19/19thpapers/049>

Fjalët e mësipërme me ngarkesë kulturore pasqyrojnë në një masë të madhe kryesisht kulturën e atyre që flasin një gjuhë. Për këtë arsye është e vështirë të kuptohen në mënyrë tërësore nga folës jonatyralë të gjuhës. Përkthimi i saktë i këtyre termave redukton këtë vështirësi dhe e bën fjalorin më miqësor për përdoruesit.

Ndonjëherë, kërkohet nga përkthyesit të krijojnë fjalë të reja për të shprehur terma që nuk gjenden ekuivalente në gjuhën tjetër. Gjithashtu, tekstet që janë shumë "specifike" nga këndvështrimi kulturor, duhet të përshtaten në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për përdoruesit e fjalorit të një kulture ose një zone gjeografike tjetër.

c. Fjalor i mirë dygjuhësh sipas Sakellariou – Symeonidi⁶ është ai në të cilin përcaktohen kuptimet e shumta të fjalëve polisemantike. Ky kriter është i rëndësishëm, pasi fjalët polisemantike zënë një pjesë të madhe të fjalorit. Në të vërtetë si rregull, polisemantike janë shumica e fjalëve të gjuhës.

Regjistrimi i kuptimeve të ndryshme të fjalëve ndihmon përdoruesit që të mos ndalojnë në kuptimin e parë, i cili ndoshta do të çojë në një përkthim të gabuar, por i shtyn ata të studiojnë dhe pjesën e mbetur të lemës për të gjetur kuptimin që me të vërtetë u nevojitet.

E njëjta gjë ndodh edhe me përkthyesin. Gjatë procesit të përkthimit të një fjale në gjuhën tjetër nuk mjafton thjesht gjetja e fjalës korresponduese dhe përshtatja e saj sipas rregullave gramatikore dhe sintaksore. Ai duhet të kuptojë plotësisht mesazhin që do të përcjellë autori i tekstit. Përkthyesit e mirë kuptojnë kontekstin, stilin dhe nuancat e kuptimit të origjinalit dhe njëkohësisht kërkojnë njësitë analoge në gjuhën e mbërritjes në të cilat do të mbartin këtë kuptim. Pyetja që i vënë vetes është: "Si mund të jap më saktë kuptimin?" Një përkthim i mirë duhet të ketë

⁶ Po aty.

të njëjtin efekt për lexuesit sikurse teksti origjinal. Nëse origjinali të bën të buzëqeshësh ose të nxit kuriozitetin, të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe përkthimi.⁷

d. Huazimi leksikor i elementeve që nuk ekzistojnë në njërën ose në tjetrën gjuhë, është një fenomen i zakonshtëm midis gjuhëve, i cili stimulohet më shumë nga përkthimi. Përkthyesi i shërben këtij qëllimi të dobishëm të futjes së fjalëve të huazuara nga gjuha e nisjes në gjuhën e mbërritjes, ku më parë mungonte nocioni/koncepti ose shprehja e përshtatshme e konceptit. Ndonjëherë përkthyesit krijojnë fjalë të reja për të plotësuar boshllëqet. Prandaj ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm në pasurimin dhe zhvillimin e fjalorit të gjuhëve dhe kulturave. P.sh., në përkthimin në shqip të «Ἀξιον ἐστί» (Axion Esti) të O. Elitis nga Niko Katsalidha, gjejmë krijimet e përkthyesit si «Τις ιδέες μου όλες ενησιώτισα/ idetë e mia krejt i **ishullova**» Η ουρά του η πλατιά να μου *αυλακώνει*/ bishti i tij i gjerë të më **brazdojë**; κλειδοκράτορες /çelësmbajtëse γεγειοφόροι/mjekërmbajtës; κατά το παραθύρι/ kundruall dritares.⁸

Që më 1844 përfaqësuesi i parë i Rilindjes Kombëtare Naum Veqilharxhi shkruante për fjalët që ai vetë ka krijuar «*edhe pse për momentin mund të mos tingëllojnë ëmbël në të dëgjuar, besoj që koha do ti bëj të dëgjohen bukur*» (Lafe 1992). Të njëjtën gjë dëshmon vite më vonë edhe J. Vreto «*Çdo fjalë kur dëgjohet për herë të parë vjen pak si e sertë, kur ama dëgjohet shumë herë, veshi mësohet dhe ajo bëhet e ëmbël.*» (1886, 3-4)⁹

E njëjta gjë ndodh edhe me leksikografinë, kur nuk ekziston një koncept ose fjalë korresponduese në gjuhën tjetër, disa herë e krijon

⁷ http://ec.europa.eu/translatores/how/index_el.htm

⁸ Shembujt janë marrë nga Odiseas Elitis, shqipëroi Niko Kacalidha, Onufri, 2001. f. 100-15.

⁹ Δ. Κ. Κυριάκης, Ελληνικές επιδράσεις στην Αλβανική, disertacion, Θεσσαλονίκη, 2001, faq. 22

vetë. Në Fjalorin e Gjinit (1993)¹⁰ për fjalën greke «αγνώμονας» "mosmirënjohës" na jep një kuptim të parë «bukëshkalë» dhe kuptimin e dytë «i pamiradijshëm» që është një fjalë e formuar nga ai vetë duke pasur si model fjalën greke.

Historiku i përkthimit greqisht - shqip dhe shqip - greqisht

Në qoftë se duam të bëjmë një përjasje të fushës së përkthimit midis dy gjuhëve, si në të gjitha rastet e tjera, edhe këtu duhet të vendosim kufij kronologjikë, të cilat janë të lidhura me periudhat historike para 1945, gjatë periudhës 1945 – 90 dhe pas 1990.

- Para viteve '45 bëhet fjalë për përkthime në një drejtim të vetëm (përveç rasteve të rralla), nga greqishtja në shqip. Këtu duhet të përmendim përpjekjet e intelektualëve shqiptarë në periudhën e Rilindjes Kombëtare për të sjellë në gjuhën shqipe: arritjet në fushën e shkencës, veprat e ndryshme kishtarë, duke filluar nga përkthimi i Dhiatës së Re dhe shërbesave të ndryshme kishtarë, të veprave të periudhës klasike dhe në vazhdim tekstet për mësonjëtoret e para shqipe. Edhe pse të gjithë ata që u morën me këtë veprimtari ishin njohës shumë të mirë të gjuhës dhe kulturës greke, vepra e tyre përkthimore vështirësohej nga fakti se gjuha shqipe, e cila në atë kohë bënte hapat e para të kristalizimit dhe konfigurimit të formës së saj të shkruar, kishte shumë boshllëqe ekspresive të cilat duhej, dhe në një farë mase, janë mbuluar me veprën e tyre. Është i njohur kontributi i V. Meksit, J. Vretos, K. Kristoforidhit, N. Frashërit, Negovanit, Th. Mitkos, etj., të cilët kanë ndihmuar në pasurimin e fjalorit të shqipes, me futjen e llojeve të ndryshme të huazimeve nga gjuha greke.

Në atë periudhë, huazimi përmes kalkeve shërbeu si një zgjidhje «shpëtimi». Nga fundi i shek. XIX shfaqen tekstet e para për mësonjëtoret shqipe. Numri i kalkeve është i konsiderueshëm dhe

¹⁰ N. Γκίνης, Λεξικό Ελληνο – Αλβανικό (Fjalor greqisht – shqip), Ιωάννινα 1993

shumica e tyre krijohen mbi modelet e greqishtes: gjeografi - γεωγραφία - dheshkronjë (dhe =γη + shkronjë=γράμμα) gjeometria- γεωμετρία- dhematje (dhe=γη + matje=μέτρηση) Universitet - Πανεπιστήμιο - gjithëmesime (gjithë =παν + mësim =μάθημα, επιστήμη).¹¹

- Gjatë periudhës 1945-90, ndodh e kundërta, por kjo ka të bëjë vetëm me MEG dhe jo me shtetin Grek, ku deri në vitin 1990 konstatojmë interes të vakët për gjuhën shqipe.¹² Gjatë kësaj periudhe kemi përkthime nga shqipja në greqisht për nevojat e arsimit të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri, por dhe përkthime letrare për anëtarët e këtij komuniteti. Gjithashtu kemi edhe përkthime të veprave të zgjedhura nga letërsia greke për lexuasit shqiptar. Këto përkthime, si dhe krijimet origjinale në gjuhën greke, në atë kohë, nga ana e anëtarëve të MEG, paraqesin probleme që kanë të bëjnë me përdorimin e greqishtes. Kjo ka një pasuri të kufizuar ekspresive, fjalor të varfër, ndikim të sindaksës së shqipes dhe përdorim të fjalëve shqip.

Izolimi me Greqinë, ndërprerja e kontakteve të gjuhës me trungun e saj natyror, ishin pasojat që formatuan gjendjen specifike gjuhësore të anëtarëve të MEG në Shqipëri. Gjuha e Minoritetit nuk mundi të ndjekë evoluimin e gjuhës së Re Greke dhe mbeti një gjuhë e ngrirë, e pakultivuar. Përkthyesit, shkrimtarët, gazetarët duke mos pasur në dispozicion fjalën e përshtatshme për të shprehur një kuptim dhe duke mos pasur një fjalor që t'i ndihmonte për ta gjetur, detyroheshin të përdornin fjalën shqipe akoma edhe në gjuhën e shkruar.

-Pas vitit 1990 në fushën e përkthimit si dhe të leksikografisë, por edhe në fusha të tjera, vihet re një përmirësim i dukshëm. Konstatojmë interesim më të madh për të dy gjuhët, për shkak të

¹¹ Δ. Κ. Κυριάκης, Ελληνικές επιδράσεις στην Αλβανική, disertacion, Θεσσαλονίκη, 2001, faq. 23

¹² Përveç, natyrisht disa përjashtimeve të cilat kanë të bëjnë më shumë me gjuhën e arvanitasve.

ngjarjeve që pasuan. Përkthimi hyri në një bazë shkencore dhe sot kemi mundësinë që shkrimtarë grekë të "flasit" shqip dhe shkrimtarët shqiptarë të "flasit" greqisht të standardeve të larta. Edhe në fushën e leksikografisë gjatë kësaj periudhe kemi hartimin e disa fjalorëve dygjuhësh greqisht – shqip dhe shqip – greqisht. Janë fjalorë voluminozë dhe më të plotë.

Fjalorët greqisht - shqip dhe shqip - greqisht të hartuar gjatë viteve¹³.

Lidhur me leksikografinë dygjuhëshe midis shqipes dhe greqishtes mund të bëjmë një kategorizim të fjalorëve dygjuhësh që janë hartuar deri sot me qëllim që të konstatojmë se sa i ka shërbyer leksikografia procesit të përkthimit.

1. Një kategori përbëjnë fjalorët shumëgjuhësh të Kavalliotit¹⁴ dhe Daniil Voskopojarit¹⁵ që u hartuan në fund të shekullit të 18-të dhe kishin si qëllim kryesor mësimdhënien dhe përhapjen e gjuhës greke në popullsitë shqipfolëse dhe vllaho-folëse rreth Voskopojes. Krijuesit e tyre kanë përdorur fjalën analoge shqipe përkundrejt fjalës greke pa qenë veçanërisht të interesuar për poliseminë e njësive gjuhësore. Korrespondenca është një me një.

2. Një tjetër kategori fjalorësh janë ato të përpiluara nga intelektualët shqiptarë gjatë Rilindjes Kombëtare shqiptare. Siç është "*Fjalori i gjuhës shqipe*" i K. Kristoforidhit¹⁶ (1904). "*Fjalëtoe Greqisht - Shqip dhe Shqip – greqisht*" i Thimi Mitkos (1887- 88). Një tipar kyç i këtyre veprave është përdorimi i gjuhës greke si metagjuhë për dhënien e kuptimit të fjalës shqipe. Sipas

¹³ Për më shumë shih Kostando Ksera – Preth leksikografisë dygjuhëshe greqisht – shqip dhe shqip – greqisht <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/kostando-ksera/?lang=en>

¹⁴ Θ. Α. Καβαλιώτης, Πρωτοπείρια, 1770

¹⁵ Δ. Μοσχοπολίτης, *Εισαγωγική Διδασκαλία*, 1802; N. Stylos, *Fjalori katërgjuhësh* i Daniil Voskopojarit, Tiranë, 2011

¹⁶ Κ. Χριστοφορίδη, *Λεξικόν της αλβανικής γλώσσας*, Αθήνα, 1904

prof. Dh. Kyriazit¹⁷, i cili u mor me përgatitjen për botim të dorëshkrimit të fjalorit të Mitkos, prezantimi i fjalës bëhet me mënyrën e mëposhtme:

fiér-i. φρύγανον, ἡ φτέρη κυρίως, ὅπερ ὁμοιάζει μὲ τὸ φρύγανον. Εἶναι χόρτον λίαν δροσερόν, φυτόμενο εἰς τὰ ὄρη τῆς Τοσκαρίας μὲ τὸ ὁποῖον περιτυλίσσουν τὸ χιόνι, πορτοκάλια κλπ. πρὸς διατήρησιν. [fiér-i. shkarpë, kryesisht fieri, që ngjan me shkarpat. Është bar që mban mjaft fresk, që mbin në malet e Toskërisë dhe me të cilin mbështjellin borën, portokajtë etj. për t'i ruajtur.]

káčkë-a. Κάρυον, καρύδι, ὅταν ἔχει ξεφλουδισμένην τὴν ὅλως ἐπάνωθι (φυτικήν) πρώτην φλούδα. Ὅταν δὲ αὐτὸ εἶναι κεκαλυμμένον καὶ μὲ τὴν ρηθεῖσαν ἐξωτερικὴν φλούδα, τότε λέγεται árre-a. [káčkë-a . Arrë, kokërr arre, kur është e zhveshur nga e gjithë lëvozhga e parë (bimore) e sipërme. Kur është e mbuluar dhe me lëvozhgën e jashtme të përmendur më lart, atëherë quhet árre-a.]¹⁸

3. Kategoria e tretë janë fjalorët që kanë më shumë lidhje me regjistrimin e idiomave Arvanitase që fliteshin në rajone të ndryshme të Greqisë, sesa me leksikografinë e mirëfilltë dygjuhëshe. Përmendim këtu fjalorët e Marko Boçarit¹⁹, Panajot Kupitorit²⁰, Tasos Neroutsous, i Petro Mesogitit, i Petro Fouriqit, Luka Belos etj.

4. Kategoria e katërt janë fjalorët dygjuhësh që u hartuan në dekadat e fundit, të cilat u afrohen më shumë standardeve

¹⁷ Dh. Q. Kyriazi, *Fjalëtore shqip – greqisht dhe greqisht – shqip i Thimi Mitkos*, Tiranë, 2014

¹⁸ Dh. Qirjazi, “Mjaltë” nga hojet dhe trojet e shqipes: Fjalori dorëshkrim shqip-greqisht i Th. Mitkos dhe suaza Ballkanike e tij, Konferencë shkencore : «Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit», Prishtinë, 10 -11 nëntor 2011.

¹⁹ Μ. Μπότσαρης, Λεξικόν της Ρωμαϊκοῖς και Αρβανητικῆς Απλῆς, 1809; Τ. Γιοχάλας, Το ελληνο – αλβανικό λεξικό του Μάρκου Μπότσαρη, Πραγματεῖαι της Ακαδημίας Αθηνών, τόμος 46, Αθήνα 1980; Ν. Stylos, *Fjalori i Marko Boçarit*, Tiranë 2011

²⁰ Ν. Stylos, *Fjalori i Panajot Kupitorit*, Tiranë 2010

bashkëkohore të leksikografisë moderne dhe mund të konsiderohen si ndihmesa të vlefshme për përkthyesit dhe studiuesit e të dy gjuhëve. Këta janë tre fjalorët e Gjinit²¹, të Sinanit²², Papafilit²³ dhe L. Markut²⁴ etj.

Fjalorët dygjuhësh dhe përdorimi i tyre në fushën e përkthimit.

Fjalorët e Kavalliotit dhe Daniil Voskopojarit nga momenti i hartimit kanë shërbyen si metoda për nevojat e mësimdhënies së gjuhës greke në Akademinë e Re të Voskopojes në fund të shekullit të 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të.

Fjalorët e Boçarit (1809), të Mitkos (1887-1888), të Koupitorit (1888;) dolën në dritë gati një shekull pas hartimit të tyre dhe për këtë arsye nuk kanë shërbyer kurrë si fjalorë dygjuhësh në ndihmë të përkthimit. Ndërsa sot ato përbëjnë një fond të rëndësishëm kërkimor nga ku shumë fusha të shkencës, të tilla si: gjuhësia, sociologjia, sintaksa, morfologjia, leksikografia, historia etj. mund të nxjerrin informacion të vlefshëm lidhur me evoluimin e të dy gjuhëve, ndikimet që kanë pasur ato nga njëra - tjetra ose edhe nga gjuhët në kontakt si dhe çështje të tjera në fushën e linguistikës.

E njëjta gjë ndodh edhe me fjalorët e gjuhës arvanitase, të cilat nuk mund të përdoren si fjalorë dygjuhësh, por më shumë janë lista fjalësh për të shpjeguar kuptimin e tyre në gjuhën tjetër.

Nga numri i përgjithshëm i fjalorëve greko - shqiptare dhe shqiptaro – greke që janë hartuar dhe botuar deri më sot, të paktë

²¹ N. Gjini, *Fjalor shqip – Greqisht*, Tiranë, 1971; N. Γκίνης, *Λεξικό Ελληνο – Αλβανικό* (Fjalor greqisht – shqip), Ιωάννινα 1993; N. Γκίνης, *Λεξικό Αλβανο - Ελληνικό* (Fjalor shqip – greqisht), Ιωάννινα 1998

²² H. Sinani, *Fjalor greqisht - shqip*, Tiranë 2001/12

²³ Κ. Παπαφίλη, *Λεξικό Ελληνο – Αλβανικό*, (Fjalor greqisht – shqip) Αθήνα 1997; Κ. Παπαφίλη, *Λεξικό Αλβανο - Ελληνικό* (Fjalor shqip – greqisht), Αθήνα 1997

²⁴ L. Marku, *Fjalor greqisht – shqip*, infobotem, Tiranë 2009; dhe L. Marku, *Fjalor shqip – greqisht*, infobotues, Tiranë, 2010.

janë ata që u veçuan dhe luajtën një rol në fushën e leksikografisë greko-shqiptare, por edhe të përkthimit.

Këta janë: së pari, "*Fjalori i gjuhës shqipe*" i Kristoforidhit (1904), botimi i të cilit pati një histori, por rezultati shpërbleu përpjekjet e autorit, por edhe të atyre që kanë kontribuar në botimin e kësaj vepre monumentale për shkronjat shqipe. Ishte pikë referimi për shumë studiues që lëvruan në fushën e studimeve greko - shqiptare dhe mbetet një burim i pashtershëm hulumtimi.

Fjalori nuk arriti të plotësojë boshllëqet në fushën e leksikografisë dhe përkthimit midis dy gjuhëve dhe kjo i dedikohet kryesisht mënyrës së hartimit të tij. Kristoforidhi ka përdorur gjuhën greke si metagjuhë për interpretimin e fjalëve të shqipes. Ai mbeti në raftet e bibliotekave dhe në zyrat e studiuesve dhe nuk arriti të bëhet pronë e përkthyesve apo dhe atyre që dëshironin të mësonin njërën apo tjetrën gjuhë.

Këtë boshllëk erdhi ta plotësojë «Fjalori shqip – greqisht» i Niko Gjinit i vitit 1971, si fjalori i parë dygjuhësh me përdorim të gjerë. Gjatë periudhës së diktaturës komuniste dhe izolimit absolut të vendit, ku kontaktet me gjuhën dhe letërsinë greke mungonin, fjalori ishte një oazë sidomos për njerëzit që merren me letrat greke në Shqipëri, siç ishin përkthyesit, shkrimtarët, gazetarët, autorët e teksteve shkollore, etj.

Ambicia filologjiko-gjuhësore e autorit që të hartojë një fjalor të shqipes me greqishten, u identifikua me "vijën" e Partisë dhe na dha një vepër të shquar për kohën e saj, e cila megjithë mungesat që kishte si produkt i kohës së tij, u prit me kritikë të mirë dhe u bë një nga fjalorët më të përdorshëm shqip - greqisht deri në vitin 1990.

Qëllimi kryesor i fjalorit ishte t'u vinte në ndihmë nxënësve të minoritetit të mësonin më mirë gjuhën shqipe për integrimin e tyre sa më të shpejtë në shoqërinë shqiptare dhe veçanërisht për të kapërcyer vështirësitë që hasnin në kalimin nga cikli fillor në atë tetëvjeçar, ku mësimet zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Fjalori ishte

një ndihmesë e madhe edhe për përkthyesit që angazhoheshin me përkthimin e teksteve nga gjuha shqipe në atë greke. Ai mbeti fjalori i vetëm shqip – greqisht deri në vitin 1993.

Ndërmarrja e Gjinit ishte me të vërtetë e guximshme, nëse do të mendojmë se nuk ka pasur një fjalor të ngjashëm, në të cilin mund të bazohet autori.

Peizazhi paraqitet i ndryshuar pas viteve 90, ku njohuritë më të mira rreth greqishtes sollën rezultate më të mira si në fushën e leksikografisë dhe në atë të përkthimit. Gjatë kësaj periudhe kemi hartimin dhe botimin e veprave leksikografike të mirëfillta, të mbështetura mbi baza shkencore, të përshtatshme për përdorim. Të tilla janë: «Fjalori greqisht – shqip» i Niko Gjinit (1993), «Fjalori shqip – greqisht» i po të njëjtit autor (1998), i cili konsiderohet si fjalori më i mirë dhe më i plotë nga të gjitha fjalorët midis shqipes dhe greqishtes që janë hartuar deri sot. Fjalori i Hysen Sinanit (2001 dhe i përpunuar më 2012) që përbën një përpjekje të vyer të një autori autodidakt që arriti të përvetësojë në një nivel të lartë gjuhën greke dhe të na jap një vepër të parametrave të tilla (megjithë problemet që paraqet). Fjalorët e Papafilis dhe L. Markut nuk janë hartuar nga leksikografë të mirëfilltë, por nga botues me kritere që kanë të bëjnë më shumë me nevojat e tregut sesa të shkencës së leksikografisë.

Konkluzione

Si konkluzion do të thoshim që në realitetin leksikografik greko - shqiptar dhe shqiptaro - grek konstatojmë se marrëdhëniet e përkthyesve me fjalorët dygjuhësh nuk janë dhe më të mirat e mundshme. Kjo vjen si pasojë kryesisht i mungesës së fjalorëve të vlefshme në këtë kategori, të cilët ofrojnë ndihmesë të vërtetë për një përkthyes. Këtë mungesë ata e plotësojnë duke përdorur fjalorët shpjegues të gjuhëve përkatëse nga të cilat përvetësojnë kuptimin e

fjalës dhe në vazhdim interpretojnë këtë në gjuhën tjetër.²⁵

Po kështu, edhe në fushën e leksikografisë midis këtyre dy gjuhëve ekzistojnë akoma shumë boshllëqe, të cilat nuk mundën t'i përmbushin fjalorët në fjalë, sepse, siç shkruan Babinjotis, «*Gjuhën duhet më përpara ta bësh pronën tënde dhe ta nënshtrosh, ta disiplinosh. Por të nënshtrosh këtë përbindësh, me një histori 30 e ca shekullore, që është gjuha greke, është vepër e paperceptuar për leksikografin. Megjithatë është një ambicie për një luftë të vazhdueshme intelektuale dhe linguistike.*»²⁶

Përkthimi është një luftë e vazhdueshme personale, një ushtrim i vazhdueshëm mendor, që ka si synim të përsosurën. E njëjta gjë do të themi se vlen edhe për leksikografinë. Gjuha evoluon. Fjalori dhe frazeologjia ndryshojnë shumë shpejt. Ide të reja dhe shpikje, si dhe përdorime të reja për termat ekzistuese detyrojnë përkthyesit për të krijuar mënyra të reja të shprehjes së këtyre koncepteve në gjuhën e tyre dhe leksikografët herë t'u paraprijnë herë t'i ndjekin duke i integruar këto koncepte në veprat e tyre.

Bibliografia:

Dh. Q. Kyriazi, *Fjalëtore shqip – greqisht dhe greqisht – shqip i Thimi Mitkos*, Tiranë, 2014.

H. Sinani, *Fjalor greqisht - shqip*, Tiranë 2001/12.

Kostando Ksera – Rreth leksikografisë dygjuhëshe greqisht – shqip dhe shqip – greqisht <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/kostando-ksera/?lang=en>

L. Marku, *Fjalor greqisht – shqip*, infobotues, Tiranë, 2009.

L. Marku, *Fjalor shqip – greqisht*, infobotues, Tiranë, 2010.

N. Gjini, *Fjalor shqip – Greqisht*, Tiranë, 1971.

N. Stylos, *Fjalori i Marko Boçarit*, Tiranë, 2011.

²⁵ Nga përvoja e përkthyesve të ndryshëm.

²⁶ Η χρήση του λεξικού στη διδασκαλία της γλώσσας μας.
<http://www.babinjotis.gr>

N. Stylos, Fjalori i Panajot Kupitorit, Tiranë, 2010.

Odiseas Elitis, shqipëroi Niko Kacalidha, Onufri, 2001. f. 100-15.

Γ. Μπαμπινιώτης, Εισαγωγή στη θεωρητική γλωσσολογία, Αθήνα, 1998

Δ. Κ. Κυριάκης, Ελληνικές επιδράσεις στην Αλβανική, disertacion, Θεσσαλονίκη, 2001, fq. 22

Δ. Μοσχοπολίτης, *Εισαγωγική Διδασκαλία*, 1802;

Κ. Παπαφίλη, Λεξικό Αλβανο - Ελληνικό (Fjalor shqip – greqisht), Αθήνα 1997

Κ. Παπαφίλη, Λεξικό Ελληνο – Αλβανικό, (Fjalor greqisht – shqip) Αθήνα 1997

Κ. Χριστοφορίδη, *Λεξικόν της αλβανικής γλώσσας*, Αθήνα, 1904

Γ. Μπαμπινιώτης, Λεξικό της Νέας Ελληνικής Γλώσσας, Αθήνα 1998

N. Stylos, *Fjalori katërgjuhësh i Daniil Voskopojarit*, Tiranë, 2011

Ν. Γκίνης, Λεξικό Αλβανο - Ελληνικό (Fjalor shqip – greqisht), Ιωάννινα 1998

Ν. Γκίνης, Λεξικό Ελληνο – Αλβανικό (Fjalor greqisht – shqip), Ιωάννινα 1993

Τ. Γιοχάλας, Το ελληνο – αλβανικό λεξικό του Μάρκου Μπότσαρη, Πραγματεία της Ακαδημίας Αθηνών, τόμος 46, Αθήνα 1980.

Χρ. Μεσογίτου, Ελληνικάί λέξεις εν τω ιδιώματι των αλβανόφωνων της Αττικής, 1940.

Artikuj shkencorë:

1. Dh. Qirjazi, “*Mjaltë*” nga hojet dhe trojet e shqipes: Fjalori dorëshkrim shqip-greqisht i Th. Mitkos dhe suaza Ballkanike e tij, Konferencë shkencore : «Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit», Prishtinë, 10 - 11 nëntor, 2011.

2. Η χρήση τού λεξικού στη διδασκαλία τής γλώσσας μας.
<http://www.babiniotis.gr>

3. Αγγελική Ι. Σακελλαρίου και Άννα Αναστασιάδη-Συμεωνίδη, *Κριτήρια παρουσίασης και αξιολόγησης δίγλωσσων λεξικών, Πανεπιστήμιο Δυτ. Μακεδονίας και Αριστοτέλειο Πανεπιστήμιο Θεσσαλονίκης*. <http://www.enl.auth.gr/symposium19/19thpapers/049>
4. http://ec.europa.eu/translatores/how/index_el.htm
5. Μ. Τσίγκου, *Σύντομη εισαγωγή στις σχέσεις γλωσσολογίας και μετάφρασης*, 2011, http://dflti.ionio.gr/sites/default/files/Tsigou03_0.pdf

ENTELA KORE (MAZE)

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

VEÇORI TË PJESËVE TË PANDRYSHUESHME TË LIGJËRATËS NË ÇAMËRISHTEN E SOTME

ABSTRACT

In the Cham Albanian dialect, in addition to the inflection forms, the uninflected lexico-grammatical categories also stand out. In this paper, we talk about some features of the functional categories that the Cham Albanian Dialect, as a peripheral dialect, still preserves as such. The examples we have analyzed have been taken from people who speak this dialect in their daily conversations and from interpretations of various folk songs. All the linguistic material is found in the area of Fier and Vlora. Among the functional categories we can emphasize the adverbial forms such as *tânia*, *táni*, *në javët*, *pstaj*, *rëpara*, *pastaja*, *tashi*, *pastajet*, *pastaje*, *të neset* etc. These forms, in addition to the dialectal features they display, at the same time, remain a good source of study in the field of linguistics and dialectology. In addition to adverbs, prepositions and conjunctions are of special interest in the paper, but there are also some cases of archaic elements of particles and exclamations.

Key words: *cham Albanian dialect, archaic features, adverb, exclamatory, linguistic phenomenon.*

Në këtë artikull jemi ndalur tek e folmja e çamërishtes duke bërë pjesë të studimit tonë disa veçori gjuhësore të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës. Duke analizuar rast pas rasti trajtat dialektore, me të drejtë mund të themi se çamërishtja mbetet një e folme me vlera të konsiderueshme në kuadër të konservimit dhe prurjeve me karakter dialektor. Krahës pjesëve të ndryshueshme, në ditët e sotme, terheqin vëmendjen edhe kategoritë leksiko-gramatikore të paepetueshme. Si fillim, po ndalemi te ndajfoljet, të cilat zënë dhe vendin kryesor në këtë punim.

1-Ndajfoljet e kohës në çamërishte paraqiten me këto trajta: *tânia, tání, në javët, pstaj, rëpara, pastaja, tashi, pastajet, pastaje, të neset, nashi, ahëre, aqhere*.

Për secilën prej tyre ne do japim nga një shembull, me qëllim që të vëmë në pah shpeshitë e përdorimit të tyre sipas zonave ku ato dalin.

Ndajfolja *tani* e mbarë gjuhës shqipe, në çamërishte del me trajtat *tânia, tání, tashi* dhe *nashi*. Trajta *tânia* është mjaft e përhapur dhe përdoret rregullisht me theks nistor, një karakteristikë që ruhet ende nga banorët çamë në Fier. Trajtat dialektore *tashi* dhe *nashi* dalin vetëm tek banorët çamë në Vlorë, një veçori e këtyre banorëve që vjen si rrjedhojë e kontaktit me labërishten, pasi këto trajta janë karakteristikë e të folmeve të Kurveleshit.¹ Shembuj: u *tânia* jam 87 vjeçe; *tání* nuk ka hënëz s'di ku të vesh gjakuni; aqe di nana jote *tání* (Fr.); *tani* atje kish nderur zjarrin në oxhak; ata 300 veta *nashi* hajën me legena aqere se më pak gjëra bëheshin aqhere; autobuzi *tashi* vinte në Gërqi; *tashi* sa kanë ikur prinët tanë e dinë (Vl.)

Ndajfolja *pastaj* del me trajtat: *pstaj, pastaja, pastajet, pastaje*. Shembuj: *pstaj* ata kishin vëndin atje, po ikëm neve; *pstaj* radhë fshatrat, të tëra me radhë, me radhë...; njëri *pstaj* vdiqi prapë 48

¹ M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, "Dialektologjia shqiptare", 1, Tiranë, 1971, f. 77-78.

vjeç (Fr.); edhe *pastaja* do bëhëj buka; edhe ikëm *pastajet* erdhëm në Gumenicë; *pastaje* ki si e preu litarin në errësirë, mbeti ki dajua im. *Pstaj* është më tepër karakteristike për çamët e Fierit, ndërsa trajtat e tjera gjenden në zonën e Vlorës, ku edhe në këtë rast, ndihet ndikimi i labërishtes.²

Të tjera ndajfolje me interes dialektor janë *ahere* dhe *aqere/aqhere*, të cilat gjenden në zonën e Vlorës: Ish një rrap i madh *ahere* aty; në fakt jermani i kish vrarë italianët *aqhere*; ata 300 veta nashi hajën me legena *aqere* se më pak gjëra bëheshin *aqere* (Vl.)³. Edhe në këtë rast mendojmë se kemi një veçori të përfutur në sajë të kontakteve që këta banorë kanë me të folmet lokale, në rastin tonë, me labërishten. Kujtojmë se trajta karakteristike për ndajfoljen *atëherë* në çamërishte dilte në trajtën *ahjere*.⁴

Në një rast të vetëm kemi edhe trajtën karakteristike *rëpara*: kish trima më *rëpara* Çamëria (Fr.) *Në javët* dhe *të neset* janë dy trajta të veçanta që përdoren nga këta banorë për të treguar një nocion kohor të caktuar: Dasma fillonte *në javët* (Fr.); *të neset* nuku dënja më asnjë orë (Vl.)

Ndajfoljet e vendit kanë këto trajta: *jashta*, *bërna*, *bërnda*, *bënda*, *bëna*, *tutje*, *tëhu*, *atjen*, *kutu*, *gjakundi*, *gjakuni* dhe *atej*. Shembuj: sazet *jashta* vu; qemë *bërna* në Sarandë; më fuste *bërna* mua ajo më jepte bukë më jepte çdo gjë; ma të hedhur i bëri *bërna* në det në vivar; tani nuk ka hënëz s'di ku të vesh *gjakuni* (Fr.); shtatë net *bërnda*; kush kish mish *bërnda* në shtëpi, ose pilaf kush kish *bërna*; të dhëndrrit isin më *tutje*, të nuses më *tëhu*; *atjen* te kroi ishte ndrtuar një stallë e madhe pularie, vajta *bërna*; ikëm që *atej*, u strehuam tre vjet *atjen*; lëre se hipa *kutu*, do zbres *këtu*; I thashë unë mos më çosh *gjakundi*; atë shtëpinë *atjen* pooshtë tha ki e ka dhënë greku; në Grigohuar *bënda*; fshati i tij ish *afrë*; vate e lau *bëna* në

² Po aty, f. 78.

³ M. Totoni, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, "Studime filologjike", 1964/1, f. 144.

⁴ M. Totoni, vep. e cit., f. 113.

shtëpi (Vl.)

Për t'u përmendur është ndajfolja *jashtë*, e cila në çamërishte del me fundoren *a*: *jashta*. Shqiptimi me fundoren *a* është një tipar dialektor, i cili del edhe në ndajfolje të tjera të tipit: *këtea*, *atea*, *ahjera* etj.⁵ Nga ndajfoljet e vendit, interes paraqesin trajtat: *bërna*, *bërnda*, *bënda* dhe *bëna*. Trajta me asimilim *bërna* del më tepër në zonën e Fierit. Ndërsa trajtat e tjera i përkasin komunitetit që jeton në Vlorë. Edhe ndajfoljet *tutje*, *tëhu*, *atjen*, *atej*, *afrë* i përkasin vetëm zonës së Vlorës. Sipas kësaj harte shpërndarjeje, banorët çamë në Vlorë na rezultojnë me më tepër variante sesa banorët çamë të vendosur në Fier. Disa prej këtyre trajtave kanë fituar terren dhe janë bërë pjesë e repertorit të tyre edhe si pasojë e ndikimeve të bashkësive pritëse.

Ndërsa trajta karakteristike *gjakundi*, *gjakuni* ka një përdorim më të qëndrueshëm dhe del në të dy zonat.

Ndajfoljet e mënyrës të tipit *aradha*, *arrotulla*, *rrotulla*, *me bët*, që ne kemi përmendur si ndajfolje tipike të çamërishtes⁶; sot kanë dalë prej përdorimit. Në vend të tyre kemi trajta më të reja të cilat kanë zëvendësuar plotësisht trajtën e hershme të tyre. Këto trajta sot mund t'i ndeshësh vetëm nëpër literatura e studime kushtuar kësaj së folmeje, pasi në ditët e sotme kanë evoluar plotësisht.

E vetmja ndajfolje mënyre që ruan fizionominë e dikurshme të çamërishtes është trajta dialektore *çish* (qysh). Por, edhe për këtë trajtë, shembujt janë shumë herë më të paktë referuar gjendjes së mëparshme: *çish* do bi u i varfëri, prapa shkallësë do rri edhe nekë ti do vi, nuk e di *çish*, e ndërron e mirr të re?! (Vl.)

⁵ M. Totoni, *vep. e cit.*, f. 108.

⁶ Për këtë shembull u jemi referuar teksteve në *Prozën popullore* dhe materialeve të mbledhura nga H. Pedersen, përkatësisht, në veprat: H. Pedersen, *Albanesische Texte mit Glossar*, Laipzig, 1895; *Proza popullore*, Seria I "Folklor shqiptar", Vëllimi VI, Tiranë, 1988; *Këngë popullore çame* (Mbledhur dhe pregatitur nga Ibrahim D. Hoxha) Shtëpia botuese "Naïm Frashëri", 44-45.

Ndajfoljet e sasisë përgjithësisht dalin me trajta që janë të njohura për gjuhën shqipe dhe janë më afër standardit. Si të tilla përmendim: *pak*, *shumë*, *një(dy)* *herë*, *çik* etj.: duhet t'ë njohësh at, e njeh *pak*? Më kanë vuar prindërit *shumë*; gruaja e dytë kjo nëna ime, se ishte martuar *dy herë* babai (Vl.); e hidh gjalpin, i hidh *çik* djathë nga të napës të njomë; mblihdh *çik* anët kështu, e një *çikë* anët këtej pastaj ktheje (Fr.)

Në mesin e këtyre trajtave të përgjithshme, dallon vetëm ndajfolja e sasisë *aqe*, e cila del vetëm një herë: *aqe* di nana jote tani (Fr.) Një trajtë e tillë gjendet edhe në qytetin e Gjirokastrës⁷, me të cilën çamërishtja ka mjaft pikëtakime.

Duke e përfunduar me ndajfoljen e mënyrës, arrijmë në përfundimin se: në fushën e ndajfoljeve, e folmja e çamërishtes arrin të na përcjellë një pjesë të trajtave me karakter arkaik, të cilat dëgjohen, më së shumti, prej brezit të tretë. Ndërsa, pjesa tjetër e ndajfoljeve, si pasojë e zhvillimit të vetë çamërishtes, e vendosur në raport me gjuhën standarde, i ka nxjerrë prej fondit të saj trajtat e hershme.

2- Parafjalët

Trajtat parafjalore të çamërishtes edhe sot dalin me forma të veçanta. Në përgjithësi, sistemi parafjalor i çamërishtes karakterizohet nga përdorimi i disa trajtave me forma karakteristike. Si të tilla përmendim: *ka*, *ne*, *nekë*. Po shkëpusim disa shembuj nga regjistrimet tona në Fier dhe Vlorë: ne ishim këtu poshtë *nek* ku është çuni Alushi; ja, të më shpjerë njeri, të vete m *ne* vatani im; bëri dekumentet gjyshja e tij, kur vate *ne* porta, u kish mbillur ajo; mu *ne* rrapë Sarandës e varën Mazar Dinon (Fr.); *ne* porta me llamarinë / *ne* ulliri që mba dhrinë // prapa shkallësë do rri / edhe *nekë* ti do vij // në Himar zbritëm *ne* varka; po këmishë parë kur bie *ka* barku, i palarë, i veshim atë; ajo më kuptoi *ka* fitira; po Ruzhdien

⁷ M. Totoni, vep. e cit. më sipër, f. 108.

sikur e ka bënë njeri tjetër, jo u; *ne* këta të tjerët, kam vuar shumë; atje *ne* ulliri shekullor; edhe dal *na* maqina; ngrihet një atje ishte çam *ka* Koshovica; hidhej një qën *ka* kta, vanë *te* hambari.

Parafjalët *ka* dhe *ne/nekë* zënë vendin kryesor në mesin e trajtave karakteristike të çamërishtes. Gjatë intervistave me banorët e këtij komuniteti, krahas trajtave me karakter arkaik, dëgjohen edhe trajta lokale e standarde, p.sh., dal *na* maqina (Vl.); vanë *te* hambari; veja thoshte Jajaja rrija maksus *te* dajua; e çojën *te* vëndi etj. Edhe me parafjalën *prej* ne kemi hasur vetëm një rast të tillë: zbritëm *prej* Paramthisë (Fr.).

Përdorimi i trajtave të hershme vërehet te brezi i tretë, ndërsa më të rinjtë përdorin trajtat e zakonshme të gjuhës shqipe.

3- Lidhëzat

Sistemi i lidhëzave në çamërishten e sotme përkon me ato të mbarë gjuhës shqipe. Lidhëza karakteristike e çamërishtes *hoj*,⁸ sot ka evoluar dhe është zëvendësuar me *ose* të gjuhës standarde. Shembull: *ose* do i therë zogunë, *ose* duhet ti bënë mish.⁹ Në bazë të materialeve që ne kemi grumbulluar mbi këta banorë, nuk kemi gjetur asnjë gjurmë të këtyre lidhëzave me karakter arkaik.

Veçori dialektore paraqet lidhëza *për*sa, e cila në zonën e Vlorës përdoret me kuptimin *derisa*, *gjersa*, *përderisa*: *për*sa kjo iku që andej, erdhi këtu, se besimi ishte gjë e madhe; *për*sa kjo iku që andej e erdhi këtu dhe ne do ndërtojmë kishën tha.¹⁰

Tipare dialektore vërehen edhe te banorët çamë në Fier, sidomos te brezi i tretë, të cilët ruajnë ende struktura të hershme lidhëzore. E kemi fjalën për fjalën lidhëse *nek ku*, që përdoret për të shprehur raporte vendore: ne ishim *tek ku* është ky çuni Alushit, *nek ku* është

⁸ Shih më sipër

⁹ Daje Musaraj, Vlorë.

¹⁰ Muhamet Musaraj, Vlorë.

Ismeti.¹¹

Të përdorshme janë edhe një numër lidhëzash bashkërenditëse të zakonshme, si: *e, dhe, as, po* etj.: të vete te brreth Çamërinë *e t'i* njoh të tëra fshtrat (Fr.); ngulën këmbë që të rrinimatje, *po* kata nuk ndenjen; daja i ksaj ka qënë i martuar me greke *dhe* atje jetoj nuk erdhi në Shqipëri (Vl.); ne marrim bamp mish, mua s'më përqlen mishi, *as* i viçit, *as* i lopës (Fr.).

4- Pjesëzat

Pjesëzat që përdorin më shpesh këta banorë janë ato të mbarë gjuhës shqipe. Përgjithësisht bëjnë vetëm disa trajta karakteristike, të cilat edhe sot ruajnë tipare dialektore në strukturën e tyre. Si të tilla përmendim pjesëzat: *njar, njera dhe nja:m*.¹² Shembuj: Ku ishte zonja dish e dua / ka vatur *njar* në krua / të më lajë fustanë mua; dasma e kish që ne qishqeku *njera* në të tëra;¹³ këtu keshmë rrugën *njaam* atje (Vl.)¹⁴ Trajtat që sollëm i përkasin vetëm zonës së Vlorës, e cila, në këtë drejtim paraqitet më konservuese.

Me një përdorim të shpeshtë del pjesëza *nuk*, e cila në çamërishte përgjithësisht ruan trajtën *nuku*: plaku *nuku* u kthe në fshat, nana ime *nuku* dinte; gratë çame *nuku* dilnin moj të keqen nana, *nuku* dilnin; tani *nuk* ka hënëz *nuk* di ku të vesh gjakuni (Fr.); ju moj zonja katërxhika / ju moj mos më shini mua / po shini njerinë tuaj / që *nuku* rroi me mua as javë as muaj; se *nuk* dinte asnjë gjellë kjo tona; rruga që *nuku* shkon maqinaria, me kardëllëmëra; *nuku* vijnë; u *nuku* luaj ka vëni (Vl.) Në shembujt e mësipërm, rastet me trajtën *nuku* i tejkalojnë disa herë ato me *nuk*, të cilët dalin më rrallë.

Krahas pjesëzave me tipare dialektore, në çamërishte përdoren në mënyrë të rregullt edhe pjesëzat e përgjithshme të gjuhës shqipe,

¹¹ Lico Aliu, Fier.

¹² Trajta *njaam*, del me zanore të gjatë. Zgjatja e zanores në këtë rast ndodh si pasojë e ndikimit të labërishtes.

¹³ Daje Musaraj, Vlorë.

¹⁴ Sejko Hajrullai, Vlorë.

si: *mos, ja dhe mu*. Shembuj: *mos shiko këtu në Myzeqe ti, po të vesh lart nga Kavaja nga Fieri...*¹⁵ *mos shiko këtu ti; ju moj mos më shini mua; Ja, të më shpjerë njeri të më vërë në maqinë të vete mu ne vatani im; ja, e ka plaku, krrëc-krrëc çikë këtu; si këto s'jemi ne, ja, ta thotë nana ty; mu ne rrapi Sarandës e varën Mazar Dinon; ja, mbase d'e ket harrirë ki babai jot (Fr.); -Po, ja, more! -I thashë. Mos i kish flokët, ja, kaq, flakë të kuqe edhe të dredhura (Vl.). Të tria pjesëzat që përmendëm dalin me të njëjtat funksione që kanë edhe në gjuhën shqipe, duke shprehur nocion mohues, tregues dhe saktësues.*

5- Pasthirrmat

Në ditët e sotme përdorim të shpeshtë kanë pasthirrmat *o, ore, moj, mori more*. P.sh.: *O djalo i thashë! O djalthi im! Kishte një mik babai im aje, nga është ky Refat Sulejmani more! Jo ore i thotë ai, nuku na vrasin neve! Ore do na vrasin neve (Vl.); ça thua ti moj të keqen nana, lere Çamërinë! Leri ato këngët e Çamrisë! Ti i do të tëra mori! (Fr.)*

Prania e pasthirrmave vërehet më tepër në këngë popullore të krahinës. Ja disa vargje që kemi regjistruar te banorët e këtij komuniteti: Se do los me miken-o / me mike syzezën-o; Kajneki *maj kajneki* / amë një gotë ujë të pi (Vl.) Çamëri *mori* sulltanë / ç'e lëshove dot vatanë // Çamëri *maj* Çamëri hárëxhi në Shqipëri (Fr.).

Përfundime dhe rekomandime

Referuar materialit gjuhësor që gjendet sot në çamërishte, për sa i përket pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, arrijmë në këto përfundime:

Së pari, në fushën e ndajfoljeve, e folmja e çamërishtes arrin të na përcjellë një pjesë të trajtave me karakter arkaik, të cilat dëgjohen, më së shumti, prej brezit të tretë. Ndërsa, pjesa tjetër e ndajfoljeve, si pasojë e zhvillimit të vetë çamërishtes, e vendosur në

¹⁵ Feruze Tahiri, Fier.

raport me gjuhën standarde, i ka nxjerrë prej fondit të saj trajtat e hershme;

Së dyti, në fushën e parafjalëve gjejmë ende trajtat e hershme *ka* dhe *ne/nekë, por*, gjatë intervistave me banorët e këtij komuniteti, krahas trajtave me karakter arkaik, dëgjohen edhe trajta lokale e standarde;

Së treti, sistemi lidhëzor i çamërishtes sot karakterizohet nga përdorimi i trajtave me karakter të përgjithshëm, duke evoluar në drejtim të gjuhës standarde;

Së katërti, krahas pjesëzave dhe pasthirmave me tipare dialektore, në çamërishte përdoren në mënyrë të rregullt trajtat e përgjithshme të gjuhës shqipe.

Literatura:

- A. Xhuvani, “Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipet”, në “Studime gjuhësore”, ribotuar në Vepra I. Tiranë, 1980.
- E. Angoni, “Pasthirrmat në gjuhën e sotme shqipe”, “Studime filologjike”, Tiranë, 1974/4.
- E. Angoni, “Pjesëzat në gjuhën shqipe”, “Studime filologjike”, Tiranë, 1971/3.
- E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
- K. Topalli, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2001.
- *Këngë popullore çame* (Mbledhur dhe pregatitur nga Ibrahim D. Hoxha) Shtëpia botuese “Naim Frashëri”.
- Q. Haxhihasani, *Dialektologjia Shqiptare I*, “Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamrisë”, Tiranë 1971.
- Q. Haxhihasani, *Dialektologjia Shqiptare II*, “Nga toponomastika e Çamrisë”, Tiranë 1975.

- Qemal Haxhihasani, *Dialektologjia Shqiptare II*, ‘Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamrisë’, Tiranë 1974.
- Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 1996.
- Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, pjesa II, Tiranë, 1966.

ELONA TORO

Universiteti i Tiranës

**MODIFIKIMI I PROCESIT TË TË NXËNIT NË
NJË MJEDIS MËSIMOR I CILI PËRDOR
TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE TË
KOMUNIKIMIT (TIK)**

ABSTRACT

Nowadays, Information and communication technologies are being used more and more in learning and teaching. In this article, we will try to see how the use of technologies can modify the process of foreign language learning by introducing in this process new dimensions and practices.

The group of students that we observed learns French in an environment where teaching used the Internet, digital foreign language manual and an interactive whiteboard. This group consists of students from different secondary schools of Tirana who learn French in the French Alliance of Tirana. Polls conducted have been intended to highlight student opinions about this way of learning and learning strategies that they think use in foreign language learning.

Keywords: *ICST, learning, learning strategies, foreign language, autonomy*

Hyrje

Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) bashkojnë dy mundësitë e mëdha që ofrojnë sistemet informatike: aksesimi në një sasi të madhe informacioni në formën digjitale dhe komunikimin në distancë, për shembull: e-maili, chat-i, blogu, forumi etj.

Zbatimi i Teknologjive të Informacionit dhe të Komunikimit në mësimdhënie nënkupton *përdorimin e potencialeve dhe vetive të këtyre sistemeve në mësimdhënie*. **(Cuq: 2003)**. Didaktika e gjuhëve të huaja është e interesuar në mënyrë të veçantë për këto dy veçori pasi, së pari, ato sjellin në klasën e gjuhës së huaj jetën reale dhe gjuhën autentike falë shumëllojshmërisë së informacionit dhe, së dyti, ato i bëjnë nxënësit dhe mësuesit të krijojnë lidhje dhe të bashkëpunojnë midis tyre, TIK-u lehtëson komunikimin, çka është dhe një nga aspektet më të rëndësishme të gjuhës.

Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit na japin mundësinë të krijojmë një dispozitiv mësimor të mediatizuar, duke u bazuar në mësimdhënien dhe mësimnxënien me anë të detyrës **(Ellis : 2003)**, çka e modifikon procesin e të nxënës dhe strategjitë që përdor nxënësi. *Zgjedhja e këtyre strategjive varet, së pari, nga lloji i detyrës që i është dhënë nxënësit dhe, së dyti, nga lloji i mjetit pedagogjik të përzgjedhur*. **(Brown: 1982)**. Aleanca Franceze e Tiranës ka integruar përdorimin e teknologjive në mësimdhënien e gjuhës frënge. Eksperiencia pranë këtij institucioni më ka ndihmuar të vëzhgoj studentët që mësojnë gjuhën frënge me anë të këtyre teknologjive.

Ky artikull do të përqendrohet në pjesën e parë të teknologjitë që përdoren për të mësuar gjuhën frënge, pranë Aleancës Franceze të Tiranës dhe karakteristikat e funksionalitetit të tyre. Në pjesën e dytë, do të trajtohet modifikimi i procesit të të nxënës nga dy këndvështrime : si modifikohet ky proces në kontekstin e klasës? Si modifikohet reflektimi i nxënësit mbi procesin e të nxënës. Në

pjesën e tretë, do të paraqiten rezultatet e një pyetësoi të bërë me nxënësit e Alencës Franceze të Tiranës, i cili nxjerr në pah opinionin e tyre lidhur me përdorimin e teknologjive në klasë.

I – Llojet e Teknologjive të Informacionit dhe të Komunikimit në mësimdhënie

Pajisjet teknologjike që përdoren pranë Alencës Franceze të Tiranës gjatë orës së mësimi të gjuhës së huaj prej vitit 2010 janë : Tabela Interaktive Digjitale (TBI), e cila ka zëvendësuar tabelën e zezë klasike. Bëhet fjalë për një tabelë grafike që lidhet me një kompjuter dhe një videoprojektor, i cili reflekton mbi tabelë desktopin e kompjuterit. Dora e njeriut ose lapsat që përmban vetë tabela, luajnë rolin e mausit dhe bëjnë të mundur komandimin e të gjitha funksioneve të kompjuterit duke qëndruar përballë klasës dhe jo me shpinë.

Tabela Digjitale përdoret në një mjedis grupi dhe vë në dispozicion të mësuesit ose animatorit të grupit të gjitha funksionet e një kompjuteri (përdorimin e internetit, funksionet e tij multimediale si teksti, dokumentet video, dokumentet dhe materialet audio etj.). Informacionet e gjetura apo modifikimet që mund t'i jenë bërë një teksti mund të ruhen dhe mund t'i dërgohen për shembull me email nxënësve që kanë munguar ose mund të shkëmbehen edhe me mësues të tjerë. Falë funksioneve të shumta që propozohen nga programet që shoqërojnë tabelën digjitale (Notebook, Scrabook etj) mund të krijohen ushtrime apo aktivitete bashkëvepruese, dinamike e zbavitëse. Tabela jep mundësinë të luhet me funksionet e zërit, të videos dhe të perdes, e cila shërben për të maskuar një pjesë të tekstit apo figurës, *çka e nxit nxënësin të formulojë hipoteza e të hamendësojë lidhur me atë çka mund të fshihet në figurë¹ duke e nxitur kështu që të shprehet në*

1 URL:

<https://www.google.com/search?q=fonctionnalit%C3%A9+rideau+tbi&client=browser->




Figura 1: Funksionimi i perdes në një TBI

Një nga teknologjitë e tjera të përdorura është edhe Interneti, i cili ka disa funksione dhe veçanti. Citojmë këtu katër funksionet kryesore të Internetit : së pari, funksioni i *multimedias*. Falë kësaj veçorie, mund të kemi në të njëjtin suport tekst, video, imazh, tingull, figura të animuara etj. Së dyti, funksioni i *hypertekstit*, i cili ndërlihdh tekste të ndryshme duke klikuar në një link të thejshtë, çka krijon një rrjet gjigand, duke lejuar përdoruesin të hyjë dhe të shfrytëzojë një masë shumë të madhe informacioni. Së treti, është edhe *kanalizimi i shumfishtë* i informacionit. Të njëjtin informacion mund ta gjejmë në forma të ndryshme komunikimi, në formatin tekst, imazh, video etj., që e lejon nxënësin apo mësuesin ta përdorë

ubuntu&hs=Mln&channel=fe&hl=en&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEëjg6-3evZrUAhëbHsAKHdrOCAëQ_AUICCgD&bië=1321&bih=639#imgsrc=2IhO8flvsfTUoM

dhe të jetë kështu në një pozicion aktiv. Funkzioni i katërt i Internetit është edhe *ndërlidhja* e informacionit në forma të ndryshme. Për shembull, një temë e caktuar mund të prezantohet duke përdorur elemente të ndryshme në mënyrë që të kuptohet më mirë, ose duke përdorur referenca të ndryshme (muzikë, letërsi, pikturë etj.) për të zhvilluar më shumë imagjinatën dhe të shprehur gjatë një aktiviteti nxënies. **(Lancien : 1998)**

Një formë tjetër e teknologjisë e cila po përdoret gjithmonë e më shumë është manuali ose metoda digjitale e gjuhës së huaj. Ajo propozon në formatin dixhital, metodën e zakonshme të gjuhës. Megjithatë metoda digjitale nuk është thjesht një dokument në formatin PDF, por përmban edhe funksione të tjera shtesë. Ajo përfshin të gjitha funksionet audio të aktiviteteve të dëgjimit që mundësojnë korrigjimin dhe plotësimin e aktiviteteve të ndryshme në grup, gjë e cila shmang probleme me ortografinë dhe shkurton kohën e korrigjimit të aktiviteteve. **(Orlifa : 2012)**



Figura 2: Pjesë e shkëputur nga metoda digjitale e gjuhës frënge Alter Ego B1 +

Ndryshe nga versioni libër i metodës së gjuhës, versioni digjital mund të propozojë edhe aktivitetet shtesë si për shembull video, që lidhen me njësi mësimore apo didaktike të caktuara.

II – Modifikimi i procesit të të nxënës

Të gjitha këto mjete teknologjike që përdoren në mësimdhënien e

gjuhëve të huaja mund të sjellin një lloj modifikimi në procesin e të nxënësit. (Hirschsprung : 2005)

Duke u bazuar në teorinë e ndërtimit të dijes, nxënësi nuk është më një person pasiv që thith informacionin e propozuar nga mësuesi, por ai shndërrohet në një aktor të nxënies së tij, ai merr vendime lidhur më të nxënësit dhe është i aftë të vetëvlerësohet.

Në mënyrë që përdorimi i teknologjive të jetë efikas, do të ishte e nevojshme që ato të integrohen në një pedagogji që e ka studiuar mirë këtë integrim. Kështu pra, përdorimi i kanaleve të ndryshme të komunikimit e ndihmon nxënësin të ndërtojë më mirë realitetin. I njëjti informacion transmetohet në forma të ndryshme. *Informacioni i tepërt dhe i përsëritur e ndihmon nxënësin ta memorizojë më mirë atë dhe si rrjedhojë ta kuptojë më mirë. (Narcy-Combes : 2005)*

Përdorimi i teknologjive kërkon që nxënësi të marrë pjesë në mënyrë aktive në nxënie dhe të reagojë duke kontribuar kështu në procesin e tij të të nxënësit. Ky përdorim mund të shihet në dy aspekte : së pari, në kuadrin e të nxënësit, por edhe në kuadrin e reflektimit mbi të nxënësin, i cili është po aq i rëndësishëm për këtë proces. Për sa i përket të nxënësit në klasë, teknologjitë nxisin motivimin e nxënësit dhe autonominë e tij. Aktivitete e propozuara mund të ndiqen sipas një ritmi personal. Pajisjet teknologjike lejojnë punën e katër aftësive të gjuhës në të njëjtën kohë, të dëgjuarin dhe të lexuarin, të shprehurin me gojë e me shkrim. *Rrjetet sociale apo faqet Wiki², të gjithë funksionet e Web 2.0³, pra, aspekti i komunikimit, bën të mundur komunikimin real, çka ngelet gjithmonë fiktiv në kuadrin e klasës. (Altan : 2000)*

Për sa i përket reflektimit mbi të nxënësin, aktivitetet e vetëkorrigjueshme bëjnë të mundur vetëvlerësimin e nxënësit, duke

²Faqet wiki janë ato faqe në linjë që bëjnë të mundur krijimin, modifikimin apo ilustrimin e një faqe interneti në mënyrë bashkëpunuese.

³Koncept i krijuar nga Dougherty D. në 2004, për të emërtuar shfaqjen e një etape të re në përdorimin e teknologjive si një sistem ndërveprimi social.

nxjerrë në pah nevojat e tij dhe duke e ndërgjegjësuar mbi procesin e të nxënës, çka i lejon nxënësin të mësojë duke ndjekur nevojat e tij dhe duke përmirësuar strategjitë e tij të të nxënës. *Falë vetive interaktive të pajisjeve teknologjike, falë funksioneve të transformimit, të ruajtjes së informacionit, nxënësi e ka më të thjeshtë të konceptojë njohuritë dhe për rrjedhojë t'i përvetësojë ato. (Hirschsprung : 2005)*

III – Pyetësi mbi përdorimin e TIK-ut në klasën e gjuhës së huaj dhe rezultatet

Duke parë interesin që tregojnë nxënësit gjatë kontaktit të parë me teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit të përdorura në mësimin e gjuhës së huaj, menduam të hartonim një pyetësor drejtuar nxënësve të Aleancës Franceze të Tiranës. Pyetësi synon të hetojë sesa përdoren teknologjitë në gjimnazet e Tiranës dhe cili është mendimi që kanë nxënësit lidhur me këtë mënyrë të nxënës.

Pyetësi (*shih aneksin 1*) që iu propozua nxënësve përmbante tetëmbëdhjetë pyetje, trembëdhjetë pyetje të mbyllura, kryesisht pyetje që kishin për qëllim të nxirrnin në pah fakte, si për shembull pajisja e shkollave me materiale teknologjike dhe pesë pyetje të hapura, të cilat i lejojnë nxënësit të shprehin më shumë. Qëllimi i pyetësit ishte të vinte në dukje opinionin dhe qëndrimin e nxënësve ndaj përdorimit të teknologjive të reja.

Rezultatet treguan se në përgjithësi shkollat e mesme janë të pajisura me salla informatike të lidhura me Internet, madje, ndonjëherë mund të gjejmë pranë gjimnazeve edhe ndonjë tabelë digjitale, po ato nuk përdoren në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Nga ana tjetër, nxënësit kanë pothuajse të gjithë një kompjuter në shtëpi, ata e përdorin Internetin, po ashtu edhe navigatorët e ndryshëm web dhe programet Office, në mënyrë të përditshme kryesisht për të kërkuar informacion dhe për të përdorur rrjetet sociale; për të dëgjuar muzikë, por edhe për të mësuar gjuhë të huaja.

Nxënësit mendojnë se mësimi i gjuhëve të huaja me anë të teknologjive është: më interesant, më tërheqës, më motivues, gjithëpërfshirës. Falë teknologjive ata kanë mundësinë të marrin më shumë informacion duke u zbavitur, ata mësojnë më shumë lidhur me kulturën e një vendi dhe përvetësimi i njohurive bëhet më lehtë.

Përgjigjet e pyetjeve të hapura të pyetësorit TIK për nxënësit e gjuhës frënge	
Pyetja 4	Për të kërkuar informacione, për të përdorur rrjetet sociale, për të dëgjuar muzikë, për t'u argëtuar, për të mësuar gjuhë të huaja
Pyetja 5	Microsoft Office, Internet
Pyetja 13	është më tërheqëse, më argëtuese, më interesante dhe më e thjeshtë për t'u kuptuar
Pyetja 16	është më interesante, kërkimi na ndihmon të gjejmë më shumë informacion, është më e thjeshtë për t'u kuptuar, është më angazhuese e motivuese
Pyetja 18	Nëpërmjet adresave dhe linkeve të shumta mund të shikojmë site të ndryshme, sepse është krijuar për të na lehtësuar punën, mësojmë më shumë rreth kulturës së një vendi sesa nga librat, është më tërheqëse dhe e kuptueshme.




Figura 3: Pyetësori mbi përdorimin e TIK-ut nga nxënësit

Pra, nëpërmjet këtij pyetësori vërejmë se nxënësit kanë një përvojë të madhe në përdorimin e teknologjisë, si për sa i përket kërkimit të informacionit, po ashtu edhe komunikimit, por përdorimi i tyre në klasë është shumë i paktë. Përdorimi teknologjive është një element interesant në nxënien apo

mësimdhënien e gjuhës, por ato nuk duhen konsideruar si një pajisje magjike që zëvendëson metodën e gjuhës dhe mësuesin, ato duhen të jenë një mjet më shumë që radhitet pranë një metodologjie që i integron në ndërtimin dhe organizimin e të nxënës.

Bibliografia

Altan, J. (2000), « L'utilisation des stratégies d'apprentissage d'une langue dans un environnement des TICE », *Alsic [en ligne]*, 3, n°1, document alisc_n05-rec3, mis en ligne le 15 juin 2000, Consulté le 09 avril 2012. URL : <http://alisc.revues.org/1759;DOI: 10.400/alisc.1750>

Cuq, j-p (2003), *Dictionnaire de didactique du français langue étrangère et seconde*, Paris, Clé International

Ellis, R. (2003), *Task-based language learning and teaching*, Oxford, Oxford University Press

Hirschsprung, N. (2005), *Apprendre et enseigner avec le multimédia*, Paris, Hachette FLE

Lancein, T. (1998), *Le multimédia*, Paris, Clé International

Mangenot, F. et Louveau, É. (2006), *Internet et la classe de langue*, Paris, Clé International

Mesguich, V et Thomas, A. (2009), *Net recherche 2009. Le guide pratique pour mieux trouver l'information utile et surveiller le web*, Paris, ADBS éditions

Narcy-Combes, J-P. (2005), *Didactique des langues et TIC : vers une recherche-action responsable*, Paris, Ophrys

Orlifa, S. (2012), *Le numérique*, Cours D0P31 de Rouquette, C., Sorbonne-Nouvelle, Paris III, Paris

Petitgirard, J-V., Abry, D. et Brodin, É. (2011), *Le Tableau Blanc Interactif*, Paris, Clé International

Ankesi 1 – Pyetësori për nxënësit mbi përdorimin e TIK-ut

Pyetësori mbi përdorimin e TIK-ut nga nxënësit

1. Keni kompjuter në shtëpi? Po Jo
2. Keni lidhje me Internetin në shtëpinë tuaj? Po Jo
3. Futeni shpesh në Internet? Po Jo
4. Cilat janë arsytet për të cilat e përdorni më shpesh Internetin?

5. Cilat janë programet që përdorni më shpesh? _____
6. Keni një sallë informatike në shkollën ku studioni? Po Jo
7. A ka salla lidhje me Internetin? Po Jo
8. Keni kompjuter të lidhur me Internetin në klasën ku mësoni? Po
Jo
9. Keni Tabelë Interaktive Digjitale (TID) në klasën tuaj? Po Jo
10. Nëse jo, a ka në shkollën tuaj një klasë ku është e instaluar një
TID? Po Jo
11. Përdorni ndonjë kompjuter gjatë orës së mësimi? Po Jo
12. Nëse jo, a do të kishit ju dëshirë që ta përdornit? Po Jo
13. Shpjegoni përse _____
14. Keni marrë pjesë ndonjëherë në një seancë mësimore që përdor
Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK)? Po Jo
15. Ju ka pëlqyer kjo eksperiencë? Po Jo
16. Shpjegoni përse _____
17. A mendoni se TIK-u ju ndihmon që të mësoni më mirë gjuhët e
huaja? Po Jo
18. Shpjegoni përse _____

Questionnaire sur l'utilisation des TICE pour les apprenants

1. Avez-vous un ordinateur à la maison? Oui Non
2. Avez-vous une connexion Internet à la maison? Oui Non
3. Naviguez-vous souvent sur Internet? Oui Non
4. Quelles sont les raisons pour lesquelles vous utilisez Internet le
plus souvent? _____
5. Quels sont les logiciels que vous utilisez le plus? _____
6. Avez-vous une salle informatique dans votre établissement
scolaire? Oui Non
7. Y-a-t-il une connexion Internet? Oui Non
8. Avez-vous un ordinateur connecté à Internet dans vos classe de

cours? Oui Non

9. Avez-vous un TBI dans vos classes de cours? Oui Non

10. Si non, avez vous une classe dans votre établissement scolaire qui a un TBI? Oui Non

11. Utilisez-vous l'ordinateur pendant les séances de cours? Oui Non

12. Si non, auriez-vous envie de l'utiliser plus pendant les cours? Oui Non

13. Expliquez pourquoi _____

14. Avez-vous assisté à un cours utilisant les TICE? Oui Non

15. Avez-vous aimé cette expérience? Oui Non

16. Expliquez pourquoi _____

17. Pensez-vous que les TICE vous aident à mieux apprendre la langue étrangère? Oui Non

18. Expliquez pourquoi _____

JONIDA LESHA

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

**SHQYRTIM SISTEMATIK LITERATURE MBI
BESIMET E MËSUESVE NË MENAXHIMIN E
KLASËS**

ABSTRACT

Researchers and scholars have recently developed great interest in teacher efficacy because it promotes teacher effectiveness and provides solutions to problems in teacher education. Furthermore, it enhances teacher productivity. Literature reveals that teacher efficacy beliefs influence classroom instruction, students learning and performance.

Keywords: *literature, teacher, beliefs, classroom*

Hyrje

Kërkuesit dhe akademikët kanë zhvilluar kohët e fundit një interes të madh ndaj besimeve të vetefikasitetit të mësuesve duke pasur parasysh faktin që një konstrukt i tillë promovon efektivitet të mësuesit dhe, gjithashtu, përfton zgjidhje të problemeve në edukimin e mësuesve. Për më tepër, një konstrukt i tillë përmirëson produktivitetin e mësuesve. Literatura tregon se besimet e vetefikasitetit të mësuesve influencojnë instruksionet në klasë, nxënien e nxënësve dhe performancën.

Rishikimi i literaturës tregon që mësuesit që vetëperceptohen me efikasitet të lartë, janë të aftë të motivojnë studentët për të mësuar dhe janë të zotë të angazhojnë studentët në nxënie, edhe kur nxënësit paraqesin sjellje jo të mirë në klasë.

Metodologjia

Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë një tablo të studimeve të kryera në fushën e psikologjisë së edukimit në lidhje me besimet e mësuesve në menaxhimin e klasës. Ky studim përbën një studim teorik i bazuar në shqyrtimin e literaturës bashkëkohore.

Rishikimi i literaturës

Sipas Richardson (1996), besimet mund të mendohen si një kuptueshmëri psikologjike, premisa ose pohime të një gjendjeje të vërtetë të realitetit. Richardson shpjegon se besimet dhe qëndrimet janë një nënkategori e konstrukteve që emërtojnë dhe përcaktojnë, përshkruajnë strukturën dhe përmbajtjen që drejton veprimet e një njeriu. Në vazhden e besimeve të mësuesve në lidhje me edukimin ato ndikojnë në mënyrë direkte çfarë ato mësojnë dhe si e mësojnë.

Besimet e mësuesve mund të vijnë nga burime të ndryshme. Tri kategori eksperience ndikojnë zhvillimin e besimeve rreth mësimdhënies dhe eksperiencave personale, eksperiencave me shkollën dhe instruktimin, eksperiencat me njohuritë formale (Richardson, 1996). Studimet kanë treguar që ndikimi i cilësisë së

eksperiencës në klasë gjatë viteve të praktikës si mësues dhe mundësia e reflektimit mbi këtë eksperiencë ka një efekt në besimin e mësuesit .

Clandinin (1986) sugjeron që eksperiencia personale është e koduar në imazhe që ndikojnë praktikën; këto imazhe kanë dimensione morali, emocionale, personale dhe private.

Për sa i përket shkollimit dhe eksperiencave instruktuese, kërkimet kanë treguar studentë që vijnë në vitin e tyre të praktikës (mësues të ardhshëm) me besime të forta rreth natyrës së mësimdhënies bazuar në eksperiencat e tyre. Kur kombinohen në botën reale praktika e mësimdhënies, besimet e vendosura nga mësuesit e ardhshëm krijojnë kushte që mund të bëjnë të vështirë për ata që mësimdhënia e tyre të ketë impakt (Richardson, 1996).

Për shembull, Knowel (1992) në studimin longitudinal të tij raportoi që familja ka ndikim po aq sa dhe figura e mësuesve të mëparshëm që kanë ndikuar në konceptimet e mësuesve të ardhshëm në kohën e praktikës profesionale për sa i përket rolit të mësuesit. Eksperiencat personale e nxënies në klasë dhe observimi i modeleve të mësimdhënies, të shoqëruara me përfshirjen prindërore mund të kontribuojë në perceptimin e rolit të mësuesit.

Studimet e origjinës së besimeve të mësuesve tregojnë që sesi një shumëllojshmëri eksperiencash kontribuojnë në formimin e besimeve të forta dhe që zgjasin rreth mësimdhënies dhe nxënies. Për më tepër, studimet tregojnë që besimet e mësuesve duhet të njihen dhe studiohen gjatë programit të edukimit të mësuesit për të bërë një diferencë në strukturën e thellë të njohurive dhe besimeve të mbajtura nga mësuesit gjatë kohës së praktikës profesionale (Richardson, 1996).

Nespor (1997) argumenton se kontaktet dhe mjediset në të cilat mësuesit punojnë, përgjatë me problemet që ato ndeshin, janë të përcaktuara, dhe që në mënyrë të veçantë i vishen besimeve në mënyrë që të bëjnë sens me ato kontekste. Studimet për të kuptuar

besimet sugjerojnë që, nëse interesi i madh është në pse mësuesit organizohen dhe menaxhojnë klasën ashtu siç veprojnë, atëherë si pasojë, më shumë vëmendje duhet ti kushtohet qëllimeve që ato ndjekin si dhe interpretimeve subjektive të tyre për proceset në klasë.

Richardson (1996) gjithashtu thekson se besimet janë për të udhëhequr veprime, me eksperiencë dhe reflektim mbi veprimin mundësisht duke udhëhequr ndryshimin ose modifikimin e besimeve.

Shumë studime janë bërë në kuadër të besimeve të mësuesit që lidhen me stilin e menaxhimit të klasës dhe janë bërë krahasime me veçanti demografike.

Shumë studime të realizuara nga Martin, Baldwin, Shoho dhe Yin (1992,1993, 1994, 1995, 1997 dhe 2000) kanë kërkuar ndryshimet në perceptimet e menaxhimit të klasës dhe besimet në termat demografik: mësues me trajnime të ndryshme dhe mosha të ndryshme, mësues me pak eksperiencë dhe me shumë eksperiencë, karakteristikat e personalitetit të mësuesve, klasa ku kanë dhënë mësim, gjinia, gjeografia e mësuesve etj. Për shembull, Martin dhe Baldwin (1992) gjetën se mësuesit me pak vite eksperiencë pune ndryshojnë dhe ndikohen nga mësuesit me më shumë eksperiencë pune, për sa i përket besimeve në disiplinë. Mësuesit me pak eksperiencë pune janë më të durueshëm, ndajnë përgjegjësinë dhe ndërveprojnë me studentët e tyre (Martin dhe Baldwin, 1992)., ndërkohë që mësuesit me më shumë eksperiencë tentojnë të veprojnë në një mënyrë që insiston në sjelljen e duhur, duke përdorur procedura të mbarimit të kohës, ndëshkimi i nxënësve, etj. Kështu këto gjetje ilustrojnë se si qëndrimet e mësuesit bëhen pesimiste dhe kontrolluese. Kërkuesit besonin se ky ndryshim vjen ndoshta se mësuesit më me shumë eksperiencë janë më shumë ndërhyrës, sepse ata perceptojnë presionin e jashtëm dhe qasjen e kontrollit të situatave në klasë (Martin dhe Baldwin, 1992). Për sa i

përket lokusit të kontrollit, mësuesit me shumë eksperiencë merrnin pikë më shumë sesa mësuesit me pak eksperiencë. Duket se vitet e eksperiencës mund të influencojnë perceptimet e mësuesve në stilin e menaxhimit të klasës, ndërsa lokusi i kontrollit mund të jetë faktori sekondar (Martin dhe Baldwin, 1993).

Martin dhe Baldwin (1994) sugjeruan se rezultatet e tyre mund të theksojnë se vetë eksperiencat e mësuesve me pak vite eksperiencë punë mund të influencojnë perceptimin e tyre për menaxhimin e klasës më shumë se eksperiencat e tyre në pjesën e praktikës së punës. Mësuesit me më shumë eksperiencë mund të kenë modifikuar besimet e tyre dhe praktikat për të korresponduar ndaj realiteteve të veçanta të mësimdhënies dhe aftësive të mësuar nga profesioni.

Për sa i përket besimeve të menaxhimit të klasës, mësuesit kanë bindje të ndryshme. Martin, Baldwin, dhe Yin (1995,) kur studionin karakteristikat e personalitetit të mësuesve në lidhje me stilin e menaxhimit të klasës, kanë zbuluar se mësuesit që ishin më shumë ndërhyrës dhe kontrollues në menaxhimin e klasës shpesh ishin më pak aventurierë dhe frenues, më praktikë dhe më të mprehtë dhe të vetëdijshëm për konvencionet shoqërore. Marrëdhëniet e ndjeshme midis karakteristikave të personalitetit dhe stilit të menaxhimit në klasë ishin pozitive dhe negative sipas shkallës së përdorur, dhe në përputhje me modelet e pritshme bazuar në hulumtimet e kaluara (Martin, Baldwin, dhe Yin, 1997). Sharma (1980) në studimin e tij ka treguar se çdo mësues ndryshon nga tjetri në lidhje me zhvillimin e tipit të menaxhimit. Disa mësues ndikuan te nxënësit e tyre me anë të strategjive demokratike, ndërsa të tjerët e bënë këtë duke i dhënë liri nxënësve të tyre në një shkallë që ata të veprojnë sipas zgjedhjeve të tyre. Ajo iu referua këtyre dy stileve të udhëheqjes si dallime të personalitetit.

Ndërsa, Henson, Bennett, Sienty, dhe Chambers (2002) ekzaminuan llojet e personalitetit të mësuesve si predikues të

menaxhimit të klasës dhe të besimeve për vetefikasitetin. Analiza e të dhënave tregoi se ekzistonte një marrëdhënie e kufizuar ndërmjet personalitetit dhe menaxhimit të klasës dhe besimet mbi efikasitetin.

Për sa i përket gjinisë, Martin, Yin, Baldwin (1997) raportuan se nuk kishte ndryshime të mëdha ndërmjet mësuesve meshkuj dhe femra në lidhje me qëndrimet dhe besimet e tyre mbi kontrollin e klasës. Vendosja e mësimdhënies (rurale apo urbane) ishte më shumë evidente si faktor sesa faktori gjinor në përcaktimin e besimeve të stilit të menaxhimit në klasë në nivelin e shkollës së mesme, duke dhënë më shumë se një ndryshim (Martin, Yin, Baldwin, 1997).

Ndërkohë që po bënin kërkime për moshën, Martin dhe Shoho (2000) hipotetizuan se mosha mund të llogaritej si një ndryshim në lidhje me stilin e menaxhimit në klasë. Ata zbuluan se mësuesit me diplomat tradicionale dhe pjesëmarrësit në programin e ciklit të dytë të studimeve rezultuan më ndërhyrës se sa mësuesit praktikantë. Martin dhe Shoho gjetën se me kalimin e kohës, besimet dhe qëndrimet e mësuesve ndaj menaxhimit të klasës bëhen më kontrolluese; ata supozojnë gjithashtu se shumica e mësuesve të vjetër kishte të ngjarë të ishin prindër. Ata spekulojnë nëse përvoja e mësimdhënies apo përvoja e jetës janë apo jo shkaktare në ndryshimin e qëndrimeve të mësuesve. Martin dhe Shoho, gjithashtu, janë në dyshim nëse mësuesit që janë prindër e drejtojnë klasën ndryshe nga ata që nuk janë prindër. Ata arrijnë në përfundimin se gjatë disa viteve të fundit ka ndodhur një ndryshim te njerëzit që hyjnë në programet e përgatitjes së mësuesve; ato janë më në moshë dhe më të ndryshëm. Martin dhe Shoho (2000) gjetën se përvojat praktike në klasë bëjnë ndryshimin në perceptimet dhe besimet e mësuesve. Sa më i pasur trajnimi në terren, aq më i dobishëm do të jetë për mësuesit fillestarë kalimi nga idealizmi në realizim, duke i edukuar ata me ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet asaj që mësuesit besojnë që dinë dhe çfarë në të vërtetë ndodh në

klasat e vërteta. Kjo mund të përfshijë ofrimin e më shumë përvojave në sfidimin e klasave në mënyrë që mësuesit fillestarë të kenë mundësi për të menaxhuar situata të ndryshme të cilat nuk janë diskutuar shpesh në programet e përgatitjes së mësuesve.

Përfundime

Kërkimet kanë treguar se ekziston një marrëdhënie mes besimeve të mësuesve, praktikave të edukimit dhe arritjes së nxënësve. Marrëdhëniet mes perceptimeve të mësuesve për menaxhimin e klasës dhe besimeve të tyre gjithashtu janë studiuar.

Kërkuesit kanë dokumentuar ndryshimet në besimet e vetefikasitetit të mësuesve në stadi të ndryshme të karrierës së tyre profesionale. Shumë kërkime kanë treguar se besimet e vetefikasitetit janë të larta te mësuesit të cilët akoma nuk kanë filluar punë dhe kjo ndjenjë, vetefikasiteti, bie, shpesh në mënyrë drastike, gjatë vitit të parë të mësimitdhënies.

Një gjetje në këtë rishikim të literaturës është fakti se të gjithë studimet mbi besimet e mësuesve të lidhura me një variabël të caktuar dëshmojnë mbi ndikimin e besimeve të mësuesve në formimin e kontekstit shkollor, kontekst i cili ndikon dhe aktivitetet instruktuese në shkollë. Gjithashtu, përfundohet se natyra kontekstuale e besimeve ka një rëndësi të veçantë dhe se besimet e mësuesve nuk zhvillohen në boshllëk, më tepër ata ndërtohen përmes ndërveprimeve me të tjerë në shkollë dhe, si të tillë, ata formojnë dhe formohen nga besimet e mësuesve dhe nga eksperiencat e tyre.

Referenca:

Clandinin, D. J. (1986). Classroom practice.

Henson, R. K., Bennett, D. T., Sienty, S. F., & Chambers, S. M. (2002). The relationship between means-end task analysis and context specific and global self-efficacy in emergency certification teachers: Exploring a new model of self-efficacy. *The Professional Educator*

Laut, J. (1999, October). Classroom management: Beliefs of preservice teachers and classroom teachers concerning classroom management styles.

Martin, N. & Baldwin, B. (1992). Beliefs regarding classroom management style: The differences between pre-service and experienced teachers.

Martin, N. & Baldwin, B. (1994). Beliefs regarding classroom management style: The differences between novice and experienced teachers.

Martin, N. & Yin, Z. (1997). Attitudes and beliefs regarding classroom management style: Differences between male and female teachers.

Martin, N. K. & Baldwin, B. (1993). Validation of an inventory of classroom management style: Differences between novice and experienced teachers. Vol.5, No.2 American Educational Research Association, Atlanta, Georgia, April.

Martin, N., & Shoho, A. (2005). Teacher experience, training, and age: The influence of teacher characteristics on classroom management style. ERIC Document Reproduction Service No. ED 440963.

Nespor, J. (1987). The role of beliefs in the practice of teaching. *Journal of Curriculum Studies*, 19

Richardson, V. 1996. The role of attitudes and beliefs in learning to teach. In J. Sikula (Ed.), *Handbook of Research on Teacher Education*. New York: Macmillan.

ERALDA ZHILLA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

LORETA MAMANI

Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastër

**TË DHUNSHME APO TË DHUNUARA?
ANALIZË PSIKOSOCIALE E GRAVE QË
KRYEJNË KRIME TË DHUNSHME**

ABSTRACT

This article reviews the literature concerning the impact of exposure to domestic violence. The first is the importance of distinctions among types or contexts of violence. Some distinctions are central to the theoretical and practical understanding of the nature of partner violence, others provide important contexts for developing more sensitive and comprehensive theories, and others may simply force us to question our tendency to generalize carelessly from one context to another. This review finds that women living with domestic violence are at increased risk of experiencing emotional, physical and sexual abuse, of developing emotional and behavioral problems and of increased exposure to the presence of other adversities in their lives. It also highlights a range of protective factors that can mitigate against this impact, in particular a strong relationship with and attachment to the others.

The study has also analyzed which are the main factors that encourage women to act in violence. It is concluded that women in the Albanian society are violent, by being the victim of violence themselves. Women also exert violence against men mainly to self-defense because most women are the ones who violate women.

1. Hyrje

Në këtë studim analizohen çështje të dhunës gjinore duke u nisur nga teza se dhunë ushtrojnë si meshkujt, ashtu dhe femrat. Qëllimi i punimit është të shqyrtohet në një këndvështrim psikosocial dukuria e përdorimit të dhunës nga gratë veçanërisht në shoqërinë shqiptare. Objektivat kryesore të studimit janë : Të përshkruhen qëndrime të autorëve të ndryshëm në lidhje me dhunën me bazë gjinore, të shqyrtohen shkaqet dhe motivet që i nxisin femrat të reagojnë në forma të dhunshme si dhe të analizohen qëndrimet shoqërore ndaj kësaj dukurie.

Duke shfletuar literaturën, vihet re se ekzistojnë dy qëndrime kryesore : qëndrimi sipas të cilit gratë reagojnë dhunshëm kryesisht për t'u vetëmbrojtur, për t'u hakmarrë ndaj ndonjë padrejtësie (Totten, 2000 : 51 ; Campbell, 1993 : 140) dhe qëndrimi sipas të cilit gratë janë po aq të dhunshme sa edhe burrat, por shoqëria ka mitizuar tipare të tilla femërore si dhembshuria, brishtësia, butësia, pafajësia dhe ka krijuar stereotipe dhe mbrojtje të ndryshme për femrat që dhunojnë dhe nuk lejon që gratë të shihen si agresive, luftarake, të dhunshme etj. (Pearson, 1997 :7 ; Denfeld, 1997 : 72)

Duke përdorur si metodë të studimit intervistat e drejtpërdrejta, janë analizuar faktorët që nxisin femrat në ushtrimin e dhunës dhe është arritur në përfundimin se në shoqërinë shqiptare femra ushtron dhunë, duke qenë vetë viktimë e dhunës. Gjithashtu, gratë ushtrojnë dhunë ndaj burrave kryesisht për t'u vetëmbrojtur sepse më së shpeshti janë burrat ata që dhunojnë gratë. Moszbatimi i ligjislacionit në mbrojtje të grave të dhunuara, ngurtësia e shoqërisë për ta trajtuar dhunën në familje si problem të brendshëm, mentalitetet patriarkale, sipas të cilave gruaja është pronë e burrit apo vajza pronë e babait krijojnë një klimë të përshtatshme për të përlegjur dhunën e burrave ndaj grave. Në këto kushte gratë ndihen të frustruara dhe i përgjigjen dhunës me dhunë, duke arritur, madje, edhe në krime të dhunshme.

2. Rishikimi i literaturës

2.1. Analiza gjinore e dukurisë së dhunës

Supozimi sipas të cilit meshkujt janë më agresivë se femrat, është evidentuar vazhdimisht në situata dhe kultura të ndryshme. Në një studim të bërë për dallimet gjinore në agresivitetin e popullsisë në fëmijëri dhe në adoleshencë, Hyde gjeti se agresioni në nivel mbi mesatar takohet në 63% të rasteve të meshkujt dhe në 38% të rasteve të femrat (Hyde, 1986: 51-66).

Megjithëse meshkujt vazhdimisht janë përcaktuar si më agresivë pothuajse në të gjitha studimet, pavarësisht nga struktura e tyre dhe nga përkufizimi i përdorur, ka një numër faktorësh që ndikojnë tek magnituda e dallimeve gjinore. *Mosha e subjektit* është një faktor i rëndësishëm. Dallimet më të theksuara gjinore takohen mes fëmijëve të vegjël, kryesisht parashkollorë. *Lloji i dhunës së studiuar* është një faktor tjetër i rëndësishëm: dallimi më i madh gjinor gjendet te dhuna fizike krahasuar me dhunën verbale dhe atë psikologjike. *Projekti i studimit* është një tjetër faktor që ndikon në magnitudën e rezultateve, dallimet gjinore janë më të theksuara në studimet ku dhuna është spontane sesa në studimet ku dhuna matet në kushte eksperimentale (Basow, 1992:34).

Është e rëndësishme të diferencohet agresiviteti në sjellje, mundësia për të sulmuar si dhe prirja për të sulmuar. Megjithëse burrat duket se kanë një gatishmëri më të madhe për të reaguar në sjellje agresive dhe të dhunshme, ata prapëseprapë duhet ta mësojnë këtë lloj sjelljeje dhe të zgjedhin që ta përdorin atë. Albert Bandura ka treguar se vajzat i mësojnë sjelljet agresive pak a shumë në të njëjtën shkallë me djemtë, por janë më të tërhequra në realizimin e këtyre sjelljeve. Kur e lejon situata, edhe vajzat demonstrojnë të njëjtën shkallë agresioni si edhe djemtë (Bandura, 1973:57).

2.1. Perspektiva feministe për dhunën e ushtruar nga vajzat dhe gratë: ndikime të stereotipave

Dhuna në termat gjinore është parë vazhdimisht si dhunë që burrat ushtrojnë ndaj grave. Si rezultat, ligjet dhe programet ndërhyrëse janë fokusuar, së pari, në mbrojtjen e grave dhe në ndërgjegjësimin e burrave për pasojat e sjelljeve të tyre të dhunshme. Me pak vëmendje në këto programe u është kushtuar grave që ushtrojnë dhunë. Sidoqoftë, të gjitha shoqëritë në përgjithësi mbështesin mendësinë se çdo lloj sjellje agresive dhe e dhunshme është e dëmshme për shoqërinë. Perspektiva feministe mbështetet në pikëpamjen kulturore tradicionale sipas së cilës dhuna e ushtruar nga gratë është më pak agresive. Pra, shumë profesionistë që merren me çështjen e dhunës mes partnerëve, kanë tentuar ta shohin këtë çështje nga perspektiva e gruas si viktimë dhe të burrit si ushtrues i dhunës. Ndaj dhe dhuna e ushtruar nga gratë vazhdon të mos vihet re.

Duke qenë se pjesa më e madhe e denoncimeve të dhunës në organet policore bëhen nga ana e femrave dhe jo e meshkujve duket se ideja sipas të cilës meshkujt janë më të dhunshëm se femrat, konfirmohet edhe nga faktet. Por një analizë më e detajuar e kësaj dukurie tregon se ky kuadër bëhet më kompleks dhe jo gjithmonë ajo që është e dukshme shpjegon gjithçka. Historia njeh mjaft raste në të cilat gratë kanë qenë të dhunshme, madje, kanë shkaktuar dhunë serioze ndaj burrave. Le të përmendim këtu John Wayne, i rrahur nga bashkëshortja e tij Conchita Martinez, Humphery Bogat i rrahur nga gruaja e tij, Mayo Methot ashtu si dhe Abraham Lincoln-it, gruaja e të cilit i theu atij hundën me një copë druri (George, M., 1997:22).

2.3.Gratë dhunuese të bashkëshortëve në marrëdhënie familjare

Për shumë njerëz ideja e një gruaje që rreh apo dhunon burrin duket si një shaka. Mjaft studime pohojnë se shumë gra abuzojnë me burrat e tyre për t'u vetëmbrojtur si rrjedhojë e ndonjë debati të ashpër. Richard Gelles zbuloi se në shumicën e rasteve, gratë e kanë përdorur dhunën ekskluzivisht për vetëmbrojtje, sepse vetë

madhësia trupore dhe forca fizike e tyre në përgjithësi shkaktojnë më pak dëmtime sesa meshkujt dhunues (Gelles,1993: 14).

Në studimet kombëtare mbi dhunën në familje në SHBA (National Family Violence Surveys) të shtrirë gjatë viteve 1975-1985, zbulimi se brenda familjes gratë janë afërsisht po aq të dhunshme sa edhe burrat, ishte shumë i papritur (Straus, 1992: 223). Studimi i vitit 1975 zbuloi se norma vjetore e burrave që ushtronin dhunë ndaj partnerëve të tyre ishte 11.6 në 1000 individë dhe ajo e grave që ushtronin dhunë ndaj partnerëve të tyre 12.1 në 1000.

Ky zbulim u mbështet edhe nga zbulimi i vitit 1985, sipas të cilit normat vjetore ishin respektivisht 11.6 dhe 12.4. Kur bëhej fjalë për goditje ose sulme të ashpra, pesha specifike ishte 4.6 për qind për gratë dhe 5 për qind për burrat. Rezultatet e këtyre zbulimeve pajtohen edhe me rezultatet e mjaft studimeve të tjera (Straus & Gelles, 1990:45).

3. Metodologjia

3.1. Kampioni dhe instrumenti i studimit

Në Institutin e Ekzekutimit të Veprave Penale «Ali Demi» vuanin dënimin gjithsej 69 gra. Popullata e marrë në shqyrtim ishte e limituar, prandaj meqë studimi bazohet në një metodë cilësore, u shtri në të gjithë popullatën. Në procesin e intervistimit morën pjesë 68 gra, kurse njëra prej të dënuarave nuk pranoi të intervistohet.

Më poshtë është paraqitur një tabelë përmbledhëse e nivelit arsimor të grave që vuajnë dënimin penal në këtë institucion:


Tabela 1: Niveli arsimor i grave të dënuara në I.E.V.P “Ali Demi”

Pa arsim	Arsim fillor	Arsim 8 – vjeçar	Arsim i mesëm	Arsim i lartë
0 të dënuara	20 të dënuara	34 të dënuara	11 të dënuara	4 të dënuara

Nga 69 gra të dënuara në Institutin e Ekzekutimit të Veprave

Penale «Ali Demi», 67 gra janë të dënuara për herë të parë, ndërsa 2 janë recidiviste.

Në grafikun 1 janë paraqitur kategoritë moshore të të dënuarave. Siç vihet re nga grafiku, numri më i madh i të dënuarave i përket kategorisë 31-40 dhe 41-50 vjeç.



Duke iu referuar të dhënave të marra në Institutin e Ekzekutimeve të Dënimeve Penale “Ali Demi”, nga intervistat e drejtpërdrejta me të dënuarat atje, vihet re se nga 68 vajza dhe gra (të intervistuar) që vuajnë dënimin penal në këtë institucion, 32 prej tyre kanë pohuar se kanë kryer vrasje të bashkëshortëve ndërsa 36 të tjera kanë kryer vepra penale si vjedhje, mashtrim, trafikim lëndësh narkotike, trafikim fëmijësh dhe prostitucion.

Instrumentet matëse të studimit

68 intervista të drejtpërdrejta u zhvilluan me gra që vuajnë dënime penale në Institutin e Ekzekutimit të Veprave Penale «Ali Demi», në Tiranë. Ato kanë shpjeguar shkaqet që i kanë shtyrë të kryejnë krimet e dhunshme për të cilat janë dënuar, duke i ardhur në ndihmë këtij studimi. Përvojat e jetuara dhe historitë e përshkruara nga vetë ato mundësuan të kuptuarin e dukurisë më në thellësi.

Intervistat ishin individuale dhe kohëzgjatja e tyre mesatare ishte

15-20 minuta.

Si instrument për realizimin e procesit të intervistimit u përdor një pyetësor me pyetje të hapura. Pjesa e parë e pyetësorit synonte të merrte të dhëna personale të të dënuarave mbi moshën, vendlindjen, vendbanimin e mëparshëm, motivin e dënimit, nivelin arsimor.

Pjesa tjetër e intervistës u fokusua në arsyet e kryerjes së veprës penale, vetëperceptimin e të dënuarave mbi masën e dënimit, shkallën e fajësimit apo vetëfajësimit të tyre, krijimin e një situatë hipotetike se si do të vepronin të dënuarat nëse do të ktheheshin edhe një herë në momentin e ngjarjes si dhe vlerësimin e tyre të përvojës në këtë institucion izolimi.

4. Rezultatet - Shkaqet dhe motivet që i nxisin gratë të reagojnë në forma të dhunshme

4.1. Përdorimi i pijeve alkoolike dhe frekuentimi i lojërave të fatit nga burrat

Shpesh përdorimi i pijeve alkoolike dhe frekuentimi i lojërave të fatit nga burrat, përbëjnë motive të rëndësishme që nxisin mosmarrëveshjet në mjedisin familjar e që shpesh bëhen burime të përdorimit të dhunës. Kështu gruaja, vajza apo motra e keqtrajtuar nga një bashkëshort, baba apo vëlla i alkoolizuar, pasi akumulon shumë frustacion në vetvete, reagon dhunshëm ndaj mashkullit abuzues.

Një 41 vjeçare që vuan dënimin në Institutin e Ekzekutimeve të Veprave Penale “Ali Demi” Tiranë, në intervistën e drejtpërdrejtë tregoi “*Burri më rrihte sa herë vinte i dehur në shtëpi. Në gjendje të dehur, ai më godiste mua dhe fëmijët me ç’të gjente, rrip pantallonash, shqelma etj.*”,-. Më pas ajo tregon se për t’u vetëmbrojtur, pasi burri kishte marrë sëpatën për ta qëlluar, ajo ishte përpjekur të vetëmbrohej duke e qëlluar burrin me në kokë me të njëjtën sëpatë. Nga kjo goditje burri kishte vdekur.

4.2. Rikthimi në traditën shqiptare të zonave rurale

Gjithashtu, në shoqërinë shqiptare ka deri diku *një rikthim në traditën shqiptare të zonave rurale të para Luftës së Dytë Botërore*. Ky variabël u mor në konsideratë gjatë analizës së përdorimit të dhunës nga gratë dhe u vu re se në mjaft intervista, gratë në IEVP, «Ali Demi», e theksonin këtë si shkakun kryesor të mosmarrëveshjeve dhe grindjeve në familjet e tyre. Normat kulturore të kanuneve të zbatuara në zonat malore, si të thuash përlligjin dhunën e burrit ndaj gruas së tij. Kështu, për shembull, në “Kanuni i Lekë Dukagjinit” theksohet se «Burri ka tagër...me e rrahë e me e lidhë gruen e vet kur të mbrijë me ia përbuzë fjalën e urdhnit» (Gjeçovi, Sh., 1993: 36)

Kështu në pamje të parë gratë dhe vajzat në zonat rurale duken sikur i pranojnë më lehtë mendësitë patriarkale dhe kanunore, por ato në mënyrë të pashmangshme akumulojnë brenda vetes pakënaqësi dhe inate, mllefe dhe dëshira për t'i thënë «mjaft» këtyre mendësive. Dhe sa më shumë këto mendësi bëhen dhunuese për to, aq më shumë rritet pakënaqësia e grave ndaj burrave mbartës të këtyre mendësive dhe aq më shumë të ngjarë ka që ato të kundërpërgjigjen dhunshëm ndaj meshkujve me mentalitete të vjetër patriarkalë.

4.3. Motive xhelozie

Nuk janë të pakta rastet e dhunimit të grave prej burrave për *motive xhelozie*. Edhe sipas Raportit Botëror mbi Dhunën dhe Shëndetin në vitin 2002, konfliktet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet bashkëshortëve, që shpesh nxiten edhe nga ndjenja të xhelozisë, përbëjnë shkaqe të rëndësishme të ushtrimit të dhunës mes partnerëve (World Report on Violence and Health, 2002: 99). Sigurisht, kjo situatë shkakton reagime të fuqishme të atyre që e pësojnë këtë dhunë. Një pjesë e konsiderueshme e grave të intervistuar në IEVP “Ali Demi” në Tiranë gjatë intervistave të tyre kanë pohuar se xhelozia që bashkëshorti kishte ndaj tyre, si dhe

sjelljet që ai bënte i shtyrë nga kjo ndjenjë xhelozie, përbënin në mjaft raste shkakun kryesor të reagimit të tyre në formë të dhunshme dhe të kryerjes së veprës penale. Në mjaft raste ky variabël kombinohet edhe me variabla të tjerë si përdorimi i alkoolit nga ana e bashkëshortit dhe ushtrimi i dhunës nga ana e tij kundrejt bashkëshortes.

Ja si shprehet një 42 vjeçare nga Kurbini. “ *Burri im ishte një xheloz i sëmurë. Bëhej xheloz edhe për kushërinjtë i mij meshkuj. Ai ishte i çmendur nga xhelozia. Kjo ndoshta dhe e detyronte të pinte dhe ashtu i dehur, vinte e më rrihte. Nuk mbaj mend ndonjë ditë të lumtur nga martesë ime...* ”

4.4. Motive vetëmbrojtjeje

Sikurse u diskutua edhe më sipër, ideja se gratë reagojnë dhunshëm *për t’u vetëmbrojtur* përbën tezën më të njohur dhe më të përhapur nga feministët. Më sipër kemi parë se në lidhje me këtë ide ka pasur edhe qëndrime kundërshtuese, megjithatë debati qëndron më tepër në lidhje me masën, në të cilën kjo dukuri është shtrirë sesa në ekzistencën apo mosekzistencën e saj. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se një pjesë e konsiderueshme e grave ushtrojnë dhunë apo kundërpërgjigjen dhunshëm për t’u vetëmbrojtur.

Nga intervistat e drejtpërdrejta në Institutin e Ekzekutimit të Dënimeve Penale, u vu re se pjesa më e madhe e grave të intervistuara kishin kryer krime të dhunshme për t’u vetëmbrojtur. Kështu në raste të skajshme vrasja e ish-bashkëshortit të dhunshëm shihet nga gruaja si rrugë e vetme për të shpëtuar nga keqtrajtimi e për t’i dhënë fund mosmarrëveshjeve. Kësisoj gratë në Shqipëri janë nxitur nga rrethana të caktuara për të hyrë në rrugën e krimit kundër jetës së tjetrit (Dervishi, Z., 2001:67, 68).

4.5. Mbrojtje ndaj fëmijëve

Përveç vetëmbrojtjes, shumë femra përdorin forma të dhunshme edhe *për të mbrojtur fëmijët e tyre*. Të qenurit mbrojtëse ndonjëherë

nuk përbën thjesht një stereotip, por një karakteristikë që mund të kthehet në motiv madje për përdorimin e formave të skajshme të dhunës. Një sjellje e tillë duket normale kur mendojmë se si te kafshët, ashtu edhe te njerëzit një nga funksionet bazë të kujdesit prindëror është mbrojtja.

4.6. Motive të dobëta dhe hakmarrjeje

Raste të një dhune të pakuptimtë nga pikëpamja e arsyes së shëndoshë dhe normale janë dhe ato që pa pasur asnjë motiv vetëmbrojtjeje, shpërthejnë *për motive të dobta në formën e ndjenjave dhe të emocioneve të xhelozisë, hakmarrjes, sedrës së sëmurë* ose për motive të tjera të këtij lloji. Nga shtypi njohim raste flagrante, të cilat trajtojnë modele të një sjelljeje krejt mizore dhe të çrregullt nga pikëpamja psikike. Foshnja të lindura jashtë martese, të braktisura ose të goditura për vdekje nga nënat e tyre. Grua që për hakmarrje ose xhelozie copëton trupin e një fëmije me lidhje gjaku me ish-të dashurin e saj...(Fuga, A., 2005: 9). Kështu, ka dhjetëra raste kur hakmarrja e grave dhe vajzave shfaqet në formën e dhunës, madje, shpesh në formën e krimeve të dhunshme. Ka jo pak njerëz që mendojnë se gratë janë më hakmarrëse sesa burrat e mjaft të tjerë që pranojnë se forca hakmarrëse e grave është shumë herë më e fuqishme se forca hakmarrëse e burrave.

4.7. Çështje të pronësisë

Teoricienë të konfliktit theksojnë se *çështjet e pronësisë* janë ndër më delikatet dhe më të vështirat për t'u zgjidhur me metodën e ndërmjetësimit. Nga traditat kanunore, çështjet që kanë të bëjnë me pronën zgjidheshin gjithmonë nga burrat dhe gratë nuk kishin të drejtë të përziheshin në to. Mirëpo jo gjithmonë gratë janë indiferente ndaj këtyre çështjeve.

Në mjaft raste të tjera gratë kryejnë mashtrime në lidhje me pronësinë. Një pjesë e konsiderueshme e grave të dënuara në IEVP "Ali Demi" janë dënuar për mashtrime që lidhen me pronësinë, psh me hipotekimin e banesave. Nga 2 intervista të marra gratë kanë

shpjeguar se në këndvështrimin e tyre ato kanë qenë të shtyra të mashtrojnë të detyruara nga kushtet e vështira ekonomike në të cilat ndodheshin.

4.8. Faktorë ekonomikë

Sigurisht *gjendja e vështirë ekonomike* është një arsye që çon në kryerjen e veprave penale në rrethana të caktuara. Në përgjithësi, për sa kohë ekziston një vartësi ekonomike e gruas nga burri, për aq kohë burri do të zotërojë një “licensë” për të ushtruar dhunë ndaj gruas. Në fakt vihet re se kur gruaja siguron një pjesë të të ardhurave të ekonomisë familjare, ajo gëzon një status më të lartë dhe “licensa” e burrit për të ushtruar dhunë ndaj saj fillon e humbet forcën.

4.9. Nxitje nga burrat për t’u përfshirë në krime të dhunshme

Nëse një grua është e përfshirë në një krim të dhunshëm, ajo përgjithësisht është e përfshirë në një marrëdhënie të dhunshme dhe të tensionuar (Brandwein, 1998: 42). Rasti i Bonnie and Clyde të cilët u vranë në 1930-ën, është ndër rastet më të njohur të grave bashkëpunëtore të burrave në krimet e dhunshme në SHBA. Vrasja e bashkëshortëve nga gratë në bashkëpunim me të dashurit e tyre, është një dukuri jo pak e përhapur. Në IEVP Ali Demi, Në Tiranë, u identifikua rasti i një 42 vjeçareje nga Berati e cila kishte vrarë bashkëshortin në bashkëpunim me të dashurin.

4.10. Përfshirje në krimin e organizuar

Në IEVP, "Ali Demi" u identifikuan disa raste të grave të dënuara për trafikim të lëndëve narkotike apo për trafikim fëmijësh. Të dhënat e mbledhura dëshmojnë që këto gra janë përfshirë në një rrjet krimi të organizuar dhe janë përpjekur të shfrytëzojnë stereotipin shoqëror, sipas të cilit burrat ka të ngjarë të merren me trafikim, ndërsa gratë jo. Gjatë intervistës një 34 vjeçare nga Elbasani, e dënuar për trafikim fëmijësh phon: " *Unë fajësoj drejtësinë. Kam marr një gjykim të padrejtë. Jam akuzuar nga*

autoritetet greke për trafikim të fëmijës së komshiut tim. Në Shqipëri jam gjykuar në mungesë. Asgjë nuk ka qenë e vërtetë. Unë atë fëmijë e kam dashur si fëmijën tim..."

5. Përfundime dhe rekomandime

5.1. Përfundime

Dhuna dhe agresiviteti janë karakteristika të sjelljes njerëzore që lipset të mos trajtohen me termat gjinorë. Fakti nëse gratë apo burrat janë më të dhunshëm në një shoqëri lidhet ngushtë me mënyrën se si kjo shoqëri ka përcaktuar rolet gjinore, role këto që modelojnë sjelljet gjinore. Edhe nëse ekziston një prirje biologjike sipas së cilës burrat janë më agresivë dhe më të dhunshëm se gratë, shoqëria ka në dorë të luajë një rol përforcues apo zbutës të këtyre karakteristikave. Përgjithësisht vihet re se sa më i fortë të jetë mentaliteti patriarkal në një shoqëri, aq më e prirur është kjo shoqëri të përkrahë dhe të motivojë burrat për të qenë të pushtetshëm, qoftë edhe duke përdorur forcën.

Në shoqërinë shqiptare një mentalitet i tillë ndihet në të gjitha sferat shoqërore. Megjithatë shpesh, duke pasur parasysh këtë, lihet pa trajtuar fakti se dhe gratë janë në gjendje të ushtrojnë dhunë, madje, gati në të njëjtat forma si burrat.

Sikurse u tha në fillim nga 69 gra të dënuara në Institutin e Ekzekutimit të Veprave Penale «Ali Demi», 67 gra janë të dënuara për herë të parë, ndërsa 2 janë recidiviste. Numri i vogël i grave që përsërisin kryerjen e veprave penale është domethënës dhe na le të besojmë se veprat që ato kanë kryer kanë qenë nxitur nga kushte specifike motivacionale.

Sigurisht miti dhe stereotipi që shoqëron gratë si qenie të brishta, të përkujdesshme, paqësore dhe mbrojtëse, shpesh kthehet në justifikim dhe mbrojtje për to. Kjo është një nga arsyet më të forta pse shpesh studimet fokusohen në trajtimin e dhunës të ushtruar nga meshkujt dhe lenë pas dore atë të ushtruar nga gratë. Megjithatë,

pavarësisht nga këto që u përmendën më lart, kur bëhet fjalë për dhunën që gratë ushtrojnë ndaj burrave në Shqipëri, arsyeja kryesore është vetëmbrojtja apo mbrojtja e fëmijëve.

5.2. Rekomandime

Duke lexuar artikullin e mësipërm, të krijohet përshtypja se shoqëria shqiptare ka mbetur disi prapa në rrugën e emancipimit dhe të zgjidhjes së konflikteve me forma dhe mënyra paqësore. Në fakt, edhe në vende shumë të zhvilluara e të emancipuara mjaft konflikte dhe mosmarrëveshje zgjidhen me mjete të dhunshme, shpesh brutale.

Një rekomandim i vlefshëm nga ky studim ka të bëjë me ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi rëndësinë e zgjidhjes së konflikteve me forma paqësore. Frustacioni nuk duhet lënë të akumulohet, sepse nëse ndosh kështu, patjetër ky akumulim do të shoqërohet me shpërthime të dhunshme dhe irracionale, qoftë nga gratë, qoftë nga burrat.

Gratë në një shoqëri ende patriarkale, siç është Shqipëria, vazhdojnë të vuajnë peshën e sundimit të burrit dhe kur vuajtjes i vjen fundi, ato shpërthejnë në akte të dhunshme. Që të evitohen këto reagime, është e nevojshme që gratë dhe burrat t'i drejtohen profesionistëve, psikologëve, punonjësve socialë, avokatëve, organeve mbrojtëse shtetërore etj. që të sigurojnë mbrojtjen dhe orientimin e duhur.

Nga ana e tij shteti duhet të garantojnë mbrojtjen e nevojshme ndaj personave që ndihen të dhunuar, qofshin këto gra apo burra, vajza apo djem. Në Shqipëri, një nga arsyet kryesore që nxit vetëgjyqësinë dhe përdorimin e dhunës, si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat, është moszbatimi i ligjit. Në këto rrethana bëhet domosdoshmëri zbatimi me korrektësi i legjisllacionit në fuqi dhe përmirësimi i tij. Aty ku funksionon ligji, edhe njerëzit vetëdijësohen më natyrshëm

6. Bibliografia

Bandura, A.: *Aggression: A Social Learning Analysis*, Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, 1973.

Basow, S., A.: *Gender: Stereotypes and Roles*, Brooks/Cole Pub Co, Florence, Kentucky, U.S.A. 1992.

Campbell, A., *Men, women and aggression*, New York / London: Basic Books / Harpercollins.1993.

Denfeld, [Rene](#): *Kill the Body, the Head Will Fall: A Closer Look at Women, Violence, and Aggression (Hardcover)*, Warner Books Inc, February 1997.

Dervishi, Zyhdh: *Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva*, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë 2001.

Gelles , R.J., & Cornell, C.P.: *Intimate Violence in families*. Beverly Hills: Stage 1985.

George, Malcolm [J.](#): *Into the eyes of Medusa: beyond testosterone, men, and violence*. [Journal of Men's Studies, May 1997](#).

Gjeçovi, Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*.Tiranë. 1993.

Hyde J. S.: *The Psychology of gender : Advances through meta-analysis, Gender differences in aggression*. J.S Hyde & M.C Linns (Eds.), Baltimore : Johns Hopkins University Press.1986.

Pearson, Patricia: *When She Was Bad...: Violent Women and the Myth of Innocence*, New York, Viking, 1997.

Straus, M.A: *Sociological Research and Social policy: The case of family violence*. Socological Forum 7 , 1992.

Totten, Mark : *Guys, Gangs and Girlfriend Abuse*, Broadview Press, January 2000.

ARBEN GABA

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër,

**ENGLISH AND ALBANIAN SOMATIC IDIOMS
ACCORDING TO CONCEPTUAL
PHRASEOLOGICAL FIELDS**

ABSTRACT

In addition to serving as simple repositories of words, languages are first and foremost repositories of cultures. Such a comprehensive notion comprises shared cultural symbols, values, information, experience, and point of view which are encoded in various ways using word sequences resting on a specific, rich and complex cognitive platform. In this paper we try to compare somatic idioms in English and Albanian from a conceptual point of view. Although these languages are distant in space and in terms of their general linguistic architecture they do have similarities when it comes to idioms. Their different mindsets seem to converge, at least at times, when it comes to giving a linguistic form to their inner cognitive mechanism. Such convergence is best reflected in idioms with the same form and meaning. Our sample of idioms is extracted both from monolingual and bilingual Albanian and English phraseological dictionaries.

Keywords: *somatic idioms, connotation, conceptual field, English, Albanian*

Introduction

Since its inception in the beginning of the 20th century as a field primarily concerned with the study of word sequences from a structural point of view, today it is seen as a discipline of an interdisciplinary character. Several researchers approach it from different angles. For example, J. R. Firth, and his followers Michael Halliday and John Sinclair. Sinclair (1989), (1991), (1994) played a great role in developing corpus linguistics and the production of dictionaries in England (A. P Cowie: 1998).

As to Gläser (1986) we can say that her work “ is a meeting point of many phraseological approaches. It has made a great contribution to our understanding of multiword units in language serving special purposes, and to the problem of the translation of idioms and collocations in a foreign language (...) her deep analysis gives proof of the stylistic sources of the phrasal dictionary and offers a lot of support for her theory of a discipline of 'phraseo-stylistics' which means the study of phraseology from a stylistic perspective”. (A. P Cowie: 1998).

The underlying theme which unites the researchers all over the world today is the culture-boundness character of its object of study, Piirainen (2008, 2011), Colson (2008), Sabban (2008), Pamies (2011), Szerszunowicz (2011), Holandi (2011), Al Jallad (2011), Arboe (2011) and many others.

Phraseology has always been developing as a discipline of many interconnected approaches and the 1990s saw the rise of a new approach to the investigation of idioms – the linguo-cultural study of phraseology.

At this point we would like to emphasize that the origins of analyzing phraseology in a culture-oriented perspective lie in the linguo-cultural approach developed by Veronika. As Cowie writes:

“A second strand can be described as broadly anthropological and is represented here by the contribution of Veronika Teliya and her colleagues, which proposes an extension of the Russian phraseological tradition to embrace the cultural dimension. They argue persuasively that this element must be elaborated in all its richness and complexity if the phraseology of a language is to be fully described and understood. (Cowie 1998: 2)

Drawing upon an exceptionally wide range of Russian examples, Veronika Teliya and her colleagues develop a conceptual framework for describing cultural data as represented in the meanings of multiword units. They argue that phraseology is a particularly fruitful point of focus for ‘linguo-cultural analysis’ (Cowie 1998: 8)

This line of research was picked up more or less at the same time or even sooner by albanian scholars. In her paper “The albanian phraseology with body-part terms” Sofika Morcka writes “The great similarity of phraseological parallels of albanian on one hand with some languages of the Balkans and french and italian on the other does not explain the fact that they all come from a common source, e.g. from the indo-european language, as it is stated by J. Thomaj and Xh. Lloshi, or from the coexistence and the neighbourliness of the people of the Balkans. Somewhere there can even be polygenesis, because there are parallels which exist in indo-european languages but there are also of those which transcend their boundaries and which are related with the status of development of the peoples in certain historical conditions. E.g. Turkish although it is a uralo-atlaic language, it has a number of common expressions with the languages of the Balkans and other languages .” (S. Morcka 1979: 92)

In addition to being clearly distinct from one another in terms of the body-part term which they utilise, idioms fall into distinct categories also in terms of the connotations they carry. Here we give some main fields which are generally related with the sphere of

thinking and the spiritual one, because the idiom as we know is a unit which carries figurative transformation and whose main trait is connotation. That is why the phraseological fields of English and Albanian which are motivated by body parts are conceived of according to the treatment of this trait of the words is first ideated by the scholar Jani Thomai. He writes “one ingredient of the lexical content of the word is also the emotional colouring. It gives the word the ability to express the attitude of the speaker to what is being talked about, how he/ she evaluates this (with love, endearment, admiration, disregard, ridicule, contempt etc.). The emotional colouring is varied, with numerous and subtle nuances, as are the feelings of the man. But in a general division we distinguish two kinds of emotional colourings: *positive* emotional colouring (approving: love, admiration, joy, enthusiasm, pleasure, endearment, amazement, optimism, pride, gratitude, approval, support, longing, pity, compassion, kindness, friendship, commendation, felicitation, wish, determination, patience, wisdom, faith, loyalty, obedience, desire, prayer, exhortation etc.) and *negative* emotional colouring (pejorative: hatred, disdain, anger, abhorrence, derision, irony, grief, sadness, boredom, annoyance, neglect, suspect, displeasure, disappointment, rebuke, threat, swearing, diffidence, disobedience, pessimism, hypocrisy, enmity, aversion, envy, jealousy etc.). In the range of emotional colourings are included also other attitudes and feelings (fear, horror, pain, shyness, frankness, passion, joke, wonder etc.).” (J. Thomai 2008: 57)

The aim of our paper is to attempt a categorization of English idioms and their Albanian counterparts containing body-part terms according to the conceptual phraseological fields they belong to and to what degree the English idiom has an Albanian equivalent.

Conceptual field related to enmity¹

*cut each other's (one another's) **throat**- (pres **fytin** njeri tjerit)-i hanë **kokën** njëri tjetrit*

*draw **blood** 1. – (tërheq **gjak**) gjakos. 2. zemëroj ose fyej.*

Conceptual field related to manliness

*keep a stiff upper **lip** –(mbaj një **buzë** të sipërme të tendosur) qëndroj i fortë, tregoj burrëri, nuk e lëshoj veten, tregohem (mbahem) burrë*

Conceptual field related to maturity

*have an old **head** on young **shoulders** –(ka një **kokë** të vjetër mbi **supe** të reja) është më i pjekur për vitet (moshën) që ka.*

Conceptual field related to frankness

***hand** over **heart** –(dorë mbi **zemër**) me **dorë** në **zemër**, çiltërsisht, ndershmërisht.*

Conceptual field related to love

***apple** of one's **eye** –(molla e **syve** të dikujt) **drita** e **syve**.*

Conceptual field related to endearment

***chuck** sb under the **chin** –(lëmoj dikë poshtë **gushës**) cek, lëmoj **gushën** e (në shenjë përkëdheljeje, dashurie etj.)*

Conceptual field related to laziness

*let the grass grow under one's **feet** –(le barin të rritet ndënë **këmbë**) rri **duarlidhur** (duarkryq).*

Conceptual field related to good luck

¹ Every English idiom is followed by its literal Albanian translation, and the corresponding Albanian idiom. The idioms in both languages are in italics and the body-part term in bold. Literal translations are in brackets and in normal.

fall on one's feet – (bie në **këmbë**) bie në këmbë, shpëtoj shëndoshë e mirë, dal pa lagur, *s'më hyn gjemb në këmbë*.

by a hair/a hair's breadth – (për gjerësinë e një fije **floku**) për një qime, *për një fije floku*, për pak.

Conceptual field related to fear

break out in a cold sweat – (shpërthej në një **djersë** të ftohtë) *më shkojnë (më dalin, më mbulojnë) djersë të ftohta*.

have one's tail between one's legs – (kam bishtin në mes të **këmbëve**) mbledh **bishtin**.

jump out of one's skin – (hidhem jashtë **lëkurës**) *hidhem përpjetë (nga frika, habia etj), trembem, habitem pa masë*.

chill sb to the bone/marrow/spine; chill sb's spine/marrow – (ftoh dikë deri në **palcë**) bëj t'i shkojnë mornica në trup (nga të ftohtit, nga frika etj.); bëj t'i hyjë frika (të ftohtit)

Conceptual field related to courage

take heart – (marr **zemër**) *marr zemër*, marr guxim.

make no bones about – (nuk bëj **kocka** përreth) nuk hezitoj, nuk më vjen zor; pranoj menjëherë; them hapur (pa hezitim).

Conceptual field related to sobriety

keep a cool/level head – (mbaj një **kokë** të ftohtë/ në nivel) *mbaj (ruaj) gjakftohësinë*, nuk e humb toruan.

Conceptual field related to indifference

close one's eyes to – (mbyll **sytë** para) *mbyll sytë para*.

close one's ear to – (mbyll **veshin** ndaj) *bëj veshin e shurdhër, nuk i'a vë veshin*.

turn a blind eye to sth – (kthej një **sy** qorr ndaj diçkaje) *bëj një sy qorr*.

turn a deaf **ear** to –(kthej një **vesh** të shurdhër) *bëj veshin e shurdhër.*

turn one's **back** -iki, largohem, *kthej krahët.*

turn one's **back** on sb -i kthej *krahët* dikujt.

Conceptual field related to stubbornness

dig one's **heels/toes** in – (gërmoj *thembrat* brenda) ngul *këmbë* si mushkë.

Conceptual field related to joy

after one's own **heart**- (pas *zembrës* së njerit) siç më pëlqen, *si ma do zemra.*

feast one's **eyes** on – (kullot *sytë* mbi) kullot *sytë*, kënaqet duke parë.

laugh one's **head** off –(qesh *kokën*) *qesh me gjithë zemër*, qesh me të madhe, shkulem së qeshuri.

Conceptual field related to pride

blue **blood** – (*gjak* blu) *gjak* fisnik, *derë (prejardhje) fisnike.*

carry one's **head** high – (mbaj *kokën* lart) jam krenar, mbaj *kokën* lart.

Conceptual field related to wariness

all **ears/eyes** – (gjithë, tërë *sy e veshë*) *gjithë, tërë sy e veshë.*

walls have **ears** – (muret kanë *veshë*) muri ka *veshë*; fusha ka *sy* e muri ka *veshë*.

Conceptual field related to remembrance

bring somebody/ something to **mind** – (sjell dikë /diçka ndër *mend*) kujtoj, *sjell ndër mend.*

call somebody/ something to **mind** – (sjell dikë /diçka ndër *mend*) *sjell ndër mend.*

cast your **mind** back (to something) –(hedh mbrapa **mendjen**)
kujtoj, sjell ndër **mend**.

have a corner in sb's **heart** –(kam një qoshe në **zemër**) ruaj të
gjallë në **zemër**.

be etched on your **heart/memory/mind**- (është e gdhendur në
zemër/kujtesë/mendje) gdhend në **zemër/ kujtesë/ mendje**

Conceptual field related to duress

force sb's **hand** – (detyroj **dorën** e dikujt) detyroj (shtrëngo)j
dikë të veprojë pa dëshirë.

Conceptual field related to deceit

lie through one's **teeth** –(gënjej nëpërmjet **dhëmbëve**) gënjej **sy**
për **sy**, gënjej pa pikë turpi.

lie one's **head** off –(gënjej **kokën**) kërdis me gënjeshtër.

do sb in the **eye** 1. (Bëj dikë në **sy**) mashtroj, i'a hedh **sy** për **sy**.

2. fytej, poshtëroj.

Conceptual field related to immaturity

have one's **head** in the clouds –(ka **kokën** në re) i fluturon
mendja; sheh ëndrra me **sy** çelë.

Conceptual field related to mockery

thumb one's **nose** at – (tregoj **hundën** dikujt) ngërdheshem,
përqesh, i nxjerr **gjuhën** dikujt.

2. të tregosh që ti nuk respekton dikë ose dicka.

Conceptual field related to conceitedness

have a big **head** – (ka një **kokë** të madhe) mendjemadh,
mburravec.

Conceptual field related to politeness

*keep a civil **tongue** in one's **head*** – (mbaj një **gjuhë** të qytetëruar në **kokë**) flas me mirësjellje (me respekt, njerëzishëm) me dikë.

Conceptual field related to ingratitude

*look a gift horse in the **mouth*** –(shoh një kalë dhuratë në **gojë**) i shoh **dhëmbët** kalit të dhuruar, i qes bishta gjësë së dhuruar.

*bite the **hand** that feeds one* –(kafshoj **dorën** që ushqen) *shkel bukën me **këmbë**, tregohem mosmirënjohës, i'a kthej të mirën me të keqe.*

Conceptual field related to naivety

*babe in **arms*** – (fëmijë në **krahë**) *foshnjë në pelena* (në shpërgënj), foshnjë e pamëkëmbur; njeri i pafajshëm, i pambrojtur.

2. një njeri naiv

*twist / wound sb around one's little **finger*** – (rrotulloj dikë përreth **gishtit** të vogël) e sjell vërdallë, e heq për **hunde**.

Conceptual field related to help

*lend sb a (helping) **hand** with sth* – (jap borxh dikujt një **dorë** ndihmuese) ndihmoj, *jap një **dorë**.*

*give/lend a (helping) **hand*** – (jap, jap borxh dikujt një **dorë** ndihmuese) ndihmoj, *i jap **dorën**, i jap një **dorë***

Conceptual field related to grief

*cry one's **eyes** out* – (qaj **sytë** jashtë) shkrihem së qari, shkrihem në lot.

*sob one's **heart** out* – (qaj **zemrën** jashtë) qaj me ngashërim, me dënesë.

Conceptual field related to inability

*bad / poor **hand** at sth* – (**dorë** e keqe/ e varfër në diçka) *dorëngathët, s'i vjen ndoresh.*

Conceptual field related to insolence

*carry/have/bear two **faces** under one hood* –(mbart, kam dy **fytyra** ndënë një kapuç) *jam njeri me dy **fytyra**, jam si mësalla me dy **faqe**.*

*have the **face/cheek** to do sth* –(ka **fytyrën/ faqen** të bëj diçka) *ka sy e **faqe**, ka paturpësinë të.*

Conceptual field related to inattentiveness

*go in (at) one **ear** and out (at/of) the other* –(shkon brenda në një **vesh** dhe jashtë nga tjetri) *i hyn në një **vesh** e i del nga tjetri.*

Conceptual field related to experience

*burn one's **fingers*** – (djeg **gishtat**) digjem, e pësoj.

Conceptual field related to control

*keep a tight **hand**/rein on sb* –(mbaj një **dorë/** fre të shtrënguar mbi dikë) *mbaj nën kontroll, nën mbikqyrje të rreptë.*

Conceptual field related to diligence

*break the **back** of* – (thyej **shpinën** e) *bëj (kryej) pjesën më të madhe, më të vështirë.*

*by the sweat of one's **brow*** –(me djersën e **vetullës**) *me djersën e **ballit**.*

*worked off one's **feet*** – (I punuar nga **shputat**) *këput nga **këmbët**, rraskapit, stërmundoj.*

*work one's **fingers** to the **bone*** –(punoj gishtat deri në **kockë**) *bie copë, robtohem sa s'ka ku të shkojë më.*

*keep one's **nose** to the grindstone* –(mbaj **hundën** në gur zmeril) *punoj pa pushim, punoj me këmbëngulje, s'ngre kokën nga puna.*

body and soul – (trup dhe shpirt) *tërësisht, me gjithçka, me gjithë **shpirt**, me gjithë hovin e **zembrës**, me të gjitha fuqitë*

Conceptual field related to respect

cap in hand – (skufje në **dorë**) me nderim, plot respekt (përulje, përunjësi).

Conceptual field related to flattery

hat in hand – (kapelë në **dorë**) gjithë servilizëm (përulësi, temena).

play into sb's hands – (luaj në **duart** e dikujt) *bëj lojën e dikujt, çoj ujë në mullirin e dikujt.*

Conceptual field related to illness

have one foot in the grave – (ka një **këmbë** në varr) *me një këmbë në varr.*

Conceptual field related to dishonesty

behind sb's back – (prapa **shpinës** së dikujt) *prapa shpinës së dikujt, prapa krahëve të dikujt.*

Conceptual field related to similarity

as like sb as if he (she) had been spit out of his (her) mouth - (si të ishte pështyrë nga **goja** e tij/ e saj) *sikur e ka nxjerrë (qitur) nga hunda.*

Conceptual field related to dumbness

have a thick head – (ka një **kokë** të trashë) 1. Është **kokë**trashë, është i trashë nga **mendja**,

2. e ka **kokën** të rëndë.

Conceptual field related to bravery

pluck up (one's) heart – (këpus **zembrën**) *marr zemër*, bëhem trim.

without turning a hair – (pa kthyer një fije **floku**) *pa iu dridhur qerpiku i syrit.*

keep a good heart – (mbaj një **zemër** të mirë) mbaj veten, *bëhem burrë*, tregohem trim.

take one's courage in both hands – (marr kurajën në të dyja **duart**) marr **zemër**, marr kurajë, bëhem burrë, tregohem trim.

Conceptual field related to death

yield one's breath – (jap frymën) jap **shpirt**.

wipe off the face of the earth/off the map – (fshij nga **faqja** e dheut/ hartës) fshij nga **faqja** e dheut.

blow one's brains out – (fryj **trutë** jashtë) hedh **trutë** në erë, vras veten (me plumb në **kokë**).

Conceptual field related to anger

box sb's ears – (qëlloj në **veshë**) qëlloj, i bie me shpullë (grusht).

foam at the mouth – (shkumëztoj, nxjerr shkumë tek **goja**) shkumëztoj, nxjerr shkumë nga **goja** (nga inati).

clench one's teeth/fists - (shtrëngo **dhëmbët** (grushtat)) shtrëngo **dhëmbët** (grushtat)

Conceptual field related to disappointment

a body blow – (një goditje trupi) zhgënjim i rëndë, goditje e rëndë, humbje e rëndë.

break one's heart – (i'a thyej **zembrën** dikujt) *i'a thyej zembrën dikujt, ia copëtoj zembrën, ia bëj zembrën copë*.

cut off one's nose to spite one's face – (këpus **hundën** të inatos **fytyrën**) *në vend që t'i vinte vetulla, i nxori sytë*.

Conclusions

In this paper we analysed the issue of phraseological meaning from a conceptual point of view, influenced by the connotation associated with our judgement on them which is implied in the idiom as a whole, taking English as our starting point. Although our corpus is small, it nevertheless is indicative of the larger picture

according to which English world view finds a counterpart (of various degrees of equivalence situated along a continuum) in Albanian world view.

As the examples show the same concept is realized in different ways in the languages under consideration. With the same cultural information channelled in and contributing to different surface thought expressions in the respective languages. Consequently, the same idea is ideated in different ways ranging from a somatic idiom in English having a perfect equivalent in Albanian, to an idiom in English being realized as an idiom in Albanian but with a different body-part term, to an English idiom being realized as a simple sentence in Albanian.

Equivalent idioms having the same body-part term in both languages although not many in number, exist. Also examples of partial equivalence where the same English idiom is expressed with an idiom in Albanian but a different body-part term are more numerous, followed by examples of zero equivalence where an English idiom is given as a sentence or even a single word in Albanian.

Our small-scale study has produced 43 conceptual fields that subsume 84 somatic idioms. These conceptual fields contain a variety of types of general cultural information based on the classification of life situations people find themselves in. The conceptual nature of somatic idioms is an inherent trait of them although not explored that much.

References

Al Jallad, Nader. 2011. A linguo-cultural study of “generosity” in Arabic. In: *Linguo-Cultural Competence and Phraseological Motivation*. Pamies, Antonio; Dobrovol'skij, Dmitrij (eds). Germany: Schneider Verlag Hohengehren. 233–240.

Arboe, Torben. 2011. Phraseological aspects of Jutlandic (western Danish). In: *Linguo-Cultural Competence and Phraseological Motivation*. Pamies, Antonio; Dobrovol'skij, Dmitrij (eds). Germany: Schneider Verlag Hohengehren. 349–357.

Colson, Jean-Pierre. 2008. Cross-linguistic phraseological studies: An overview. In: *Phraseology. An interdisciplinary perspective*. Granger,

Sylviane; Meunier, Fanny (eds). Amsterdam / Philadelphia: John Benjamins. 191–206.

Cowie, A. P. (ed.), *Phraseology. Theory, analysis, and applications*. Oxford: Oxford University Press. (1998)

Holandi, Rayna. 2011. Language symbolism in animalistic phraseology (a contrastive study on English and Bulgarian). In: *Linguo-Cultural Competence and Phraseological Motivation*. Pamies, Antonio; Dobrovol'skij, Dmitrij (eds). Germany: Schneider Verlag Hohengehren. 255–270.

J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 57

Pamies, Antonio. 2011. A propos de la motivation phraséologique. In: *Linguo-Cultural Competence and Phraseological Motivation*. Pamies, Antonio; Dobrovol'skij, Dmitrij (eds). Germany: Schneider Verlag Hohengehren. 25–39.

Piirainen, Elizabeth. 2008. Figurative phraseology and culture. In: *Phraseology. An Interdisciplinary Perspective*. Granger, Sylviane; Meunier, Fanny (eds). Amsterdam / Philadelphia: John Benjamins. 207–228.

Sabban, Annette. 2008. Critical observations on the culture-boundness of phraseology. In: *Phraseology. An interdisciplinary perspective*. Granger, Sylviane; Meunier, Fanny (eds). Amsterdam / Philadelphia: John Benjamins. 229–241.

S. Morcka, *Frazeologjia shqipe me gjymtyrë që emërtojnë pjesë të trupit të njeriut*, SF, 1979, 4, f. 92

Szerszunowicz, Joanna. 2011. On selected source domains of onomastic phraseology in a cross-linguistic perspective. In: *Linguo-Cultural Competence and Phraseological Motivation*. Pamies, Antonio; Dobrovol'skij, Dmitrij (eds). Germany: Schneider Verlag Hohengehren. 81–90.

Dictionaries

Cambridge Idioms Dictionary. 2006. 2nd edition. UK: Cambridge University Press.

Cambridge International Dictionary of Idioms. 1998. UK: Cambridge University Press.

Concise Oxford dictionary of English Etymology. 1993. Hoad, T. F. (ed.). Oxford: Oxford University Press.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980). Tiranë.

Fjalori i shqipes së sotme. (1984). Tiranë.

Ilo Stefanllari, *English-Albanian Dictionary of Idioms*, Hippocrene Books, Inc. New York, 2000

Longman Dictionary of English Idioms, Longman group limited 1979

Oxford Dictionary of Idioms, edited by Judith Siefring, Oxford University Press, 1999

Thomai, J.(1999). *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Shtëpia Botuese “Shkenca”, Tiranë.

Thesaurus of TRADITIONAL ENGLISH METAPHORS Second edition
P.R.WILKINSON, 2002

DANIELA QIQI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

**ASPEKTE TË BURIMEVE NJERËZORE NË
SEKTORIN TURISTIK**

ABSTRACT

Tourism is considered as a major social phenomenon of the modern society with major economic consequences. The tourism industry is globally recognized as a major economic contributor, employment generator and investment flows in this area are constantly growing. For these reasons, tourism development is considered as an instrument for economic growth in underdeveloped countries. Tourism is also estimated by the Albanian Government as one of the sectors with more impact on the expected, qualitative and quantitative development of Albanian economy. However, the growth of the tourism industry has created a number of problems in the field of human resource development. Now, in different countries, there is not a problem the lack of work, because in some cases the market demands exceeds its offer, but the problem lies in terms of HR quantity for developed countries and their quality for developing countries, given that the tourism product quality is mainly affected by the performance of employees. In this paper, significant potential for tourism development in Gjirokastra and several HRM issues that preoccupy the host structures operating in the region are highlighted. Also the paper provides some conclusions and recommendations to improve the role of HR in tourism sector development.

Key words: *HRM, tourism, hotel, Gjirokastra*

Hyrje

Turizmi, si dukuri, është përkufizuar nga studiues të ndryshëm si një përvojë njerëzore individuale dhe sociale, si një fenomen gjeografik e mjedisor, si një burim vlere dhe një industri biznesi. Tashmë, është vërtetuar edhe nga kërkime empirike që turizmi është një fenomen i madh social i shoqërisë moderne me pasoja të mëdha ekonomike. Rëndësia e zhvillimit të turizmit është e njohur, sepse sot kjo industri njihet globalisht, si një kontribues i madh ekonomik, gjenerator i punësimit dhe flukset e investimeve në këtë fushë janë vazhdimisht në rritje. Zhvillimi i turizmit po vlerësohet si një instrument për zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e punësimit edhe në vendet në zhvillim të cilat kanë potenciale për zhvillimin e këtij sektori.

Turizmi është vlerësuar edhe nga Qeveria Shqiptare si një ndër sektorët me më shumë ndikim në zhvillimin e pritshëm, cilësor dhe sasior të ekonomisë shqiptare. Kjo qeveri ka hartuar disa dokumente mjaft të rëndësishme për sektorin e turizmit (si p.sh., Ligjin e ri për Turizmin dhe Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2014-2020), duke synuar *“nxitjen dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm; licensimin, standardizimin, certifikimin e shërbimeve turistike; zhvillimin e fushatave të pandërprera informuese dhe promovuese për imazhin e ri të Shqipërisë turistike, i cili synohet të arrihet nëpërmjet mbrojtjes, promovimit të burimeve turistike, kulturës dhe trashëgimisë së popullit shqiptar etj”*¹.

Turizmi dhe roli i tij

Turizmi është një aktivitet i rëndësishëm ekonomik, por duhet pasur parasysh që të ardhurat e realizuara nga ky sektor janë akoma më të larta se ato që sjellin statistikën, sepse impakti i këtij sektori, në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe në numrin e të punësuarëve, është direkt dhe indirekt. Ky fenomen ndodh për arsye të vështirësive praktike që ekzistojnë për matjen e saktë të të

¹ <http://turizmi.gov.al/al/>

dhënave vetëm nga ky sektor, falë strukture së larmishme të shërbimeve që ofron dhe natyrës gjithëpërfshirëse të tij. Në këtë punim do t'iu referohemi kryesisht të dhënave nga institucione të ndyshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Kështu duke iu referuar Raportit të WTTC (World Travel & Tourism Council) për Shqipërinë: Kontributi total i Udhëtimit & Turizmit në PBB për vitin 2015 ishte 306,2 mld lekë ose 21,1 % i PBB dhe ishte parashikuar të jetë rreth 322,7 mld lekë në 2016 ose 21,5 % të PBB. Për 2026 parashikohet të arrijë në rreth 27,2% të PBB². Gjithashtu, turizmi krijoi 51,000 vende pune në mënyrë direkte në 2015 ose 5.5% të punësimit total dhe parashikohej që në 2016 të jetë në 53,000 të punësuar ose 5,6 %. Deri në 2026 pritet të shkojë rreth 77,000 të punësuar, pra, pritet një rritje prej 3,8 % në dekadën e ardhshme³.

Njëkohësisht, si rezultat i specifikave të punës që ka ky sektor, të punësuarit që zënë peshën kryesore janë kryesisht femrat dhe të rinjtë. Po t'iu referohemi të dhënave që paraqet INSTAT (Instituti i Statistikave) në Shqipëri, për tremujorin e tretë 2016, shkalla zyrtare e papunësisë për femrat është 14,0 %, ndërsa papunësia për të rinjtë është 27,4 %.⁴ Këto grupe të punësuarish përballen me sfida në të gjithë treguesit e tregut të punës, prandaj edhe Shqipëria e shih zhvillimin e turizmit si një mundësi për zbutjen e papunësisë, përmirësimin dhe rritjen e nivelit të jetesës në vend. Gjithashtu, turizmi renditet i treti në renditjen e sektorëve të përcaktuara si sektorë me potenciale të larta për t'u investuar nga Albanian Investment Development Agency (AIDA)⁵.

Gjatë vitit 2016, janë ndërmarrë hapa konkrete duke synuar orientimin e sektorit të turizmit në rrugën e duhur dhe kryesisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe

² WTTC, Travel & Tourism Economic Impact, 2016, Albania, pg 3

³ Idem, pg 4

⁴ <http://www.instat.gov.al/>

⁵ www.AIDA.gov.al

Sipërmarrjes, e cila mbulon direkt çështjet e turizmit. Kështu, MZHETTS, ka punuar fort për promovimin e Shqipërisë turistike duke nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi dhe duke mbështetur projekte të reja që vijnë nga donatorë si EU, SIDA, USAID, kooperacioni holandez apo dhe GIZ që mbështesin operatorët që kanë ide zhvillimi për turizmin.⁶

Sigurisht që të gjitha këto arritje janë për t'u përshëndetur, por nuk mjafton vetëm hartimi i politikave cilësore. Shqetësimi që pason është: A ekzistojnë burimet njerëzore kompetente që do të realizojnë këto politika në mënyrë që të arrihen rezultatet e parashikuara dhe të shumëpritura? Burimet njerëzore dhe kompetenca e tyre në punë janë elementë të cilët kanë një rëndësi vendimtare në sektorin turistik, sepse natyra e produktit që ky sektor ofron është kryesisht shërbime dhe cilësia e shërbimit varet në një masë të konsiderueshme nga fakti se çfarë sasi dhe cilësie burimesh njerëzore ka të përfshira në të. Për zhvillimin e suksesshëm të turizmit, është i domosdoshëm sigurimi i standardeve të larta të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit. Por, objektivat e synuara mund të arrihen vetëm duke përcaktuar nevojat specifike për zhvillimin e burimeve njerëzore në segmente të ndryshme të industrisë së turizmit. Hotelet, restorantet, agjensitë turistike dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve turistike kërkojnë personel të aftë profesionalisht në të gjitha nivelet. A është kuptuar nga organet e pushtetit qendror dhe lokal rëndësia e zhvillimit të BNJ? A është punuar në drejtimin e duhur për përgatitjen e specialistëve të turizmit duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm të tij?

Aktualisht ka një mungesë kërkimesh apo punimesh shkencore që trajtojnë çështje të menaxhimit dhe cilësisë së BNJ në sektorin e turizmit në Shqipëri. Megjithatë çdo kërkim dhe informacion në këtë fushë është i vlefshëm dhe mund t'iu shërbejë të gjithë atyre

⁶ <http://www.ekonomia.gov.al/>

që janë të interesuar për çështjet që trajtohen në të.

Karakteristikat e turizmit dhe rëndësia e BNJ

Mjaft studiues, njerëz të biznesit apo politikëbërës janë përpjekur të përcaktojnë qartë natyrën e turizmit dhe pozicionin e nënsektorit të mikpritjes brenda këtij koncepti, por ende nuk ka një përkufizim të qartë dhe të pranuar nga të gjithë. Duhet pranuar që ky është një problem konkret i përkufizimit për këtë sektor të ndryshëm dhe të madh, sepse ka mjaft aktivitete që përfshihen në të, të cilat mbivendosen dhe mund të përshkruhen si turizëm dhe mikpritje. Për shembull, Lucas (2004) në punimin e saj për marrëdhëniet e punësimit në industrinë e mikpritjes dhe turizmit, bëri një klasifikim dhe trajtoi çështje të Hotelit, Ushqimit dhe Sektorit të Turizmit (HCTS). Ky përshkrim i HCTS tregon se, në realitet, shumë punë në mikpritje dhe turizëm,

" ndajnë attribute të përbashkëta dhe janë të lidhura me të dyja edhe me mikpritjen edhe me aktivitetet e turizmit "(f. 4). Pra, del qartë se është e vështirë të bëhet një përshkrim i saktë i industrisë së turizmit dhe të mikpritjes. Për të pasur një ide më të plotë për këtë sektor dhe shërbimet që përfshihen në të, le t'i referohemi të dhënave nga People 1st, i cili është Sector Skills Council (SSC)⁷ në Mbretërinë e Bashkuar. People 1st sugjeron që ky sektor përbëhet nga 14 nënsektorë: Hotele; Restorante; Pub-e, Bare-e&Night-club-e; Furnitorët ushqimorë të kontraktuar; Klubet e anëtarësimit; Eventet; Kazinotë; Shërbimet e udhëtimit; Shërbimet turistike; Argëtimi i vizitorëve; Hostele (për të rinjtë); Parqe pushimi; Akomodim self-catering (vetëfurnizim ushqimi); Shërbimet e mikpritjes. Dhe në qoftë se vazhdohet me një përshkrim më të gjerë të sektorit, ka një numër akoma më të madh dhe të ndryshëm vendesh pune që lidhen me të dhe ndikojnë me kërkesat teknike, nivelin e edukimit, kushtet

⁷ SSC janë organet shtetërore të licensuara në Mbretërinë e Bashkuar, të cilat janë përgjegjëse për përmirësimin e aftësive brenda industrisë.

dhe llojin e personave që do të punojnë në to.

Në të vërtetë, në një industri që karakterizohet nga diversiteti dhe heterogjeniteti për nga qëllimi, madhësia, pronësia dhe kërkesat e ndërmarrjes, e vetmja pikë e vërtetë e homogjenitetit është dhënia e shërbimit ndaj klientëve dhe nevoja për të menaxhuar njerëzit në një mënyrë të tillë që ata të ofrojnë një shërbim cilësor.

Baum (1997) thotë se bashkëveprimi i personave të punësuar në këta nënsektorë midis tyre, por edhe bashkëveprimi i tyre me turistët është vendimtar në "realizimin apo dështimin e eksperiencës turistike". Është e vërtetë që produkti fizik është i rëndësishëm për shumicën e turistëve, por ka mjaft të tjerë për të cilët, cilësia e eksperiencës së tyre është shumë e rëndësishme dhe preferojnë nivel të lartë në bashkëveprimin me stafin front-line gjatë udhëtimit, turizmit dhe mikpritjes. Këto, të ashtuquajtura "momente të së vërtetës" (Carlzon, 1987), janë arsyet vendimtare për efektivitetin organizativ, suksesin, konkurrencën dhe përfitimin. Smith (1990) ka mbështetur idenë se: industria e turizmit mund të konsiderohet si një industri njerëz-për-njerëz, sepse brenda kësaj industrie punësohen njerëz, përpunohen njerëz dhe produkti përfundimtar është njerëz. Mullins dhe Davies (1991), gjithashtu, pajtohen: *"Shumë anëtarë të fuqisë punëtore kanë kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorin dhe njerëzit janë një përbërës thelbësor i operacioneve efektive të hotelit: ata janë pjesë e produktit përfundimtar për të cilin konsumatori paguan"*. Pra, njerëzit janë thelbi i industrisë së turizmit dhe turizmi i suksesshëm varet kryesisht nga burimet njerëzore.

Pavarësisht nga retorika e politikëbërësve dhe drejtuesve të biznesit se njerëzit janë aset i rëndësishëm i një industrie, shumë mbeten skeptik, nëse një këndvështrim i tillë është i vërtetë apo jo dhe kjo ka ardhur si rezultat i provave empirike.

Menaxhimi i BNJ të punësuar në turizëm

Ka pasur shumë përpjekje për të përcaktuar se çfarë është

saktësisht Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (MBNJ) dhe Heery & Noon (2008) pranojnë se MBNJ është objekt i mjaft analizave akademike dhe se, në fund të fundit, *"nuk ka asnjë marrëveshje të përbashkët mbi atë që është MBNJ"*. Por Storey (1995) thotë: *"MBNJ, është një qasje e veçantë për menaxhimin e punës, e cila synon arritjen e avantazhit konkurrues nëpërmjet vendosjes strategjike të një fuqie punëtore shumë të përkushtuar dhe të aftë, duke përdorur një sërë teknikash të integruara strukturore dhe kulturore të personelit"*.

Pra, sfida e MBNJ duket të jetë mënyra se si do të kryhet rekrutimi, përshtatja me vendin e punës, zhvillimi, shpërblimi dhe motivimi i stafit, duke e bërë atë që të jetë një burim i përparësisë konkurruese.

Një karakteristikë tjetër në turizëm është ekzistenca e firmave të vogla dhe të mesme dhe shpesh mendohet se duke qenë se kanë një veprimtari të kufizuar ato nuk do të punësojnë një specialist të MBNJ për të aplikuar e zhvilluar trajtime të sofistikuar. Për më tepër, është e mundur që të kërkojnë politika për BNJ që kërkojnë pak mendim duke u bazuar në rrethanat apo situatat e tyre të biznesit. Pavarësisht gjithçkaje të thënë në teori, është fakt se organizatat duhet të menaxhojnë punonjësit e tyre çdo ditë dhe të përfshihen në ciklin e gjetjes së burimeve njerëzore, shpërndarjen e tyre në pozicionet e punës dhe zhvillimit të tyre.

Zhvillimi i burimeve njerëzore është një tjetër element shumë i rëndësishëm për industrinë e turizmit. Rritja fenomenale e industrisë së turizmit, sidomos në turizmin ndërkombëtar, ka krijuar një numër problemesh në fushën e zhvillimit të burimeve njerëzore. Tashmë, në vendet e zhvilluara është problem sasia e burimeve njerëzore, ndërsa në vendet në zhvillim cilësia e tyre. Në shumë vende, ekziston një problem i përshtatshmërisë së arsimit të turizmit dhe trajnimit me nevojat e industrisë, sepse ekziston ndërlikohje e dobët mes tyre. Industria e turizmit vuan nga një imazh i varfër si

një punëdhënëse. Niveli i konkurrencës është rritur në të gjitha destinacionet turistike dhe ka një nivel në rritje të pritshmërive të klientëve duke rritur koston e punës në të gjitha nivelet. Në vendet në zhvillim, furnizimi i bollshëm me fuqi punëtore nuk është një pengesë, por aftësia për të siguruar programe të përshtatshme trajnimi për të prodhuar numrin e kërkuar të personelit të kualifikuar për të punuar në fushën e turizmit mund të jetë një pengesë, të paktën në vitet e hershme të zhvillimit (Inskeep 1994). Ritmi i zhvillimit duhet të jetë i lidhur ngushtë me cilësinë e personelit të trajnuar. Përndryshe, niveli i cilësisë së shërbimeve turistike nuk do të jetë arritur dhe turizmi do të vuajë nga ky problem. Megjithatë, kur sasia e vendeve të punës në një sektor është e padiskutueshme, cilësia e kryerjes së kësaj pune është një çështje e madhe për akademikët dhe politikëbërësit, sepse që një vend të konkurrojë me vendet e tjera në turizëm, është e nevojshme të ofrojë një cilësi të lartë shërbimi. Këto sfida shihen në një numër vendesh, përfshirë edhe Shqipërinë.

Prandaj, qeveritë duhet të përfshijnë planifikimin e burimeve njerëzore, si pjesë e planit të zhvillimit të turizmit të vendit dhe të përcaktojnë një politikë të qartë të zhvillimit të burimeve njerëzore duke marrë në konsideratë kërkesën dhe ofertën për punë, në mënyrë që të plotësohen nevojat e industrisë së turizmit. Qeveria duhet të japë mbështetjen dhe nxitjen e nevojshme për edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm. Qeveria gjithashtu ka një rol të rëndësishëm për tejkalimin e hendekut në sektorin privat për të plotësuar nevojat e përgjithshme të turizmit si dhe për të inkurajuar investimet private në zhvillimin e burimeve njerëzore në industrinë e turizmit. Megjithatë, çdo vend ka veçantinë e vet në backgroundin politik, ekonomik dhe social; çfarëdo politike dhe strategjie e suksesshme në një vend mund të mos japë fryte edhe në një tjetër, kështu që njohja e kushteve konkrete dhe hartimi i strategjive në përputhje me këto realitete do të ishte çelësi i suksesit.

Gjirokastra dhe turizmi

Gjirokastra ka një sipërfaqe 469.25 km² dhe një popullsi prej 70,331 banorë⁸. Gjirokastra shtrihet në juglindje të Shqipërisë dhe është qendra administrative e qarkut me të njëjtin emër. Potenciali i madh turistik shprehet në ekzistencën e qytetit historik të Gjirokastrës, i krijuar rreth shekullit XII rreth një forte mbi një kodër⁹. Për vlerat e saj arkitektonike, isopolifoninë labe dhe karakteristikat e saj unike, qysh prej vitit 2005, ajo është pjesë e listës së trashëgimise botërore të UNESCO-s, fakt ky që shton edhe më tepër vlerat turistike të këtij qyteti. Pra, Gjirokastra ka potenciale të shumta për ta parë turizmin si një mundësi të zhvillimit të saj ekonomik, sepse zotëron një ofertë turistike të pasur që kryesohet nga ajo historiko - kulturore duke vazhduar me turizmin natyror, turizmin arkeologjik e me atë kulinar.

Nga statistikat në vite, vihet re që numri i turistëve që vizitojnë Gjirokastrën ka ardhur duke u rritur. Kështu, duke iu referuar të dhënave që ofron Sektori i Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore pranë Bashkisë Gjirokastrë, numri total i turistëve për vitin 2016 ka qenë 69,347 persona, ndër të cilët 64% të huaj dhe 36% vendas, pa llogaritur këtu edhe ata turistë individual të cilët nuk kanë marrë shërbime nga zyra e informimit turistik, apo nuk kanë vizituar muzetë në këtë qytet. Kjo rritje e numrit të turistëve ka bërë që edhe numri i strukturave pritëse, kryesisht hoteleve dhe restoranteve të vijë duke u rritur. Aktualisht në bashkinë e Gjirokastrës, në bazë të informacioneve të marra pranë Zyres Rajonale të Shërbimit Turistik, sektori hotelier përbëhet nga 34 Hotele, 1 Hostel, 1 Guest House, 1 Kompleks hotelier dhe 1 B&B.

Ky studim empirik është fokusuar në bashkinë e Gjirokastrës dhe informacionet janë grumbulluar në terren nëpërmjet intervistave të zhvilluara me përfaqësues të biznesit vendas. Intervistat u

⁸ <http://zgjedhje2015.reporter.al/profili-i-bashkise-gjirokaster/>, <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>

⁹ J. Guillemin, *Anthropological Realities: Readings in the Science of Culture*, New Brunswick, N.J., Transaction Publishers, 1^a gjenajo 1980, pp. 387.

përqendruan kryesisht në 3 çështje : Së pari, si e kuptojnë rëndësine e burimeve njerëzore këto biznese dhe çfarë nevojash kanë ato për bnj. Së dyti, çfarë praktikash të MBNJ ndjekin për punonjësit e vet. Së treti, cili është niveli i bashkëpunimit me institucionet lokale apo qendrore.

Gjatë grumbullimit të të dhënave për këtë punim u konstatua se numri i subjekteve të regjistruara në organet përkatëse si hotele ishte i ndryshëm nga ai që operonte në terren dhe në disa raste të tjera aktiviteti i deklaruar i subjektit ishte i ndryshëm nga ai që kryen në realitet. Pra, kishte subjekte që në QKR ishin të regjistruar si subjekte të aktivitetit tregtar apo diçka tjetër dhe ndërkohë ushtrojnë aktivitet hotelier, ashtu siç kishte subjekte që ishin të regjistruara si hotele dhe ushtrojnë aktivitet krejtësisht të ndryshëm. Në këto kushte lindin disa problematika: Kjo situatë ndikon negativisht në konkurrencën e ndershme midis bizneseve turistike dhe rrjedhimisht edhe në performancën e tregut turistik, sepse ofrohen shërbime në të njëjtën fushë, por me kosto të ndryshme. Gjithashtu, është e vështirë të identifikohen dhe të përlllogariten të ardhurat ekonomike që realizohen nga sektori i turizmit në përgjithësi, por edhe nga segmente të caktuara të tij në veçanti. Këto informacione të munguara pengojnë gjithashtu edhe kryerjen e analizave ekonomike dhe nxjerrjen e përfundimeve të duhura për zhvillimin e sektorit, të cilat do të ndihmonin vendimmarrësit lokalë apo edhe qendror për orientim të qartë të investimeve të tyre në të ardhmen. Segmentimi i duhur i tregut është i domosdoshëm edhe për efekte studimi, sepse nga vetë natyra komplekse e turizmit ekziston një shkallë e lartë vështirësie për ndarjen e qartë të të ardhurave apo investimeve të realizuara në këtë sektor dhe kjo situatë e vështirëson akoma më tepër punën e politikëbërësve apo studiuesve të ndryshëm. Si rezultat, lind domosdoshmëria e formalizimit të tregut turistik për të gjitha segmentet e tij si në rastet e subjekteve që kanë mospërputhje të tilla ashtu edhe për rastet e subjekteve të paregjistruara ende në organet shtetërore.

Konkluzione:

Nga informacionet e grumbulluara dhe të përpunuara dolën këto përfundime:

- Në këndvështrimin e sipërmarrësve, BNJ për nga rëndësia renditen të tretat, pas marketingut dhe kapitalit.
- Nevojat kryesore të bizneseve janë kryesisht për punonjës front-office dhe konkretisht recepsionist, guida dhe shoqërues të grupeve turistike.
- BNJ që rekrutohen nuk kanë aftësitë e duhura për vendet e punës që ofrohen, kanë mungesa të njohurive në gjuhët e huaja dhe në çështje të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit.
- Edhe kur bnj janë të arsimuara në fushën e turizmit, njohuritë e tyre nuk u përgjigjen kërkesave të tregut të punës, sepse ka mungesë fuqie punëtore të kualifikuar për postet nënmenaxheriale.
- Nuk aplikohen praktika të mirëfillta seleksionimi dhe rekrutimi, por këto procese kryhen me iniciativën spontane dhe sipas këndvështrimit të pronar-menaxherit.
- Trajnimi i stafit nuk konsiderohet si detyrim i biznesit, por si një gjë që duhet ta ofrojnë institucionet shtetërore të formimit profesional, megjithatë kur është e nevojshme ai realizohet në punë.
- Stafi është kryesisht i përhershëm dhe shpërblimi i tyre është i ulët duke u justifikuar me “sigurinë” e punës që ofrohet.
- Qarkullimi i ulët i stafit shpjegohet me mungesën e stafit të kualifikuar në tregun e punës dhe pasigurinë e menaxherit për të siguruar stafin e nevojshëm në momentet kur ka nevojë.
- Bashkëpunimi me institucionet shtetërore si lokale ashtu edhe qendrore është mjaft i dobët dhe kjo për arsye të mungesës së

vullnetit nga të gjitha palët, por edhe për arsye të mungesës së edukimit mbi rëndësinë e bashkëpunimit. Biznesi dhe komuniteti presin gjithçka nga shteti ndoshta edhe për arsye të traditës së “qytetit-muze” të Gjirokastrës, ndërsa institucionet nuk kanë orientuar ende politika të qarta dhe nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për ngritjen e strukturave të duhura që do të mbështetin zhvillimin e turizmit.

Rekomandime:

- Është i nevojshëm edukimi i përfaqësuesve të biznesit për të kuptuar rolin jetik të bnj në cilësinë e shërbimit dhe suksesin e biznesit të tyre.

- Institucionet trajnuese profesionale, shtetërore apo private, të kenë të qarta kërkesat e tregut të punës dhe të përgatitin burime njerëzore kompetente duke synuar përputhjen midis kërkesës dhe ofertës së të punësuarëve në turizëm.

- Biznesi dhe komuniteti të ndërgjegjësohen për rolin e tyre dhe rëndësinë e partneritetit në fushën e zhvillimit të turizmit, ndërsa institucionet, megjithëse identifikohen disa përpjekje pozitive të bëra kohët e fundit, të orientojnë qartë politika dhe të kalojnë në veprime konkrete, për ngritjen e strukturave të duhura që do të mbështetin zhvillimin e turizmit dhe, sigurisht, duhet të realizojnë edhe buxhetimin e duhur të tyre.

- Riorientimi i programeve që ofrojnë institucionet arsimore ekzistuese, në mënyrë që të përputhen me kërkesat reale të tregut të punës.

Referenca:

Baum, T. (1997) ‘Making or breaking the tourist experience: the role of human resource management’, in C. Ryan (ed.) *The Tourist Experience: A New Introduction*, Cassell, 92–111.

Carlzon, J. (1987) *Moments of Truth*, Ballinger.

Guillemin, J (1980) [Anthropological Realities: Readings in the Science of Culture](#), New Brunswick, N.J, Transaction Publishers, pp. 387.

Heery, E. and Noon, M. (2001) A Dictionary of Human Resource Management, Oxford University Press

Inskeep, E. (1994): Tourism Planning: An Integrated and Sustainable Development Approach, Van Nostrand Reinhold.

Lucas, R. (2004) Employment Relations in the Hospitality and Tourism Industries, London: Routledge.

Mullins, L dhe Davies, I (1991), What Makes for an Effective Hotel Manager?", International Journal of Contemporary Hospitality Management, Vol. 3 Iss: 1.

Smith, SLJ (1990) "A test of Plog's allocentric / psychocentric model: Evidence from seven nations", Journal of Travel Research 28 (4), 40-43.

Storey, J. (1995) 'Human resource management: still marching on, or marching out?', in J. Storey (ed.) Human Resource Management: A Critical Text, Routledge, 3-32.

WTTC, Travel & Tourism Economic Impact, 2015, Albania, pg3

BELINDA XARBA

ETLEVA PETA

DANIELA QIQI

ZAMIRA VEIZI

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër

**LIDHJA MIDIS EDUKIMIT DHE
MIRËMENAXHIMIT TË FINANCAVE
PERSONALE**

ABSTRACT

Providing consumers with the necessary tools that can help them make smart financial choices is nowadays a necessity. Many authors around the world have come to the conclusion that financial education significantly impacts financial behavior. This study was conducted in the Municipality of Gjirokastër, on September 2018, where 583 people were involved.

The analysis of data collected from this study showed that mismanagement of personal finances comes from the absence of information and lack of knowledge around this topic. The analysis also showed that individuals who have read about family finances are more likely to accurately identify their personal expenses. This meaning, the inclusion of field specialists in the process of awareness and offering of assistance to family economies is critical. This can be done through the publishing of books, leaflets, guides, magazines, internet web pages and other forms of providing information on personal.

Key words: *Personal finance, financial literacy, personal expenditures*

Rishikimi i literaturës

Në ekonominë e sotme është e rëndësishme t'i pajisësh konsumatorët me mjetet e nevojshme për të kryer zgjedhje të zgjuara financiare. Njëri nga këto mjete është edukimi financiar (Lusardi, 2008, p.20).

Në një analizë statistikore të 126 studimeve nga autorë të ndryshëm në të gjithë botën, u arrit në konkluzionin se edukimi financiar ndikon në mënyrë sinjifikative në sjelljen financiare (Kaiser & Menkhoff, 2017).

Në rezultatet e testit të tyre, autorët Braunstein, Sandra dhe Carolyn Welch,(2002) treguan se të ardhurat dhe edukimi kishin një lidhje statistikisht domethënëse me menaxhimin e parasë. Si burime më të cituara dhe më të rëndësishme të informacionit mbi financat personale ishin eksperiencat personale, mediat, broshurat e ndryshme dhe të shikuarit e një videoje në shtëpi.

Ndërsa Hilgert, Hogarth, & Beverly (2003), në studimin e tyre, gjetën se njohuritë financiare mund të jenë statistikisht të lidhura me praktikat financiare që lidhen me menaxhimin e parasë, menaxhimin e kredisë, kursimin dhe investimet. Rezultate më të larta kishin familjet që kishin më tepër njohuri.

Norman (2010) thekson se ndërsa të ardhurat e përfituara në çdo nivel janë të rëndësishme, vështirësitë financiare të lidhura me të ardhurat e pamjaftueshme në shumë familje shkaktohen nga keqmenaxhimi i shpenzimeve, i cili vjen nga mungesa e njohurive në fushën e financave personale.

Personat që janë më realistë në lidhje me vlerësimin e zakoneve që kanë ndikuar në shpenzimet e tyre të kaluara, janë gjithashtu realistë edhe në lidhje me shpenzimet e tyre të ardhshme (Peetz & Buehler, 2009).

Fernbach, Kan, & Lynch, (2015) gjetën se personat që mbajnë një buxhet të shkruar i përgjigjen kufizimeve të të ardhurave me një

plan prioritar të parashkruar dhe raportojnë më pak sjellje financiare të papëlqyeshme si shpenzimet e tepërta dhe blerjet impulsive. Sipas (Husniyah & Fazilah, 2011), familjet që mbajnë shënime parashikohen të jenë më të qëndrueshme financiarisht krahasuar me ato që thjesht ndërtojnë një buxhet.

Mungesa e njohurive rreth financave të familjes nuk është vetëm te të rinjtë. Në studimin e tyre Volpe, Chen, Liu (2006) gjetën se temat e anketimit të financave personale janë të rëndësishme dhe të rriturit që punojnë nuk kanë njohuri rreth tyre.

Realiteti ekonomik shqiptar dhe mungesa e njohurive mbi financat e familjes dhe menaxhimin e tyre e bëjnë mjaft të rëndësishme rritjen e vëmendjes së duhur drejt financave personale. Këtë emergjence e tregon edhe eksperiencia botërore e viteve të fundit që e lidh fillimin e krizës financiare botërore me financat familjare dhe mosmenaxhimin e tyre (Xarba 2014).

Metodologjia

Ky studim u zhvillua në bashkinë e Gjirokastrës, ku sipas Censurit të vitit 2011, ka një popullsi prej 25.301 banorësh (Bashkia Gjirokastrë, 2018), në periudhën 2018.

Pyetësorët u shpërndanë dhe u plotësuan në mënyrë të rastësishme nga banorë të Gjirokastrës. Personat që plotësonin pyetësorët inkurajoheshin të pyesnin dhe ndihmoheshin nga anketuesit për termat që ata mund të mos i kuptonin apo i kishin të paqarta.

Nga 600 pyetësorë të shpërndarë, ishin plotësuar dhe ishin të vlefshëm për t'u përpunuar dhe analizuar 583 pyetësorë. Pyetësori u hartua bazuar në literaturën vendase dhe të huaj. Informacioni i cili synohej të grumbullohej nga ky pyetësor përfshinte: Burimet e informacionit për financat e familjes (librat, fletëpalosjet, revistat, internet, T.V), grupet e shpenzimeve/ të ardhurave personale, evidencën e të ardhurave/ të shpenzimeve personale,

mirëmenaxhimin e shpenzimeve me synim kursimin.

Variablat e përfshira në këtë studim janë variabla *nominal* dhe *ordinal* dhe metoda statistikore e përdorur është *testi Chi – square*. Për përpunimin e të dhënave janë përdorur programet *Microsoft Office Excel* dhe *Spss Ibm Statistics*.

Rezultatet

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara vetëm 7% e të anketuarve pohuan se kishin marrë informacion për financat e familjes nga leximi i librave, 0.3% nga fletëpalosjet, 1.4% nga revistat, 9.6% nga interneti dhe 2.9% nga TV (tabelat 5,6,7,8,9). Të dhënat e mësipërme paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Nga tabela 2 vërejmë se një pjesë e mirë e individëve (75.6%) që kishin vetëdeklaruar se kishin lexuar libra mbi financat e familjes mbanin evidencë mbi shpenzimet e tyre personale kundrejt 29.9% të atyre që nuk kishin lexuar. 67% e individëve të pyetur deklaruan se nuk mbanin shënim shpenzimet e tyre.

Nga rezultatet e *Chi-Square Tests*, tabela 3 për variablat “A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga librat?” dhe “Mbajtja e një evidence mbi shpenzimet” konkludojmë se mbajtja e një evidence mbi shpenzimet personale është e lidhur me një nivel të lartë *sinjifikance* me leximin e informacioneve rreth financave të familjes (χ^2 35.979, $p < 0.05$), (kur $Sig < \alpha$, ekziston një lidhje midis variablave).

Nisur nga rezultati që shpreh lidhjen midis dy variablave, tabela 4, ($\Phi = -0.248^1$) mund të themi se: Leximi rreth financave të familjes ka një ndikim afër nivelit mesatar (0.3) të mbajtja e një evidence mbi shpenzimet personale. Nga rezultatet mund të themi

¹ Të dhënat janë *dichotomous nominal* shenja nuk merret parasysh. (<http://www.people.vcu.edu/~pdattalo/702SuppRead/MeasAssoc/NominalAssoc.html>)

se testi: “Individët që kanë lexuar mbi financat e familjes kanë më shumë gjasa që të mbajnë evidencë shpenzimet e tyre personale” vërtetohet plotësisht.

Përfundime dhe rekomandime

Nga analiza e të dhënve të grumbulluara nga ky studim rezulton se mosmenaxhimi i financave personale të të anketuarit vjen si pasojë e mungesës së informacionit dhe njohurive rreth financave të familjes dhe jo si rezultat i mungesës së dëshirës së tyre për mirëmenaxhimin e ekonomisë familjare.

Me anë të *Chi square test* u vërtetua se:

Individët që kanë lexuar informacion mbi financat e familjes kanë më shumë gjasa që të evidentojnë saktë shpenzimet personale.

Me qënë se ky studim konstatoi se mungesa e informacionit rreth mirëmenaxhimit të financave personale është ende e dukshme në tregun tonë, del domosdoshmëri që kjo mungesë të plotësohet me botime librash, guidash për financat personale, shpërndarje fletëpalosjesh, botime me informacione për financat personale në revista dhe faqe të ndryshme interneti, si dhe forma të tjera të përcjelljes së informacionit. Iniciatorë të kësaj ideje duhet të jenë stafet akademike të Universiteteve si dhe stafet e institucioneve që e kanë në fokus këtë objekt.

Për menaxhimin e financave personale duhet të ndërmerren fushata sensibilizuese. Në këto fushata duhet të përfshihen patjetër të gjithë personat që kanë aktivitet financiar personal. Këto fushata mund të iniciohen dhe mbështëten edhe nga stafet akademike të cilat kanë njohuri financiare dhe menaxhuese pranë Fakulteteve të Ekonomisë.

Gjithashtu, për ekonomitë personale familjare duhet të ofrohet asistencë teknike që mundëson mbajtjen e një evidence mbi të ardhurat dhe shpenzimet personale. Në këtë mënyrë do të krijohen kushtet për mirëmenaxhimin e financave personale edhe në vendin

tonë, sepse kjo qasje i vjen në ndihmë jo vetëm familjeve në veçanti, por edhe ekonomisë në tërësi.

Referenca

Braunstein, Sandra and Carolyn Welch. 2002 “*Financial Literacy: An Overview of Practice, Research, and Policy*,” Federal Reserve Bulletin, The Federal Reserve Board, November 2002, pp. 445-457.

Fernbach, P. M., Kan, C., & Lynch, J. G. (2015, February). *Squeezed: Coping with Constraint through Efficiency and Prioritization*. Journal of Consumer Research, 41. doi:10.1086/679118.

Kaiser, T., & Menkhoff, L. (2017). Does Financial Education Impact Financial Literacy and Financial Behavior, and If So, When? Policy Research Working Papers. doi:10.1596/1813-9450-8161.

Lusardi, A. (2008, June 19). Financial Literacy: An Essential Tool for Informed Consumer Choice? Retrieved from <https://www.nber.org/papers/w14084>.

Husniyah, A.R M. Fazilah, A.S (2011) “*Factors contributing to financial stability of urban and rural families*”, Pertanika Journal of Social Sciences & Humanities, [Volume 19, No. 1, 2011 Pages 99 to 112](#).

Volpe, P., Chen, H. & Liu Sh. (2006) "An Analysis Of The Importance Of Personal Finance Topics And The Level Of Knowledge Possessed By Working Adults," 2006, v15(1, Spring), 81-98.

Norman, A. (2010, September). Importance of financial education in making informed decision on spending. Retrieved from.

Peetz, J., & Buehler, R. (2009). *Is there a budget fallacy? The role of savings goals in the prediction of personal spending*. Personality and Social Psychology Bulletin, 1579-1591.

Të dhëna të përgjithshme. (n.d.). Retrieved from <http://bashkiagjirokaster.gov.al/te-dhena-te-pergjithshme/>

Xarba, B: “Njohja e financave personale dhe miradministrimi i treguesve të saj faktorë të rëndësishëm në përmirësimin e ekonomisë familjare.” *Universiteti Bujqësor I Tiranës, Fakulteti I Ekonomisë Dhe Agrobiznesit*, 2014, pp. 1–187.

Anekse

Tabela 1: Informacione rreth financave të familjes

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Kam marrë informacion në lidhje me financat e familjes	99	17.0	17.0	17.0
Valid Nuk kam hasur ndonjë lloj informacioni për financat e familjes	484	83.0	83.0	100.0
Total	583	100.0	100.0	

Tabela 2 Crosstab: A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga librat? * Mbajtja e një evidence mbi shpenzimet

			Mbjtja e një evidence mbi shpenzimet		Total
			Po	Jo	
A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga librat?	Nuk kam lexuar	Count	162	380	542
		% within A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga librat?	29.9%	70.1%	100.0%
		% within Mbajtja e një evidence mbi shpenzimet	83.9%	97.4%	93.0%
		% of Total	27.8%	65.2%	93.0%
	Kam lexuar	Count	31	10	41
		% within A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave	75.6%	24.4%	100.0%

	të familjes nga librat?			
	% within Mbajtja e një evidence mbi shpenzimet	16.1%	2.6%	7.0%
	% of Total	5.3%	1.7%	7.0%
Total	Count	193	390	583
	% within A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga librat?	33.1%	66.9%	100.0%
	% within Mbajtja e një evidence mbi shpenzimet	100.0%	100.0%	100.0%
	% of Total	33.1%	66.9%	100.0%

Tabela 3: Chi-Square Test (Leximi për financat e familjes dhe mbajtja e një evidence mbi shpenzimet personale)

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	35.979 ^a	1	.000		
Continuity Correction ^b	33.944	1	.000		
Likelihood Ratio	33.602	1	.000		
Fisher's Exact Test				.000	.000
Linear-by-Linear Association	35.917	1	.000		
N of Valid Cases	583				

a. 0 cells (0.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 13.57.

b. Computed only for a 2x2 table

Tabela 4: Symmetric Measures (Leximi për financat e familjes dhe mbajtja e një evidence mbi shpenzimet)

		Value	Approx. Sig.
Nominal by Nominal	Phi	-.248	.000
	Cramer's V	.248	.000
N of Valid Cases		583	

a. Not assuming the null hypothesis.

b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis.

Tabela 5:

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga librat?	Nuk kam lexuar	542	93.0	93.0	93.0
	Kam lexuar	41	7.0	7.0	100.0
	Total	583	100.0	100.0	
A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga fletëpalosje?	Jo	581	99.7	99.7	99.7
	Po	2	0.3	0.3	100
	Total	583	100.0	100.0	
A keni lexuar ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga revistat?	Jo	575	98.6	98.6	98.6
	Po	8	1.4	1.4	100.0
	Total	583	100.0	100.0	
A keni marrë ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga interneti?	Jo	527	90.4	90.4	90.4
	Po	56	9.6	9.6	100.0
	Total	583	100.0	100.0	

Kërkime universitare Nr 41

			0.0	0	
A keni marrë ndonjëherë informacione rreth financave të familjes nga TV?	Jo	566	97. 1	97.1	97.1
	Po	17	2.9	2.9	100.0
	Total	583	100.0	100.0	

AGIM BERISHA

Kolegji Biznesit, Prishtinë

Kosovë

**NDIKIMI DHE EFEKTI EKONOMIK I
REMITANCAVE NË KOSOVË PARA DHE GJATË
PANDEMISË COVID 19**

ABSTRACT

Remittances sent by the Kosovo Diaspora have been and remain an important source of income for households in Kosovo. The paper addresses issues related to the remittances of the Kosovar diaspora, including the analysis of their economic effect before and during Covid 19.

In different periods, remittances from the diaspora have played an important role in economic terms, especially remain an important source of finance for the household in Kosovo. Given that Kosovo after the last war, remains among the countries with low level of development and high unemployment, the importance and economic effect of remittances of the Kosovar diaspora has been and remains of particular importance, affecting consumption and well-being of host families in Kosovo.

Key concepts: *Remittances, Kosovo diaspora, Covid19, formal and informal routes.*

Hyrja

Në kuadër të punimit trajtohen çështje të cilat kanë të bëjnë me remitancat e diasporës kosovare, rëndësinë e tyre për ekonominë familjare në Kosovë, format e dërgimit dhe efekti ekonomik para dhe gjatë Pandemisë Covid 19. Diaspora Kosovare është e shpërndarë në shtete të ndryshme, pjesa më e madhe e tyre janë të përqendruar në vendet e Evropës Perëndimore. Remitancat nga diaspora padyshim mbesin një burim i rëndësishëm i financave për ekonominë familjare në Kosovë. Dërgimi i mjeteve financiare nga diaspora në Kosovë vijnë përmes rrugëve të ndryshme që në përgjithësi përdoren rrugët formale dhe joformale të dërgimit të parave.

Marr parasysh nivelin e ulët zhvillimor në vend, shkallën e lartë të papunësisë, deficitin në bilancin tregtar, rëndësia dhe efekti ekonomik i remitancave të diasporës kosovare ka qenë dhe mbetet i një rëndësie të veçantë, kryesisht në konsumin dhe mirëqenien e familjeve pranuese në Kosovë.

Metodologjia e përdorur

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje përfshirë literaturën shkencore, si dhe raporte e publikime nga Banka Qendrore e Kosovës, ku trajtohen çështje të lidhura me remitancat, përkatësisht ndikimi dhe efekti ekonomik i remitancave në Kosovë para dhe gjatë Pandemisë Covid 19. Po ashtu është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

Rezultatet

Rëndësia e remitancave në Kosovë

Për shumë kosovarë kushtet e pafavorshme politike dhe ekonomike ishin nxitje për emigrim në vendet e tjera. Emigrimi nga Kosova ka filluar në fund të viteve të 60-ta dhe fillim të viteve të

70-ta dhe mund të ndahet në katër faza:¹

- 1) 1960-1988;
- 2) 1989-1997;
- 3) Grupi i refugjatëve të luftës së vitit 1998-99 dhe
- 4) 2000---.

Shumica e emigrantëve janë të koncentruar në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet tjera më të zhvilluara të Evropës e Botës.

Remitancat nga jashtë konsiderohen kontribues i rëndësishëm për mirëqenien e familjeve kosovare. Dërgesat e emigrantëve kanë ndikim në proceset ekonomike dhe shoqërore në Kosovë, veçmas në vlerën e konsumit të popullsisë.²

Tabela 1: Ecuria e remitancave të dërguara në Kosovë në periudhën 2007-2019
-në milionë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Remitencat	588.5	608.1	585.7	584.3	492.5	516.4	573.4	622.3	665.5	691.0	759.2	800.6	851.7

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 222, Prishtinë, fq. 99.

Në tabelë dhe grafikë vërehet ecuria e remitancave të dërguara në Kosovë përfshirë periudhën 2007-2019. Në vitin 2007 remitancat e dërguara në Kosovë ishin në vlerë prej 588.5 milionë euro, duke pasur ecuri të rënies në vitin 2011, ndërsa viteve në vijim ecuri të rritjes duke arritur në vitin 2019 në vlerë prej 851.7 milionë euro.

¹ Instituti Riinvest. (2007). Diaspora dhe politikat e migracionit, Prishtinë, fq. 27.

² Limani. Dr. Musa. (2013). Makroekonomia, Prishtinë, fq. 222.




Figura 1: Ecuria e remitancave të dërguara në Kosovë në periudhën 2007-2019

Format e dërgimit të remitancave në Kosovë

Kosova që nga paslufta vazhdon të ketë nivel të ulët të rritjes ekonomike, normë të lartë të papunësisë dhe deficit të lartë tregtar. Marr parasysh këtë tregues, ekonomia e Kosovës veçmas ekonomitë familjare vazhdojnë të kenë varësi në masë të madhe nga remitancat e dërguara nga diaspora kosovare. Për dërgimin e mjeteve të tyre emigrantët shfrytëzojnë rrugë të ndryshme që në përgjithësi ndahen në dy grupe kryesore:³ rrugët formale dhe joformale të dërgimit të parave.

Gjatë transferimit përmes kanaleve jozyrtare emigrantët kanë shfrytëzuar dy rrugë kryesore: i kanë dërguar mjetet vetë personalisht gjatë vizitave në vendlindje, apo mënyra tjetër përmes të afërmeve e miqve të tyre.⁴

³ Banka Qendrore e Kosovës. (2013). Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitancave në Kosovë, Prishtinë fq, 19.

⁴ Po aty, fq, 23.

Tabela 2: Remitancat dhe kanalet e dërgimit -në milionë euro

Viti	Totali	Bankat Komeriale	Agjencionet transferim parave	Të tjera
2007	588.5	156.5	226.8	205.3
2008	608.1	126.3	213.1	269.3
2009	585.7	148.8	213.1	223.8
2010	584.3	141.3	213.1	229.9
2011	492.5	93.9	220.2	178.4
2012	516.4	92.6	236.7	187.0
2013	573.4	115.4	250.3	207.7
2014	622.3	115.2	281.6	225.4
2015	665.5	121.1	303.3	241.1
2016	691.0	116.3	324.4	250.3
2017	759.2	120.4	363.7	275.0
2018	800.6	123.1	387.5	290.0
2019	851.7	123.0	420.1	308.5
Janar- 2020	62.3	10.1	29.6	22.6
Shkurt-2020	63.3	5.9	34.5	22.9
Mars-2020	61.7	7.3	41.2	13.8
Prill 2020	60.3	8.8	51.5	---
Maj 2020	104.00	15.40	88.60	---
Qershor 2020	81.60	11.30	59.00	---

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 226, Prishtinë, fq, 99.




Figura 2: Remitancat sipas kanaleve të dërgimit

Remitancat dhe efekti ekonomik i tyre para dhe gjatë Pandemisë Covid 19 në Kosovë

Kapitali i diasporës ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në burimet financiare të popullsisë së Kosovës, pasi një pjesë të kursimeve të tyre ua dërgojnë familjarëve të tyre në Kosovë. Remitancat paraqesin burim shumë të rëndësishëm të hyrjeve të popullsisë së Kosovës. Remitancat në Kosovë kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë, nga të cilat sigurojnë një pjesë të madhe të konsumit final. Në këtë kuadër, remitancat (dërgesat e parave nga diaspora) paraqesin një vlerë të caktuar të investimeve private duke përbërë një element të rëndësishëm të kërkesës agregate, sepse ndikojnë në rritjen e konsumit. Padyshim, mërgata kosovare e shpërndarë në vende të ndryshme të botës përmes remitancave (mjeteve financiare) të dërguara familjeve në Kosovë, ndikojnë në rritjen e konsumit dhe standardit jetësor, në zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin e problemeve sociale, si dhe përmes investimeve ekonomike në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Pra, diaspora kosovare në periudha të ndryshme ka luajtur rol të

rëndësishëm duke siguruar një burim të rëndësishëm të financave për ekonominë e Kosovës. S'ka dyshim që, diaspora ka qenë dhe vazhdon të mbetet një potencial i rëndësishëm dhe mbështetës në zhvillimet në aspektin ekonomik në Kosovë.

Remitancat janë zakonisht të ndjeshme dhe ndikohen ndaj kushteve ekonomike të vendeve nga të cilat ato burojnë, të cilat mund të jenë dobët të lidhura me ngjarjet në shtetin përfitues. Pa dyshim që remitancat kanë tendencë të rriten (zvogëlohen) kur kushtet në shtetet përfituese keqësohen (përmirësohen). Me fjalë të tjera, vështruar nga aspekti ekonomik remitancat kanë varësi të drejtpërdrejtë ndaj rrjedhave ekonomike dhe kushteve të tjera në shtetin përfitues. Pandemia Covid19, e filluar në Kinë në fund të vitit 2019 dhe e cila përfshiu, pothuajse, të gjitha vendet e botës në fillim të vitit 2020, kështu që edhe Kosova u përfshi nga kjo pandemi duke filluar nga muaji Mars 2020. Nisur nga kjo, Pandemia Covid19 që ka përfshirë botën, pa dyshim që ka ndikuar në gjendjen financiare të emigrantëve kosovar duke ndikuar drejtpërdrejt edhe në remitancat (mjetet financiare) të dërguara nga diaspora në Kosovë.


Tabela 3: Remitancat e dërguara në Kosovë para Pandemisë dhe fillimi Pandemisë Covid19 -në milionë euro

Viti	Totali	Bankat Komerciale	Agjencionet transferim parave	Të tjera
Janar-Shkurt 2020	123.7	14.8	64.1	44.9
Mars-Prill 2020	122.0	16.1	92.7	13.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 224, Prishtinë, fq, 99.

Nga tabela dhe grafiku pasqyrohet ecuria e remitancave të dërguara në Kosovë nga diaspora përfshirë periudhën para pandemisë Covid 19 dhe fillimin e pandemisë Covid 19 në Kosovë. Në periudhën Janar-Shkurt 2020 para fillimit të pandemisë Covid

19, shihet se remitancat e dërguara në Kosovë ishin në vlerë prej 123.7 milionë euro, ndërsa në periudhën Mars-Prill 2020 me fillimin e pandemisë Covid 19 ishin në vlerë prej 122.0 milionë euro. Krahasuar ecurinë e remitancave të dërguara para dhe gjatë pandemisë Covid 19, shihet se në periudhën Mars-Prill 2020 me fillimin e pandemisë Covid 19 në Kosovë kishte rënie të lehtë të remitancave të dërguara në Kosovë, krahasuar me periudhën Janar-Shkurt 2020 para fillimit të pandemisë Covid 19 në Kosovë.



Grafiku 3: Remitancat e dërguara në Kosovë para Pandemisë dhe gjatë Pandemisë Covid19

Në Kosovë me vendim të Qeverisë së Kosovës masat e para emergjente për parandalimin e përhapjes së Pandemisë Covid19 janë marrë në muajin Mars 2020. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen remitancat e dërguara në Kosovë para Pandemisë (TM1, TM2 2019) dhe fillimin e gjatë Pandemisë Covid19 (TM1, TM2 2020).

Vështuar tabelën dhe grafikun lidhur me ecurinë e remitancave të dërguara në Kosovë në periudhën Janar-Mars 2019 dhe Janar-Mars 2020 vërehet se ecuria e remitancave të dërguara në Kosovë kishte një rritje të lehtë gjatë periudhës së TM1 (Janar-Mars) të vitit 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të TM1 (Janar-Mars) 2019. Kështu që, në periudhën Janar-Mars 2019, remitancat e dërguara në Kosovë ishin 184.7 milionë euro, duke pasur një ecuri të lehtë të rritjes në periudhën Janar-Mars 2020 në 187.3 milionë euro.

Tabela 4: Remitancat dhe kanalet e dërgimit për periudhën Janar-Qershor 2019 dhe Janar-Qershor 2020 -në milionë euro

Viti	Totali	Bankat Komeriale	Agjencionet transferim parave	Të tjera
Janar 2019	56.4	9.0	27.0	20.4
Shkurt 2019	56.6	5.6	30.5	20.5
Mars 2019	71.7	9.1	36.6	26.0
Prill 2019	68.8	9.4	34.5	24.9
Maj 2019	78.4	7.6	42.4	28.4
Qershor 2019	73.5	9.9	37.0	26.6
Janar-Qershor 2019	405.4	50.6	208.0	146.8
Janar- 2020	62.3	10.1	29.6	22.6
Shkurt-2020	63.3	5.9	34.5	22.9
Mars-2020	61.7	7.3	41.2	13.8
Prill 2020	60.3	8.8	51.5	---
Maj 2020	104.0	15.4	88.6	---
Qershor 2020	81.6	11.3	59.0	---
Janar-Qershor 2020	433.2	58.8	304.4	59.3

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës. (2020). Buletini Mujor Statistikor Nr. 224, Prishtinë, fq. 99.

Gjatë muajve Janar-Shkurt 2020 ka pasur një rritje të remitancave prej 11% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (2019) janar-Shkurt 2019, ndërsa në muajin Mars 2020 pati një rënie të remitancave prej rreth 14%, krahasuar me muajin Mars 2019. Remitancat në muajin Mars 2020 ishin 61.7 milionë euro kundrejt 71.7 milionë euro në muajin Mars 2019. Rënie kjo që mund të jetë si rezultat i fillimit të pandemisë Covid 19 dhe ndikimit të saj që ka mund të ketë në ekonominë e vendeve ku jetojnë dhe punojnë diaspora Kosovare duke pasur efekt edhe në dërgimin e remitancave nga diaspora në Kosovë në periudhën e fillimit të pandemisë Covid 19.




Figura 4: Ecuria e remitancave për periudhën Janar-Qershor 2019 dhe Janar-Qershor 2020

Duke analizuar remitancat e dërguara nga Diaspora në Kosovë dhe duke krahasuar periudhën e njëjtë të vitit 2019 me periudhën e vitit 2020, nga tabela Nr.3, pasqyrohet ecuria e remitancave të dërguara në Kosovë për periudhën Janar-Qershor 2019 dhe Janar-Qershor 2020. Remitancat në periudhën Janar-Qershor 2019 ishin në vlerë prej 405.4 milionë euro, ndërsa në periudhën Janar-Qershor 2020 ishin në vlerë prej 433.2 milionë euro, duke pasur rritje të remitancave të dërguara në Kosovë.

Përfundimi

Në këtë punim analizohet ndikimi dhe efekti ekonomik i remitancave para dhe gjatë pandemisë Covid 19 në Kosovë. Pa dyshim vazhdon të mbetet rëndësia e remitancave të diasporës kosovare për ekonomitë familjare në Kosovë, duke qenë burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe efekti i drejtpërdrejtë i tyre për konsumin e ekonomive familjare në Kosovë.

Duke pasur parasysh se Kosova ka nivel të ulët të prodhimit vendor dhe të rritjes ekonomike, si dhe normë të lartë të papunësisë, në këtë kuadër rëndësia dhe efekti i remitancave të diasporës kosovare ka qenë dhe mbetet i një rëndësie të veçantë për ekonomitë familjare në Kosovë.

Në kuadër të punimit dhe analiza që kemi bërë lidhur me ndikimin dhe efektin ekonomik të remitancave para dhe gjatë

pandemisë Covid 19 në Kosovë, paraqesim disa nga konkluzionet dhe rekomandimet:

➤ Remitancat e dërguara të diasporës paraqesin një burim të rëndësishëm të të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë, duke pasur ndikim dhe efekte ekonomike gjithsesi në mirëqenien e familjeve pranuese.

➤ Remitancat (dërgesat e parave nga diaspora) mbeten burim i rëndësishëm financiar dhe një element ndikues i rëndësishëm i kërkesës agregate, duke ndikuar në nivelin e konsumit dhe në standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë

➤ Pandemia Covid 19 dhe ndikimi i saj në ekonomitë e vendeve ku jetojnë dhe punojnë Diaspora Kosovare ka ndikuar drejtpërdrejt në rënien e remitancave të dërguara në Kosovë.

Literatura

1. Agjencia e statistikave të Kosovës. (2013). *Studimi mbi Remitencat në Kosovë*, Prishtinë;

2. Banka Qendrore e Kosovës. (2020). *Buletini Mujor Statistikor Nr. 226*, Prishtinë;

3. Banka Qendrore e Kosovës. (2020). *Buletini Mujor Statistikor Nr. 223*, Prishtinë;

4. Banka Qendrore e Kosovës. (2019). *Buletini Mujor Statistikor Nr. 212*, Prishtinë;

5. Banka Qendrore e Kosovës. (2013). *Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitancave në Kosovë*, Prishtinë;

6. Musa. Dr. Limani. (2013). *Makroekonomia*, Prishtinë;

7. USAID, UNDP. (2010). *Studimi i Remitancave në Kosovë 2010*, Prishtinë;

8. Instituti Riinvest. (2007). *Diaspora dhe politikat e imigracionit*, Prishtinë.

ALEKSANDËR QIQI

Shkolla e Mesme “Abaz Shehu” Tepelenë

DANIELA QIQI

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

EVENTET SPORTIVE DHE IMPAKTI I TYRE EKONOMIK

ABSTRACT

Mega sport events attract millions of people from all over the world. However, there is a longstanding debate in the literature towards what the economic impact of such mega sport events have in the hosting country's economy. Authors who have studied this topic are split into two categories: the ones who make projections before the event (ex-ante) and predict that the benefits are huge and the others (ex-post) who, based on statistical analysis of the data, generally conclude that a mega sport event has no positive impact on the hosting country's economy and in some cases this impact might also be negative. The selected indicators to be analyzed in this paper are GDP per capita and the unemployment rate of the hosting countries. The statistical analysis is focused on two mega sports events: the Olympic Games (Summer & Winter) and the World Football Championship held in the period between 1966 and 2013. As a general conclusion it appears that these events should be oriented mainly to developing countries because the economic impact of this organization has been generally positive.

Key Words: *Sport Events, Economic Impact, Developing Countries.*

Hyrje

Tashmë është i njohur fakti se ngjarjet e mëdha sportive tërheqin miliona njerëz nga e gjithë bota. Në literaturë autorët debatojnë se çfarë mund të quhet ngjarje e madhe sportive, por të gjithë janë dakord se një ngjarje e tillë mund të ndikojë në aspektin ekonomik, turistik, kulturor, social, psikologjik dhe politik të vendit organizator.¹

Ka mjaft debate nëse këto ngjarje janë pozitive apo negative për vendin pritës dhe këto debate janë zhvilluar, pothuajse, për çdo ngjarje sportive, por konkurrenca e fortë midis vendeve potenciale për të organizuar një ngjarje të madhe sportive tregon se ekziston perceptimi universal që një event i madh sportiv sjellë mjaft përfitime për vendin në të cilin organizohet.

Në këtë këndvështrim, ky artikull shtron pyetjen: Cili është impakti i organizimit të një eventi të madh sportiv në ekonominë e vendit pritës? Dhe për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, është realizuar një analizë krahasuese e statistikave ekonomike ekzistuese që lidhen me dy evente sportive: Lojërat Olimpike (Verore & Dimërore) dhe Kampionati Botëror i Futbollit, të cilat pa dyshim mund të konsiderohen si ngjarje të mëdha sportive. Zgjedhja e këtyre dy ngjarjeve nuk është rastësore, por është bërë duke pasur parasysh që realizimi i tyre kërkon infrastrukturë e cila përbëhet nga objekte të mëdha, kosto kolosale dhe pritshmëritë e vendit organizator janë shumë të larta.

Gjithashtu, duke pasur parasysh se në studimet ekzistuese është trajtuar përgjithësisht impakti i një ngjarjeje specifike në qytetin apo vendin pritës, në këtë artikull janë përdorur të dhëna për të gjitha organizimet e këtyre eventeve që nga viti 1966 deri në 2013 dhe analizohet ndikimi i këtyre dy ngjarjeve në ekonominë e vendit

¹ O'Reilly, Lyberger, McCarthy & Seguin (2008). Mega-Special-Event Promotions and Intent To Purchase: A Longitudinal Analysis of the Super Bowl, fq.392

organizator.

1- Rishikimi i literaturës

Në përgjithësi, literatura ekzistuese për këtë çështje është e ndarë në dy kategori: analiza (ex-ante) përpara eventit dhe (ex-post) pas eventit. Studimet ex-ante realizohen për të nxitur qeveritë e shteteve të ndryshme që të mbështesin organizime të tilla nëpërmjet subvencioneve të mëdha publike për të përballuar shpenzimet për infrastrukturën e nevojshme dhe monitorimin e eventit. Studimet ex-post janë më tepër akademike dhe sjellin rezultate të larmishme, në varësi të autorit dhe eventit që është studiuar. Megjithatë, shumica e literaturës analizon efektin e një organizimi të vetëm sportiv në një rajon të caktuar. Vetëm Tien, Lo, dhe Lin (2011)² realizuan një studim më të gjerë, duke përdorur statistikat dhe bazën e të dhënave të disa vendeve organizatore të Lojërave Olimpikë (verore dhe dimërore), për të përcaktuar ndikimin e këtyre lojërave në ekonominë e vendeve pritëse .

1.1 Studimet ex-ante

Studimi Matheson (2006) trajton efektet kombëtare dhe ndërkombëtare të eventeve kryesore sportive. Ky studim thekson vlefshmërinë e studimeve ex-ante, siç është ai i realizuar nga Dentsu Humanities Institute i cili parashikon impaktin ekonomik në Japoni dhe Korenë e Jugut (2002) apo ai i realizuar nga Shoqata e Futbollit të Afrikës së Jugut përpara Kupës së Botës (2010) në Afrikën e Jugut. Në këto studime parashikohet numri i vizitorëve të tërhequr vetëm nga eventit, numri i ditëve dhe shuma që secili vizitor do të shpenzojë. Më tej këto shifra përpunohen për të vlerësuar edhe impaktin ekonomik indirekt në ekonominë e vendit duke shumëzuar efektin ekonomik direkt me multiplikatorin (një koeficient statistikor). Matheson (2006) thotë se multiplikatori në këto studime është rreth 2, kështu që "impakti i përgjithshëm

² Tien, Lo& Lin (2011). The economic benefits of mega events: A myth or a reality? A longitudinal study on the Olympic Games.

ekonomik është dy herë më i madh se kostot fillestare"³ Ndërsa studimet ex-post thonë se multiplikatori 2 është jashtëzakonisht i lartë dhe se studimet ex-ante bëjnë parashikime “heroike” në lidhje me situatën ekonomike dhe vlerësimin e variablave që përcaktojnë ndikimin ekonomik të eventit. Ata që kryejnë shumicën e studimeve ex-ante janë të prirur për të mbivlerësuar ndikimin ekonomik të eventeve sportive, por megjithatë, ka edhe studime që janë bërë nga akademikët.

Kështu, studimi Alhert (2001) është një qasje ex-ante dhe parashikon ndikimin e Kupës së Botës 2006 në ekonominë gjermane. Ky studim përdor një model kompleks “input-output” së bashku me hipoteza të ndryshme dhe tregon një efekt pozitiv të ngjarjes në treguesit e të ardhurave dhe të punësimit në vendin pritës. Studimi tregon, gjithashtu, se në qoftë se taksat do të ishin rritur përpara turneut për të financuar shpenzimet e qeverisë, atëherë PBB do të ishte rritur ndjeshëm, (rreth 0.05%) ⁴dhe ndikimi në punësim në vitet e ardhshme do të ishte pozitiv.

Nga ana tjetër, studimi i Humphreys dhe Prokopowicz (2007), i cili përdor një analizë të thjeshtë kosto-përfitim, nuk tregon rezultate pozitive për Poloninë dhe Ukrainën si pritëse të EURO 2012, sepse në këtë rast shpenzimet i tejkaluan të ardhurat. Metodologjia e kërkimit bazohet në vlerësimin e kostove në katër kategori të ndryshme: infrastrukturë, hoteleri, siguri publike dhe kostot e objekteve sportive. Ndërsa përfitimet direkte dhe indirekte ata i vlerësojnë nga numri i turistëve të huaj, gjatësia mesatare e qëndrimit dhe shpenzimeve mesatare ditore të tyre, si dhe përmirësimi në infrastrukturës. Megjithatë, autorët konkludojnë se turneu mund të sjellë përfitime të tjera, siç janë mbulimi nga media, krenaria kombëtare dhe njohja globale e këtyre vendeve.

³ Matheson V. A. (2006). Mega-events: The effect of the world's biggest sporting events on local, regional and national economies, fq. 3

⁴ Ahlert, G. (2001). The economic effects of the soccer world cup 2006 in Germany with regard to different financing, fq. 125

1.2 Studime “ex-post”

Mjaft studime “ex-post” krahasojnë ekonominë e një qyteti apo vendi pritës para, gjatë dhe pas një eventit të madh sportiv, duke analizuar të ardhurat për frymë, punësimin dhe situatën fiskale të vendit. Por, studimet “ex-post” përballen me sfidën e identifikimit të ndikimit të një eventit sportiv në ekonominë e një vendi, sepse, p.sh., ngjarje si Lojërat Olimpike, Super Bowl dhe World Series zhvillohen në të njëjtin qytet të një shteti dhe ata duhet të dallojnë rritjen ekonomike nga zhvillimi i eventit sportiv nga rritja që vjen nga ndryshimet në ciklin e biznesit. Prandaj, studimet e këtij lloji realizohen zakonisht në nivel rajonal, madje, edhe për Kupën e Botës, pavarësisht se ajo zhvillohet në qytete të ndryshme të një vendi.

Hotchiss, Moore dhe Zobay (2003) analizojnë Lojërat Olimpike në vitin 1996 në Gjeorgji dhe sjellin rezultate pozitive. Autorët përdorin teknikën difference in difference për të analizuar të dhënat e tyre (p.sh të dhënat mbi pagat nominale janë konvertuar në paga reale). Gjithashtu, ata përdorin edhe modelin e rritjes së rastësishme (random-growth model) për të krahasuar punësimin dhe pagat pas garave me punësimin dhe pagat para garave. Autorët konkludojnë se punësimi është rritur jo vetëm në prefekturat që u zhvilluan garat, por në të gjitha prefekturat e Gjeorgjisë, ndërkohë që efekti në paga ishte i parëndësishëm.

Një studim tjetër që flet për një ndikim pozitiv ekonomik të një ngjarjeje të madhe sportive është ai i Lee & Taylor (2005). Autorët përdorin një model input-output për të vlerësuar ndikimin e Kupës së Botës (2002) në Korenë e Jugut. Studimi përdor të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve të kryera në pikat hyrëse dhe dalje të vendit për të vlerësuar karakteristikat e turistëve (shpenzimet, kohëqëndrimin, arsyen e vizitës etj.) si dhe të dhënat nga Bilanci i Pagesave. Të dhënat e mbledhura nga anketa shumëzohen me multiplikatorin turistik, i cili përcaktohet nga

bilanci kombëtar i pagesave. Multiplikatori përdoret për të vlerësuar ndikimin direkt dhe indirekt të turistëve në ekonominë koreane. Me këtë metodologji, autorët llogaritën se "Kupa e Botës kishte një ndikim ekonomik prej 1.35 miliardë dollarë në prodhim (shitje), 307 milionë \$ në të ardhura dhe 713 milionë \$ në vlerë të shtuar për Korenë e Jugut".⁵

Ndërkohë, shumica e studimeve "ex-post", ndryshe nga sa më sipër, konkludojnë se ngjarjet kryesore sportive nuk kanë ose kanë një ndikim negativ ekonomik në vendin pritës. Në studimin e tyre, Baade dhe Matheson (2005) studiojnë marrëdhënien ndërmjet ngjarjeve sportive të mëdha dhe shitjeve të taksuara, duke përfshirë një gamë më të gjerë të ngjarjeve sportive, si: Super Bowl, Kupën e Botës dhe World Series. Autorët argumentojnë se shitjet e taksuara janë treguesi më i mirë për të matur ndikimin e një ngjarjeje të madhe sportive për shumë arsye. Së pari, ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë ndërmjet shitësve dhe infrastrukturave sportive në të cilat zhvillohen eventet e mëdha sportive. Shumë stadione të ndërtuara për evente të veçanta si Kupa e Botës financohen nga taksat vendore. Së dyti, shitjet e taksuara përfshijnë shpenzimet e konsumit, që është komponenti më i rëndësishëm i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe për këtë arsye është një tregues i mirë i aktivitetit ekonomik⁶. Së fundi, autorët argumentojnë se përdorimi i shitjeve të taksuara është më i mirë për të vlerësuar ndikimin ekonomik të një eventit të madh në krahasim me përdorimin e statistikave të të ardhurave sepse është e vështirë të veçohen të ardhurat nga luhatjet e ciklit të biznesit. Për më tepër, të ardhurat për frymë dhe shifrat e punësimit janë tregues vjetorë dhe është e vështirë përlllogaritja e të dhënave vetëm për një muaj që zhvillohet eventit sportiv, ndërsa shitjet e taksuara mund të përlllogariten edhe

⁵ Lee C. & Taylor T. (2005). Critical reflections on the economic impact assessment of a mega-event: The case of 2002 FIFA World Cup, fq. 595.

⁶ Baade & Matheson (2005). Selling the big game: Estimating the economic impact of mega- events though taxable sales, fq. 10.

mujore. Pra, shitjet e taksuara janë mjeti më i mirë i ndërmjetëm për të vlerësuar ndikimin ekonomik të eventeve të mëdha sportive. Autorët konkludojnë se evente të mëdha si Kupa e Botës apo World Series kanë një korrelacion negativ me shitjet e taksuara, por ata pranojnë se në çdo studim ekonometrik ekziston një shkallë pasigurie dhe rekomandojnë që shtetet duhet të jenë të kujdesshëm kur hartojnë ofertat për organizimin e eventeve të mëdha sportive.

Studimi i Baade dhe Matheson (2004) vlerëson ndikimin ekonomik të Kupës së Botës 1994, të organizuar nga Shtetet e Bashkuara. Ata përdorin modele dhe variabla të vjetra për të llogaritur rritjen ekonomike pas eventit. Vlerësimi i ndikimit ekonomik është bërë duke krahasuar rritjen e parashikuar ekonomike pa zhvillimin e eventit me rritjen ekonomike reale në qytetet që u zhvilluan ndeshje. Modeli që përdoret bazohet në ndryshimet e treguesit të të ardhurave për shkak të organizimit të Kupës së Botës dhe përdor të dhëna historike deri në njëzet vjet përpara zhvillimit të saj, nga 1970-2000. Studimi arriti në përfundimin se ndërkohë që në disa zona si Chicago efekti ishte pozitiv, për Los Anxhelos, Nju Jork dhe San Francisko pasojat ishin negative. Këto efekte negative të vitit 1994 ishin 9.26 miliardë dollarë. Pra, ky event sportiv jo vetëm që nuk solli efektin pozitiv prej 4 miliardë dollarësh që pritej, por gjithashtu shkaktoi dëme në ekonominë amerikane.

Ndërsa studimi i Tien, Lo dhe Lin (2011) përdor modelin e regresionit dhe të event study për të kontrolluar secilin nga parametrat kryesorë ekonomikë dhe për të përcaktuar përfitimet ekonomike të Lojërave Olimpikë. Studimi përdor një periudhë prej nëntë vjetësh (katër vjet para Olimpiadës, viti i Lojërave Olimpikë, dhe katër vjet pas Lojërave Olimpikë), për të shqyrtuar ndikimin ekonomik të organizimit të Lojërave Olimpikë, në treguesit e PBB, papunësisë dhe investimeve. Gjetjet tregojnë se organizimi i lojërave nuk sjell një zhvillim të qëndrueshëm në vendet pritëse, por ka një ndikim pozitiv afatshkurtër në PBB dhe në papunësinë e

vendit pritës (efekti i madh është në periudhën para lojërave, jo gjatë ose pas tyre). Prandaj, studimi pajtohet me literaturën ekzistuese, që shumica e eventeve sportive nuk kanë pasojë ekonomike të rëndësishme për qytetet dhe shtetet pritëse.

1.3 Dobësitë e bibliografisë

Pavarësisht qëllimit për të bërë një analizë cilësore, literatura ekzistuese mund të japë parashikime ekonomike false dhe kjo ndodh për shkak të disa arsyeve teorike ekonomike.

Arsyeja e parë është një teori themelore e ekonomisë, kostoja oportune. Ekonomistët nuk mund të vlerësojnë me saktësi përfitimet ekonomike të ngjarjeve sportive, sepse nuk mund t'i marrin parasysh të gjitha kostot oportune. Edhe nëse disa autorë konkludojnë se një ngjarje e madhe sportive ka një ndikim pozitiv në ekonominë e vendit pritës, ata nuk llogaritin koston oportune të alternativës së ardhshme më të mirë. Një vend duhet të investojë në një ngjarje të madhe sportive, "vetëm nëse përfitimet neto nga ky investim tejkalojnë përfitimet nga një përdorim alternativ i burimeve"⁷.

Një tjetër çështje teorike që del në literaturë dhe që studion ndikimin ekonomik të një ngjarjeje të madhe sportive është dallimi midis koncepteve të "neto" dhe "bruto". Ka metoda që përdorin shpenzimet bruto të një eventi për të llogaritur ndikimin e tij në ekonominë e një vendi. Ajo që studiuesit injorojnë është se edhe banorët me banim të përhershëm shpenzojnë në të njëjtën kohë. Për të eliminuar këtë problem, ekonomistët duhet që nga shpenzimet totale të zbresin një përqindje që shpenzohet nga banorët e përhershëm të zonës. Megjithatë, ekonomistët argumentojnë se shpenzimet nga popullsia lokale janë minimale në krahasim me shpenzimet e turistëve që vizitojnë vendin vetëm për eventin dhe se moszbritja e tyre nga shpenzimet totale nuk do të

⁷ Baade & Matheson (2002) Bidding for the Olympics: Fool's gold? fq. 8.

ketë një efekt të rëndësishëm mbi rezultatet.

Gjithashtu, haset edhe efekti i “crowding out” i cili lidhet me vështirësinë për të “ndarë” turistët që vizitojnë vendin vetëm për eventin sportiv nga turistët që do ta vizitonin vendin gjithsesi. Kjo do të thotë se studimet nuk arrijnë t’i klasifikojnë turistët midis tyre dhe, rrjedhimisht, edhe shpenzimet neto të vizitorëve të eventit. Baade dhe Matheson (2005) konsiderojnë se ekziston edhe një efekt “ndryshimi në kohë”, “time switching” që lidhet me përsheptimin e vizitës në një vend për shkak të eventit sportiv. Për sa i përket shpenzimit kjo do të thotë se nuk ka rritje të shpenzimeve në vend për shkak të eventit, sepse gjithsesi do të ndodhte, ajo që ka ndryshuar është koha kur bëhet shpenzimi.

Një tjetër çështje teorike që lidhet me kostot është efekti i zëvendësimit. Kjo do të thotë që nëse një vend nuk do të fitonte zhvillimin e një ngjarjeje të madhe sportive dhe do ta bënte investimin në një sektor tjetër, ai mund të kishte të njëjtin ndikim në shpenzimet e saj të përgjithshme. Prandaj, ky fenomen zëvendësimi është një problem për matjen e rezultatit neto të eventit sportiv.

Çështja e fundit teorike është koncepti ekonomik i “rrjedhjeve”⁸. Në vendet pritëse, disa biznese mund t’i përkasin kompanive multinacionale (hotele, restorante, etj.) dhe të ardhurat e tyre shkojnë jashtë vendit, duke mos rritur të ardhurat lokale. Prandaj, përcaktimi i saktë i madhësisë së rrjedhjes është i nevojshëm për të llogaritur impaktin e eventit sportiv.

2- Përshkrimi i të dhënave dhe metodologjia

Gjatë historisë së Kampionateve Botërore të Futbollit dhe Lojërave Olimpike, vendet pritëse janë të ndryshme, por në këtë studim janë përfshirë 10 vende pritëse për Kupën e Botës dhe 17 vende për Lojërat Olimpike. Studimi fokusohet në ndikimin e

⁸ Baade & Matheson (2005). Selling the big game: Estimating the economic impact of mega- events though taxable sales, fq. 8.


eventit në të gjithë vendin pritës dhe jo vetëm në zonën ku zhvillohet eventit, me përjashtim të SHBA-ve. Në këtë rast të dhënat janë rajonale (zona ku u mbajtën Lojërat Olimpike) për shkak të madhësisë së vendit dhe ekonomisë së fortë, ndërsa analiza e të dhënave për Kupën e Botës përfshin të gjithë vendin. Gjithashtu, për analizën krahasuese janë përdorur të dhëna edhe për vende të cilat në të njëjtën periudhë nuk kanë zhvilluar një ngjarje të madhe sportive, me qëllim që të identifikohet qartë impakti ekonomik i eventit sportiv.

Treguesi i studiuar është norma e rritjes së PBB-së. Përzgjedhja e këtij treguesi është bërë duke pasur parasysh se nga një event i madh sportiv pritët një ndikim pozitiv në PBB e vendit. Të dhënat për normat e rritjes së PBB-së janë pothuajse për të gjitha vendet për periudhën 1962-2013.

Studimi gjithashtu, analizon ndikimin e ngjarjeve të mëdha sportive në vendin pritës jo vetëm në vitin e zhvillimit, por edhe para eventit dhe pas tij. Kjo është arsyeja pse të dhënat janë që prej vitit 1962, edhe pse studiohen eventet 1966-2013. Të dhënat janë të shtrira në kohë, sepse dihet që përgatitjet për evente të tilla duan shumë kohë si dhe ka objekte të reja për t'u ndërtuar. Prandaj, pritët që ndikimi në ekonomi të fillojë para eventit dhe do të vazhdojë edhe disa vite më vonë. Për vendet e përfshira në studim është përdorur klasifikimi që ka bërë Banka Botërore⁹ në vende të zhvilluara dhe vende në zhvillim sipas treguesit të PBB për frymë. Grafiku në vazhdim (2.1) tregon qartë se shumica e vendeve organizuese i përkasin kategorisë së vendeve të zhvilluara. Studimi nxjerr disa përfundime bazuar në analizën statistikore të të dhënave.

⁹ <http://data.worldbank.org/about/country-and-lending-groups>

Grafiku 2.1 Vendet pritëse të eventeve të mëdha sportive



3- Analiza statistikore e të dhënave

Kjo pjesë e artikullit do të analizojë se si treguesit ndryshojnë në vende të ndryshme pritëse me kalimin e kohës. Të dhënat e përdorura u morën nga statistikat e Bankës Botërore¹⁰ dhe OECD¹¹. Në tabelën 3.1 paraqiten vendet pritëse, lloji i eventit dhe viti i organizimit. Në total janë 18 vende dhe 9 prej tyre kanë organizuar të dy eventet e përzgjedhura Lojërat Olimpike dhe Kupën e Botës.

Tabela 3.1 Shtetet që kanë organizuar evente sportive botërore për periudhën (1966-2013)

Shteti	Lojërat Olimpike	Kampionat Botëror
Argjentina		1978
Australia	2000	
Austria	1976	
Franca	1968,1992	1998
Gjermania	1972	1974,2006
Greqia	2004	
Anglia	2012	1966
SHBA	1980,1984,1996,2002	1994
Japonia	1972,1998	2002
Spanja	1992	1982
Italia	2006	1990
Kanada	1976,1988,2010	

¹⁰ <http://www.worldbank.org/>

¹¹ <http://stats.oecd.org/>

Kina	2008	
Meksika	1968	1970,1986
Norvegjia	1994	
Afrika e Jugut		2010
Koreja e Jugut	1988	2002
Rusia	1980	
Totali	23	12


Burimi: Faqja zyrtare e FIFA dhe IOC¹²

Literatura sugjeron se për të pasur rezultate reale, është e rëndësishme që ekonomia e vendit pritës të studiohet jo vetëm në vitin në të cilin zhvillohet ngjarja, por disa vjet para dhe pas saj. Bazuar në studimin e Tien, ja dhe Lin (2011), qasja dhe mënyra e të cilit është mjaft e ngjashme me qasjen e këtij artikulli, luhatjet në ekonominë e vendit duhen studiuar gjatë një periudhe prej nëntë vjetësh: katër vjet para ngjarjes , në vitin e ngjarjes dhe katër vjet më vonë.

Në grafikun 3.2 jepen disa nga vendet e zhvilluara organizatore të të dy eventeve dhe norma mesatare e rritjes së PBB-së për frymë e këtyre vendeve në vitin që është zhvilluar eventi. Për të izoluar ndikimin e eventit ajo krahasohet me normën mesatare të rritjes së PBB-së për frymë të vendeve të tjera që nuk kanë organizuar event të tillë në të njëjtin vit (RoW). Krahasimi këtyre dy parametrave çon në konkluzionin se në përgjithësi vendet e zhvilluara kanë pasur një rritje më të ulët të PBB-së gjatë vitit të organizimit të një ngjarje sportive se sa vendet që nuk kanë pritur një ngjarje të tillë. Por, vihet re gjithashtu se ka edhe përjashtime, si në rastin e SHBA dhe Francës, të cilat duket se kanë pasur rritje më të lartë të PBB-së, krahasuar me normën e rritjes së PBB-së globale.


¹² <http://www.fifa.com/mm/document/fifafacts/mencompovw/51/99/03/133485-factsheet-fifahostcountriesoverview1930-2022.pdf>
<http://www.olympic.org/>

Grafiku 3.2 Norma mesatare e rritjes së PBB/frymë në vendet e zhvilluara, viti i eventit.



Grafiku 3.3 tregon rritjen e PBB-së për frymë në vendet në zhvillim në vitin që ky vend organizoi një ngjarje sportive. Metoda e prezantimit dhe e krahasimit është e njëjtë me grafikun e mëparshëm. Ajo që ndryshon nga grafiku i mëparshëm është rezultati. Në vendet në zhvillim, norma e brendshme e rritjes së PBB për frymë është më e lartë se pjesa tjetër e botës në vitin e organizimit të eventit sportiv. Prandaj, në vendet në zhvillim organizimi i një ngjarjeje të madhe sportive ka ndikim pozitiv në rritjen e PBB-së. Sigurisht, ka edhe përjashtime, siç është Afrika e Jugut, sepse rritja e PBB-së vendase në vitin e eventit ishte më e ulët se në pjesën tjetër të botës.


Grafiku 3.3 Norma mesatare e rritjes së PBB-së/frymë në vendet në zhvillim, viti i eventit.



Në vazhdim analizohet i njëjti tregues për të gjitha vendet për nëntë vjet rresht. Grafiku më 3.4, tregon normën mesatare të rritjes së PBB për frymë në vendet e zhvilluara për çdo vit të periudhës

nëntë-vjeçare. Norma mesatare e rritjes së PBB-së për frymë është llogaritur bazuar në normat mesatare të rritjes së të gjitha vendeve të zhvilluara të cilat kanë organizuar një event të madh sportiv. Për të identifikuar efektin e eventit, jepet gjithashtu edhe norma mesatare e rritjes së PBB për frymë edhe për vendet e zhvilluara të cilat nuk kanë organizuar ndonjë eveniment sportiv, të llogaritur në të njëjtën mënyrë. Rezultati i krahasimit është negativ, dmth norma mesatare globale e rritjes së PBB-së për frymë është më e lartë se norma mesatare e rritjes së PBB-së për frymë të vendeve që kanë zhvilluar eventin pothuajse për çdo vit të periudhës së analizuar. I vetmi efekt pozitiv i qartë mbi ekonominë e këtij grupi shtetesh vërehet dy vjet përpara ngjarjes. Ndërsa një vit më parë, është vërejtur pothuajse e njëjta normë mesatare e rritjes së PBB për frymë.

Grafiku 3.4 Norma mesatare e rritjes së PBB/frymë në vendet e zhvilluara gjatë periudhës nëntëvjeçare¹³




Për grupin e vendeve në zhvillim, janë bërë të njëjtat llogaritje si për vendet e zhvilluara. Mënyra e paraqitur në Grafikon 3.5 është e njëjtë. Por ndryshe nga vendet e zhvilluara, për këtë grup vendesh është vërejtur se eventit ka një ndikim pozitiv në normën e rritjes së PBB-së për frymë në të gjitha vitet që studiohen. Viti i vetëm kur rritja e PBB-së për frymë është e barabartë me normën e rritjes së PBB-së për frymë të vendeve të tjera është viti i dytë pas ngjarjes. Grafiku tregon qartë se për vendet në zhvillim ndikimi pozitiv i

¹³ katër vjet para ngjarjes, vitin e ngjarjes dhe katër vjet më vonë


organizimit të një ngjarje sportive në normën e rritjes së të PBB-së për frymë është e rëndësishme dhe afat-gjatë.

Grafiku 3.5 Norma mesatare e rritjes së PBB/frymë në vendet në zhvillim gjatë periudhës nëntëvjeçare¹⁴



Në vazhdim të analizës, Grafiku 3.6, është bërë krahasimi i të njëjtit tregues (norma mesatare e rritjes së PBB-së/frymë), për të dy grupet (vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim) midis tyre dhe normës globale për të gjithë periudhën në studim.

Grafiku 3.6 Normat mesatare të rritjes së PBB-së/frymë në vendet e zhvilluara, në zhvillim dhe globale



Nga krahasimi i mësipërm vihet re se ndikimi pozitiv i organizimit të një eventi të rëndësishëm sportiv në normën e rritjes së PBB-së për frymë për vendet në zhvillim në krahasim me rritjen

¹⁴ katër vjet para ngjarjes, vitin e ngjarjes dhe katër vjet më vonë

globale është më i madh sesa ndikimi negativ në vendet e zhvilluara në krahasim me rritjen globale.

Prandaj, konkluzioni i kësaj analize është se vendet në zhvillim duhet të konkurrojnë vazhdimisht për organizimin e një eventi të madh sportiv, sepse kështu ato njëkohësisht krijojnë mundësitë për zhvillim në aspektin ekonomik, turistik, kulturor, social, psikologjik dhe pse jo edhe politik të vendit.

Referenca:

Ahlert G. (2001). *The economic effects of the soccer world cup 2006 in Germany with regard to different financing*. Economic Systems Research, 13(1), 109-127.

Baade R. A. & Matheson V. A. (2005). *Selling the big game: Estimating the economic impact of mega- events though taxable sales*. Worcester, Mass., USA: College of the Holy Cross.

Baade R. & Matheson V. (2002). *Bidding for the Olympics: Fool's gold?* Transatlantic sport: The comparative Economics of North American and European Sports, 127.

Lee C. & Taylor T. (2005). *Critical reflections on the economic impact assessment of a mega-event: The case of 2002 FIFA World Cup*. Tourism Management, 26(4), 595-603.

Matheson V. A. (2006). *Mega-events: The effect of the world's biggest sporting events on local, regional and national economies*. College of the Holy Cross, Department of Economics Faculty Research Series, Paper, (06-10)

O'Reilly, Lyberger, McCarthy & Seguin (2008). *Mega-Special-Event Promotions and Intent to Purchase: A Longitudinal Analysis of the Super Bowl*. [Journal of Sport Management](#), 22(4), 392.

Tien C., Huai-Chun Lo & Hsiou-Wei Lin (2011). *The economic benefits of mega events: A myth or a reality? A longitudinal study on the Olympic Games*. Journal of Sport Management, 25(1), 11-23.

Irena Boboli

Valbona Duri

Drita Luzo

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë

KARAKTERISTIKAT E UDHËTIMIT DHE TË SJELLJES NË DESTINACION TË VIZITORËVE NË ZONËN RURALE TË GJIROKASTRËS

ABSTRACT

Tourism is considered one of the most important economic activity in global economy and for many regions an important factor regarding economic development. Its impact in rural areas is economical, socio-cultural, environmental and measuring this impact is important for local economies. Under this optic understanding visitors needs, behavior and travel characteristics is a necessity. In this paper it will be presented a description of the characteristics of travel and behaviour of visitors in the rural area of Gjirokastra, an area which is characterized by a variety of cultural and natural attractions, convenient geographical location and easily accessible and where some forms of tourism are identified. Determining the profile of tourists will help in adapting the tourist product of the area.

Hyrje

Turizmi prej kohësh konsiderohet si një mjet për zhvillim ekonomik për shkak të aftësisë për të gjeneruar përfitime ekonomike të konsiderueshme në rajonet dhe komunitetet pritëse (Craggs & Schofield, 2009). Turizmi është një fenomen kompleks ekonomik dhe social, ndaj dhe studimi i aspekteve të sjelljes së aktorëve kryesorë të tij (turistëve), ka një dimension të gjerë për të kuptuar nevojat e tyre, motivet, motivimin dhe qëndrimet gjatë fazave të para-vendimit dhe vendimit para se të udhëtojnë (Marujo *et al*, 2012). Matja e impaktit të turizmit është e rëndësishme për ekonominë lokale dhe njohja e nevojave turistike të konsumatorëve përbën një dosmosdoshmëri.

Turizmi për shkak të zhvillimit dhe ndikimit të tij në ekonominë botërore tashmë përbën një fushë të rëndësishme komplekse studimi. Fenomeni turistik duhet të studjohet nga këndvështrimi i shumë fushave të ndryshme shkencore si marketingu, manaxhimi, psikologjia, gjeografia, ekonomia, historia, antropologjia, shkencat politike dhe rregullimit të territorit (Ritchie & Goeldner, 1994). Gjithashtu karakteri ndërkombëtar i tij çon në domosdoshmërinë e mbledhjes së të dhënave nga kampione që dallohen për ndryshime dhe veçanti të theksuara kulturore (Craig & Douglas, 2005).

Zona e Gjirokastrës është një nga destinacionet më të preferuara në Shqipëri e cila tërheq një numër të konsiderueshëm vizitorësh vendas dhe të huaj dhe ku oferta turistike është e shumëllojshme. Potenciali turistik që ka Gjirokastra mund të ofrojë një shumëllojshmëri produktesh kryesore turistike, si turizëm të kulturës dhe trashëgimisë, rural dhe të natyrës, por jo vetëm, akoma dhe produkte dytësore dhe të turizmit të interesit të veçantë. Është e rëndësishme për produktet turistike të kuptohet sjellja e udhëtimit dhe më specifikisht motivet e udhëtimit të turistëve, sikundër mund të ndihmojë në zhvillimin e produktit, të përmirësojë strategji marketingu, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe krijimin e një

avantazhi konkurrues. Rrjedhimisht, sjellja e udhëtimit luan një rol të rëndësishëm në turizëm, si koncept, industri dhe ekonomi, dhe studimin e kërkesës (Van Vuuren & Slabbert, 2011).

Ndërkohë që modelet e sjelljes së konsumatorëve po specifikohen gjithnjë e më shumë, njohja e profilit të vizitorit-konsumator, preferencave, sjelljes në destinacion dhe përcaktimi i kërkesës turistike të tij përbën faktor të rëndësishëm. Informacioni në lidhje me profilin e turistëve dhe fokusimi në tregje të caktuara do të sigurojë sukses dhe zhvillim të qëndrueshëm të destinacionit.

Rishikim i literaturës

Informacioni turistik mund të kërkohet për një sërë qëllimesh, p.sh. për të vlerësuar ndikimin ekonomik dhe kontributin që ai ka për ekonominë lokale, ndikimet mjedisore të aktivitetit të tij apo përfitimet dhe disavantazhet për komunitetet lokale.

Shumica e studimeve ekzistuese kanë përdorur numrin e mbritjeve turistike për matjen e kërkesës ndërkombëtare turistike. Megjithatë, produkti turistik nuk është vetëm një mall, por një paketë të mirash dhe shërbimesh të blera nga turistët. Sjellja blerëse e turistëve ka gjithashtu gjasa të ndryshojë për shkak se turistët ndryshojnë nga pikpamja e aspekteve demografike të tyre, kohëzgjatja e qëndrimit, llojet e akomodimit të përdorura, qëllimi i vizitës, dhe shumë aspekte të tjera. Këto variacione çojnë në ndryshime në shpenzimet midis turistëve. Rrjedhimisht, përdorimi i mbritjeve turistike, të cilat nuk pasqyrojnë modelet konsumatore turistike dhe shpenzimet e konsumit turistik, nuk mund të matin saktësisht ndikimin ekonomik të turizmit në destinacion¹.

¹Wang, Y., & Davidson, M. C. (2010). A Review of Micro Analyses of Tourist Expenditure. <http://www98.griffith.edu.au/dspace/bitstream/handle>, fq 3

Studimet makro dhe mikro ekonomike u shërbejnë qëllimeve të ndryshme. Ndërkohë, modelet mikroekonomike rezultojnë të kenë avantazhe ndaj modeleve makroekonomike, pasi ato nuk devijojnë shumë nga modelet ekonomike të teorisë konsumatore. Gjithashtu, ato lejojnë kontrollin e njësive pjesmarrëse, të cilat merren parasysh kur analiza bazohet në informacionin agregat. Dhe së fundmi, njohin diversitetin dhe heterogjenitetin e sjelljeve konsumatore të cilat nuk merren parasysh në studime të cilat përdorin të dhëna agregate (Wang & Davidson, 2010). Avantazhi kryesor në përdorimin e të dhënave mikro përfshin faktin që këto të dhëna raportojnë shpenzimet e udhëtarëve individualë së bashku me karakteristikat demografike, sociale ose të tjera karakteristika, të cilat mund të përdoren për të kontrolluar (ose profilizuar) njësitë e analizuara (Belenkiy & Riker, 2013). Kërkesa turistike përcaktohet nga një sërë faktorësh ekonomikë, socialë, psikologjikë, sociologjikë, demografikë, institucionalë, politikë, kulturorë, të jashtëm dhe teknologjikë. Këta faktorë përcaktohen nga një seri variablash.

Midis variablave më të rëndësishën që përcaktojnë kërkesën janë: karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të turistëve, motivet e tyre, të ardhurat e disponueshme, koha e disponueshme dhe vendi i origjinës së tyre (Patsouratis, 2002). Sipas (Kim, 2002) është e rëndësishme që profesionistët e industrisë turistike duhet të identifikojnë ato ide, teori dhe ideologji të rëndësishme për “konsumatorët” e tyre, për të siguruar shërbimet dhe eksperiencat e dëshiruara nga turistët.

Metoda e studimit


Në këtë punim do të përshkruajmë karakteristikat e udhëtimit dhe sjelljes në destinacion të vizitorëve në zonën rurale të Gjirokastrës. Në funksion të këtij studimi është zhvilluar një anketim që konsistoi në mbledhjen e informacionit të nevojshëm.

Nëpërmjet pyetjeve të strukturuar drejtuar vizitorëve të zonës së studimit, u mbledhën të dhënat në lidhje me karakteristikat e udhëtimit dhe të sjelljes në destinacion të vizitorëve. Periudha e anketimit ishte periudha maj-shtator 2015, për arsye se kjo periudhë përkon me fluksin më të madh turistik në zonë. Gjatë kësaj periudhe u plotësuan rreth 300 pyetësorë që lejoi një marzh gabimi 5,67%. Nga përlogaritja e fluksit të vizitorëve rezultoi se gjatë muajit maj do të realizoheshin 18% e anketave, në muajin qershor 16% e anketave, gjatë muajit korrik 18% e anketave, gjatë muajit gusht do të realizoheshin 26% e anketave dhe gjatë muajit shtator 22% e anketave. Zgjedhja e mostrës ishte probabilitare dhe u përdor zgjedhja klaster në dy faza. Në fazën e parë u përcaktuan disa nga pikat e lëvizjes së vizitorëve dhe në fazën e dytë, u bë një zgjedhje e rastësishme e vizitorëve në këto pika.

Rezultatet e studimit

Përqindja më e madhe e vizitorëve udhëtonin në mënyrë individuale 64,50% kundrejt 35.50% që udhëtonin në grup. Pjesa më e madhe e vizitorëve 77.40%, preferojnë të qëndrojnë disa ditë në zonë për disa arsye: eksplorimi i të gjitha vendeve nuk mund të bëhet brenda një dite, një pjesë e tyre përshkron rrugët antike dhe të mesjetes me karvane, udhëtim i cili kërkon disa ditë për t'u realizuar, shumë vizitorë shfrytëzojnë periudhën e eventeve kulturore. Vizitorët udhëtonin të shoqëruar kryesisht nga shokë-miq 54 %, nga bashkëshorti/ja 26%, nga e gjithë familja 13,3%. Pra afro gjysma e vizitorëve udhëtojnë të shoqëruar nga familja (grafiku 1).


Grafiku 1: Shoqëruesi



Burimi: Anketa 2015

Për transportin e tyre, përdorin kryesisht makinën 42.20%, mikrobusin 25,60%, autobusin 24,4% dhe një pjesë më e vogël 3,30% kanë përdorur rulot, 3% kanë bërë guida me kalë, ndërsa 1,50% kanë lëvizur me autostop (grafiku 2).

Grafiku 2: Mjeti i transportit



Burimi: Anketa 2015


Një pjesë e rëndësishme e karakteristikave të udhëtimit lidhet me burimin e informacionit për të vizituar zonën, ku nga anketat rezultoi se burimi kryesor i informacionit ishin të afërmit-miq të 40% (grafiku 3). 11.5% u përgjigjën opsionit “tjetër” ku si burim informacioni kryesisht ishin guidat turistike, ekspozitat turistike, GCDO (Gjirokastra Conservation and Development Organization) dhe njohja e veprës së Kadaresë.

Për sa i përket planifikimit të udhëtimit për pjesën më të madhe 43,7% koha për të vendosur ishte 15 ditë deri 2 muaj (grafiku 4). Ndërkohë që për sa i përket mënyrës së prenotimit pjesa më e madhe 32.20% nuk kishin prenotuar (grafiku 6.14). Mbështetur në opinionet e vizitorëve ato nuk prenotojnë për disa arsye:

- Nuk ka qënë qëllimi kryesor i vizitës turizmi në Gjirokastrë
- Tërhiqen nga aventura
- Janë njohës shumë të mirë të zonës pasi këtë tip turizmi e kanë të përsëritur
- Mungesë besimi nga guidat turistike apo faqet e internetit

- Mendojnë të qëndrojnë vetëm për një kohë të shkurtër në zonë


Grafiku 3: Burimi i informacionit



Burimi: Anketa 2015

Një nga elementët e rëndësishëm të një udhëtimi është dhe akomodimi. Rezultatet treguan që 48.50% e vizitorëve akomodohehen në hotel, 21.9% preferon dhomat/shtepitë me qera, 10.7% akomodohehen tek të afërmit, ndërsa 18.9% i është përgjigjur opsionit “tjetër” ku përmendet kryesisht akomodimi në hostel, në rulot dhe kampingu në natyrë (grafiku 5).

Grafiku 5: Akomodimi




Burimi: Anketa 2015

Nga këta 35.8% e kanë vizituar për herë të dytë, 28.4% 3 deri në 4 herë dhe më shumë se katër 35.8% e tyre. Koha që ndërmjetësoi nga realizimi i vizitës së fundit të tyre ishte deri në 3-mujor 12.5%, 6-mujor 11.3%, deri 1 vit 38.8% dhe mbi një vit 37.5%. Vizitorëve të cilët kishin ardhur përsëri në Gjirokastrë, i'u kërkua të vlerësonin zonën në krahasim me vizitën e kaluar. Kështu sipas gjykimit të tyre

56.3% mendojnë se situata është më mirë.

Në përzgjedhjen e një destinacioni një rol të rëndësishëm luajnë dhe të gjithë faktorët pjesë përbërëse të një udhëtimi si: kosto e udhëtimit, transporti, akomodimi, veprimtaritë/infrastruktura, atraksionet, organizimi, etj. Në lidhje me rëndësinë që kanë këta faktorë në përzgjedhjen e një destinacioni në përgjithësi, vizitorëve i'u është kërkuar të japin vlerësimin e tyre me shkallën Likert ku 0=aspak i rëndësishëm deri te 3=shumë i rëndësishëm. Nga rezultatet shohim që të gjithë faktorët e mësipërm janë mesatarisht dhe shumë të rëndësishëm për vizitorët. Më konkretisht, faktori kosto vlerësohet 10% aspak, 16,3% pak, 38,12% mesatarisht dhe 35,5% shumë i rëndësishëm. Transporti vlerësohet 11% aspak, 16,3% pak, 44,5% mesatarisht dhe 28% shumë i rëndësishëm. Akomodimi vlerësohet 6,35% aspak, 28,4% pak, 42,5% mesatarisht dhe 22,7% shumë i rëndësishëm. Veprimtaritë/infrastruktura vlerësohen 4,5% aspak, 17% pak, 39% mesatarisht dhe 38,4% shumë të rëndësishme. Shumëllojshmëria e atraksioneve vlerësohet 3,3% aspak, 12% pak, 33,5% mesatarisht dhe 51,2% shumë e rëndësishme. Organizimi vlerësohet 11,8% aspak, 25% pak, 36% mesatarisht dhe 26,8% shumë i rëndësishëm. Faktori “tjetër” që vlerësohet 1,6% pak, 16,3% mesatarisht dhe 82% shumë i rëndësishëm për përzgjedhjen e një destinacioni specifikohet si unikaliteti i destinacionit, kultura, tradita, eksperiencat e reja, arti dhe historia, natyra, destinacione të panjohura, etj (grafiku 7). Pra krahas elementëve kryesorë të udhëtimit, si kosto, transporti, akomodimi, për vizitorët e zonës, një rol të veçantë luan dhe unikaliteti i destinacionit.

Grafiku 7: Pjesët përbërëse të një udhëtimi




Burimi: Anketa 2015

E njëjta pyetje është përdorur për të përcaktuar rëndësinë që luajnë faktorët pjesë përbërëse të një udhëtimi si: kosto e udhëtimit, transporti, akomodimi, veprimtaritë/infrastruktura, atraksionet, organizimi, etj në përzgjedhjen e Gjirokastrës si destinacion në veçanti, për të parë mundësinë e përmirësimit të tyre. Rezulton se për vizitorët, faktorët kosto, akomodimi dhe shumëllojshmëria e atraksioneve janë aspak ose pak të rëndësishëm për përzgjedhjen e Gjirokastrës si destinacion. Më konkretisht, faktori kosto vlerësohet 26,6% aspak 44,4% pak, 24,2% mesatarisht dhe 4,7% shumë i rëndësishëm. Transporti vlerësohet 10% aspak, 33,2% pak, 42,6% mesatarisht dhe 14,2% shumë i rëndësishëm. Akomodimi vlerësohet 24,2% aspak, 42,8% pak, 29% mesatarisht dhe 4% shumë i rëndësishëm. Veprimtaritë/infrastruktura vlerësohen 3,4% aspak, 14,5% pak, 54,7% mesatarisht dhe 27,4% shumë të rëndësishme. Shumëllojshmëria e atraksioneve vlerësohet 10,8% aspak, 59% pak, 20,3% mesatarisht dhe 9,8% shumë e rëndësishme. Organizimi vlerësohet 5,4% aspak, 18% pak, 44,4% mesatarisht dhe 32,2% shumë i rëndësishëm. Faktori “tjetër” që vlerësohet 100% shumë i rëndësishëm për përzgjedhjen e Gjirokastrës si destinacion specifikohet informacioni në lidhje me atraksionet e zonës. Pra elementët që luajnë rol në përzgjedhjen e destinacionit janë

kryesisht organizimi dhe veprimtaritë/infrastruktura si dhe mesatarisht kosto dhe akomodimi (grafiku 8).

Grafiku 8: Faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e Gjirokastrës si destinacion



Konkluzione

Potenciali turistik që ka Gjirokastra mund të ofrojë një shumëllojshmëri produktesh kryesore turistike, si turizëm të kulturës dhe trashëgimisë, rural dhe të natyrës, por jo vetëm, akoma dhe produkte dytësore dhe të turizmit të interesit të veçantë. Është e rëndësishme për destinacionin të kuptohen karakteristikat e udhëtimit të vizitorëve dhe më specifikisht sjellja në destinacion, pasi do mund të ndihmojë në përshtatjen dhe zhvillimin e produktit turistik, strategji marketingu dhe krijimin e një avantazhi konkurrues.

Për sa i përket karakteristikave të udhëtimit të vizitorëve në zonën rurale ata udhëtojnë kryesisht në mënyrë individuale, kanë planifikuar udhëtimin e tyre relativisht në një kohë të shkurtër, kryesisht pa prenotuar, burimi kryesor i informacionit për zonën janë miqtë/ të afërmit, qëndrojnë më shumë se 1 ditë.

Mjeti i transportit që përdorin për të vizituar zonën është makina, janë të shoqëruar kryesisht nga shokë/miq dhe akomodohen në hotel. Gjithashtu në vendimin e tyre për të vizituar një destinacion një rol të veçantë luan dhe unikaliteti i tij.

Nga faktorët kryesorë që ndikojnë në përzgjedhjen e Gjirokastres si destinacion janë organizimi dhe veprimtaritë/infrastruktura, ndërkohë mesatarisht ndikojnë kosto e udhëtimit dhe akomodimi. Ndërkohë faktori që vlerësohet 100% shumë i rëndësishëm për përzgjedhjen e Gjirokastres si destinacion specifikohet informacioni në lidhje me atraksionet e zonës.

Burimi i informacionit për të vizituar zonën janë kryesisht miqtë/të afërmit dhe ka mungesë informacioni për sa i përket atraksioneve të zonës.

Burime bibliografike

- Belenkiy, M., & Riker, D. (2013). Destination choices of individual international travellers. *Tourism Economics*, 19 (5) , fq. 1099-1106.
- Boboli, I. (2017). *Ndikimi I turizmit ne zhvillimin e zonave rurale te rrethit te Gjirokastres, Punim Doktorature*. Tirane.
- Craggs, R., & Schofield, P. (2009). Expenditure-based segmentation and visitor profiling at The Quays in Salford, UK. *Tourism Economics*, 15 (1), , fq. 243–260.
- Craig, S., & Douglas, S. (2005). *International Marketing Research (3rd edition)*. New York: John Wiley & Sons).
- Kim, K. (2002). THE EFFECTS OF TOURISM IMPACTS UPON QUALITY OF LIFE OF RESIDENTS IN THE COMMUNITY. *Dissertation submitted to the Faculty of the Virginia Polytechnic Institute and State University* .
- Kotler, P., & McDougall, G. (1983). *Principles of marketing*. Englewood Cliffs, NY: Prentice-Hall.
- Marujo, N., Serra, J. M., & Borges, M. d. (2012). VISITORS TO THE CITY OF ÉVORA: WHO ARE THEY? *European Journal of Tourism, Hospitality and Recreation*, Vol. 3, Issue 2 , fq. 91-108.
- Osmani, M. (2015). *Metodat e Statistikës për Ekonomistët*. Tiranë: Pegi.

- Patsouratis, B. A. (2002). H Antagwnistikotita tou Ellinikou Touristikou Tomea. *Institouto Touristikwn Ereywn kai Problepsewn, Meletes*;12 , fq. 35-36.
- Ritchie, J., & Goeldner, C. (1994). *Travel, Tourism and Hospitality Research: a handbook for managers and researchers*. (2nd edition). New York: John Wiley & Sons.
- Van Vuuren, C., & Slabbert, E. (2011). TRAVEL MOTIVATIONS AND BEHAVIOUR OF TOURISTS TO A SOUTH AFRICAN RESORT. *BOOK OF PROCEEDINGS VOL. I – INTERNATIONAL CONFERENCE ON TOURISM & MANAGEMENT STUDIES* – , fq. 295-304.
- Wang, Y., & Davidson, M. C. (2010). *A Review of Micro Analyses of Tourist Expenditure*.
<http://www98.griffith.edu.au/dspace/bitstream/handle>.

LEONARD SALA

Gjirokastër

**VËSHTRIM HISTORIK MBI TË DREJTËN
PENALE ZAKONORE SHQIPTARE**

ABSTRACT

A law in its broadest sense is a set of rules of conduct prescribed by a controlling authority that have binding legal force. The laws of a country can be created in different ways. Different ways of creation therefore entail different sources. In the hierarchy of sources of law customary law occupies a special place. Known through its variations the Kanun is a collection of unwritten laws and norms, passed down orally from one generation to another for centuries, which reflect the socio-economic situation of past periods and which in their time protected the interests of certain classes and strata of society.

Due to its importance, customary law is treated as one of the sources of law. In this article we focus precisely on Albanian customary criminal law. With this modest paper we aim to draw attention to the importance of the study of this set of laws, its institutions and the concepts that have reached us, through the Albanian customary criminal law of our time. Thus, our article aims to give a general and specific view of customary criminal law, emphasizing the main institutions that it addresses.

E drejta zakonore ka vepruar në mënyrë të vazhdueshme në vendin tonë që nga kohët e lashta e deri në mesin e shekullit të XX. E drejta zakonore nuk mund të thuhet se është tipar apo karakteristikë vetëm e popullit shqiptar, ajo ka vepruar edhe në shumë popuj të tjerë të Europës dhe të botës. Ajo paraqitet si tërësi e normave juridike, rregullave të sjelljes, të pashkruara, të vendosura në kohë të ndryshme e të përcjella në traditën gojore nga njëri brez tek tjetri dhe që shërbejnë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në mes njerëzve, në fusha të ndryshme të jetës, zbatimi i të cilave sigurohet sipas traditës nga vetë bashkësia e njësisë së vetëqeverisjes vendore, pa ndikimin e shtetit. Përveç kësaj rregullat e të drejtës zakonore pasqyrojnë gjendjen ekonomike-shoqërore të periudhave të kaluara dhe që në kohën e vet mbronin interesat e klasave e të shtresave të caktuara shoqërore. Ato paraqiten si besnikëria e njeriut ndaj bashkësisë ku ai jetonte, ndaj familjes, vëllazërisë, fisit, fshatit, e grupimeve të tjera sociale në të cilat ai ishte anëtar. Burimet e së drejtës zakonore shqiptare të njohur deri tani janë: Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Maleve dhe Kanuni i Labërisë.

Në antropologjinë juridike si karakteristikë e përbashkët e të drejtave të pashkruara (në rastin tonë e drejta kanunore) njihet dukuria e zbatimit nëpërmjet një bindje të brendshme, një mekanizmi të brendshëm psikologjik, pra jo vetëm prej frikës së zbatimit të një ndëshkimi fizik a ekonomik të jashtëm. Një kriter kryesor që një normë të ketë legjitimitet dhe të sjellë bindje në zbatimin e saj, veç të tjerash, kërkohet që kjo e drejtë të ketë një garant, një autoritet ligjvënës. Krijimin e së drejtës kanunore ia atribuojnë Lekë Dukagjinit përgjithësisht në krahinën etnografike të njohur më parë si Lekni. Në krahinën e njohur si Gegni këtë atribut ia njohin Skënderbeut ndërsa në krahinën e Labërisë Papa Zhulit e më vonë Idriz Sulit. Kurse në Luginën e Shkumbinit njihet si zakonet e Mus Ballgjinut. Banorët e trevës në fjalë shprehen se “kshtu asht me kanu të Leks”, “kshtu asht e drejt se e ka lan vet

Leka” apo me “Kanun të Lek Dukagjinit” e me radhë.

Funksioni themelor i së drejtës penale është mbrojtja e vlerave më të rëndësishme shoqërore nga kriminaliteti. Ky funksion duhet që të sigurojë ekzistimin e shoqërisë por edhe zhvillimin e mëtejshëm të saj. Ky është funksioni i përgjithshëm dhe i përbashkët i së drejtës penale, pa marrë parasysh shoqërinë ose shtetin konkret që i shërben si mjet mbrojtjeje. Njëkohësisht këtu është edhe dallimi bazë në mes të së drejtës penale të vendeve të ndryshme. E drejta penale është për mbrojtjen e rregullimit të caktuar shoqëror dhe ekonomik të një shteti në shkallën e caktuar të zhvillimit dhe si i atillë është specifik sepse posedon karakteristika sipas të cilave dallon nga e drejta penale e vendeve të tjera. E drejta penale zakonore paraqitet si tërësi e normave juridike, rregullave të sjelljes, të pashkruara, të vendosura në kohë të ndryshme e të përcjella në traditën gojore nga njëri brez tek tjetri dhe që shërbejnë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në mes njerëzve, në fusha të ndryshme të jetës, zbatimi i të cilave sigurohet sipas traditës nga vetë bashkësia e njësisë së vetëqeverisjes vendore, pa ndikimin e shtetit. Në tërësinë e rregullave të të drejtës zakonore me anë të të cilave rregullohen marrëdhënie juridike të ndryshme, në këtë të drejtë vend të veçantë zënë dhe ato rregulla të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e marrëdhënieve të ndryshme dhe të vlerave të ndryshme shoqërore dhe njerëzore nga veprimet. E drejta zakonore shqiptare është një nga të drejtat më të vjetra dhe më të veçanta në Evropën moderne të viteve 1400- 1900. Veçanëria e saj qëndron në faktin se ajo lind paralelisht me shtetin në një kohë kur nuk ekzistonte shteti shqiptar si njësi territoriale me një organizim qeveritar institucional. Për studiuesit e të drejtës zakonore kanuni dhe e drejta zakonore shqiptare shikohet me një sy jo kritik, po me një kuriozitet sesi ajo ndërthur bashkë një larmishmëri të drejtës penale, administrative, civile, kishtarë, private dhe publike. E drejta zakonore shqiptare nuk lind nga një legjislator dhe as nga një parlament, ajo i paraprin shtetit, është e pashkruar dhe e transmetuar gojarisht brez pas brezi

për gati 500 vjet rradhazi.

E drejta zakonore merr emërtime të ndryshme në veri dhe në jug të Shqipërisë, në Veri njihet kryesisht si kanun kurse në jug me termin “Venom”. E para, kanun, etimologjikisht rrjedh nga fjala latine "canon" që do të thotë rregull, ose diçka që përdoret në mënyrë të rregullt, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për fjalën e përdorur në jugun e Shqipërisë “Venom”. Shpesh herë, e drejta zakore shqiptare lidhet ngushtë me termin Kanun, për faktin se e vetmja e drejtë e kodifikuar dhe e përmbledhur është Kanuni i Lek Dukagjinit, i hedhur në letër vetëm në fillim të viteve 1900 nga prifti franceskan Dom Stefan Gjeçovi.¹ Sipas albanologes së shquar angleze Edit Durham, fakti që kanuni kryesor, pra një nga të drejtat zakonore më të përhapura i atribuohet Lek Dukagjinit, duke i dhënë edhe emrin Kanuni i Lekës, na len të kuptojmë por edhe vërteton faktin se të tilla norma zakonore i përkasin shekullit XIV, periudhë kur ai jetoi. E drejta zakonore shqiptare ndahet në disa kanune, më i përhapuri është ai i quajtur Kanuni i Lek Dukagjinit, pastaj është ai i maleve të Skënderbeut, i Lumës dhe ai i Labërisë. Kanuni i Lekë Dukagjinit, është mbledhur në librin e At Shtjefën Gjeçovi rreth viteve 30, dhe i botuar në vitin 1939. Ai është i ndarë në dymbëdhjetë libra ose kapituj që mund të quhen në gjuhën bashkëkohore juridike në 12 kapituj ose krye nene, ku secili prej tyre trajton një çështje që mund të klasifikohen nga e drejta private, tek ajo familiare, penale etj me radhë. Kanuni i Lekës ndahet në: Libri i parë që është Kisha (e cila në të drejtën bashkëkohore kjo pjesë mund të futet si në të drejtën publike ashtu dhe e cila mund të klasifikohet si e drejtë private dhe familjare “Ius Privatorum” dhe trajton imtësisht organizimin dhe rolin e çdo familjari dhe cakton rolin e kryefamiljarit (Pater familias, koncept dhe figurë e njohur edhe në të drejtën romake), duke vënë kryesisht figurën e tij mbi të gjitha dhe si baza e celulës prej nga nis struktura shoqërore shqiptare, duke qënë edhe njëkohësisht delegati i tij në bajrak. Libri

¹ Elezi, I. E drejta zakonore penale e shqiptarëve, Tiranë 1983

i tretë është martesë dhe organizimi i saj, rregullat sesi kryhet nga momenti i njohjes së çiftit e deri në organizimin e ceremonialit, por edhe duke përfshirë disa norma imperative ku ndalon rreptësisht martesat midis kategorive dhe në lidhje gjaku.²

Në kanun nuk pranohet divorci, madje saksionohet se vajzës që i është vënë unazë nuk mund të ndahet. Një risi për kohën është edhe testamenti, apo siç përshkruhet “Nji gja e send e lanë me gojë”. Kjo është një risi sepse në kodet e asaj kohe nuk është e pranishme. Libri i Katërt është “Shtëpia, gjëja dhe prona”, dhe mund të themi që është tërësisht e drejtë private, ku rregullon me dispozita pronën private në mënyrë perfekte dhe të detajuar, sesi ajo merret apo fitohet. Dhunimi i pronës private që në kodet moderne e gjejmë vetëm në shekullin e kaluar, pra dhunimi i një banese është i saksionuar nga e drejta zakonore shqiptare në shekullin e XV, ku shprehimisht thuhet “Si hyhet kujt në oborr pa i ba za”, domethënë pa e paralajmëruar. Sanksionet në kapitullin e katërt zakonisht janë me vlerë monetare.³ Ndërsa në Kapitullin e Pestë trajtohet Puna që në gjuhën bashkëkohore moderne mund të klasifikohet si e drejta e punës, e drejtë kjo e kodifikuar në legjislacionet evropiane vetëm në shekullin e XX, kurse në Kanun, gjen një trajtim sado modest, ajo i përkushton vëmendje duke e konsideruar punën si mjet i ligjshëm fitimi dhe trajton njëkohësisht edhe organizimin e saj. Në këtë kapitull ose ndarje, zë vend edhe pagesa apo institucionet që përfitojnë nga puna, duke u renditur edhe Kisha. Zanatet e kohës, kryesisht bujqësia dhe artizanati janë pjesë e kësaj ndarje ligjore, por nuk mbetet jashtë as gjuetia e kafshëve të egra apo peshkimi. Në kapitullin e Gjashtë janë të dhënat, edhe pse krahasimi nuk është tepër i saktë, ky kapitull mund të klasifikohet si pjesa financiare e këtij kodi, atë që kodet civile evropiane e trajtojnë tek pjesa

² Elezi, I. Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965

³ Elezi, I. Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965

financiaro- bankare. Ai emërtohet të “Dhanunat” ose të Dhënat, që janë Huatë. Edhe pse kanuni nuk ka ndikime prej së drejtës islamike, e cila ndalon rreptësisht interesin mbi atë që është dhënë borxh, duke e klasifikuar si mëkat të madh, kanuni e trajton si të tillë. Në paragrafin e parë (499- Kanuja e maleve nuk njih hua me shtojca fitimesh (fajde). Po në këtë pjesë trajtohet edhe donacioni si formë trashëgimie.

Në kapitullin e Shtatë është Fjala e Gojës, e cila mund të interpretohet në dy mënyra, premtimi dhe betimi njëkohësisht. Për të kuptuar këtë koncept duhet të kemi parasysh të drejtën romake, por më mirë të drejtat gjatë periudhës mesjetare. Sinonimi i të bërit Be (Me Nxan Be), është ajo që në latinisht apo në disa prej sistemeve tradicionale juridike afrikane quhet "ordalium", një praktikë juridike betimi, sipas të cilës pafajësia ose vërtetësia e një të akuzuari vendosej nën betimin hyjnor, duke u betuar në Zot apo qoftë edhe në duele, se ashtu siç ndodh në fiset afrikane duke dhënë prova nga më të ndryshmet si ajo e pirjes së helmit. Ky kapitull na lë të kuptojmë edhe diçka tjetër, atë të vendosshmërisë së këtyre fiseve për të respektuar Kishën, Ungjillin dhe Perëndinë (Beja është një sjellje besimtare në të cilën thirret perëndia për të dëshmuar ...). Libri i Tetë, përbën shtyllën e kanuneve dhe të drejtës zakonore shqiptare, atë që mban fort lidhjen e këtij kodi dhe e bën të respektueshëm. Për një moment le të mundohemi të imagjinojmë disa rregulla, kur nuk ka një fuqi apo komunitet shtet, i cili mbikqyr mbi substancialitetin e këtyre normave. Pyetja lind: Kush vigjilon mbi këto norma? Cila është sanksioni dhe pika që mban një kod? Padyshim që përgjigja është pikërisht në kapitullin e tetë, ku shprehet barazia e pjesëtarëve që jetojnë në një komunitet, një barazi e tipit e "Ius Naturale" , ku edhe shprehet në paragrafin e parë:⁴

⁴ Elezi, I. Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965

“Kanunja e Maleve të Shqypnis nuk veçon nierin prej nierit, Shpirt për Shpirt se duken fale e Zotit”. Me këtë paragraf jo vetëm që gjejmë barazinë midis njerëzve, por duke e lexuar hollësisht, hedhim dritë mbi ato që shpesh hidhet baltë mbi normat kanunore, duke i cilësuar ato si diskriminuese përsa i përket gjinisë femër. Koncepti i nderit në kanunet dhe në kodin e nderit shqiptar nuk ka të bëjë me skemën e përgjithshme evropiane, ku për nder konsiderohet nderi seksual i femrës karshi pjesëtarëve të tjerë të familjes, zakonisht ndershmëria bashkëshortore ndaj bashkëshortit apo ndaj familjes. Në kanun, kur flitet për nder, i referohet një vlere dhe koncepti shumë më të gjerë sesa klasik. Nderi në kanunin e maleve shqiptare ishte vetjak por edhe kolektiv, pra çdo person respektohej dhe duhet të respektonte nderin e tjetrit. Ky nder përbëhej nga disa elemente. Një burrë Shqiptar i ç’nderuar sipas kanunit ishte pa kurrfarë roli në shoqërinë, domethënë humbja e nderit bënte që ai të deklasifikohej në njëfarë mënyre, dhe me doemos nderi duhej të vendosej në vend. Nderi vetjak ishte baza e së drejtës zakonore shqiptare dhe ajo ndeshet si në kanunin e Lekë Dukagjinit, të maleve të Skënderbeut dhe gjithashtu në atë të Labërisë. Po cilat janë rastet kur një burrë humbte nderin vetjak?⁵

Burrat shqiptarë organizohen ndër kuvende, ato janë me përmasa modeste, mund të jenë Kuvende që mbahen në një fshat sikurse mund të jenë kuvende rajonale, burrat të cilët u thohej në kuvend që jepni fakte të rella, që gënjehin burrat e mbledhur, atëherë ata çnderoheshin. Raste të tjera ishin nëse ato pështyheshin, rriheshin, apo nëse u merrej arma në krah. Nëse i vidhej shtëpia apo gjëja e gjallë, nëse i ndalej uhaja (kredia), apo detyra, dhe kryesisht nëse thyente rregullat e tryezës kur kishte mysafirë. Ndera shoqërore, që është edhe pjesa e dytë e këtij libri merret kryesisht me mikun, pra me mysafirin. Cili është mysafiri dhe çfarë të drejtash dhe detyrash ka sipas rregullave të maleve shqiptare, kreu i tetëmbëdhjetë, i jep përkufizimin se cili është mysafir i shtëpive të shqiptarëve, ai nuk

⁵ S. Gjecovi "Kanuni". Shkodër 1993

duhet të jetë patjetër një mik familje me të cilën duhet të ketë lidhje gjaku, por shtëpia e shqiptarit është e hapur për çdokënd që nuk është i shtëpisë: paragrafi 602 “Shpija e Shqypitarit asht e Zotit dhe e Mikut”, ku duhet pritur dhe servitur me shumë dashamirësi, ti shërbehet ushqim dhe pritje siç e kërkon zakoni, por mbi të gjitha duhet ta garantosh atë se nuk do ti ndodhë asgjë dhe së shtëpia që e mirëpret duhet ti dalë zot që ti sigurojë atij/asaj çfarëdolloj mbrojte, qoftë garanci fizike, por edhe ekonomike duke i siguruar edhe punë apo ushqim me qëllimin që ai të mos vjedhë, plaçkisë apo të shkaktojë diçka që të turpërojë atë.

Në librin e nëntë janë përcaktuar Damet, ky kapitull e bën kanunin edhe një kod të mirëfilltë civil, ashtu siç ishin kodet civile të kohës që përcaktonin vlerat në sasi monetare për dëmet e shkaktuara, duke thënë shprehimisht “Dami ka çmim dhe jo pushkë”. Nëse libri i nëntë është i ngjashëm me kodet civile bashkëkohore, i dhjeti mund të cilësohet si tërësisht penal, ku përmban norma për vetëgjyqësinë dhe norma për atë që konsiderohen të Mbrapshitevet (ato që ecin kundër normave morale dhe juridike që përfshihen në kanun. Studiuesit e të drejtës zakonore e shohin kanunin në dy optika përsa i përket këtij fenomeni. Së pari vetëgjyqësia (por jo tërësisht, pasi çdo shkelje gjykohej nga një juri), rridhte si një mangësi e sistemit shtet, në mungesë të një gjykate apo organi hetimor, së dyti, fenomeni i vetëgjyqësisë apo i kodeve të tilla, veproi në një kohë kur ishte pothuajse e përhapur në të gjithë. Kjo vlen vetëm për kanunin e Lek Dukagjinit, ndërsa në kanunin e maleve të Labërisë, disa dëme dënohen me dënime të rënda, si ajo psh e hajdutit, ku nuk i kërkohet një dëmshpërblim monetar por shkon edhe në prerjen e dorës.⁶ Vrasjet për motive gjakmarrje janë të lejuara vetëm kundrejt burrave, dhe ndalohen rreptësisht ndaj grave, fëmijëve.

⁶ Elezi, I. Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965

Koncepti tjetër që trajtohet në këtë kapitull mbetet sërish ai i besës, që nuk është asgjë tjetër vetëm se një farë premtimi, ku shtëpia e të vrarit i jep vrasësit një periudhë kohe për të kryer nevoja dhe i siguron atij se në periudhën që ai është nën besë nuk i kanoset jeta. Besa ka hyrën në të drejtën zakonore jo vetëm si garanci e të dy familjeve që janë në gjak, ajo shfaqet si premtimi i çdo shqiptari dhe vlera e tij karshi shoqërisë rritet aq më shumë sa është Besa e tij. Koncepti i besës ishte edhe në të drejtën mesjetare evropiane i njohur me termin latin Fides. Pra nuk ishte vetëm një koncept, por vlerë e çdo malësori, edhe vetë fjala i pabesë, nuk nënkuptonte vetëm faktin se ai nuk ishte i besueshëm, por se në atë njeri nuk kishte kurrëfarë sigurie apo mirëbesimi. Vrasja e këtyre kategorive në kanunin e Lekës e çnderon dorasin, përveç faktit që bie në gjak, kurse në kanunin e maleve të Skënderbeut, vrasja e një gruaje apo fëmije paguhet me shtatë burra.⁷ Nga shek. XII u krijua shteti i Arbrit dhe fillon një gjendje e re për drejtësinë penale. Faktori i parë kryesor është që, në mesjetë, edhe në Shqipëri, si në vende të tjerë, sundonte rendi feudal i hershëm. Në këto rrethana karakteri i shtetit të Arbrit ishte shtet i tipit feudal. Edhe e drejta penale romake – bizantine që vazhdoi të vepronte ruante po ato karakteristika dhe mbronte rendin ekzistues.⁸

Por edhe për shtetin e Arbrit derisa mungonte gjuha shqipe e shkruar, kuptohet se nuk mund të bëhej fjalë për të drejtë (ligje) të shkruara në gjuhën shqipe.⁹ Krahës së drejtës pozitive bizantino-romake të shtetit të Arbrit, në të drejtën zakonore penale që vepronte në zonat malore, të cilat vazhdonin të vetqeveriseshin sipas saj, kishte edhe norma të së drejtës zakonore me karakter penal të njëllorë me ato të bizantit, si përsa i përkonte kriminalizimit

⁷ Elezi, I. Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965

⁸ Grup autorësh, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Luarasi, Tiranë 2001

⁹ Lloshi, XH. Përvijimi i gjuhës së shtetit shqiptar, botuar në gazetën “Telegraf” datë 9 korrik 2012

të veprave penale (tradhëtia, vrasja, vjedhja etj.) ashtu dhe penalizimit – llojeve e masave të dënimit për secilin prej tyre (dënimi me vdekje, gjymtimet etj.) Statutet e qyteteve – komunë të fillimit të shek. XIV shënojnë një etapë të re në zhvillimin e traditës juridike shqiptare, sepse ato janë akte juridike të shkruara, të përgatitura sipas rregullave të teknikës ligjore dhe të plota për rregullimin e marrëdhënieve juridike në sfera të ndryshme të jetës, përfshirë edhe normat me karakter penal. Karakteristikë tjetër kryesore e tyre është se ato ishin hartuar sipas modeleve të statuteve të qyteteve – komunë të Italisë me orientim perëndimor me ndihmën e Venedikut.

Karakteristikë e rëndësishme e statuteve ishte sigurimi i respektimit dhe zbatimit të tyre nëpërmjet mekanizmave të veçanta dhe efektive për të luftuar kriminalitetin. Statutet ishin mjet i fuqishëm në mbrojtje të jetës, shëndetit, pasurisë, dhe të vlerave të tjera të rëndësishme të njeriut e të shoqërisë ku ato vepronin duke goditur krimet e ndryshme. Në normat e Statuteve institutet e pjesës së përgjithshme të së drejtës penale jepen nëpërmjet normave të pjesës së posaçme, si psh. mosha për përgjegjësi penale – 14 vjeç, për figura të veprave penale të caktuara, dallimi i veprave penale sipas objektit (krimet në detyrë), format e fajësisë – qëllimi si element i domosdoshëm i falsifikimit të dokumenteve, llojet e dënimit (dëbimi i përkohshëm ose i përhershëm, ndalimi për të marrë ofiqe në komunë, mbyllja në shtëpi, zhdëmtimi ose prerja e kokës (dënimi me vdekje) etj.).

Normat e pjesës së posaçme parashikojnë këto lloje të veprave penale:

1. Vepra penale kundër pasurisë (vjedhje, grabitje etj.)
2. Vepra penale kundër personit (vrasja, plagosja)
3. Goditjet – rrahja
4. Pabesia
5. Falsifikimi

6. Veprat penale kundër moralit
7. Veprat penale kundër nderit e dinjitetit personal
8. Dëmtimet
9. Vepra penale kundër drejtësisë
10. Vepra penale të ndryshme.¹⁰

Në statute parashikoheshin edhe normat me karakter procedural penal: organet kompetente për gjykimin e veprave penale janë, si rregull, gjykatat. Nga ky rregull bëjnë përjashtim katër çështje që gjykohen nga vetë mbreti. Më tutje flitet për rregullat e shqiptimit të gjyimit të çështjes, provat, etj. Statutet janë monument i shkruar i kulturës juridike shqiptare. Për Statutet e qytetit të Durrësit flasin shumë dokumentet venedikase që në vitin 1392 dhe, më vonë, në aktin e hartuar në kohën e Gjergj Topisë, ky statut kishte 35 kapituj (që përbënin vetëm një fragment). Gjithashtu sqarohet dhuna publike, padrejtësitë, falsifikimet, grindjet, vrasjet.¹¹ Dorëshkrimi origjinal i Statutit të Katedrales së Drishtit nga viti 1468, ruhet në Bibliotekën e Danimarkës dhe u zbulua nga dr.Musa Ahmeti, i cili e botoi në Shqipëri në vitin 2010.¹²

Statuti ka 53 kapituj (32 faqe) dhe përmban zakone të vjetra të shoqërisë shqiptare e ka karakter kishtar. Në të flitet edhe për sanksionet penale për disa vepra penale (vjedhje, mashtrime etj). Në dhënien e drejtësisë veprohet sipas ndershmërisë duke pasur parasysh frikën e Zotit, dënimet e konkubinatit, mosmarrëveshjet rreth respektimit të statuteve. Në shtetin e Skënderbeut, si shtet i përqëndruar i tipit feudal, ka vepruar e drejta penale e tipit feudal, bizantino – romake, që mbronte pabarazinë shoqërore – ekonomike, politike dhe juridike.¹³ Krahas së drejtës penale laike, bizantino – romake e sanksionuar nga pushteti qëndror, ekzistonte dhe ruhej e

¹⁰ Elezi, I. Normat penale në Statutet e Shkodrës, suplement, Revista “Ligji dhe Jeta” dhjetor 2003

¹¹ Ulqini, H. Statutet e Durrësit, “Të drejtat e Njeriut”, Nr. 50/2000, f. 50 - 63

¹² Ahmeti, M. Statutet e Drishtit, Tiranë 2010

¹³ Historia e popullit shqiptar, Tiranë

drejta tradicionale zakonore, penale me shtesat e ndryshimet e bëra në kohë e në rrethanat e reja të ekzistencës së shtetit, si dhe e drejta kishtarë (kanonike) për një kategori të caktuar çështjesh civile.¹⁴ Problemet e shtetit të Skënderbeut janë trajtuar gjerësisht në literaturën shqiptare dhe të huaj, duke filluar nga Historia e Skënderbeut, hartuar nga bashkëkohësi i tij, Marin Barleti dhe në vazhdimësi nga shumë autorë të tjerë¹⁵ dhe nga prof. Aleks Luarasi etj.¹⁶

Në sistemin e së drejtës, e drejta penale zinte një vend me rëndësi, sepse ajo kryente funksionin mbrojtës nga krimet e spiunazhit e të tradhëtisë në kushtet e luftës kundër pushtimit të huaj.¹⁷ Sipas Marin Barletit në atë kohë janë përdorur nocione të së drejtës penale, si nocioni i krimit, nocioni i mbrojtjes së nevojshme. Gjithashtu, sipas Barletit njihen llojet dhe masat e dënimit që jepeshin për krime të rënda, sidomos për spiunazh dhe tradhëti. Krimi i tradhëtisë dënohej me vdekje ose me burgim të përjetshëm. Këtë dënim e zbatoi Skënderbeu kundër nipit Hamza Kastrioti, pas tradhëtisë u kap rob dhe u dënua. Më pas Skënderbeu urdhëroi që të mos dënohej me vdekje, por e dërgoi të vuante dënimin me burgim në burgun e Napolit (Itali). Po kështu veproi edhe me Gjergj Stres Balshën, i cili kishte tradhëtuar duke u dorëzuar pushtuesve osmanë kështjellën e Modricës. Si dënim plotësues zbatohej edhe dënimi me konfiskimin e pasurisë, siç u veprua kundër Moisi Golemit.¹⁸ Kështu, krahas dënimeve, e drejta zakonore penale, njihte edhe institutin e faljes nga Skënderbeu. Veç elementeve të së drejtës penale, si pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë penale, njiheshin e zbatoheshin në praktikë edhe norma të pashkruara procedurale

¹⁴ Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Luarasi, Tiranë

¹⁵ Barleti, M. Historia e Skënderbeut, Tiranë 1967, f. 125, 300

¹⁶ Luarasi, A. Shteti dhe e drejta shqiptare në epokën e Skënderbeut, Luarasi, Tiranë 1998

¹⁷ Elezi, I. E drejta penale në shtetin e Skënderbeut, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri

¹⁸ Ky ritual i kërkesës për falje është i ngjashëm me atë që është zbatuar në Labëri

penale si dhe për organizimin e funksionimin e gjyqeve. Skënderbeu, si kryetar shteti, kishte të drejtën (e pashkruar) të gjykonte e të dënonte vetë bujarët feudalë për krimet që kryenin. Këtë cilësi ai e kishte si kryetar i shtetit dhe kryezot feudal.¹⁹ Përsa u përket fshatarëve të lirë, të bashkësive territoriale (fshatrave), sidomos në ato zona ku nuk ishte vendosur sistemi feudal, gjykoheshin e dënoheshin nga pleqtë (gjykata) të krijuara ad hoc nga burra zakoni. Dënimet caktoheshin sipas së drejtës zakonore penale.²⁰

Gojëdhëna popullore i atribuon Skënderbeut Kanunin e quajtur Kanuni i Skënderbeut, që përmbante normat e së drejtës zakonore të pranuar nga Skënderbeu dhe të zbatuara prej tij. Normat e së drejtës zakonore që përmbante kanuni i Skënderbeut (të pashkruara, por të përcjella në traditën gojore brez pas brezi) janë mbledhur e botuar nga Frano Ilia në Kanunin e Skënderbeut (2003).²¹ Një vend të rëndësishëm zë edhe drejtësia penale. E drejta zakonore penale e shqiptarëve përmbante insitutet kryesore të pjesës së përgjithshme të së drejtës penale dhe figura të veprave penale, me sanksionet penale përkatëse. Në shtetin e Skënderbeut e në principatën e Lekë Dukagjinit niveli i së drejtës zakonore penale ndryshonte në raport me të drejtën pozitive bizantino – romake që sundonte. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit njiheshin insitutet e pjesës së përgjithshme të së drejtës penale, instituti i fajit (veprës penale), faji dhe format e tij (dashja, pakujdesia), bashkëpunimi në krim dhe përgjegjësia e bashkëpunëtorëve, fazat e zhvillimit të krimit (kanosja, tentativa), mbrojtja e nevojshme dhe dënimi (llojet e tij: hakmarrja e gjakmarrja, gjoba, dëbimi, dënimi me vdekje, djegia e shtëpisë, rrënimi i pasurisë, leçitja).²²

¹⁹ Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Luarasi, Tiranë

²⁰ Elezi, I. E drejta zakonore penale e shqiptarëve, Tiranë 1983

²¹ Ilia, F. Kanuni i Skandërbegut, Milot 2003

²² Elezi, I. Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965

Normat penale të Kanunit të Lekë Dukagjinit shtrinin veprimin e tyre mbi gjithë banorët e bajrakeve ku ai zbatohet. Normat e pjesës së posaçme parashikonin këto vepra penale:

- veprat penale kundër personit
- veprat penale kundër familjes e martesës
- veprat penale kundër pronës private
- veprat penale kundër kishës
- veprat penale të tjera.²³

Edhe Kanuni i Skënderbeut²⁴ e Kanuni i Labërisë²⁵ në vija të përgjithshme kanë ngjashmëri si përsa i përket pjesës së përgjithshme, ashtu dhe për pjesën e posaçme. Natyrisht, nuk përjashtohen aspak dallimet, sidomos në llojet dhe masat e dënimit. Në përgjithësi, gjakmarrja ishte si dënim kryesor që rregullohet me norma të posaçme. Karakteristika kryesore e gjyqeve të pleqve ishte se, pavarësisht nga niveli kulturor, kishin përvojë të gjatë dhe tregonin paanshmëri në zgjidhjen e çështjes. Vendimet e gjyqeve të pleqve ishin të zbatueshme vullnetarisht nga palët.

Si përfundim mund të nxirret sa vijon:

1. Bashkësitë fisnore të zonave malore që vetqeveriseshin, nuk jetonin në anarki e arbitraritet, por mbroheshin nga normat e së drejtës zakonore penale e procedurale penale të pashkruara, por të njohura e të përcjella në traditën gojore nga njëri brez te tjetri, me shtesat e ndryshimet e diktura nga praktika, nevojat e jetës së përditshme. Vetëmbrojtja nëpërmjet normave të së drejtës zakonore penale e procedurale penale përfshinte mbrojtjen e tërë bashkësisë, të jetës, shëndetit, nderit e dinjitetit personal, familjes, lirisë, pronës private dhe të vlerave të tjera të rëndësishme.

2. Në tërësinë e tyre, normat e së drejtës zakonore penale të pashkruara kanë pasqyruar elementë të rëndësishëm të drejtësisë

²³ Gjeçovi, Sh. Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër 1933

²⁴ Ilia, F. Kanuni i Skënderbeut, Milot 1993

²⁵ Elezi, I. Kanuni i Labërisë, Toena, Tiranë 2006

penale, kanë luajtur një rol si një kushtetutë e vetmbrojtjes së vetqeverisjes vendore. Ndërkohë ajo ka shërbyer si formë e qëndresës së përgjithshme kundër ligjeve të pushtuesve të huaj, në mbrojtje të identitetit kombëtar.

3. E drejta zakonore penale dhe procedurale penale, së bashku me gjyqet e pleqve (pleqësitë) kanë patur karakter mbarëshqiptar sepse kanë vepruar në veri, në Kosovë e deri në Labëri e Sul.²⁶ Këto karakteristika themelore të përbashkëta nuk kanë përjashtuar veçoritë vendore, lokale.

4. Studimi i elementëve të drejtësisë penale sipas së drejtës zakonore ka për qëllim të evidentojë vlerat kulturore e juridike që ajo përmban dhe të ruhen si monument historik i kulturës juridike shqiptare, por jo për zbatimin në praktikë të tyre.

Nën sundimin e Perandorisë osmane që nga shek.XV e deri në fillimet e shek. XX, në Shqipëri ishte vendosur drejtësia penale osmane.²⁷ Bënin përjashtim zonat malore që vetqeveriseshin dhe zbatonin të drejtën zakonore tradicionale.²⁸

Në Shqipëri hyri në fuqi dhe veproi e drejta e Sheriatit, si pjesë e së drejtës islame që e kishte burimin e saj në Kuran, Ixhma dhe Hadith. Ai përmbante norma me karakter penal dhe procedural penal.²⁹

Porta e Lartë organizoi sistemin gjyqësor – Kaditë profesionistë, të cilët gjykonin në qendrat kryesore të vendit, të vetëm, bazuar në sheriatin dhe procedurat gjyqësore. Sistemi procedural kishte karakter inkuizitor dhe elemente të pakët të sistemit akuzator. Kjo gjendje vazhdoi deri kur u miratua Kodi Penal osman në vitin 1878, si dhe u miratua Kodi i Procedurës Penale (1878) të cilët u

²⁶ Elezi, I. E drejta zakonore e Labërisë, Tiranë 2002

²⁷ Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, botim 1994, f.4-5

²⁸ Meksi, V. Autonomia lokale e krahinave shqiptare gjatë pushtimit osman, 1965, Drejtësia Popullore N.6

²⁹ Elezi, I. E drejta zakonore e Labërisë, Tiranë 2002

mbështetën në modelin e legjislacionit penal e procedural – Kodet e Napoleonit.³⁰

Në Kodin Penal parashikoheshin institutet e pjesës së përgjithshme dhe figurat e veprave penale në pjesën e posaçme. Në Kodin e Procedurës Penale parashikoheshin të gjitha normat procedurale penale që kishin të bënin me hetimin dhe gjykimin e veprave penale. Përsa i përket sistemit të drejtësisë penale në periudhën e pashallëqeve të mëdha shqiptare në zotërimin e Ali Pashë Tepelenës dhe të Bushatllinjve duhet të vihet në dukje se ata ruajtën po atë sistem të dhënies së drejtësisë që ishte i njohur në gjithë perandorinë osmane. Krahas Sheriatit në këto pashallëqe vepronin kanunametë ose ligjet laike osmane, siç ishte Kodi Penal i vitit 1878, i hartuar sipas modelit të Kodit Penal të Francës të vitit 1810. Në pashallëqe vepronin edhe “bujurditë” (urdhrat – vendimet e tyre personale). Njëkohësisht vepronte e drejta zakonore penale shqiptare, si dhe e drejta kanonike (kishtare) pra në Pashallëkun e Janinës u ruajtën po ato organe që jepnin drejtësi në Perandorinë Osmane. Kadiu ishte gjykatës dhe kryetar i zyrës së Sheriatit. Për veprat penale jepte dënime sipas Kuranit. Për ato vepra penale që nuk parashikoheshin në Kuran, kadiu kishte të drejtë të dënonte këdo, pa ndonjë kufizim. Ai drejtonte gjyqin. Ali Pasha ishte gjykatës suprem dhe jepte drejtësi penale. Vendimet e tij ishin të formës së prerë. Ali Pasha ushtronte kompetencat e gjykatësit suprem. Vendimet e tij ishin të formës së prerë. Vetë ai ishte gjykatë apeli për vendimet e padejta për të cilat bëhej ankimi nga i dënuari. Në dhënien e drejtësisë Aliu nuk pranonte e nuk lejonte asnjë tolerim apo ndërhyrje nga brenda ose nga jashtë. Në fshatrat ortodokse zbatohej e drejta kanonike (kishtare) dhe kishte organizim të veçantë për dhënien e drejtësisë – fshatrat episkopoke apo të metropolisë, që formoheshin pranë peshkopit të provincës. Ato gjykonin faje të lehta.

³⁰ Ligja penale otomane, përkthyer në gjuhën shqipe nga Dhimitër Kacimbra dhe av.Koço Tasi, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 1924

Në mjaft fshatra të Shqipërisë së Jugut, si Himara, Labëria, Suli, vazhdonte të zbatoheshin drejta zakonore penale. Pavarësisht se në tërësi pranohej sistemi i drejtësisë osmane, në Pashallëkun e Ali Pashës ka mjaft elemente origjinale në organizimin dhe kompetencat e sistemit të drejtësisë penale, sidomos për organet ortodokse të drejtësisë. Kryesorja ishte se Ali Pasha njohu parimin e barazisë para ligjit të njerëzve në dhënien e drejtësisë, pavarësisht nga etnia e tyre. Në Pashallëkun e Bushatllinjve sundonte e drejta penale osmane – sheriatit, i cili zbatoheshin kryesisht për popullsinë muslimane sepse përfshinte norma juridike dhe fetare. Për këtë dëshmon një shkresë e Mehmet Pashë Bushatlliut drejtuar krerëve të Barbullushit, ku thuhet se: “Populli është i bindur ndaj sheriatit dhe të gjithë shkojnë mirë me shoqi shojnë. Asnjë ngjarje nuk ka ndodhur në kundërshtim me sheriatin në asnjë vend”.³¹

Fshatarët e lirë të zonave malore vetqeveriseshin me anë të së drejtës zakonore të tyre dhe nuk njihnin e pranonin sheriatin. Kadiu ishte gjykatës dhe kryetar i zyrës së Sheriatit, duke u mbështetur në Kuran. Rolin e instancës më të lartë gjyqësore e luante veziri Bushatli. Vendimet e tij të paapelueshme kishin formë të prerë. Si përfundim në Pashallëkun e Bushatllinjve në Shkodër vepronte e drejta pozitive e Perandorisë osmane, por njëkohësisht njiheshin e zbatoheshin edhe norma të së drejtës zakonore penale dhe elemente të procedurës penale të saj. Në tërësinë e tyre, së bashku me organizimin gjyqësor, formonin sistemin e drejtësisë penale të Pashallëkut. Idetë e rilindësve për organizimin e gjykatave vendase, si një hallkë kryesore për arritjen e autonomisë, u konkretizuan në mjaft dokumente të Rilindjes Kombëtare. Kështu një nga kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte krijimi i gjykatave të reja me gjykatës vendas, që të gëzonin besimin e popullit, të mbështeteshin në praktikën e tyre, në normat e së drejtës zakonore shqiptare dhe jo

³¹ AQSH. Dokument Nr. 5 Fondi: Korrespondenca e Pashait, dosja 3, kutra 2, dokument 20014 (pa datë)

në kodet e vështira turke.³²

Mbledhjet e përfaqësuesve të Malësisë së Lezhës (1878), në Prishtinë (mars – prill 1879) i drejtuan Portës së Lartë kërkesën që të lejohej krijimi i gjykatave shqiptare. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në mbledhjen e 11 majit 1879 e përsëriti kërkesën jo vetëm për autonominë gjyqësore, por edhe për administratën shtetërore në përgjithësi. Pa kaluar shumë kohë gjykatat shqiptare u krijuan në disa qytete të Kosovës, në Shkup, Kumanovë etj. Anëtarë të gjykatave u zgjodhën nga paria e vendit. Gjykatat vepronin në bazë të një statuti, që përmbante udhëzime të përgjithshme me karakter procedural penal e material. Porta e Lartë nuk pranoi kërkesën për shtrirjen e këtyre gjykatave në të gjithë Shqipërinë dhe për mbylljen e gjykatave shtetërore. Në Kuvendin e Gjirokastrës (korrik 1880) Abdyl Frashëri një nga organizatorët kryesorë të Kuvendit, paraqiti një program të rëndësishëm për organizimin e Shqipërisë autonome në tërësi dhe të gjykatave në veçanti, të reja të tipit demokratiko – liberal. Rilindësit nëpërmjet autonomisë gjyqësore mendonin të arrihej në autonominë e Shqipërisë dhe nuk pajtoheshin me sistemin gjyqësor osman ose patriarkal. Porta e Lartë kërkonte me çdo kusht të nënshtronte edhe krahinat malore të Veriut. Për këtë qëllim krijoi në Shkodër komisionin ose gjykatën e Xhibalit, në të cilën u caktuan përfaqësues nga 26 bajrakët e Vilajetit të Shkodrës. Malësorët nën drejtimin e Dedë Gjo Lulit e kundërshtuan krijimin e Xhibalit dhe kërkonin të mos njihej, por të ruanin doket dhe zakonet e të parëve.³³

Faktet tregojnë se në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillimet e shek.XX, vepronin me forcë zakonet dhe normat e pashkuara në të drejtën zakonore shqiptare dhe gjykatat e pleqve – pleqësitë.³⁴ Në zonat malore vrasjet gjykoheshin nga gjykatat e pleqve sipas Kanunit, duke i lënë shteg gjakmarrjes. Edhe Sami Frashëri në

³² Elezi, I. Elezi, E. Zhvillimi historik i mendimit teoriko – juridik, Tiranë 2010

³³ Historia e Shqipërisë 2, f. 142-150

³⁴ Elezi, I. Elezi, E. vep.cit. f.18-20

veprën e tij “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?” shkruante për organizimin gjyqësor dhe shprehej se gjykatat e paqit duhej të kishin kompetenca të gjera që të mund të vështrojë edhe gjyqe më të mëdhenj”.³⁵

Krahas organizimit gjyqësor, një vend të veçantë zë problemi i legjislationit penal e procedural penal, si pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë penale. Në kanunametë (vendimet) e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit parashikoheshin shprehimisht krimet e tradhëtisë, të dezertimit etj. dhe dënimet përkatëse kundër fajtorëve.³⁶ Në Kanonizmën e Komitetit të Fshehtë të Manastirit (1865) “Për lirinë e Shqipërisë” ndër të tjera kishte një dispozitë me karakter penale me përmbajtje si vijon: Nyja XX: “Çdo faj i shokëve të Komitetit dhe të degëve të tij dënohet me të paguar të holla (gjobë) ose me tjetër gjë, po tradhëtia do të gjykohet keq, shumë herë pagesa të mos jetë më pak se vdekja. Ky vendim do të bëhet vetëm nga Kryekomiteti”.³⁷

³⁵ Frashëri, S. Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?, Tiranë 1982

³⁶ Akte të Rilindjes Kombëtare 1878-1912, Tiranë 1978, f.41 e vijim

³⁷ AQSH. Fondi n.102, dosja 19, f.1-6, botuar në Tribuna Juridike N.10, 1996, f.19

ANXHELINA ZHIDRO

SOKOL MËNGJESI

Universiteti i Tiranës

**PERSPEKTIVAT E LEGJISLACIONIT
PROCEDURAL PENAL SHQIPTAR NE KUADRIN
E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN**

ABSTRACT

Judicial cooperation in criminal matters is based on the principle of solidarity between different states, where each state must help and at the same time be helped in fulfilling the primary obligation of preventing criminal offenses, administering justice, and executing criminal sentences. To fulfill the mission of common justice, each of the states must contribute to its realization even if it would harm the special interests of a certain state. Thanks to this cooperation, criminal justice is done, so that the perpetrators of criminal offences, regardless of where they are sheltered or where they have committed their offences, are brought to justice and at the same time receive and serve the respective sentence. Based on the above and in an attempt to define the notion of judicial cooperation in criminal matters, we would consider that it represents the "legal relationship" which is established between states, in all cases where the competent authorities are not able to act outside the territorial jurisdiction where they perform their functions, due to the location of the perpetrator of the criminal offense or the place of its commission.

Key words: *judicial cooperation; jurisdictional relations; extradition; European protection order; criminal procedure code*

I. Historiku i marrëdhënieve të bashkëpunimit penal ndërmjet Shqipërisë e vendeve të tjera

Nisur nga një këndvështrim historik e krahasues vërehet se bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale, përgjithësisht ka njohur zhvillim në periudhën e së drejtës moderne. Në këtë kuadër, Shqipëria për vetë specifikat e saj në drejtim të momentit të njohjes si shtet në arenën botërore, pozicionit gjeografik, por dhe llojit të regjimit politik të cilit i është nënshtruar, ka njohur zhvillime të vonshme në këtë fushë të së drejtës. Bazuar në një analizë retrospektive dhe kronologjike, do të konsideronim se marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me shtete të tjera kanë evoluar si në vijim. Pas shpalljes së pavarësisë, shteti shqiptar formoi një bazë të mirë legjislative në këtë drejtim, duke u renditur si palë në disa prej traktateve të rëndësishme të kohës. Traktati i parë¹ për ekstradim është nënshkruar me Greqinë. Pas tij vijnë traktate të tjerë ekstradimi të nënshkruara me Britaninë e Madhe dhe me Mbretërinë e Serbisë, Kroacisë e Sllovenisë. Në kohën e regjimit të monarkisë, Shqipëria ka miratuar një legjislacion modern duke shfrytëzuar modelet më të mira të kohës dhe konkretisht atë italian e francez. Bazuar në këtë legjislacion, por pa mohuar edhe vullnetin politik të kohës për të bashkërenduar forcat së bashku me shtete të tjera në luftën kundër kriminalitetit, bashkëpunimi në fushën penale njohu një zhvillim të rëndësishëm që u kurorëzua me nënshkrimin e disa marrëveshjeve dypalëshe. Një akt ndërkombëtar me rëndësi të veçantë për kohën konsiderohet edhe Traktati i lidhur ndërmjet Mbretërisë Shqiptare dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës². Përveç rëndësisë së tij juridike e historike ky traktat konsiderohet edhe si tregues i vullnetit të klasës politike për të vendosur bashkëpunimin në fushën penale jo vetëm me vendet e rajonit, por edhe me vende përtej oqeanit. Lidhur me këtë traktat i cili nuk është denoncuar nga asnjëra palë, është shtruar problemi i fuqisë juridike

¹ Nënshkruar më 25 Qershor, 1925.

² Traktat i lidhur më 01.03.1933.

në ditët e somte³. Në gjykimin tonë, vlera juridike e këtij traktati e për rrjedhojë zbatimi i tij nga praktika jonë gjyqësore, mbetet e diskutueshme, për shkak se moszbatimi për një kohë mjaft të gjatë ka shkaktuar rënien në desuetudo⁴ të normave të tij. Megjithatë, përtej kësaj polemike doktrinale, miratimi së afërmi i një marrëveshjeje të re ndermjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës duket se do të kontribuojë të paktën për të ardhmen, në shuarjen e këtij debati juridik⁵. Pas Luftës së Dytë Botërore, kontinenti i vjetër u nda në dy kampe, ku blloku i shteteve evropiane që u rreshtuan përkrah Bashkimit Sovjetik krijuan normat e tyre ndërkombëtare. Bazuar në regjimin e asaj kohe, Shqipëria përfaqësonte një shtet autarkik e, në këto kushte, izolimi ekonomik shoqërohej natyrshëm edhe nga një izolim juridik. Sistemi ynë juridik bazohej në parimin e territorialitetit të zbatimit të ligjit penal, i cili në kushtet e një Shqipërie të izoluar, konsiderohej i mjaftueshëm për të parandaluar e luftuar kriminalitetin. Në vijim të këtij parimi themelor, kodi i procedurës penale të asaj kohe nuk parashikonte një rregullim të përgjithshëm lidhur me format e bashkëpunimit me autoritetet e huaja⁶. E gjendur në këto rrethana politike e juridike, Shqipëria gjatë kësaj periudhe ka lidhur vetëm disa konventa dypalëshe dhe këto vetëm me shtetet e ish-bllokut

³ Gjykata e Lartë në Vendimin nr. 665, datë 17.12.2004 e ka konsideruar të mbështetur në ligj vendimin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër e cila i është referuar këtij traktati për pranimin e kërkesës së SHBA-së për ekstradimin e shtetasit Dh.N.

⁴ Rënia në desuetudo, sipas mendimit juridik, përfaqëson atë situatë kur norma juridike, pa u shfuqizuar në menyrë të shprehur apo të heshutr, nuk gjen më terren për t'u zbatuar, nuk ka më objekt, e, për rrjedhojë, bëhet e tejkaluar si pasojë e evoluimit të marrëdhënieve shoqërore.

⁵ Sikurse është bërë e ditur nga Plani i punës, Ministria e drejtësisë ka iniciuar negociimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje të re me SHBA-në "Për ekstradimin e shtetasve" dhe atë "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale", për më gjerë shih <http://mail.justice.gov.al> Plani i punës për vitin 2008 DBGJN.

⁶Dr. A. Hoxha, "Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE-së. Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentet e Këshillit të Europës", faqe 27, Shtëpia botuese Morava, Tiranë 2010.

komunist⁷. Zhvillimin real e të qenësishëm marrëdhëniet e bashkëpunimit me autoritetet e huaja e morën pas ndryshimeve që pësoi regjimi politik pas viteve '90.

Në këtë periudhë Shqipëria u anëtarësua në disa organizata ndërkombëtare e për pasojë nënshkroi e ratifikoi marrëveshjet ndërkombëtare bazë që rregullojnë bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale në përgjithësi e ekstradimin në veçanti. Nga ana tjetër, miratimi i një legjislacioni modern dhe konkretisht Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale, përkatësisht në vitet 1994 e 1995, mund të konsiderohen si akte normative që pasqyruan ekstradimin në harmoni me standartet evropiane të vendosura nga konventat e Këshillit të Europës,⁸ protokollet e tyre shtesë, si dhe rekomandime e miratuara në zbatim të tyre.

II. Kushtet dhe procedura e ekstradimit

Për të përkufizuar konceptin e ekstradimit ashtu sikurse ky institut rregullohet nga e drejta moderne, do ta konsideronim atë si “një nga format e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale, i cili përfaqëson procedurën nëpërmjet së cilës një shtet (shtetit që i kërkohet) pranon të dorëzojë një shteti tjetër (shtetit kërkues) një individ që gjendet në territorin e tij, i cili ndiqet penalisht ose është dërguar në gjykatë për kryerjen e një vepre penale, apo kërkohet për të ekzekutuar një dënim penal, në shtetin kërkues”.

⁷ Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë e Çekosllovakisë “Për ekstradimin dhe ndihmë e ndërsjellë në fushën penale” e vitit 1959, Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe Rumanisë “Për ndihmën juridike në çështjet penale e vitit 1960, Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë e Hungarisë “Për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën penale” e vitit 1960, Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë e Rusisë “Për ndihmën juridike në çështjet civile, familjare e penale” e vitit 1960

⁸ Përmendim këtu Konventën Evropiane “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe protokollet e saj shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8498 datë 10.06.1999, Konventa Evropiane “Për ekstradimin” dhe dy protokollet e saj shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8322 datë 02.04.1998, Konventa Evropiane “Për transferimin e personave të dënuar” ratifikuar me ligjin nr.8499 datë 10.06.1999.

Bazuar në veçorinë e ekstradimit si akt sovraniteti i shtetit të kërkuar, autoriteti qendror që si rregull është Ministria e Drejtësisë, ka një rol shumë të rëndësishëm në përmbushjen e kësaj procedure. Kështu në pjesën më të madhe të shteteve, ekstradimi vendoset nga një autoritet ekzekutiv⁹, vendim i cili si rregull bazohet edhe në një vendim gjyqësor, i cili përgjithësisht luan një rol konsultativ. Në sistemin shqiptar të së drejtës ekstradimi rregullohet nga Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë. Në bazë të nenit 39 të Kushtetutës “Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor”. Gjithashtu ekstradimi rregullohet edhe nga dispozitat e kodit të procedurës penale, respektivisht nenet 488 deri 504, dispozita të cilat janë hartuar në pajtueshmëri të plotë me rregullimin e Konventës Europiane “Për Ekstradimin”.

Bazuar në këto dispozita, ekstradimi aplikohet në rast se nuk ekziston asnjë prej rasteve (kushteve) të ndalimit të cilat janë si në vijim: a) shteti kërkuar duhet të garantojë kushtin se personi i ekstraduar nuk do të procedohet, nuk do të dënohet, nuk do të mbahet me qëllim për ekzekutimin e një vendimi dënimi ose mase sigurimi dhe as do t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera individuale për një vepër tjetër penale, përveç asaj për të cilën jepet ekstradimi. I njohur ndryshe edhe si “parimi i veçorisë” apo rregulli i specialitetit, ky kusht parashikohet si në Konventën Evropiane për Ekstradimin ashtu edhe në kodin e procedurës penale. Gjejmë vendin të theksojmë se këto vepra penale për të cilat duhet të garantohet mungesa e procedimit, janë ato të kryera nga personi përpara dorëzimit të tij për shkak të ekstradimit. b) ekstradimi nuk do të pranohet kur vepra penale për të cilat personi kërkohet për t’u

⁹ Si autoritet ekzekutiv në SHBA është Departamenti i Shtetit, në Francë dhe në Spanjë është Këshilli i Ministrave, në Kanada e Itali është Ministri i Drejtësisë etj.

ekstraduar, nuk parashikohet si e tillë edhe nga legjislacioni i shtetit të kërkuar. Ky kusht i njohur edhe si parimi “kriminalizimit të dyfishtë” parashikohet jo vetëm nga legjislacioni shqiptar, por edhe nga neni 2 i Konventës Për Ekstradimin. Ai i referohet sanksionimit të veprës penale për të cilin kërkohet ekstradimi, si nga legjislacioni i shtetit kërkuar, ashtu edhe shtetit që i kërkohet ekstradimi. c) ekstradimi nuk lejohet kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe kur nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe. Në zbatim të Konventës Evropiane për Ekstradimin “objeksioni i shtetësisë” konsiderohet si një motiv refuzimi, bazuar në faktin se kjo i siguron mbrojtje sociale individit, së paku, në kontekstin kur një shtet i huaj formulon një kërkesë ekstardimi për një shtetas të vendit që i kërkohet ekstradimi. Siç u theksua në fillim të këtij punimi, Shqipëria vetëm me SHBA-në ka pranuar ekstradimin e shtetasve të saj në atë shtet dhe anasjelltas, me traktatin “Për Ekstradimin”, të 1 marsit të vitit 1933. Në praktikë ka lindur diskutimi nëse ky traktat është ende në fuqi¹⁰.

ç) ekstradimi nuk jepet për vepra penale të konsideruara si vepra politike apo kur rezulton se personi kërkohet për motive politike. Në zbatim të kësaj dispozite, shtetit të cilit i kërkohet ekstradimi, pra, shtetit shqiptar i lejohet të vendosë se kur një vepër penale është politike¹¹. d) ekstradimi nuk lejohet kur vlerësohet se personi i kërkuar do t’u nënshtrohet persekutimeve apo diskriminimeve për

¹⁰ Me vendimin nr.241 date 22.05.2001, Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë pranoi fuqinë e këtij traktati dhe vendosi ekstradimin e shtetasit shqiptar në shtetin e Nju- Jorkut, me kushtin që të mos ndiqet, të mos dënohet apo të mos i dorëzohet një shteti tjetër për akuza të ndryshme nga ato për të cilat është ekstraduar.

¹¹ Konventa e Këshillit të Europës “Për Ekstradimin” parashikon shprehimisht se cilat janë veprat penale që nuk konsiderohen politike. Kështu, në zbatim të kësaj konvente, nuk konsiderohen si vepër politike atentati për vrasjen e kryetrait të shtetit apo ndonjë pjesëtar i familjes së tij. Dukuri shqetësues dhe e zhvilluar kohët e fundit janë veprat e terrorizmit dhe të akteve terroriste, që në mjaft raste kanë marrë ngjyra të besimit fetar apo atij politik. Theksojmë se në bazë të Konventës së Strasburgut “Për shtypjen e terrorizmit” e datës 27 janar 1977 në nenin 2 të saj citohet se “këto akte për qëllim ekstradimi nuk do të konsiderohen si vepra penale politike”.

shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve apo trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore. e) ekstradimi nuk lejohet edhe në rastin kur, për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi, personi është proceduar apo gjykuar në vendin të cilit i kërkohet ekstradimi, edhe pse vepra është kryer jashtë saj. f) ekstradimi nuk jepet kur personi për të cilin kërkohet ekstradimi ka kryer një vepër penale në territorin shqiptar¹². g) ekstradimi nuk jepet kur për veprën është dhënë amnisti nga shteti shqiptar. h) kërkesa për lejimin e ekstradimit do të refuzohet edhe në rastin kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi për veprën e kryer, sipas ligjit të shtetit që e kërkon.

Në rast se nuk ekziston asnjëri prej rasteve të ndalimit të sipërcituar, Ministria e Drejtësisë, i dërgon aktet prokurorit pranë gjykatës kompetente. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim njofton palët të paktën dhjetë ditë përpara për datën e caktuar të seancës gjyqësore. Kur vendos në favor të lejimit të ekstradimit, vendimi i gjykatës mund të ankimohet nga ana e palëve në gjykatën e apelit, sipas rregullave të përgjithshme të anikimit. Në këtë rast do të pritët përfundimi dhe vendimi i kësaj gjykate për të disponuar përfundimisht mbi ekstradimin. Kur gjykata vendos refuzimin e kërkesës për ekstradim për ekzistencën e një ose më shumë prej shkaqeve, atëherë Ministria e Drejtësisë nuk lejon ekstradimin. Duke qenë se përfundimisht është në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë për të disponuar mbi kërkesën e shtetit të huaj për ekstradim, ajo sipas nenit 499/1 duhet ta bëjë këtë brenda tridhjetë diteve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës. Në rast se Ministria nuk vendos brenda këtij afati, atëherë personi për të cilin është kërkuar ekstradimi dhe që ndodhet i arrestuar në burg, lirohet. Kur ekstradimi lejohet,

¹² Kuptimi i territorit të Shqipërisë jepet në nenin 5 të kodit penal. E rëndësishme është të theksojmë faktin se, jo vetëm vepra penale në tërësi, por edhe në qoftë se një pjesë e saj është kryer në Shqipëri, ekstradimi nuk mund të jepet.

Ministria e Drejtësisës duhet të përcaktojë dhe një datë për dorëzimin e personit autoriteteve të shtetit kërkuar.

III. Zëvendësimi i ekstradimit me Urdhrin Evropian të Ndalimit

Në kuadrin e përgjithshëm të procesit të integritetit në të cilin ndodhet Shqipëria, përafrimi i legjislacionit të brendshëm që rregullon bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale me *acquis communautaire*, paraqitet si një prioritet në fushën e reformave ligjore e institucionale. Nga ana tjetër, në kushtet kur kriminaliteti ndërkufitar ka fituar një zgjerim të madh, bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale duhet të jetë, bashkë me bashkëpunimin informativ ndërmjet organeve kombëtare të ruajtjes së rendit, instrumenti efikas që disponojnë shtetet evropiane për të balancuar këtë fenomen, ndaj reformat që duhet të ndërmerret Shqipëria në këtë drejtim duhet të ravigjëzojnë gjithë aktet evropiane që thjeshtojnë dhe lehtësojnë këtë bashkëpunim.

Për përmbushjen e këtij objekti, ligjvënësi shqiptar duhet të synojë miratimin e një ligji të posaçëm për bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale ndërmjet Shteteve anëtare të BE-së, i cili do të bëjë të mundur që në marrëdhëniet me to, të zbatohen dispozita të posacme që lehtësojnë në mënyrë të ndjeshme bashkëpunimin gjyqësor dhe policor në fushën penale. Në këtë legjislacion duhet përfshirë instrumenti i Urdhrit Evropian të Ndalimit, i cili ka si objektiv zëvendësimin e procedurave të ekstradimit me procedurën e thjeshtëzuar të ndalimit dhe të dorëzimit të personit të kërkuar që ndodhet në hapësirën e përbashkët. Është vendi të kujtojmë se Vendimi-Kuadër 2002/584/JAI i Këshillit të BE-së, i 13 qershorit 2002 që ka për objekt lëshimin dhe ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit, nuk zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj pas aderimit të Shqipërisë në BE nuk pritet një “dorëzim automatik” i personave që i kërkohen apo, sipas rastit, që do të kërkohen nga Shqipëria, por duhet që më parë Shqipëria të implementojë këtë

Vendim- Kuadër në legjislacionin e saj të brendshëm.

Natyrisht, ky zëvendësim ndërmjet konventave të Këshillit të Europës dhe normave juridike të BE-së, do të funksionojë ekskluzivisht në marrëdhëniet e bashkëpunimit penal ndërmjet Shteteve anëtare, ndërkohë që ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera joanëtare të BE-së do të vazhdojë të zbatohet procedura klasike e ekstradimit, ashtu sikurse kjo rregullohet nga konventat e Këshillit të Europës. Zëvendësimi i procedurës së ekstradimit të parashikuar nga kodi i procedurës penale dhe konventat e Këshillit të Evropës ku Shqipëria është palë, do të jetë një zëvendësim “pro parte” dhe “jo in integrum”.

Thënë këto, është e kuptueshme se Shqipëria ndodhet në një proces sfidash, ku më e rëndësishmja në fushën tonë të interesit paraqitet ajo e ballafaqimit të legjislacionit shqiptar me Vendimin Kuadër për Urdhrin European të Ndalimit. Ky proces do të shoqërohet në mënyrë të pashmangshme me ndryshime të dispozitave materiale dhe proceduriale të legjislacionit tonë penal dhe në ndonjë rast ndoshta edhe të dispozitave kushtetuese.

Në çdo rast, implementimi i Urdhrit Evropian të Ndalimit do të ndryshojë kuptimin dhe për rrjedhojë interpretimin e disa prej parimeve themelore të së drejtës penale e asaj së procedurës penale. Përballja me rritjen e fenomenit të kriminalitetit duhet të balancohet me cështjen delikate të mbrojtjes së vlerave themelore të parashikuara në legjislacionin tonë të brendshëm. Në këtë kuadër kompleks, i cili përfshin pjesërisht edhe sferën e lirive personale të shtetasve, shtrohet pyetja nëse ligjvënësi shqiptar duhet t’i japë përparësi zbatimit të normës europiane, e cila imponon efikasitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar apo parimeve kushtetuese.

Megjithë efikasitetin e padiskutueshëm që shoqëron këtë mekanizëm të ri, të domosdoshëm për t’u përballur me një kriminalitet që nuk njihet kufij, ai duhet trajtuar me ekzigjencën e nevojshme për të evituar cënimin e këtyre lirive të garantuara, mbi

të cilat bazohen qytetërimet moderne në përgjithësi dhe vendet demokratike në veçanti. Për këtë motiv, është me rëndësi që elementet e diskutueshëm që shoqërojnë këtë instrument juridik, të bëhen objekt debati e analizash dhe veçanërisht të përfitohet nga orientimet e Gjykatave Kushtetuese e praktikës gjyqësore të Shteteve anëtare, të cilat e kanë përfshirë ndërkohë në legjislacionet e tyre Urdhrin Evropian të Ndalimit.

Parë në këtë këndvështrimin, do të trajtojmë më poshtë shkurtimisht, disa nga problematikat që do të shoqërojnë përshtatjen e kësaj forme të bashkëpunimit gjyqësor penal në sistemin shqiptar të së drejtës.

IV. Zbatimi i Urdhrit Evropian të Ndalimit, ndërmjet respektimit të normave evropiane dhe parimeve themelore të sistemit shqiptar të së drejtës

Nga të gjitha polemikat që kanë shoqëruar përfshirjen e Urdhrit Evropian të Ndalimit në të drejtën e brendshme, vëmendjen e zbatuesve të së drejtës e kanë tërhequr risqet antikushtetues që shoqërojnë zbatimin e Vendimit-kuadër. Urdhri Evropian i Ndalimit, i konceptuar si një alternativë e re kundrejt procedurave të stërgjatura të ekstradimit klasik, të cilat janë të papajtueshme me kërkesat e thjeshtimit dhe efikasitetit që duhet të shoqërojnë hapësirën e përbashkët social-ekonomike, shoqërohet me risqe antikushtetueshmërie, pikërisht në ato drejtime ku Urdhri i Ndalimit shmangët nga procedura klasike e ekstradimit.

Si rregull, një burim i ri i së drejtës -siç është ligji që do të përfshijë Urdhrin Evropian të Ndalimit në rendin tonë juridik-, mund të shmangë disa prej parimeve të së drejtës; mirëpo, disa kufizime që ky akt normativ parashikon në drejtim të parimeve themelore nuk mund të anashkalohen. Kështu, praktika e Gjykatës Kushtetuese italiane ka theksuar disa herë në arsyetimet e vendimeve të dhëna prej saj, pamundësinë e cënimit të të drejtave themelore që përcaktohen nga Kushtetuta, edhe në hipotezën kur

kjo shmangie realizohet nëpërmjet normave evropiane.

Në këtë linjë idesh duhet theksuar se eksperiencia e vendeve të tjera ka treguar se zbatimi “tale quale” i Vendimit-kuadër, disa herë nuk ka qenë i mundur¹³. Duke shfrytëzuar këtë eksperiencë, ligjvënësi shqiptar duhet të realizojë ndryshimet e duhura kushtetuese që do bëjnë të mundur pajtueshmërinë e aktit themeltar me Urdhrin Evropian të Ndalimit apo, sipas rastit, të parashikojë regjimin juridik të Urdhrit të Ndalimit, në frymën e parimeve kushtetuese.

Edhe pse jo një burim i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e ligjit themeltar parashikon parimet themelore të cilave do t’i nënshtrohet kufizimi i lirisë personale në përgjithësi dhe ekstradimi në veçanti. Më tej po analizojmë problematikën e përfshirjes së Urdhrit Evropian të Ndalimit në të drejtën tonë të brendshme, parë nga këndvështrimi i këtyre parimeve kushtetuese.

V. Urdhri Evropian i Ndalimit dhe ekstradimi i shtetasve shqiptarë

Neni 11 i Kodit penal parashikon të njëjtin formulim sikurse neni 39 paragrafi i dytë i Kushtetutës, duke shtuar në paragrafin e tretë se ekstradimi nuk do të lejohet në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe.

Pas një periudhe të gjatë në të cilën shtetet europiane kanë vendosur bazat e një bashkëpunimi gjyqësor penal dhe kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për t’i zhvilluar më tej këto forma

¹³ Mjafton të kujtojmë këtu ndryshimet që i janë nënshtuar disa nga Kushtetutat e Shteteve anëtare para miratimit të ligjit të brendshëm të implementit –Francë; Itali; Slloveni ; Rumani; e ndonjë tjetër-, apo shpalljen antikushtetuese të ligjit që implementoi Urdhrin e Ndalimit në disa nga Shtetet anëtare –Gjermani ; Poloni ; Qipro ; e ndonjë tjetër.

bashkëpunimi, ka arritur ndërkohë momenti i konsideruar nga shumë studiues si i paevitueshëm: kufizimi i sovranitetit dhe për pasojë heqja dorë edhe nga parimi i shtetësisë.¹⁴

Pas miratimit të Vendimit-kuadër, Shtetet anëtare nuk mund të refuzojnë dorëzimin e të akuzuarit apo dënuarit me motivin se personi ka shtetësinë e vendit të ekzekutimit të Urdhërit Evropian të Ndalimit. Pikërisht bazuar në eliminimin e shkakut të refuzimit që bazohej në shtetësinë e personit të kërkuar, disave prej Shteteve anëtare u është dashur të rishikojnë dispozitat ligjore, madje, në ndonjë rast edhe ligjin themeltar.¹⁵

Në këtë kontekst evropian, edhe ligjvënësit shqiptar i duhet të pranojnë se Vendimi-kuadër që rregullon Urdhrin Evropian të Ndalimit ka shfuqizuar parimin e shtetësisë. Në zbatim të këtij vendimi, ekzistenca e shtetësisë shqiptare të personit të kërkuar, nuk do të konsiderohet shkak i detyrueshëm për refuzimin e ekzekutimit të Urdhrit Evropian të Ndalimit. Megjithatë, ligji shqiptar mund ta përfshijë objeksionin e shtetësisë shqiptare të personit të kërkuar ndër motivet fakultative për refuzimin e ekzekutimit të Urdhrit të Ndalimit, në zbatim të nenit 5, paragrafi i tretë i Vendimit-kuadër, i cili e parashikon këtë mundësi të kushtëzuar nga disa premisa. Kështu, kur ky urdher është lëshuar me qëllimin e kryerjes së ndjekjes penale, gjykata mund të kushtëzojë dorëzimin me faktin që personi i kërkuar të kthehet në Shqipëri për të ekzekutuar dënimin që eventualisht do të jepet kundër tij. Në të kundërt, kur UEN është lëshuar për ekzekutimin e dënimit të një shtetasi shqiptar, ligjvënësi duhet të mbajë parasysh “objeksionin e nacionalitetit” dhe në ato raste kur dënimi është i pajtueshëm me legjislacionin shqiptar dhe

¹⁴ Elaine Krivel Q.C. – IAP Neësletter, 20.02.2003; Elaine Krivel, *op.cit.* Një analizë më e gjërë e këtij problemi mund të gjendet në punimin e Deen-Racsmany.Z dhe Rob Blekstoorn, « Rënia e prapsimit të nacionalitetit në ekstradimin evropian », në *Jurnal European i veprave penale.*, v.13,nr.3(2005), fq.317-363. S.A.Ëiliams, “Shtetësia, pengesa e dyfishtë”, fq 261.

¹⁵ Shih për një shembull të tillë Rumaninë.

autoritetet kompetente shqiptare marrin përsipër të vënë në ekzekutim këtë vendim, gjykata mund të refuzojë dorëzimin e shtetasit shqiptar. Në çdo rast, ekzekutimi i dënimit në vendin e origjinës do të bëhet me pëlqimin e Shtetit anëtar që ka lëshuar Urdhrin e Ndalimit.

VI. Pajtueshmëria e parimit të “kriminalizimit të dyfishtë” dhe atij të ligjshmërisë së veprave penale me dispozitat e Vendimit-kuadër

Në zbatim të dispozitave të Vendimit-kuadër, në ligjin që do të rregullojë Urdhrin Evropian të Ndalimit nuk do të gjejë zbatim -të paktën në kuptimin që i kemi dhënë deri më sot kësaj norme-, neni 11, paragrafi i dytë i kodit penal, sipas të cilit, “ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është parashikuar si e tillë njëkohësisht si nga ligji shqiptar dhe ai i huaj”.

Mirëpo, ekzekutimi i detyrueshëm i Urdhrit të Ndalimit, pa një verifikim paraprak të fajësimit të dyfishtë, mund të konsiderohet në kundërshtim me nenin e sipërcituar, i cili në kuadrin e një parimi të përgjithshëm, nuk i referohet vetëm procedurës klasike të ekstradimit të parashikuar nga kodi i procedurës penale, por çdo formë të bashkëpunimit që bazohet në arrestimin e një personi dhe dorëzimin e tij kundrejt një shteti tjetër. Kjo zgjidhje e parashikuar nga Vendimi-kuadër është konsideruar nga shumë autorë, që vjen në kundërshtim edhe me parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga Kushtetuta, pasi veprimi që konsiderohet si vepër penale në shtetin që ka lëshuar Urdhrin e Ndalimit, edhe pse mund të përshihet në hipotezat gjenerike të parashikuara në Vendimin-kuadër, mundet të mos përmbushi të gjithë elementet e nevojshëm për t’u konsideruar vepër penale në rregullimin ligjor të brendshëm të shtetit që do të ekzekutojë UEN-ja. Kështu, edhe neni 29, paragrafi i parë i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon “nullum crimen sine lege”, sipas të cilit “askush nuk mund të dënohet për një vepër penale, e

cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj...”¹⁶. Gjithashtu, i cënuar duket edhe parimi tjetër i përcaktimit të fakteve ligjore, duke pasur parasysh që Vendimi-kuadër bën një rregullim aq të gjërë të disa prej 32 veprave penale, sa që lë vend për një interpretim të zgjeruar të tyre, realitet ky i panjohur për sistemin tonë të interpretimit të ligjit penal¹⁷. Praktikisht, dorëzimi do të realizohet për një sjellje që përfshihet formalisht në tipologjinë e parashikuar nga neni 2, paragrafi 2 i Vendimit-kuadër, por që nuk përmbush të gjitha elementet konstitutive që karakterizojnë krimin “ekuivalent” në të drejtën tonë të brendshme, e, pra, me fjalë të tjera, nuk konsiderohet vepër penale nga legjislacioni shqiptar.¹⁸

Për të evituar këtë papajtueshmëri kushtetuese, parimi i ligjshmërisë duhet të lexohet me më shumë fleksibilitet. Kështu, në vijim të kësaj ideje, parimi kushtetues i ligjshmërisë vepron në këtë kuptim: ai imponon që fakti i paligjshëm të jetë i parashikuar si vepër penale në ligj, edhe pse vetëm në ligjin e shtetit që kërkon dorëzimin e personit.¹⁹ Sipas kësaj llogjike, interpretimi mund të bëhet edhe duke u nisur nga një tjetër premisë, atë që parimi i ligjshmërisë gjen zbatim vetëm për veprat penale që kryen në teritorin kombëtar, si edhe në rastet kur gjykimi zhvillohet në këtë teritor. Kështu, në rastin e Urdhrit Evropian të Ndalimit, Shteti anëtar që do ta ekzekutojë atë, nuk do të gjykojë personin e ndaluar në drejtim të veprës penale që pretendohet të jetë kryer prej tij, por

¹⁶ I njëjti parim parashikohet nga neni 2 i kodit penal në këtë formë “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale”.

¹⁷ Sipas nenit 1 të Kodit penal “Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre”.

¹⁸ Në fakt, nëse i referohemi konkretisht listës së parashikuar nga neni 2 i Vendimit-kuadër, bindemi kur konstatojmë natyrën e disa prej këtyre veprave penale: ex “korrupsioni”; “mashtrimi”; “kriminaliteti informatik”; “kriminaliteti mjedisor”; “racizmi e ksenofobia”, dhe njëkohësisht i referohemi specifikimeve penale që bëhen për veprën/veprat penale korrespoduese në legjislacionin tonë të brendshëm.

¹⁹ Cassese.A., “*Diritto penale e processo*”, n. 12/2003, fq. 1565.

vetëm do ta dorëzojë atë. Me fjalë të tjera, shteti i ekzekutimit vetëm do të ndihmojë që ndaj personit të kërkuar të kryhet hetimi apo të ekzekutohet vendimi i një gjykate të një vendi tjetër, ndaj parimi i ligjshmërisë nuk është i nevojshëm të respektohet edhe nga ky shtet. Autorët që mbështesin këtë opinion shtojnë edhe argumentin sipas të cilit, nëse do të zbatojmë me rigorozitet parimin e ligjshmërisë edhe në një rast të tillë, autorët e veprave penale mund të evitojnë hetimin apo ekzekutimin e dënimit duke u strehuar në territorin e një shteti ku nuk parashikohet vepra penale e kryer prej tyre, duke krijuar kështu “parajsë kriminale”.

Në fakt, është e natyrshme të hezitosh për pranimin e kësaj teze përballë parimit të taksativitetit dhe përcaktimit të veprave penale, parim i cili nënkupton që ligji themeltar nuk lejon që askush t’i nënshtrohet dënimit për fakte që ligjvënësi nuk i konsideron që çenojnë vlerat sociale dhe, për rrjedhojë, meritojnë të ndëshkohen penalisht.

Duke iu bashkangjitur opinionit të disa autorëve të tjerë, në gjykimin tonë, përjashtimi i listës së 32 veprave penale përfaqëson dhe bazohet jo mbi shpërfilljen e parimit të ligjshmërisë, por mbi prezumimin se ky parim është zbatuar për listën prej 32 veprash penale, që në momentin e përzgjedhjes së tyre nga hartuesit e Vendimit-kuadër.²⁰ Me fjalë të tjera, lista e parashikuar në nenin 2, paragrafin 2 të Vendimit-kuadër, përfaqson individualizimin e zonës së vlerave sociale të përbashkëta të vendeve të BE-së dhe i jep të gjithëve mundësinë që t’i sanksionojnë penalisht nëpërmjet parashikimit të posaçëm në legjislacionet e tyre të brendshme. Pikërisht mbi një prezumim të tillë është bërë e mundur që të “shpërfillet” verifikimi paraprak i kushtit të fajësimit të dyfishtë, i cili në këto raste do të konsiderohet i mirëqenë.

Në analizë të fudit, pak alternativa i mbeten ligjvënësit shqiptar,

²⁰ E. Selvaggi; O.Villoni in Cass. Pen. 2002, 114.1., fq. 453 e më tej.

për sa kohë zgjedhja politike në kuadrin e BE-së ka qenë sa precize, aq edhe penguese: të harmonizojë legjislacionin penal në përputhje me standardin europian.

VII. Rastet e kufizimit të lirisë personale; masa e ndalimit dhe e drejta e ankimit

Një analizë e veçantë i duhet kushtuar pajtueshmërisë ndërmjet instrumentit të ri të UEN-së dhe rasteve të kufizimit të lirisë personale, të cilat si rregull parashikohen nga ligji themeltar. Në këtë linjë idesh kujtojmë se edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon një varg parimesh që lidhen me rastet e heqjes së lirisë dhe afatet maksimale në të cilat mund të kufizohet liria e individit; procesin e rregullt ligjor, parime këto që zbatohen si për shtetasin shqiptar, ashtu edhe për të huajt që do t'i nënshtrohen procedurave të ndalimit dhe dorëzimit.

Sipas disa autorëve, në rastin e ekzekutimit të UEN-së, teknikisht masa shtrënguese e ndalimit merret nga një autoritet që nuk është ai të cilit rendi i brendshëm juridik i jep të drejtën eksklusive të kufizojë lirinë e personit.²¹

Në këto kushte, është propozuar që ligji i brendshëm që rregullon Urdhrin e Ndalimit, duhet të lejojë njohjen e motiveve për të cilat është marrë masa e arrestit nga ana e autoritetit gjyqësor që ka lëshuar UEN-ja dhe duhet të parashikojë që ky urdhër duhet të jetë lëshuar nga një gjyqtar. Për rrjedhojë, personi që i nënshtrohet një urdhri të tillë duhet të dëgjohet, të gëzojë cilësinë e të akuzuarit dhe duhet t'i bëhen të ditura motivet e kërkesës së masës së arrestit.

Në gjykimin tonë, këto opinione bazohen në një premisë të gabuar, pasi vënë shenjë e barazimit ndërmjet kufizimit të lirisë si pasojë e ndalimit që realizohet nga Shteti i ekzekutimit në bazë të një UEN-je, dhe arrestimit që kryhet si pasojë e marrjes së masës së sigurimit së arrestit me heqje lirie, në kushtet e kodit të procedurës

²¹ Prof. P. Gualtieri, *Convegno sul mandato d'arresto europeo*, Urbino, maj 2003.

penale. Urdhri Evropian i Ndalimit është një instrument i cili zbaton njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës penale. Në llogjikën e Vendimit-kuadër, autoriteti gjyqësor i Shtetit në territorin e të cilit gjendet personi i arrestuar, nuk mund të vlerësojë masën e marrë ndërkohë nga një gjykatë e një tjetër Shteti anëtar, por do të kontrollojë vetëm kushtet formale që kanë të bëjnë me dorëzimin e personit të kërkuar. Me fjalë të tjera, gjykata shqiptare që do të ekzekutojë UEN-në, nuk do të shprehet mbi bazueshmërinë/ligjshmërinë e masës së vendosuar nga autoriteti gjyqësor i shtetit kërkuar.

Për rrjedhojë, ndryshe nga procedura e ekstradimit, nëse gjykata konstaton ekzistencën e UEN-së, do të disponojë ndalimin e personit të kërkuar dhe do të gjykojë automatikisht kërkesën për dorëzimin në shtetin e kërkuar, pa gjykuar nëse plotësohen kushtet e legjislacionit shqiptar për marrjen e masës shtrënguese të arrestit. Në këto rrethana, autoriteti gjyqësor shqiptar që do të ekzekutojë UEN-në do të japë një pëlqim “tout court”, vetëm lidhur me kushtet formale për të cilat është lëshuar urdhri përkatës dhe jo mbi kontrollin e legjitimitetit të titullit në bazë të të cilit është kufizuar liria personale.

Kështu, ligji shqiptar për zbatimin e Vendimit-kuadër duhet të parashikojë verifikimin e disa elementeve formalë të përmbajtjes së Urdhrit Evropian të Ndalimit, përkatësisht: ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë; marrjen e masës së sigurimit të arrestit; apo çdo lloj tjetër vendimi gjyqësor të ekzekutueshëm që ka të njëjtën pasojë. Gjukata shqiptare nuk mund ta shtrijë shqyrtimin edhe mbi kushtet për dhënien e masës shtrënguese, të cilat janë ekzaminuar nga autoriteti i Shtetit që ka lëshuar UEN-në. Natyrisht, kundërshtimi si i pabazuar në ligj e në prova i vendimit të dhënë nga gjykata e Shtetit anëtar që ka lëshuar Urdhrin e Ndalimit, do të realizohet në shtetin që ka dhënë vendimin, ku personi që do të dorëzohet do të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe garancitë proceduriale.

Ligji shqiptar që do të parashikojë Urdhrin e Ndalimit duhet të rregullojë në mënyrë të detajuar gjithë këtë procedurë, në mënyrë që ajo të realizohet në përputhje me parimet kushtetuese. Kështu, në momentin e ndalimit, personi i kërkuar duhet të vihet në dijeni për motivet e masës së ndalimit dhe do të informohet mbi ekzistencën e UEN-së; t'i njihet mundësia të njoftojë familjarë apo të afërm të tjerë; të njohë përmbajtjen e Urdhrit të Ndalimit; t'i bëhet e ditur mundësia që ka për të dhenë pëlqimin ose jo mbi dorëzimin në një tjetër shtet anëtar; si edhe mbi të drejta të tjera proceduriale, sikurse janë e drejta për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi; t'i garantohet mbrojtja me ndihmën e një mbrojtësi; t'i sigurohet mbrojtja falas; të komunikojë lirisht dhe privatisht me mbrojtësin, e të tjera.

Bazuar në gjithë sa theksuam, do të mbetet në vlerësimin e ligjvënësit shqiptar, i cili në ligjin që do të rregullojë UEN-në mund të kushtëzojë ekzekutimin dhe dorëzimin e personit të kërkuar me parashikimin e motiveve për të cilat është lëshuar Urdhri i Ndalimit. Në gjykimin tonë, një parashikim i tillë nuk është i nevojshëm për të vlerësuar pajtueshmërinë me vlerat themelore të garantuara nga legjislacioni i brendshëm.

Një problem i posacëm mund të lindë lidhur me të drejtën e ankimit kundër masës së arrestit, në mënyrë që të respektohen parimet e parashikuara nga legjislacioni ynë i brendshëm dhe mbi të gjitha neni 28, paragrafi i tretë i Kushtetutës, normë e cila rregullon si një ndër garancitë procesuale, të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjyqtarit që i garantohet personit i cili i nënshtrohet masës së kufizimit të lirisë. Mirëpo një e drejtë e tillë kushtetuese -e cila duhet të parashikohet edhe nga ligji që do të rregullojë Urdhrin e Ndalimit-, duhet të respektojë kufijtë kohorë të parashikuar për ekzekutimin e dorëzimit të personit në bazë të UEN-së, kufij të cilët parashikohen shprehimisht në Vendimin-kuadër. Në zbatim të nenit 17 këto afate do të jenë: 60 ditë dhe në raste të veçanta mund të zgjaten deri në 90 ditë; ndërsa kur për dorëzimin është marrë

pëlqimi i vetë personit që do të dorëzohet, ky afat është vetëm 10 ditë.

Në këto rrethana, për të bërë të mundur e të realizueshme që i gjithë mekanizmi i Urdhrit Evropian të Ndalimit dhe procedurat e dorëzimit të realizohen brenda këtyre afateve dhe njëkohësisht të respektohen edhe të gjitha të drejtat e garancitë personal që sistemi i brendshëm parashikon në favor të personit që i hiqet liria, është e nevojshme të parashikohet një “rrugë preferenciale” për të gjitha ankimet që bazohen në ekzekutimin e UEN-së.

Bazuar në sa argumentuam më sipër, gjejmë vendin të kujtojmë se vendimi që pranon ekzekutimin e Urdhrit të Ndalimit, mund të ankimohet vetëm në drejtim të respektimit të kushteve të parashikuara nga Vendimi-kuadër, në të cilat duhet ekzekutuar Urdhri i Ndalimit, dhe jo atyre të “ligjshmërisë” të titullit në bazë të të cilit është lëshuar Urdhri Evropian i Ndalimit.

Një verifikim i tillë delikat, nga i cili varet fati i shtetasit që do të ekstradohet, do t’i besohet procedurave të brendshme të shtetit kërkues. Mirëpo, duhet pranuar se Shtetet anëtare të BE-së gëzojnë dispozita ligjore të ngjashme, për nga përmbajtja; modalitetet dhe koha e verifikimit, ndaj nuk mund të pranohet “a priori” se garancitë kushtetuese mund të përmbushen nëpërmjet besimit reciprok ndaj legjislacioneve të Shteteve të ndryshme anëtare të BE-së, megjithëse niveli i demokracisë së të cilave, në disa raste, nuk garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.²² Në këto rrethana, ligji shqiptar mund të parashikojë edhe garanci të tjera shtesë si kusht për ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Ndalimit.

VIII. Perspektiva të reformimit të legjislacionit procedural penal shqiptar

Nëntë vjet pas krijimit të Urdhrit Evropian të Ndalimit, konstatohet se në kuadrin e bashkëpunimit penal ndërmjet Shteteve

²² *Idem.*

anëtare të BE-së, procedura e ekstradimit ka mbetur në plan të dytë. Suksesi dhe efikasiteti janë dy terma që sintetizojnë përgjithësisht bilancin aktual të Urdhrit Evropian të Ndalimit²³. Nga një analizë e bashkëpunimit gjyqësor penal e zhvilluar në bazë të këtij instrumenti juridik, evidentohen qartësisht dy ndryshime themelore që ka sjellë ky mekanizëm bashkëpunimi dhe konkretisht: thjeshtimi e përsheptimi i konsiderueshëm i procedurave dhe intensiteti i përdorimit të tyre në praktikë²⁴. Në këtë kuptim, pa dyshim, që UEN-ja përfaqëson një progres të vërtetuar, karahasuar kjo me procedurën e ekstradimit.

Mirëpo, për të shfrytëzuar të gjithë potencialin që ofron Urdhri Evropian i Ndalimit është e nevojshme të tejkalohen disa pengesa legislative të cilat ende kufizojnë zbatimin e tij në praktikë. Kështu, duhet theksuar se vështrimi optimist mbi këtë mekanizëm të ri, venitet disi nga ekzistenca e disa problemeve që u ndeshën gjatë implementimit të këtij urdhri në legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare²⁵. Në këtë kontekst, duhet theksuar gjithsesi se përqasja e së drejtës së brendshme me atë evropjane apo implementimi i së drejtës europiane në të drejtën e brendshme, është shfaqur si një proces tepër kompleks. Kështu, eliminimi i disa prej shkaqeve të refuzimit të ekstradimit; procedura e dorëzimit në vetvete; përcaktimi i autoriteteve gjyqësore kompetente; respektimi i të drejtave të personit të kërkuar, janë vetëm disa nga çështjet e diskutuara që kanë shoqëruar këtë procedure të re.

²³ Këto janë edhe konkluzionet e raportimeve të vlerësimit të Komisionit për implementimin e legjislacionit evropian në fushën e bashkëpunimit penal ndërmjet Shteteve anëtare.

²⁴ Vetëm në 5 vitet e parë, zbatimi i kësaj procedure ka çuar në lokalizimin dhe ndalimin e 1770 personave të kërkuar, ndër të cilët 1532 janë dorëzuar nga autoritetet kombëtare, gjë që përfaqëson një përmirësim në masën 25% në raport me situatën e një viti më parë. Franca, Polonia, Spanja, Britania e Madhe dhe Vendet e Ulëta, numërohen ndër shtetet që lëshojnë dhe marrin numrin më të madh të Urdhrave Evropian të Ndalimit. Gjithashtu, kohëzgjatja e procedurës ka zbritur në mënyrë të ndjeshme.

Në këto rrethana, është e kuptueshme se procedura e hartimit dhe miratimit të ligjit që do të implementojë UEN-ja në rendin tonë juridik, duhet të shoqërohet nga një analizë e specializuar në mënyrë që të përcaktohet nëse dhe në çfarë mase, ligji i përfshirjes do të jetë i pajtueshëm me parime të rendit tonë juridik, në mënyrë që të evitohen polemika e konflikte të mëtejshme kushtetuese, sikurse ka ndodhur në disa prej Shteteve anëtare²⁶. Në gjykimin tonë, praktika e Shteteve të tjera anëtare merr një rëndësi të veçantë në këtë drejtim.

Pikërisht, bazuar në përvojën e shteteve të cilat kanë kaluar ndërkohë një proces polemikash politike e juridike, por edhe konfliktesh gjyqësore në drejtim të vlefshmërisë së ligjit që ka zbatuar këtë mekanizëm në legjislacionin e tyre të brendshëm, është lehtësisht e kuptueshme se puna e hartuesve të ligjit të implementimit të UEN-së në legjislacionin tonë të brendshëm, nuk do të jetë e lehtë.

Në zbatim të parimeve të së drejtës evropiane, ***shtetet anëtare kanë detyrimin që nëpërmjet legjislacionit të tyre të brendshëm të arrijnë rezultatin që parashikohet në Vendimin-kuadër Nr. 2002/584/JAI. Për pasojë, i përket Shqipërisë të përzgjedhë instrumentin ligjor apo formën në të cilën do të kryhet ky proces.***

Këto norma juridike mund të përfshihen në kodin e procedurës penale sikurse ka ndodhur në sistemin francez të së drejtës²⁷; apo

²⁶ Ligjet e implementimit në tri Shtete anëtare janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese:

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, më 18 korrik, 2005.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Polonisë, më 2 prill, 2005.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Qipros, më 7 nëntor, 2005.
- Reaksion zinxhir: Vendimi i *Audencës spanjolle* më 20 shtator, 2005.
- Madje, vetë ligjshmëria e Vendimit-kuadër është vënë nën pikëpyetje: dërgimi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë për verifikim, nga Gjykata Kushtetuese e Belgjikës, më 13 korrik, 2005.

²⁷ Ligji nr.204, datë 9.03.2004. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, 12 mars 2004, nenet 695-11 deri 695-51 të Kodit të procedurës penale, përbëjnë kuadrin ligjor që rregullon Urdhrit Evropian të Ndalimit dhe proceduart e dorëzimit në sistemin

në një ligj të posaçëm, sikurse ka ndodhur sistemin italian²⁸.

Pavarësisht nga teknika legislative konkrete që do të përdoret, këto ndryshime do të përfaqsojnë një tërësi normash juridike nëpërmjet të cilave do të rregullohet “grosso modo”: fusha e zbatimit të Urdhrit Evropian të Ndalimit; shkaqet e refuzimit të UEN-së; gjykata kompetente që shqyrton këtë urdhër në rastet e procedurës së ekzekutimit apo ajo e lëshimit të këtij urdhri; procedura e ekzekutimit të urdhrit dhe afatet brenda të cilave realizohet ajo; procedura e transferimit të personit të kërkuar kundrejt shtetit që ka lëshuar UEN-në, autoritetet kompetente e ndonjë tjetër.

Duke qenë se Urdhri Evropian i Ndalimit përfaqson një mekanizëm të posaçëm të bashkëpunimit gjyqësor penal, i cili bazohet në njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore, rezulton se rregullimi i tij ligjor do të jetë i ndryshëm nga ai i formave të tjera të bashkëpunimit. Në këtë kontekst gjejmë me vend të theksojmë se dispozitat e kodit të procedurës penale që rregullojnë ekstradimin, edhe pse vijnë në kundërshtim me disa prej parimeve të Urdhrit të Ndalimit, do të vazhdojnë të jenë në fuqi. Këto dispozita do të zbatohen në të gjitha ekstradimet që do të kërkojnë apo do t’u kërkojnë shteteve të tjera, të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Lidhur me teknikën legislative në përgjithësi dhe veçanërisht hartimin e përmbajtjes së ligjit për zbatimin e urdhrit Evropian të Ndalimit, ligjvënësi shqiptar do të bazohet, më së pari, në dispozitat e Vendimit-kuadër, i cili përfshin elementet procedurale bazë mbi të cilat mbështetet ky instrument ligjor. Nga ana tjetër, një rëndësi e veçantë do t’u kushtohet dispozitave të Kodit të procedurës penale, i cili përfaqëson kuadrin ligjor ku parashikohen parimet të cilave i

ligjor francez.

²⁸ Ligji nr 69, datë 22 prill 2005, “disposizioni per conformare il diritto interno alla [decisione quadro 2002/584/gai](#) del consiglio, del 13 giugno 2002, relativa al mandato d'arresto europeo e alle procedure di consegna tra stati membri”

nënshtrohet procesi penal dhe, për pasojë, duhen evidentuar ato elemente të cilat do t'i nënshtrohen në vazhdimësi këtij rregullimi apo do të përfitojnë nga një rregullim i posaçëm.

LEONARD SALA

Gjirokastër

FATJON MALAJ

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

**E DREJTA PENALE DHE KANUNI I LEKË
DUKAGJINIT**

ABSTRACT

In the history of customary law, customs have been conceived as a set of unwritten norms, passed down orally from one generation to another and which have served to regulate social legal relations in socio-economic contexts, based on private property. The medieval civil codes that form the basis for Albanian customary law are: The Kanun of Skanderbeg, The Kanun of Lekë Dukagjini, The Kanun of the Mountains and The Kanun of Labëria. All the variations of the Kanun, without exception, provided a number of norms of criminal character. Among these, the Kanun of Lekë Dukagjini takes pride of place. According to it, a criminal offence was considered any action or inaction which violated important social relations, specially protected by the Kanun.

All the variations of the Kanun without exception, considered the existence of guilt in its two forms: premeditation and negligence as a prerequisite for criminal responsibility.

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, veprat penale ishin sistemuar në këtë mënyrë:

- veprat penale kundër personit;
- veprat penale kundër familjes dhe martesës;
- veprat penale kundër pronës private;
- veprat penale kundër kishës;
- vepra penale të tjera.

E drejta zakonore penale shqiptare njih dhe institutin e bashkëpunimit. Kjo duket në normat penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Kanunin e Skënderbeut dhe Kanunin e Labërisë. Në këto kanune jepen elementët thelbësorë të kuptimit të institutit të bashkëpunimit, llojet e bashkëpunëtorëve dhe rregullat e përcaktimit të përgjegjësisë së tyre. Instituti i bashkëpunimit parashikohet në kreun e njëzetë e dytë (*Vrasa*). Me bashkëpunim kuptohet kryerja me dashje e një vepre penale nga dy ose më shumë persona bashkë, me marrëveshje midis tyre. Për të pasur bashkëpunim duhet të ekzistonte dijenia dhe marrëveshja midis bashkëpunëtorëve. Kjo parashikohej në pikën 839 të Kanunit të Lekë Dukagjinit: *"Pushka e buka e dhanun me dije të vrasës, i sjellin gjakun atij që e epë"*

Nga ky parim del se në rast se dikush ka pranuar në shtëpinë e tij fajtorin, para kryerjes së vrasjes, dhe i jep bukë atij, duke e ditur se fajtori do të shkonte për të kryer një vrasje, atëherë dhe ai do të quhej bashkëpunëtor në vrasje në rolin e ndihmësit. Buka i jepej atij që vinte mik në shtëpi, dhe jo vrasësit, prandaj për rastin e fundit kanuni parashikonte përgjegjësi. Për këtë arsye ai që shkonte të vriste një njeri dhe merrte me vete dhe shokë, duhet të merrte me vete ushqim për vete dhe për të tjerët. Ky rregull vepronte edhe për atë që jepte pushkën për vrasje. Në rast se ai jepte hua pushkën për vrasje një tjetri, pa e ditur se ai do të vrasë me të një person tjetër, atëherë përgjegjësi do të mbante vetëm ai që kryen vrasjen, dhe jo ai që jep pushkën (pikat 829 dhe 830 të Kanunit të Lekë Dukagjinit). Gjithashtu në rast se dikush i jepte fishekët një tjetri,

për të vrarë, atëherë dhe ai do të mbante përgjegjësi ashtu si vrasësi: *"Kush e ep fishekun, gjakun e ban të ve'n"* (pika 826 e Kanunit të Lek Dukagjinit).

Kanuni i Lekë Dukagjinit dallonte këta lloje bashkëpunëtorësh:

- Dorëراس (ekzekutori).
- Simahuer (ndihmësi).
- Hjekësi (ndërmjetësi).

Dorëراس është ai që vret kand me dorë te vet (pika 843 i Kanunit të Lek Dukagjinit). Për dorëراسin kanuni cakton rregulla sjelljesh të detyrueshme nga pikëpamja morale, por që kishin dhe pasojë juridike. Dorëراسi sapo të vriste një njeri, duhej të njoftonte të afërmit e të vrarit, se e kishte vrarë ai viktimën (pika 844 e Kanunit të Lek Dukagjinit). Dorëراسi do të çojë me lypë besë (pika 845 e Kanunit të Lek Dukagjinit). Ai nëse mundet ta kthejë viktimën në kurriz, duhet ta bëjë këtë, nëse nuk mundet duhet ti thotë kujtdo që takon në rrugë që ta kthejë në kurriz viktimën, dhe ti vërë armën në krye (pika 846 e Kanunit të Lek Dukagjinit). Dorëراسi nuk duhet të marrë armën e viktimës, sepse do të bjerë në dy gjaqe, sepse përveç vrasjes, ai fyente viktimën duke i marrë dhe armën (pika 847 e Kanunit të Lek Dukagjinit). Dorëراسi mund të lëvizte vetëm natën, ditën ai duhet të fshihet (pika 849 e Kanunit të Lek Dukagjinit). Dorëراسi i prindit të vet, do të vritej nga fisi dhe gjithë katundi (pika 848 e Kanunit të Lek Dukagjinit). *Simahuer* është ai i cili i jep dorë dorëراسit duke e ndihmuar për të vrarë, për të vjedhur apo për të kryer ç'do mbrapshti tjetër (pika 850 e Kanunit të Lek Dukagjinit). Me këtë përkufizim jepet kuptimi i ndihmësit, si një nga llojet e bashkëpunëtorëve. *Hjekësi* është ai i cili me ndërmjetësi të mbrapshtë e për nën dhe, i jep ndihmë tjetrit për me ba ndo'i rrënim a ndo'i faqe të zezë tjetër në katund të vet (pika 766 e Kanunit të Lek Dukagjinit).

Në normat e kanunit nuk bëhen dallime midis bashkëpunimit në formën e ndihmës dhe përkrahjes pas kryerjes së krimit.

Kanuni i Lek Dukagjinit parashikonte se në rast se dikush brenda flamurit të vet, merrte shokë për të vrarë dikë, atëherë të gjithë do të mbanin përgjegjësi (të gjithë do të binin në gjak), (pika 824).Përfundim nga ky rregull bëhet vetëm kur gjakmarrësi merrte shokë brenda flamurit të tij për të vrarë hasmin, kur ky i fundit nuk ishte pjesëtar i flamurit të vrasësit. Në këtë rast përgjegjësi mbante vetëm vrasësi dhe jo bashkëpunëtorët në rolin e ndihmësit. Ai që prin e merr gjakun mbi vedi (pika 825).Në rast se dikush merr në ndihmë shokë dhe zë pusi për të vrarë dikë, duke i thënë: të gjithë pushkët që zbrazen mbi të janë të miat, dhe e kryen vrasjen (pika 827) atëherë përgjegjësia do të përcaktohet në këtë mënyrë:

- Në rast se vrasësi vret dikë pa të drejtë, atëherë dhe vrasësi dhe ndihmësit do të mbajnë përgjegjësi (pika 832)

- Në rast se vrasësi vret dikë për të marrë gjakun, atëherë gjakmarrja e marrë në këtë mënyrë shlyhet, dhe ndihmësit nuk mbajnë përgjegjësi (pika 833).

Bashkëpunëtorët në rolin e ndihmësive përgjigjen njëloj si ekzekutorët, ndërsa si rregull shtytësit ose nxitësit në krim nuk përgjigjen si bashkëpunëtorë, por i paguajnë një gjobë bajrakut të tyre ose u digjej shtëpia.Kjo sepse nxitja me fjalë nuk konsiderohej dhënie ndihme dhe nuk barazohej me dhënien e bukës ose të pushkës tjetrit për vrasje, sepse zbatohej rregulli që “ *goja s’qet kënd për gjak*”. Në të drejtën penale zakone të mëvonshme vërehet prirja për të individualizuar përgjegjësinë e bashkëpunëtorëve, por megjithatë ajo qëndron larg kërkesave të së drejtës penale bashkëkohore për institutin e bashkëpunimit.

Lidhur me fazat e zhvillimit të krimit, Kanunet flisnin për përgatitjen, por për këtë fazë nuk parashikohej përgjegjësi penale. Si fazë e parë e krimit pranohej tentativa dhe pastaj krimi i kryer (i konsumuar). Tentativa dallohej në disa lloje: kur një person qëllonte me pushkë një tjetër dhe plumbi i shkonte pranë, ai detyrohej të shpërblente gjysmën e gjakut. Kur një person qëllonte

kudërshtarin, por pushka nuk i shkrepse, sepse fisheku nuk ishte i përshtatshëm, fajtori përgjigjej njëloj si për krim të kryer. Kush qëllonte mbi një kufomë përgjigjej për dy gjaqe: për tentativë vrasje dhe për fyerje të të vdekurit. Në Jug të Shqipërisë është ruajtur vetëm një kanun, ai i Labërisë, i cili ka vepruar në krahinën e Labërisë, e cila ka qënë më e gjerë nga sa është sot si nocion gjeografik. E drejta zakonore shqiptare kishte për bazë disa parime themelore të saj, si barazia e njerëzve nga gjaku, nderi vetjak, mikpritja dhe besa. Të gjitha normat e tjera me karakter penal, familjar, civil, statutor etj përbënin pjesën tjetër të së drejtës zakonore. Ato nuk mund të vinin në kundërshtim me parimet themelore të kësaj të drejte, por kishin një zhvillim harmonik midis tyre, sipas fushave përkatëse.

Përsa i përket dënimeve, në të drejtën zakonore shqiptare gjenden gjurmët e rendit primitiv që pasqyrohen tek masat shtrënguese të tilla si gjakmarrja, si dhe vihet re kategorizimi i dënimeve. Dënimi ishte atribut i të dëmtuarit.

Ndërsa llojet e dënimeve sipas po këtij Kanuni ishin:

- gjakmarrja;
- dënimi me vdekje;
- dëbimi;
- djegja e shtëpisë;
- rrënimi i pasurisë;
- të prerit e pemëve dhe të lënit e tokës djerë ;
- gjoba;
- leçitja (bojkotimi).

Me vrasje sipas të drejtës zakonore kuptohet ajo vepër që ia privonte jetën personit tjetër, e kryer me faj dhe e parashikuar nga normat penale të së drejtës zakonore të mbledhura në kanune. Në këto vende pasi nuk kishte shtet të organizuar, nuk ka dyshim që roli i normave të saj (të drejtës zakonore) në mbrojtje të personit ishte pozitiv, sepse ia priste rrugën arbitraritetit, dhunës, vrasjeve pa

kufi etj. Ato norma marrin nën mbrojtje jetën e personit që nga lindja e tij. Sipas të drejtës zakonore penale, vrasja mund të kryhej me veprime aktive dhe me mosveprime (me porosi, direkt dhe indirekt). Materialet e grumbulluara në kanune dëshmojnë se shumica e madhe e vrasjeve kryhej me veprime aktive, duke përdorur mjete të ndryshme, sidomos pushkën. Vrasja për t'u quajtur krim për t'u dënuar, duhet të parashikohet nga e drejta zakonore penale si vepër që binte në kundërshtim me normat e saj.

Veçoria e së drejtës zakonore penale është se ajo njeh edhe vrasje të padënueshme si p.sh. vrasja e fëmijës nga babai, vrasja e gruas në marrëdhënie seksuale bashkë me personin me të cilin kryente aktin seksual, vrasja ndërmjet njëri-tjetrit – krye për krye, gjak për gjak etj. Për krimin e vrasjes mund të përgjigjej cildo burrë që ishte i aftë për të mbajtur armë (rreth moshës 14-15 vjet). Gruaja në çdo rast nuk kishte përgjegjësi penale, sepse ajo nuk mbante armë, për vrasjen që ajo mund ta kryente përgjigjej prindi i saj, sipas parimit: *“Gruaja s’bien në gjak”* sepse botëkuptimi fisnor patriarkal gruan e konsideron si e huaj në familje. Vrasja kryhej me dashje (me qëllim) dhe nga pakujdesia, kështu edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit dallohen këto forma të fajit: Paramendimi dhe Pakujdesia.

E drejta zakonore njihnte llojet e vrasjeve:

1) *Vrasjet që drejtohen kundër jetës së një personi*, pavarësisht se cili është motivi i kësaj vrasje.

2) *Vrasjet që drejtohen kundër jetës së disa personave*. Ky lloj më shumë ka ndodhur nëpër dasma, p.sh. kur takoheshin dy grupe krushqish në rrugë (dhe rrugët ishin të ngushta sa për një karrocë), ata nuk ia lëshonin rrugën njëri-tjetrit dhe kjo ndodhte sepse kjo konsiderohej nënçmim dhe dobësi për palën që lëshonte rrugë dhe fillonin të gjuanin me pushkë dhe ndodhnin vrasjet e disa personave (krushqve).

3) *Vrasja për kufij, toka, dhe kullosa.* Këtu vrasjet bëheshin për shkak të luajtjes së gurit i cili ka qenë dhe është për ndarjen e pronave, tokave dhe kullosave. Vrasja e këtillë sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dënohej me vdekje, grihej katundisht (pushkatohej nga i gjithë katundi ose prehej me shpatë apo sëpatë etj.) dhe paguhej gjoba me 100 desh dhe 1 ka. (pika 251 e Kanunit të Lekë Dukagjinit).

4) *Vrasjet për grabitje ose rrëmbim grash.* Ky fenomen ka qenë i njohur në të kaluarën te shqiptarët ku ndodhte që të grabitet vajza ndoshta edhe pa dëshirën e saj dhe të merret në shtëpi për grua. Pastaj familja e vajzës e nënçmuar me këtë, detyrohej ta merrte vajzën e tyre dhe këtu fillonte problemi dhe shpesh përfundonte me vrasje.

5) *Vrasja e personave të mbrojtur ose në besë.* Vrasja që drejtohej kundër një personi që ishte nën besën e një familje, fisi ose katundi, me këtë prekeshin marrëdhëniet shoqërore. Me këtë lloj të besës, siguroheshin netët e personit të caktuar të mbrojtur posaçërisht nga normat penale të kanunit.

6) *Vrasja për gjakmarrje.* Gjakmarrja si rregull kryhej botërisht dhe haptazi, kështu që dihej dorasi dhe sipas kanunit, pika 844, dorasi duhet t'i çojë fjalë se ai e vrau dhe të mos habiten prindërit e të vrarit. Por ato kryheshin edhe fshehurazi, edhe pse ky konsiderohet veprim i turpshëm. Me rastin e kryerjes së vrasjes ose gjakmarrjes, dorasit i ndalohej ta masakrojnë viktimën, sepse kjo dënohej me të drejtën zakonore dhe vrasësi konsiderohej dy herë fajtor dhe ngarkohej me dy gjaqe. Pastaj, dorasi sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit nuk guxon t'ia marrë armën të vrarit, sepse ai me këtë vepër vjen në dy gjyqe. (pika 847).

Ajo që vlen të theksohet është se sipas të drejtës zakonore shqiptare për ligjet fenomeni i vrasjes për gjakmarrje. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe kanuneve të tjera shqiptare gjakmarrja drejtohej në rradhë të parë kundër atij që kishte kryer vrasjen, sipas

rregullit “gjaku shkon për gisht”. Sipas së drejtës zakonore gruaja, fëmijët, pleqtë që nuk mbanin armë, personat me të meta fizike ose psikike nuk mund të vriteshin. Gjakmarrja mund të kryhej kudo, por kishte edhe përjashtime:

- Nuk mund të kryhej në shtëpinë e vet ose të një tjetri.
- Nuk mund të kryhej në kuvende, në kishë apo në xhami.
- Gjakmarrja pezullohej në kohe lufte kundër armikut të jashtëm.

Ka edhe shumë lloje të vrasjeve, vrasja për marrëdhënie të dhunshme seksuale dhe vrasja e gruas në punë të liga me gjithë partnerin, vrasjet në gjendje të dehur nga alkooli, vrasjet në gjendje të papërgjegjshme, vrasjet e provokuara nga agresioni.

Përsa i përket Kanunit të Labërisë Ali Pashë Tepelena (1740-1822) në pashallëkun e tij, krahas sheriatit për popullsinë myslimane dhe kanuneve kishtare për banorët e krishterë, zbatoi bujurditë (urdhëresat) e tij. Në raste të veçanta lejoi të zbatohesh edhe e drejta zakonore vendase. Por, sipas gojëdhënës popullore Ali Pasha e vrau Idriz Sullin, sepse kërkonte të kufizonte veprimin e kanunit. Pavarësisht nga motivet, vrasja e këtij burri zakoni të shquar ishte një krim i rëndë. Pasi nënshtroi me forcë të armëve dhe futi në pashallëkun e tij edhe Sulin e Himarën (1798), Ali Pasha u përpoq të bënte organizimin gjyqësor në çdo qytet e krahinë dhe të zbatonte ligjet njëloj si për myslimanët dhe të krishterët, sipas parimit të barazisë para ligjit. Me këto masa synonte të bënte një hap përpara sipas modelit të shteteve perëndimore. Gjithashtu ai kufizoi vrasjet për gjakmarrje dhe gjakmarrjen e zëvendësoi me dënime të tjera, si me pagimin e dietës (shpërblimin e gjakut) ose me dëbimin e deri me dënimin me vdekje, siç veprohej në shtetet e tjerë për vrasjet me dashje.

Për kufizimin e gjakmarrjes e të pasojave të saj (ngujimet) në Labëri kanë luajtur rol të madh Kuvendet e burrave që nga shek.XVIII e në vazhdimësi. Ky fakt është një argument tjetër i

fuqishëm në mbështetje të pikëpamjes që mbronte At Gjergj Fishta në parathënien e Kanunit të Lekë Dukagjinit kundër autorëve që shpreheshin se gjakmarrja përcaktonte “barabarësinë e egërsinë e kombit shqiptar...”.

Mbas Kanunit – thotë Fishta, qi asht të shprehunit e shpirtit të Kombit shqiptar, vrasa asht e ndëshkueme me dekë (vdekje). (Parathënia e Kanunit të Lekë Dukagjinit, f. 22). Procesi i kufizimit gradual deri në zhdukje i gjakmarrjes në Labëri, është dëshmi e gjallë edhe kundër pikëpamjeve të një sërë studiuesve të huaj, që e shpjegojnë gjakmarrjen nga pozita biologjike dhe ia atribuojnë racës shqiptare, ndonëse dihet botërisht që ajo ka qenë fenomen historik – shoqëror ndërkombëtar, që ka lindur në bashkësinë primitive, si rrjedhojë e jetesës së përbashkët, e solidaritetit ndërmjet njerëzve, që përcaktonte vetëmbrojtjen në kushtet e mungesës së shtetit.

Megjithatë, si në zonat e tjera malore, edhe në Labëri, në një shoqëri ku nuk kishte autoritet shtetëror, hakmarrja në kuptimin e gjerë të fjalës, vepronte për rivendosjen e drejtësisë, si shpagim për rrahjen, fyerjen, shpifjen ose nga çdo veprim tjetër i padrejtë në dëm të palës së dëmtuar. Në këtë kuptim edhe gjakmarrja ishte veprimi për marrjen e gjakut të babait, djalit, vëllait, xhaxhait, nipit nga babai të vvarë më parë. Derisa nuk kishte autoritet shtetëror për mbrojtjen e jetës, gjakmarrja funksiononte si mjet i vetëmbrojtjes. Krejt ndryshe është gjakmarrja në kushtet e funksionimit të shtetit. Ajo nga mjet i vetëmbrojtjes kthehet në vetëgjyqësi dhe është e dënueshme nga ligjet e shtetit. E drejta zakonore përveç trajtimit të krimeve kundër shëndetit apo personit, një vend të rëndësishëm ia lë dhe krimeve në marrëdhëniet martesore. Kanunet njihnin si krim martesën brenda fisit dhe martesën me grabitje.

Kanuni i Lekë Dukagjinit parashikonte këto dënime për burrin që martohej pa vënë kurorë:

- Shtëpia i digjej dhe toka i mbetej djerrë.

- Dëbohej e nuk mund të kthehej në vendin e tij derisa të largonte gruan.

Krim tjetër ishte shkelja e besnikërisë bashkëshortore nga gruaja, e cila si pasojë dënohej me vdekje, por më vonë ky zakon u zbut e u zëvendësua me poshtërimin e saj publik. Kanuni i Lek Dukagjinit njihte si mjetet racionale, ashtu dhe ato iracionale të provës. Procedura penale zhvillohej nga “*pleqnia*” dhe ishte e tipit akuzues. Natyrisht, mjetet e kërkimit të provës, që përdorshin sipas Kanunit të Lek Dukagjinit, janë shumë larg kuptimit dhe përmbajtjes, që ka “përgjimi” sot. Por, nga tërësia e mjeteve të kërkimit të provës që përfshihen në Kanun (si kod juridik i shkruar në historinë e jurisprudencës sonë kombetare), ai që i përafrohet më shumë në përmbajtje e procedurë “përgjimit” të sotëm, - nëse mund të shprehemi në kuptim të një krahasimi, - është ai mjet i kërkimit të provës që në Kanun është quajtur **KAPUCARI**. Kapucari parashikohet në Kanunin e Lekë Dukagjinit - varianti i Mirditës - në Kreu XI, neni 311 e në vazhdim. Kapucari pajtohej nga paditësi dhe dilte përpara pritarëve (pleq beje) me cilësinë e dëshmitarit. Detyra e kapucarit ishte të kryente hetime mbi çështjen, për të cilën e pajtonin, dhe të argumentonte se personi të cilin e ndiqte, e vëzhgonte të ishte me të vërtetë kryersi i veprës penale. (hajnisë, djegies së pasurisë, helmimit të bagtisë, vrasjes etj). Për të vërtetuar plotësisht thëniet e tij, kapucari, i shoqëronte me be.

Neni 312 që titullohet “Mshëhtësia e Kapucarit” shprehet:

“Kapucari ka tager me kërkue kushtet e veta për çka kallzon. Kushti i parë ashtë me e mbajt të mfshehtë emnin e tij. Kushti i dytë me i dhanë “këpucët”. Me pranue kapucari me dale haptas, asht punë tjetër. Detyrë nuk i bahet”. Në këtë nen del qartë se, si regull, emri i kapucarit mbahej i fshehtë pra, ai për të mbledhur provat, me të cilat do të vërtetonte fajësinë e të dyshuarit, vepronte fshehtas. Ndërsa paragrafi i fundit është përjashtim nga rregulli i mësipërm: kapucari mund të vepronte haptas.

Përfundime:

Shprehja shqiptare, për të drejtën zakonore shqiptare, është Kanuni, burimet e të cilës janë: Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Malësisë së Madhe, Kanuni i Labërisë, Kanuni i Lekë Dukagjinit .

Sipas kësaj të drejte zakonore, vetë personi ishte i aftë për të mbajtur drejtësi, ku dhe bëhej dallimi mes vetë personit dhe pjesëve shtesë. Për arsye të këtij dallimi, e drejta zakonore shqiptare mbronte të mirat e trupit dhe të shpirtit, ndërsa në pjesën shtesë të një personi hynin veprimet dhe raportet.

E drejta zakonore, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, është e ndarë në 1263 nene dhe në 12 libra. Kanuni rregullonte si çështjet civile ashtu edhe ato penale. Ky kod për shumë shekuj me radhë ishte në të njëjtën kohë edhe kushtetuta e shqiptarëve. Kanuni i Lekë Dukagjinit përmban rregulla statutore, familjare juridike, civilo-juridike, penalo-juridike si dhe rregulla konkrete mbi procedurën penale dhe civile.

Gjithashtu Kanuni i Lekë Dukagjinit njih këto sanksione penale: dënimin me vdekje, gjakmarrjen, dëbimin nga bashkësia, bojkotin etj, të cilat shqiptoheshin ndaj autorit që kishte kryer veprën penale e në raste të caktuara edhe ndaj familjes së tij. E drejta penale në kanun ishte një përzierje mes të drejtës penale publike dhe vetëgjyqësisë.

E drejta zakonore shqiptare njihete si gjyq kanunin e pleqve. Pleqtë, ishin të parët e vëllazërive ose krerët efiseve. Pa pjesëmarrjen e tyre, çdo vendim apo veprim ishte i pavlefshëm. Kanuni i pleqve ishte i përbërë nga njerëz të zakonshëm, pa dallim të gjendjes së tyre sociale, prejardhjes së tyre apo dallimeve tjera. Ata bëheshin gjykatës të popullit vetëm nga aftësia e tyre që kishin për t'i kuptuar shpejt rrethanat dhe si gjykatës për t'i interpretuar ato me arsye dhe për të vendosur sipas rregullave të Kanunit.

E drejta zakonore shqiptare njihete dy lloje kanune pleqsh. Për

pleqni të vogla merreshin më të vjetrit në fshat, të cilët merrnin vendime për mosmarrëveshje të vogla. Çështjet serioze, të cilat cënonin nderin e gjithë fshatit dhe fisit, gjykoreshin prej “*Pleqve të katundit e prej krenve të Flamurit*”.

Edhe pleqtë, të cilët vepronin si gjykatës, kishin sipas Kanunit të drejtat dhe detyrimet e tyre. Pleqtë kishin të drejtë të mënjanonin çdo mosmarrëveshje dhe kërcënim dëmsh e kërcënim për vrasje, “*ku me urti, ku me fuqi*” bashkë me gjithë fshatin. Ndërsa, për kërcënime serioze mund të lypnin “*krahin e Krenve të djemve të Flamurit, për me pru në mend të dalunin mendësh*”. Për më tepër, nëse dikush nuk donte të respektonte vendimin e paanshëm, pleqtë mund të thirrnin takim me gjithë fshatin.

Në të drejtën zakonore shqiptare vlente parimi: “*Gjygj mbi gjygj e Plak mbi Plak kanuja nuk ba* ” Bazuar në këtë rregull, mund të vijmë në përfundimin, se Kanuni njihte vetëm një instancë gjyqësore. Një ankesë kundër vendimeve të pleqve mund të bëhej vetëm në raste të veçanta, dhe konkretisht ajo (ankesa), nuk mund të bëhej nga palët. Një ankesë të tillë kishin të drejtë ta bënin vetëm ata që iu ishte besuar pengu (d.m.th që vetë pleqtë kishin vendosur).

Nëse më vonë konstatonin se kishin gjykuar jodrejtë, Pleqtë nuk e kthenin pengun, por ishin të detyruar, siç thuhej në Kanun, “*me e dliirë vedin*”. Nëse një gjykim i pleqve nuk e kënaqte popullin, ose ndodhte që ata vendosnin gabim, populli kishte të drejtë të mos e ndiqte vendimin e tyre. Në një rast të tillë, krerët dhe më të vjetrit, detyroheshin ta trajtonin përsëri çështjen.

E drejta zakonore shqiptare, sipas procedimeve në Kanun, njihte dëshmitë (provat) vijuese: pohimi i të pandehurit, fjala e nderit, kapucari, personi që tregonte veprën e dikujt, p.sh. për një vjedhje apo vrasje të fshehtë, betimi (beja), porota ose betarë, dëshmitarët, ekspertët, ndjekja e gjurmëve, garantët(dorëzanët) dhe flagranca. Llojet e ndëshkimeve në të drejtën zakonore shqiptare ishin: dënimi me vdekje, largimi nga fisi, djegia dhe shkatërrimi i

shtëpisë, prishja e tokës, prerja e pemëve, dënimi me bagëtitë e gjalla, dënimi me para,dhe lëçitja, djegia gjallë e një gruaje, një të veje apo vajze.

Bibliografia:

- *Luarasi, A.* Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Tiranë 2007
- *Ahmeti, M.* Statutet e Drishtit, Tiranë 2010
- Akte të Rilindjes Kombëtare 1878-1912, Tiranë 1978
- AQSH. Dokument Nr. 5 Fondi: Korrespondenca e Pashait, dosja 3, kutia 2, dokument 20014 (pa datë)
- AQSH. Fondi n.102, dosja 19, f.1- 6, botuar në Tribuna Juridike N.10, 1996
- *Bardhoshi, N.* E Drejta Kanunore dhe Shteti i së Drejtës, revista Polis
- *Barleti, M.* Historia e Skënderbeut, Tiranë 1967
- *Elezi, I.* “Njohuri për të drejtën zakonore mbarëshqiptare”, Prishtinë 2003
- *Elezi, I.* E drejta penale në shtetin e Skënderbeut, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri
- *Elezi, I.* E drejta zakonore e Labërisë, Tiranë 2002
- *Elezi, I.* E drejta zakonore penale e shqiptarëve, Tiranë 1983
- *Elezi, I. Elezi, E.* Zhvillimi historik i mendimit teoriko – juridik, Tiranë 2010
- *Elezi, I.* Kanuni i Labërisë, Toena, Tiranë 2006.
- *Elezi, I.* Normat e së drejtës zakonore penale të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Tiranë 1965
- *Elezi, I.* Normat penale në Statutet e Shkodrës, suplement, Revista “Ligji dhe Jeta” dhjetor 2003

- *Frashëri, S.* Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet?, Tiranë 1982
- *Gjeçovi, Sh.* Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër 1933
- Grup autorësh, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Luarasi, Tiranë 2001
- Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, botim 1994
- *Ilia, F.* Kanuni i Skandërbegut, Milot 2003
- *Ilia, F.* Kanuni i Skënderbeut, Milot 1993
- *Lloshi, XH.* Përvijimi i gjuhës së shtetit shqiptar, botuar në gazetën “Telegraf” datë 9 korrik 2012
- *Luarasi, A.* Shteti dhe e drejta shqiptare në epokën e Skënderbeut, Luarasi, Tiranë 1998
- *Mandro-Balili, A.* Pashallëqet feudale shqiptare në këndvështrimin e shtetit dhe të së drejtës, Tiranë 2008.
- *Meksi, V.* Autonomia lokale e krahinave shqiptare gjatë pushtimit osman, 1965, Drejtësia Popullore N.6
- *Gjeçovi, Sh.* “Kanuni. Shkoder 1993
- *Ulqini, H.* Statutet e Durrësit, “Të drejtat e Njeriut”, N.50/2000
- *Ulqini, K.* Bajraku si formë organizimi shoqëror (pjesa e dytë e shek.XIX – 1912), Tiranë 1985
- *Meçi Xh ,* “Kanuni i Leke Dukagjinit - varianti i Mirdites”
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, Përmbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Prishtinë 1972.